



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 27, 28 DHE 31 MAJ 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
27. 28 I 31 MAJA 2010. GODINE

MAJ – MAJA
2010

E enjte, 27 maj 2010, ora 10:00

Drejtën seancën: anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar,
Zotëri zëvendëskryeministra, ministra, kolegë të nderuar të Kuvendit,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj në sallë janë të pranishëm 73 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në ndërkohë, në pajtim me nenin 49 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar si çështje urgjente ratifikimin e marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër.

Ftoj kryetarin e Komisionit, zotin Gani Koci, të praqesë arsyetimin.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të nderuar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur kërkesën nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për shqyrtimin e marrëveshjes me Shoqatën në fjalë IDA, shoqatë financiare rreth miratimit të një kredie, është kërkesë e Bankës Botërore, do të thotë, është asociacion financiar i Bankës Botërore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka pasur në një mbledhje të vet para datës që është bërë rekomandimi, por në mungesë të komplet dokumentacionit, ne nuk e kemi pas shqyrtuar dhe kemi kërkuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave që të na kompletojë marrëveshjen në fjalë dhe ne e kemi marrë atë dhe e kemi shtruar edhe ne si komision, si çështje urgjente në mbledhjen e djeshme dhe kemi rekomanduar që Kuvendi ta miratojë këtë marrëveshje në mënyrë që sipas Ligjit mbi borxhet publike, çështjet financiare edhe marrëveshjet financiare me institucionet financiare ndërkombëtare të miratohen në Kuvend. Fjala është për një marrëveshje për kredi, për financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare IDA. Ne kemi analizuar këtë marrëveshje dhe kjo marrëveshje ndahet në dy pjesë, ka dy pjesë të veta të veçanta. Në pjesën e parë ose Marrëveshja e parë, Shoqata Ndërkombëtare IDA do t'i japë Kosovës një kontribut financiar dhe një kredi që nuk e kalon totalin e 5.200.000 euro, prej të cilave 2.300.000 do të jenë në formë të grantit financiar dhe 2.900.000 të tjera në formë të kredisë. Ky është neni 2 i marrëveshjes, në qoftë se e kemi pasur. Qëllimet e kësaj pjesë të parë të kredisë kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike dhe performancën e prokurimit. Ju e dini që ka edhe një kërkesë nga Komisioni Evropian për ndryshimin e ambientit të prokurimit në Kosovë dhe ata janë kah punojnë edhe në përgatitjen e Ligjit të ri të prokurimit publik dhe sigurisht një pjesë e saj do të shkojë në përgatitjen e një ambienti më të mirë, edhe të një kuadri ligjorë, edhe të një performancë më të mirë të prokurimit publik.

Pjesa e dytë nga pjesë e parë e kredisë është administrimi i listave të pagave dhe themelet e një shërbimi civil profesional. Ju e dini që ne kemi miratuar kohëve të fundit edhe Ligjin për

shërbyesit civilë, edhe Ligjin për pagat civile dhe, natyrisht, edhe aty kërkojnë të bëhet një performancë më e mirë dhe investimet do të shkojnë në këtë drejtim.

Pjesa e tretë ka të bëjë me sigurinë dhe efikasitetin e sistemeve qeveritare të informacionit, ka të bëjë me teknologjinë informative që, megjithatë, si sistem të mund të funksionohet komplet, institucionet tona, natyrisht, do të kemi edhe një sistem informativ të perfeksionuar.

Në nenin 3 të kësaj marrëveshje thotë se afati i distribuimit të kësaj vlere është 30 qershori...

KRYESUESI: Zotëri Koci, ju e propozuat, debati kur të hyjë, nuk ka debat tash, e propozuat.

GANI KOCI: Për atë po e shpjegoj pasi që s'ka debat.

KRYESUESI: Jo, jo, kur të hyjë në rend të dite bëhet debati.

GANI KOCI: Unë po e jap arsyeshmërinë që të futet në rend të ditës dhe pastaj kur të futet në rend të ditës, ka veç një votim formal. Ju e dini se votimi sipas Ligjit për huat publike është me dy të tretat e Kuvendit dhe debat nuk ka sepse ne nuk mund t'i ndryshojmë pjesët e kësaj marrëveshje. Ne ose duhet ta pranojmë si të tillë, ose duhet ta refuzojmë si të tillë. Prandaj, po i jap këto shpjegime zoti kryesues.

Meqë doni ta shkurtoni, atëherë pjesa e dytë e kësaj kredie ka të bëjë me administrimin e tokave komunale, me kuadrin institucional të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe, natyrisht, edhe me menaxhimin e projektit. Ka një kosto tejet të ulët ose një shkallë të ulët të interesit, që nuk mbërrin kjo pjesa që është në formë të kredisë, që nuk mbërrin as 1%, është diku 0.80% të kësaj. Prandaj, në qoftë se janë krijuar kushtet, zoti kryesues, që kjo pikë të futet në rend të ditës, të futet për votim në rend të ditës pa debat. Ministri eventualisht mund të shpjegojë për natyrën e kësaj kredie.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Koci!

Kërkoj deklarinimin e grupeve parlamentare për këtë propozim të pikës së re për të hyrë në rend dite. Për Grupin e PDK-së, kush flet? Do të thotë, është Gani Koci. Për LDK-në, Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah të vihet në rend dite dhe të aprovohet kjo çka propozoi Komisioni për Buxhet.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Është i pashmangshëm reagimi ynë që të mos na bien propozimet të cilat, vërtet, pa materialin e lexuar tash të votojmë diçka që, në fakt, nuk e kemi pasur më herët në dorë. Prandaj, është e pakuptueshme të aprovojme në rend të dite një pikë, e cila, si dokumentacion nuk na është sjellë më herët që ta kemi në dorë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Për Aleancën Kosova e Re, shefi i grupit Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Nuk është hera e parë që përkundër urgjencës që kanë këto materiale, ne vihemi para një akti të kryer. Ne nuk kemi material për ditur për çka po votojmë “për” ose “kundër”. Prandaj, si Grup Parlamentar ne abstenojmë nga ky votim, sepse nuk kemi material dhe nuk dimë për çka të votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli!

Për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, kush e jep deklaratën? Zonja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj që së paku edhe mënyra që e shtruat para një pike tjetër, që është sot si çështje urgjente, është krejtësisht e papranueshme për arsye se shumë më urgjente kemi gjëra të tjera në Kosovë se sa këtë, pikë krejtësisht e pa përgatitur për Kuvendin e Kosovës. Dhe, realisht, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e ka të qartë ose do ta bëjë me dije për qytetarët e Kosovës se Qeveria e Kosovës nuk ka mund të tregojë performancë pozitive që të nënshkruaj Marrëveshjen me FMN-në dhe t’i lejohen donacionet nga Konferenca e donacioneve, që është 1.6 miliardë të investohen për projekte të tilla të cilat nuk janë investime kapitale, por janë investime në trajnime, në çështje të ndryshme që, natyrisht, në kuadër të tyre janë edhe donacionet, kredi, më falni, kredi, të marrim kredi duke mos investuar investime kapitale, kjo është, natyrisht, e papranueshme. E kam shumë të qartë që Kuvendi nuk është i përgatitur për këtë pikë të rendit të ditës dhe natyrisht që Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk do ta mbështesë.

KRYESUESI: Unë nuk përzihem në deklaratimet e grupeve, veç ju sjell në vëmendje që kjo është shtruar në rend të dite në bazë të rekomandimit të Komisionit për Buxhet, komisionit funksional ku, sa di unë, jeni edhe anëtare edhe ju. Një moment, më vonë është. Le të deklarohen grupet, mandej vinë sqarimet, të lutem shumë!

Për Grupin Parlamentar “7+”, Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „7+“, će podržati predlog Komisije, jer kao ozbiljna grupa, mi smo ozbiljno shvatili ovaj problem i mislim da treba da prođe.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi SLS, Petar Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: I naša Poslanička grupa podržava predlog komisije.

KRYESUESI: Faleminderit!

Për Grupin Parlamentar për Integrim, kush e do fjalën? Branislav Grbiq e merr fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Pa dobro, pošto smo potpisali koalicioni sporazum sa LDK, mi moramo da glasamo „za“, jer želimo da budemo ozbiljna grupa i da nas prepozna i premijer. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit!

Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha vetëm një sqarim lidhur me punën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ku të gjithë anëtarët e Komisionit që kanë qenë prezentë, unanimisht e kanë përkrahur këtë propozim dhe e kanë përkrahur që marrëveshja të shtrohet në mënyrë urgjente në Kuvend. Në këtë kuadër ka qenë edhe zonja Besa Gaxherri, kolegia ime shumë e nderuar dhe e di shumë mirë se ne kemi pasur një

mbledhje para mbledhjes së djeshme që e kemi shtruar këtë si çështje, po kemi kërkuar një informacion shtesë, jo që se kemi pasur informacionin, po kemi kërkuar informacion shtesë dhe informacioni shtesë na ka ardhur dhe bashkë me zëvendësministrin, i cili në detale i ka shpjeguar Komisionit për Buxhet dhe Financa, bile zonja Besa Gaxherri ka kërkuar disa sqarime dhe i ka marrë sqarimet prej ministrit dhe ka votuar që kjo çështje të futet sot urgjentisht si pikë e parë e rendit të ditës. Dua të them edhe një fakt, në qoftë se nuk miratohet kjo marrëveshje sot, afati i nënshkrimit të marrëveshjes është 8 qershori dhe ne nuk dimë në aspektin procedural a do të mund ta zëmë, sepse ka një afat të botimit në “Gazetën zyrtare”, por edhe aty duhet ta përshpejtojmë, atëherë ne si Kosovë do të mbesim pa 13 milionë euro, që i përbëjnë dy pjesë, edhe në formën e një kredie me një interes shumë të lehtë dhe një afat shumë të gjatë, edhe pjesën e donacionit. Ne nuk mundemi, ashtu siç ka shpjeguar dhe edhe zëvendësministri për çështje të financave, që Banka Botërore kërkon një herë përgatitjen e kuadrit dhe të tregohet një performancë e mirë e administratës dhe e menaxhimit, në mënyrë që ti t’i thithësh ato donacione që i ke pasur dhe që t’u kanë akorduar. Prandaj, në qoftë se sot ju nuk e miratoni këtë, atëherë ju po e leni pa e realizuar një pjesë të donacioneve dhe një vlerë prej 13 milionë euro, që është më se e nevojshme për Kosovën. Kjo vlerë është fillestare dhe pas saj pastaj të tjerët do të mendojnë se a do të bëjnë përpjekje që të alokojnë mjetet e deklaruara si donacione për Kosovën. Prandaj, mos të dalim para televizionit dhe para opinionit dhe në një vend themi ndryshe dhe të diskutojmë ndryshe dhe në një vend, kur jemi para televizionit, të deklarojmë krejt ndryshe. Është çështje e juaja, e votës së juaj, a i doni apo nuk i doni këto.

KRYESUESI: Replikë, 2 minuta, Besa!

BESA GAXHERRI: Koleg i nderuar, deputet i nderuar, Nuk e di a i kupton ti procedurat. Ne dhe në Komision të Buxhetit dhe në bazë të Rregullores së Kuvendit e të ligjeve që i kemi, ne si komision mund të marrim vendim vetëm për ta prurë në Kuvend dhe Kuvendi mund ta votojë ose ta fut në rend të ditës ose jo. Unë kam abstenuar, koleg i nderuar dhe, ndërsa sot po e mbaj qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë dhe është absurdi i llojit të vetë të merret kredi për ngritje, performancë dhe për trajnime të ndryshme, ju lutem shumë. Por, ju e keni shumicën, punoni, organizoni, votoni. Ky ishte mendimi im dhe, që gjithmonë çështjet shumë të rëndësishme, ju, kjo qeveri i bien urgjent, nuk ka me çka t’i mbështesë. Sot e ke edhe ministrin këtu, le të dalë ai të na jep sqarime se vërtet a duhet Kosova të hyjë në kredi për të trajnuar stafin ose për me trajnuar njerëz, të ngritë trajnime, të ngritë performancë të menaxhimit të buxhetit. A duhet të marrim kredi ne për këtë gjë? Ju lutem, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, jo, s’ka nevojë kundër replikë. E nxjerr në votim propozimin që kjo pikë e rendit të ditës të hyjë për këtë seancë.

Ju lutem, kush është “për”, votojmë tash:

Faleminderit! Kush është “kundër”? Numëroni dhe m’i jepni votat.

Në sallë kemi të pranishëm 84 deputetë. Shumica votojnë “për”, 18 “kundër”, pika hynë në rend dite të seancës. Shkojmë tutje.

Në pajtim me nenin 49 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i LDD-së ka kërkuar për radhitje në rend të dite, si çështje urgjente, për shqyrtim: - Cenimi i integritetit dhe i sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, që brenda 3 minutash ta praqet këtë propozim.

LULZIM ZENELI: Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryesues, Qeveri,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka proceduar me datën 25 maj të këtij muaji dhe sot para jush përsërit kërkesën që në rend të ditës të vendoset si çështje urgjente për shqyrtim: – Cenimi i integritetit dhe i sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

Shqyrtimi me urgjencë vjen nga shkaku se në këtë të diele Republika e Serbisë në disa komuna në territorin e Republikës së Kosovës, duke i konsideruar si pjesë të territorit të saj, organizon zgjedhje lokale.

Të nderuar deputetë,

Duke parë se zhvillimet në vend, që kanë të bëjnë me Kushtetutën, ligjshmërinë dhe ushtrimin e sovranitetit, në 30% të territorit të Republikës nuk njohin trende pozitive, por përkundrazi, kanë vetëm përkeqësim. 3 muaj më parë Kuvendit të Republikës i është propozuar një rezolutë për miratim nga Grupi Parlamentar i LDD-së, e cila pikërisht bënte fjalë për kushtetutshmërinë dhe zhbërjen e pushtetit serb në Kosovë. Dhe sot, nga ajo ditë, kur ky Kuvend ka diskutuar për herë të fundit, zhvillimet kanë evoluuar, fatkeqësisht, në disfavor të ushtrimit të sovranitetit në këtë pjesë të territorit të Kosovës ose të jem më i qartë, gjendja në këtë pjesë të territorit të Kosovës ka vazhduar të keqësohet edhe më shumë në të gjitha rrafshet. Dhe tash hapur në opinionin ndërkombëtar, por edhe në atë vendor flitet për skenarë të mundshëm për veriun e Kosovës.

Arsyeja e dytë, pse duhet të debatohet sot? Përveç faktit se vizitat e zyrtarëve serbë dhe të grupeve të armatosura që lirisht shëtisin në Kosovë, e që promovojnë projekte të spastrimit etnik dhe rrezikojnë stabilitetin, sigurinë individuale dhe kolektive të qytetarëve të Kosovës, ekziston edhe një arsye tjetër që është tejet brengosëse për ne dhe për perspektivën e vendit.

Institucionet e Republikës së Kosovës, presidenti i vendit, qeveria, nuk kanë dhënë të kuptojmë asnjëherë se kanë vizion dhe politika shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me sovranitetin dhe integritetin e vendit. Dhe, si rrjedhojë, sot lirisht mund të themi se interesi shtetëror i qytetarëve të Kosovës është i pambrojtur. Prandaj, kjo mungesë gjithsesi shihet se ka reflektuar edhe në mosgatishmërinë e misionit ndërkombëtar për t'u përballur me strukturat e pushtetit serbë dhe grupet kriminale në komunat veriore të vendit.

Të nderuar deputetë,

Sot, kur qytetarët e Kosovës me të drejtë janë frikësuar dhe po humbasin besimin çdo ditë e më shumë se gjërat në vend mund të marrin kahe pozitive. Kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të demonstrojë rolin kushtetues dhe vendosmëri në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe të sovranitetit të vendit...

KRYESUESI: Regjia, ia jepni edhe gjysmë minute, kryeje! Po, 3 minuta i ke me rregull.

LULZIM ZENELI: Prandaj, të nderuar deputetë,

Dalja me qëndrim të qartë, në përputhje me përgjegjësitë kushtetuese, e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sot është obligim për qytetarët e Republikës, është obligim dhe borxh për gjeneratat e ardhshme.

Duke u mbështetur në argumentet e theksuara, kërkoj që kjo çështje urgjente të vihet si pikë e parë e rendit të ditës për seancën e sotme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë, shumë qejf për të komentuar s'kam, po unë jam duke u çuditur me deputetët me 2 – 3 mandate, s'donë ta lexojnë rregulloren. Për paraqitje të rendit të ditës – 3 minuta janë. Kërkoj deklarinimin e grupeve parlamentare për propozimin. Për PDK-në, kush flet? Safete Hadergjonaaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk është kundër ndonjë debati për çështje të caktuara. Prandaj, mund të debatojmë edhe për çështjen e mbajtjes së zgjedhjeve serbe në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Për Lidhjen Demokratike, në këtë rast, deputeti Ramë Manaj.

RAMË MANAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës asnjëherë nuk është kundër debatit, ndonëse nuk besoj të prodhojë shumë çka ky debat. Megjithatë, nuk jemi kundër.

KRYESUESI: Faleminderit!
Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
I nderuar kryesues,
Tema që u hap, është temë shqetësuese për gjithë opinionin e Kosovës, madje jo vetëm të Kosovës, unë konsideroj edhe të bashkësisë ndërkombëtare, sepse sot kemi një gjendje tejet alarmuese në veriun e Kosovës, kur institucionet e vendit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë, nuk mund të mbajnë zgjedhje, ndërsa në të njëjtën kohë kemi një agresion të drejtpërdrejtë nga shteti serb në territorin e Kosovës duke i shpallur zgjedhjet.

Prej 17 shkurtit të vitit 2008, duhet të jemi të vetëdijshëm se institucionet e vendit kanë obligim që të jenë prezentë në gjithë territorin e Kosovës, të zbatojnë ligjin dhe kushtetutën, të merren me të gjitha problemet e qytetarëve në nivel të vendit. Është e pajustificueshme deklarata se ne nuk duam të shkaktojmë incidente, nuk duam të shkaktojmë dhunë, po kush po e kërkon këtë? Shteti kërkon zbatim të kushtetutës dhe të ligjit, shteti kërkon vendime të cilat janë në dobi të qytetarëve të një vendi. Paramendoni ndërhyrjen dhe hyrjen e personaliteteve serbe në territorin e Kosovës të armatosur, me uniformë dhe çka nënkupton kjo? Mos po presim ne që të hynë me tanke e aeroplanë, të kallëzojnë që është agresion dhe është cenim i integritetit territorial të vendit.

Prandaj, kërkesa jonë është që të debatohet, madje në bashkëpunim me EULEX-in të ndërmerren të gjitha masat që të mos lejohen mbajtja e zgjedhjeve serbe në një territor të një shteti tjetër. Kjo ndërlidhet edhe me disa elemente tjera që po ndodhin gjithmonë në rajon kur është në pyetje Kosova, kur janë në pyetje hapat progresiv të Kosovës.

Vrasja e 4 shqiptarëve në Maqedoni duhet të na shqetësojë shumë pse ndodhë kjo dhe, në vend se të kërkohej sqarime nga Qeveria e Maqedonisë, Qeveria jonë shkon edhe rrëfëhet atje, sikur është fajtorë, pse? Pse nuk kërkon sqarime të drejtpërdrejta si shtet? Nëse duam të jemi shtet, atëherë të sillemi si shtet dhe në raport me vende të tjera të jemi në raporte të plota shtetërore.

Po ashtu, kemi një sulm në pikën 31 dhe asnjë sqarim para opinionit, asnjë reagim të institucioneve tona. Kush do të na mbrojë vendin tonë, kush duhet udhëheqë me vendin tonë, kush e ka për obligim të zbatojë kushtetutën dhe ligjin?

Edhe një herë kërkoj të mbahet debat dhe Qeveria të jetë e kujdesshme në obligimet që i ka para qytetarëve të Kosovës. Nuk mund më të sillemi edhe pas 10 vjetësh me një pjesë të territorit të cunguar, pa asnjë obligim ndaj asaj pjese. Përgjegjësi për institucione duhet të ketë dhe unë jam që debati të hapet dhe Qeveria të vendos anulimin e këtyre zgjedhjeve në veriun e Kosovës, të zbatojë kushtetutën, të zbatojë ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për AKR-në, kush e do fjalën? Ibrahim Makollit, kryetar i grupit!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet iniciativën e Lidhjes Demokratike të Dardanisë për t'u debatuar për mbajtjen e zgjedhjeve serbe në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi i LDD-së, e paraqiti.

Kërkojmë deklarinimin e Grupit "7+", Enis Kervan, e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryesues.

7 + Parlamentar Grubu da LDD Parlamentar Grubunun Mitroviça'daki seçimlerle ilgili tartışma önerisinin gündeme alınmasını desteklemektedir ve kabul etmektedir.

Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar SLS-së, Petar Miletic, e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke ne podržava ovaj predlog grupe LDD za diskutovanje na ovu temu, ne zato što smo protiv debate, već čini nam se da je EULEX juče dao svoj komentar na ovu temu, tako da mislimo da je današnja rasprava na ovu temu bespredmetna. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin për Integritet, Branislav Grbić.

BRANISLAV GRBIĆ: Parlamentarna grupa za Integraciju podržava ovu temu jer je jako bitna i u interesu svih građana Kosova. Ovo je tema koja ne treba da podeli građane na predstavnike Albanske zajednice, Srpske i ostalih zajednica, jer zaista radi se o jednom problemu koji je sigurno i pitanje međunarodne zajednice. Prisustvo izbora koji će se desiti u Mitrovici, sigurno da treba da interesuju i Srbe pogotovo, jer ovog puta radi se o sprovođenju nekih zakonitosti za koje Parlamentarnoj grupi za Integraciju nije jasna stvar da li jedna menažerska grupa ili grupa SLS koja tri godine drži vlast u ovoj Skupštini, ima dva ministra, ima sve pozicije koje je dala i ne verujem da ne može da ih interesuje jedna zajednica za koju mislim da su i oni odgovorni, jer su svojim radom sigurno trebali da doprinesu nekom delu opredeljenja predstavnika Srpske zajednice i sigurno da je i ovo tema gde možemo svi da uzmemo učešće i da damo svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Atëherë, ju lus të bëheni gati ta votojmë propozim e LDD-së për diskutim, për temën e re të rendit të ditës.

Kush është "për"? Faleminderit! Kush është "kundër"? 2 vota "kundër". Me shumicë, hynë në rend dite tema e kërkuar nga Grupi Parlamentar i LDD-së.

Zotëri deputetë,

Ju njoftoj se në bazë të Nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Kjo aplikohet për herë të parë në Kuvendin tonë. Diskutimi i deputetit është deri në 3 minuta, ndërsa diskutimet në emër të grupit parlamentar mund të zgjatin 5 minuta. Unë i them edhe regjisë që ata që diskutojnë në emër të grupeve, duhet të flasin 5 minuta, deputetët mund të flasin vetëm 3 minuta në këtë pjesë, në këtë 30 - minutësh që po e aplikojmë për herë të parë.

Atëherë, unë kam paraqitje këtu në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, u tërhoq njëri. Shkojmë tutje. Ahmet Isufi, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Urdhëro, bravo, u tërhoqe edhe ti.

Shkojmë tutje. Në emër të Partisë Demokratike, a ka që flet në emër të grupit? Nuk ka. Në emër të LDK-së, a ka që flet në emër të grupit? Nuk ka. Në emër të LDD-së, nuk ka.

Atëherë, unë i thërras deputetët e paraqitur me radhë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali. 3 minuta, Driton!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, konform fjalimit që u bë me plotë pasion për 13 milionë euro këtu, do të flas për shumën 16.200.000 euro, mbase jo me aq pasion sa u fol përpara.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Që nga 6 shkurti i vitit 2007, pra që 3 vite e katër muaj ka që garancioni bankar prej 16.200.000 euro, i cili ishte paguar nga fituesi i tenderit të dytë të operatorit mobil, rri pa kurrfarë arsyeje dhe baze ligjore në ART dhe nuk dorëzohet në Departamentin e Thesarit. Shumë e shumë herë në këtë Kuvend kam bërë pyetje unë, personalisht, por edhe kolegët e mi se ku është ky çek bankar dhe pse ky çek bankar nuk deponohet në Thesar, aty pra ku e ka vendin. Në këtë pyetje, ministri i Ekonomisë dhe Financave, më 25 shkurt të këtij viti dha këtë përgjigje: “Në ART është garancioni bankar prej 16.200.000 eurove dhe është valid deri në vitin 2011. Unë e kërkoj po aq me forcë, sa ju e kërkon, nga ju pra, Kuvendi, që ju jeni autoritet mbi Rregullatorin e ART-së, që ta detyroni që të ekzekutohen ato 16.200.000 euro”, fundi i citatit. Kjo është përgjigja e ministri, pra çeku qenka edhe më tutje në ART dhe qenka valid deri më 2011. Unë përsëri e bëra këtë pyetje në seancën e kaluar, më 29 prill, pyeta se a është deponuar çeku prej 16.200.000 eurove në Thesar apo akoma është në ART? Përgjigja ishte e njëjtë.

Pra, të nderuar qytetarë të Kosovës, siç shihet as Qeveria, as Kuvendi nuk paskan autoritet mbi ART-në. Kjo tregon se çfarë shteti kemi ndërtuar deri më tani, ku çdo kush është po aq në vete dhe nuk jep përgjegjësi dhe nuk e respekton ligjin. Kjo është turp, të nderuar qytetarë, ne nuk jemi barbarë të sillemi kështu. Prandaj, pasi as Qeveria, as Kuvendi nuk po munden ta detyrojnë Bordin e ART-së që ta dorëzojnë këtë çek në Thesar, unë kërkoj që EULEX-i, gjithmonë duke iu referuar, duke u thirrur në kompetencat që i janë dhënë EULEX-it nga ky Kuvend më 12 shkurt të vitit 2007, të na ndihmojë që këtë çek ta deponojnë në Thesar, aty pra ku e ka vendin dhe ndaj atyre që nuk e kanë respektuar ligjin të merren masat adekuate, sepse kjo, po them edhe një herë, është turp, turp i madh, 16.200.000 euro të rrijë çeku që 3 vjet e 4 muaj e të mos dërgohet në Thesar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e merr deputeti Mark Krasniqi, po ashtu 3 minuta!

MARK KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Më duket që nuk duhet të bisedojmë vetëm për këtë rast, rast i zgjedhjeve do të thotë. Këtu është një rast kompleks, si duhet ne ta sqarojmë edhe t'i sqarohet edhe faktorit ndërkombëtarë se ne nuk do të pajtohemi kurrse, populli i Kosovës, që të cenohet integriteti i territorit të tij. Duhet ju, që

jeni Qeveri, që jeni në kontakt gjithmonë me këta ndërkombëtarët, t'ua bëni me dije se kjo është tokë e kosovarëve edhe këtë tokë kosovarët e mbrojnë me çdo kusht. Prandaj, mos ta vejmë në provë këtë mundësi, që ne nuk e dëshirojmë. Me Serbinë të diskutohet, është krejt humbje kohe. S'kemi çka të diskutojmë me Serbinë, është diskutuar dhe Republika e Kosovës është e njohur ndërkombëtarisht, e ka kushtetutën e vet, edhe Rezoluta 1244 ka rënë në ujë, sepse ndërkohë janë bërë ndryshime esenciale të cilat nuk kanë lidhje me këtë rezolutë, realiteti atë e ka asgjësuar. Prandaj, ju lutem, të jemi më aktiv ju që jeni kompetentë dhe ju që e keni për detyrë, e për detyrë e ka edhe Parlamenti me kushtetutë, por Parlamentit nuk i jepet kurrnjëherë ndonjë rast që t'i diskutojë këto çështje që janë esenciale për ardhmërinë tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi!

Fjalën e merr për 3 minuta, deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Në vitin 2008, tenderin shumë kontrovers për operatorin virtual të Telefonisë mobile e pati fituar ndërmarrja Dardafon. Përkundër shumë kundërshtimeve nga stafi i PTK-së, me një letër të botuar në gazeta të përditshme, por edhe nga shoqëria civile. Derisa dikush që ne nuk po e dimë, apo që ata që e kanë bërë e dinë, e bien për përfitime që do t'i ketë PTK-ja, përfitimet 72% atij që shet kartela, më 28% Vala, ajo që e bën tërë punën dhe procesin e vë në lëvizje. Pra, ja ku jemi, e kemi sot Z-mobile. Çuditërisht, Dardafon ishte fitues zyrtar deri në janarin e këtij viti, kur papritmas në skemë na doli një ndërmarrje tjetër me emrin Dardafon.net, e cila fare nuk kishte konkurruar në konkursin për shprehje të interesit për operatorin virtual mobil të shpallur nga PTK. Mirëpo, përsëri doli dora e padukshme dhe vendosi në mënyrë joligjore se Dardafon dhe Dardafon.net janë një, sepse ashtu ishin marrë veshë në mes veti aksionarët. Harruan se në Kosovë një ditë mund të ketë kërkesa për respektim të ligjit dhe se askush nuk është “mbi ligjin” dhe ju vë ligjet me dy këmbët në fyt. Ndoshta pse mendojnë që janë të fuqishëm dhe mund të ecin, ndoshta mendojnë se Kosova ju ka ndonjë borxh ose ndoshta edhe mendojnë se janë pronarët e Kosovës dhe nuk kanë nevojë të respektojnë ligjet e Kosovës. Dardafon është regjistruar në Agjencionin për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numrin e vet të biznesit dhe me adresën e vet në Pejë, e licencuar për operator virtual në vitin 2008. Po ashtu, edhe Dardafon.net është e regjistruar në Agjencion si shoqëri e përgjegjësi të kufizuar, me numër të vet të biznesit dhe e regjistruar në Miradi të Epërme, në Fushë Kosovë, e licencuar për operatorin virtual në janar të vitit 2010. Sa për freskim të memories edhe të opinionit publik, po edhe të vendimmarrësve të sistemit të drejtësisë në Kosovë, të gjitha hallkave të drejtësisë, po ju përkujtoj se shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është person juridik, që është juridikisht i ndarë dhe i dallueshëm nga pronarët. Pas shumë kërkesave të drejtuara përmes mediumeve të ndryshme publike, por edhe përmes pyetjeve parlamentare, që shpesh iu kemi drejtua ministrit Shala, përkundër përgjigjeve që i pati dhënë poshtë e përpjetë, që nuk e ka marrë kurrkush vesh, unë personalisht jo, jo vetëm që nuk u morën hapa konkretë, por u tentua që të jepet një arsyetim sa më jo profesional dhe manipulues, por edhe fyes për inteligjencën e njerëzve bartës të sundimit të ligjit, por edhe fyes ndaj qytetarëve të Kosovës. Pse? Prej nga i gjithë ky guxim, kur dihet se askush nuk është mbi ligjin. Arsyetim zyrtar se Dardafon dhe Dardafon.net janë të njëjta, sepse aksionarët e konzorciumit janë marrë vesh mes veti. Por, hapi tjetër, por edhe kjo storie po del...

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Nekibe Kelmendi, 3 minuta!

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Jemi dëshmitarë se këto ditë, duke hyrë të armatosur pjesëtarë të institucioneve të Republikës së Serbisë në territorin e Kosovës, tregojnë për përgatitjet e tyre për nisjen e një konflikti të

armatosur në një pjesë të territorit të Kosovës. Ndërkaq, qëllimi i këtij konflikti të armatosur, siç janë deklaruar haptas liderët dhe disa ministra që kanë ardhur këto ditë dhe kanë shëtitur nëpër territoret e Kosovës, flet qartas për veprimet përgatitore për spastrimin etnik të një pjese të Kosovës, e kjo paraqet edhe veprime përgatitore për krim kundër njerëzimit, siç është spastrimi etnik. Prandaj, ne duhet këtu, meqë nuk u propozua që të merret ndonjë qëndrim apo vendim nga ky Parlament lidhur me këtë çështje, duhet të jemi shumë më syçelët, sepse nuk jemi duke parë ëndrra, por po shohim realitet që po ndodh në ato pjesë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, 3 minuta!

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Të nderuar qeveritarë, deputetë,

Shqetësimi im konsiston në faktin që i referohet heshtjes së administratës, heshtjes së gjyqësorit. Heshtja e administratës është kur autoriteti i administratës publike fare nuk e vendos çështjen juridike administrative dhe fare nuk e informon palën e interesuar legjitime, kjo është një.

Dy, për gjykatën, apo për gjyqësorin, përderisa shumë herë këtu ka justifikime se gjyqësori nuk na përgjigjet neve, e tjera, e tjera, e lë anash, mirëpo e theksoj se ka raste që unë i di, rastësisht, që bie fjala, 5 vjet parashtresa nuk është trajtuar fare. Kjo është tepër keq dhe është çështje që meriton për t'u trajtuar në një seancë të veçantë speciale, nëse është, e them, edhe prapa dyerve. Unë do të jap një shembull sa i përket ekzekutivit. Ja, po e zëmë, një rast. Një çështje juridike administrative, e thjeshtë, që do të mund të zgjidhej brenda 5 minutash, mos të them 3 minutash, MASHT-i, Ministria për Arsim, Shkencë, Teknologji nuk e ka vendosur brenda tri vjetëve e tre muajve, ekziston numri i lëndës, të cilën ia kam adresuar ministrit edhe ministri nuk mu ka përgjigjur dot deri më sot. Nuk është mirë, absolutisht është e patolerueshme, sepse autoritetet tona duhet t'i vendosin çështjet, po qoftë edhe gabimisht, ka instanca tjera, sepse ato janë për atë punë dhe atë punë nuk e kryejnë dot. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Arsim Bajrami, tre minuta!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Megjithëse ne u morëm vesh që të kemi një pikë të veçantë të debatit për gjendjen në Mitrovicë, unë do të ndalem vetëm në një segment, sepse më vonë do të diskutoj për kompleksin e situatës në Mitrovicë.

Para disa ditëve, unë kam parë përmes televizionit një takim në Mitrovicë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues ndërkombëtarë dhe është biseduar për perspektivën e qytetit. Mes tjerash kam parë përfaqësues të qyteteve të ndara, të zgjidhjeve jo të mira kushtetuese, që kanë marrë pjesë dhe ata kanë treguar përvojat e veta. Ka pasur përfaqësues nga qyteti i Mostarit, përfaqësues nga Belfasti dhe nga shumë vende të tjera që nuk janë raste të mira për Mitrovicën, nuk janë modele të mira. Unë e gjykoj këtë takim si një gabim politik dhe mendoj që Qeveria e Kosovës nuk duhet të pranojë dhe nuk duhet të delegojë përfaqësuesit e vet. Ka pasur edhe përfaqësues të Qeverisë në debate, ku në mënyrë të tërthortë bisedohet për perspektivën e qytetit, duke mos e përjashtuar edhe ndarjen. Unë e vlerësoj këtë një gabim të rëndë politik, sepse Kosova ka bërë kompromisin politik dhe kompromisin ligjor sa i përket qytetit të Mitrovicës përmes pakos së Ahtisarit dhe assesi përmes një dere të vogël ne nuk duhet të ulemi në tryeza, ku neve na jepen përvoja të Mostarit. Ne e dimë që Mostari është një qytet i ndarë dhe ne duhet të insistojmë që të përmbushen obligimet ndërkombëtare sa i përket qytetit të Mitrovicës. Ne

duhet të kërkojmë që të përmbushet agjenda e përgatitjes së zgjedhjeve lokale në pjesën veriore të Mitrovicës, e jo të ulemi në debate shterpë dhe në debate kot, që nuk sjellin kurrfarë dobie për Kosovën kur ne dëgjojmë përvojat e qytetit të ndarë të Mostarit. Kështu që unë mendoj se në këto takime që mund t'i organizojnë OJQ-të, nuk duhet të marrin pjesë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës. Unë e kuptoj që OJQ-të mund të kenë interesa që të debatohen konceptet e shoqërisë multietnike, konceptet e diversitetit etnik, por nuk mund të kuptoj zyrtarët e lartë politikë, që kanë marrë votën e popullit, të jenë në këto debate, të cilat në mënyrë të tërthortë e legjitimojnë një debat të tillë në Kosovë sa i përket perspektivës së Mitrovicës. Çështja e Mitrovicës sa i përket Kosovës është e mbyllur, është e mbyllur në zgjidhjen që është propozuar në pakon e Ahtisarit dhe atëherë është bërë kompromisi politik dhe ne do të insistojmë që ajo edhe të implementohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka ministri, Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar profesor Arsim Bajrami,

Sa për një sqarim, kjo është një konferencë ndërkombëtare, që herën e parë është mbajtur në Boston dhe quhet Sit in transition, qytete me probleme të ndryshme, ku nuk diskutohet për zgjedhje politike të situatës së tyre, por për mënyra të bashkëpunimit. Dhe, në atë konferencë është vendosur që nikoqir i ardhshëm të jetë Mitrovica. Ka qenë, po s'keni informatat të mjaftueshme, prandaj biseduat, se ju i njihni këto gjëra shumë mirë. Rregull e kësaj ka qenë që asnjëherë s'diskutohen çështjet politike, po udhëheqës janë Shoqëria Civile të gjejë forma të bashkëpunimit në infrastrukturë në çështje që janë në interes të qytetarëve. Me qenë se është qyteti i lindjes dhe kemi marrë pjesë në Konferencën e Bostonit edhe unë, edhe ministri Sadri Ferati, kemi qenë në cilësinë e qytetarëve dhe jemi treguar edhe në atë format, kemi marrë pjesë vetëm në pjesën inauguruese edhe aty absolutisht nuk diskutohet për solucionet politike dhe ne e kemi shumë të qartë se kjo do të shkojë sipas pakos së Ahtisarit. Prandaj, shkëmbimi i përvojave, ndonjë bashkëpunim qoftë policor, infrastrukturë, çështje tjera që ajo në asnjë mënyrë nuk kuptohet se ne i legjitimojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Veç një sqarim të vogël. Zoti deputet Bajrami, kësaj radhe do ta jap fjalën, por lexoni këtë rregullore që e keni aprovuar vetë, kjo është koha e deklarimeve, replika s'ka. Meqë është dita e parë, urdhëro!

ARSIM BAJRAMI: Nuk do të doja që të kualifikohet si replika, aq më pak do të doja të bëjë replikë me ministrin e rendit. Sinqerisht, nuk e di a ka qenë ai pjesëmarrës apo jo, por unë mendoj se në momentin kur dikush bëhet ministër dhe ushtron një post shumë të rëndësishëm politikë, nuk është qytetar i thjeshtë, ai përfaqëson edhe qëndrime politike. Unë e kuptoj tendencën e Shoqërisë Civile që të organizojë konferenca edhe në Boston, edhe në Mitrovicë për të promovuar idetë e diversitetit, por në mënyrë të tërthortë me faktin që ajo po mbahet në Mitrovicë, ne po e hapim atë debat, po e legjitimojmë atë debat me shembuj jo të mirë për qytetin e Mitrovicës. Unë i di qëllimet e mira të organizimit të asaj konference, po në një mënyrë përmes një dëre të vogël ne po e hapim një debat dhe nesër nuk mund të themi që ne nuk duam të hyjmë në këtë debat, sepse përmes një dëre të vogël po e legjitimojmë një debat që ka premisa të pastra politike.

KRYESUESI: faleminderit!

Koleg të nderuar, nuk ka më kërkesa për deklarime.

Kalojmë në rendin e ditës.

- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 13 maj 2010

A ka ndonjë vërejtje? Nëse s'ka vërejtje, kush është "për"? Faleminderit! "kundër"? S'ka. Miratohet Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 13 maj.

Më lejoni, kolegë të nderuar, për një vërejtje. Para se të kalojmë në – Kohën për pyetje parlamentare, ju lutem shumë! Ju tërheq vërejtjen shëfave të grupeve parlamentare dhe deputetëve vetë, ne sot kemi një rend dite të ngjeshur, i cili i tërë është legjislativ dhe me votim. Unë ju lus shumë, sidomos dy pikat e para i kërkojnë 80 vota "për", që i kemi në rend dite, të gjitha tjerat i kërkojnë, ju i dini, 60 + 1. Atëherë, unë ju lus të keni përgjegjësitë dhe detyrat t'i ushtroni ashtu si kërkohet.

Fillojmë me pyetjet parlamentare.

- Pyetjet parlamentare

Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Fatmir Limaj, Naser Rugova, s'është këtu. Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Urdhëro, zoti Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Këtë pyetje, zoti ministër, e kam drejtuar në kohën kur ministër ka qenë zoti Alush Gashi, por megjithatë mendoj që nuk është e vonuar. Çështja është kjo: Është paralajmëruar riparimi i dy CT-ve të vjetra të tipit Shimadzu njëstresor, njëra nga to është në funksion. Kontrata për riparim llogaritet të jetë 260.000 euro. Një CT tjetër 64-shtresore dhe tredimensionale është montuar para 3 vjetëve dhe ka funksionuar vetëm disa muaj. Riparimi i saj, sipas përlllogaritjeve kushton jo më shumë se 35.000 euro, mjete të cilat po arsyetohen se mungojnë. Jashtë funksionit është edhe Rezonanca Magnetike, e montuar para 2 vjetësh, e cila edhe kur punon, nuk punon fare. Brenda vitit shpenzon 70 mijë helium. Pyetja është: Sa është çmimi i një CT-je të re të tipit Shimadzu, që po pretendohet të riparohet dhe pse nuk riparohet CT-ja e re 64 - shtresore dhe pse Rezonanca nuk funksionon?

KRYESUESI: Zoti ministër, Bukoshi!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Zoti Makolli, edhe herën e kaluar ka pasur, është shtruar një pyetje e ngjashme, nuk e di tash me çfarë saktësie jam përgjigj në atë, po prapë ishte fjala për aparate të tomografisë kompjuterike dhe një lëmsh të cilën e kam trashëguar unë aty dhe është me të vërtetë një situatë e ngatërruar, po së pari t'i përgjigjem pyetjes së juaj direkte. Çmimi i një aparati Shimadzu është afër 200.000 euro, ndërsa riparimi për ato dy aparate që i kemi, se është një i vjetër, edhe ky i riu, të cilat janë ushtruar edhe përpara, disa vjet, 3 – 4 vjet, ka kushtuar rreth 95.000 euro. Domethënë, tash duhet të bëhet një llogari aty, sa ka hesap për ta riparuar, por përmbi të gjitha këto, është një problem i cili duhet të analizohet përsëri, rasti i objektit për Onkologji, rasti i sjelljes së aparaturës shumë të shtrenjtë të Siemensit, të këtij aparati 64 - shtresor, mandej uji i cili ka depërtuar aty dy herë, një dëmtim të cilin ne jemi duke e vlerësuar tash. Nëse pajtoheni t'ju jap një përmbledhje në këtë pyetje të juaj ose mund t'ju referoj ose tash ose kur të doni, në çdo moment, për gjithë këtë kompleksitetin e kësaj, por ne jemi tash në procesin e evaluimit ose një inspektimi sa konsiston ai dëmtim që është. Kem të bëjmë me dëme, janë dëmtuar aparatet të cilat kanë ndërtuar në ujë aty. Problemi i objektit i cili është nuk është pranuar teknikisht, domethënë nuk është kryer pranimi teknik i objektit të Institutit të Onkologjisë, është kryer puna, nuk janë bërë kurrfarë..., është punë ashikare se nuk i plotësojnë shumë nga ato normativat edhe kautelat e funksionimit të një instituti të atillë lidhur me rrezatimin, lidhur me rrezikimin e personelit i cili do të punojë aty dhe me ato dëme që janë bërë. Kjo është përgjigja në këtë pyetjen tuaj.

KRYESUESI: Zoti, deputet a ke pyetje shtesë?

IBRAHIM MAKOLLI: Kam pyetje shtesë. Zoti ministër, pse nuk riparohet CT-ja 64 – shtresore, që kushton vetëm 30.000 euro, por riparohen 2 aparatura të tjera, të cilat janë shumë më të vjetra dhe shumë më jo funksionale, që kushtojnë 3 herë më tepër për t'u riparuar?

KRYESUESI: Ministër!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Nuk riparohet sepse nuk mund të fillojmë tani ta superpunojmë gabimin me gabim, domethënë duhet të shohim ne ku jemi, domethënë të shohim sa kemi llogari ta riparojmë, a duhet t'i dërgojmë në hekurishte të vjetra ato aparate, që unë nuk besoj, sepse jemi në biseda të mira me Kompaninë Siemens, kam bërë dy herë bisedime, t'i quaj negociata apo kërkesë për një mirëkuptim që të vazhdohet puna. Kjo kompani është e interesuar që të vazhdojë të ndihmojë, të bëhet një evaluim përafërsisht i këtij dëmtimi dhe mandej në atë kontratë e cila do të rividohet, në të cilën parashihet, është shumë me rëndësi kjo, zoti Makolli. Ato aparate nëse fillojnë nesër, prapë do të kishim probleme, sepse ne kemi probleme të mëdha me personelin e patrajnuar ose pjesërisht e trajnuar, ose me mungesën e personelit, mungesën e fizicientëve. Jemi në rrugë të mirë, por nuk dua të japë kurrëgjë optimiste sot, një lloj i hetimeve domethënë do të bëhet aty, se çka është puna Jemi shumë të interesuar që ta bëjmë një rekapitullim, ta shohim ku jemi ne, pastaj ne llogarisim, a kemi llogari ta riparojmë Shimadzun e vjetër apo ta blejmë të riun, apo të orientohemi në këto të Siemensit. Është shumë komplekse, por vetë nuk mund t'i kryej ato punë. E kemi formuar edhe një ekip të mirë me njerëz kompetentë dhe me njerëz tanë që punojnë jashtë, është një kolege nga, që është shumë kompetente për këto punë, edhe po them, vullneti i mirë i kompanisë, ta shohim, natyrisht edhe interesat e kompanisë për të shitur aparate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Ministri s'është. Deputet, a do ta bësh pyetjen?

DRITON TALI: Zoti kryesues, më duhet të them se ka një kohë që kam marrë përkrahje të pa rezervë nga miqtë tanë ndërkombëtarë për ta bërë këtë pyetje, fal të cilëve ne e gëzojmë këtë liri që e kemi. Pyetja është për tenderin, për pajisjet e shkollave me teknologjinë informative, që u dhanë 24 milionë më shtrenjtë se sa ofertuesi më i lirë dhe zoti Enver Hoxhaj nuk vjen të përgjigjet në këtë pyetje. Po them edhe një herë, mbështetjen e kam pa rezervë prej miqve tanë ndërkombëtarë për këtë pyetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Shumë mirë që e ke mbështetjen.

Atëherë, deputeti Shkumbin Demaliaj, pyetje për kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçin. Deputeti Demaliaj!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Më duket është pyetja e parë që i drejtohet sot kryeministrit të Kosovës.

Gjatë vitit të kaluar iu drejtova kryetarit Krasniqi se misioni i EULEX-it duhet të ndërmarrë diçka lidhur me keqpërdorimet që ndodhin në Qeveri, tha se është një mision teknik. Qeveria e Kosovës, me rastin e humbjes së 50 kilogramëve drogë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë tha se me këtë detyrë e ka ngarkuar EULEX-in dhe mendohej të humbeshin hapat. Në këtë rast, EULEX-i e zhburrnoi në radhë të parë Qeverinë e Kosovës me një ndërhyrje spektakulare, që personalisht, po edhe për vetë qytetarët është pa precedencë një ndërhyrje e tillë dhe e ka shëmtuar shumë shtetin e Kosovës, që është e papranueshme edhe për mua. Mirëpo, atë

zhburrrim e përjetoi kjo Qeveri, ishte ndërhyrja në Ministrinë e Telekomunikacionit. Kanë menduar se kësaj pyetje do t'i dalë afati, por është shumë ende aktuale dhe sot po ia drejtoj kryeministrit të Kosovës. Si mendoni të dilni nga ky kolaps, zoti kryeministër, edhe pse personalisht, pa e thënë fjalën drejtësisht, nuk mund të prejjudikoj diçka të tillë, po si mendoni të dilni nga ky kolaps dhe në qoftë se me të vërtetë ka ndodhur diçka me ministrinë që ju i drejtoni, si do ta ndieni veten në të ardhmen?

KRYESUESI: Zoti kryeministër.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari deputet!

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar kryesues,

Më lejoni fillimisht që të siguroj gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, natyrisht edhe juve, të nderuar deputetë, se Qeveria e Republikës së Kosovës është mjaftë stabile, është vigjilente, vazhdon me qeverisje të mirë efektive dhe efikase.

Si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës kam qenë dhe do të jem udhëheqës i luftës kundër korrupsionit, kundër dukurive negative dhe kundër krimit të organizuar. Në vazhdimësi kam kërkuar e do të kërkoj dhe do të punoj maksimalisht për thellimin e bashkëpunimit në mes të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të gjitha autoriteteve të ftuara nga institucionet e Republikës së Kosovës, institucionet ndërkombëtare, qofshin ICO, EULEX apo edhe mekanizma tjerë.

Qeveria e Republikës së Kosovës me iniciativën e vetë, mund të them edhe timen personale, e ka krijuar për herë të parë task-forcën e përbashkët të institucionit të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës dhe të EULEX-it brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës. E kam vizituar edhe vetë Prokurorinë Speciale dhe i kam dhënë mbështetje të plotë, të hapur, publike, një mbështetje kjo inkurajuese, politike, financiare dhe teknike në luftë të pa kompromis kundër këtyre dukurive negative, pra, për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Dje, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe një udhëzim administrativ, që është në përputhje me reformat e reja dhe me Ligjin e ri të prokurimit publik, është një udhëzim i konsultuar dhe i këshilluar edhe me Komisionin Evropian, si një masë imediate dhe preventive në luftën antikorrupsion dhe antikrim i organizuar. Për herë të parë, pra, në vendin tonë Qeveria merr vendim që çdo kontratë që kalon mbi 10 mijë euro, duhet patjetër të nënshkruhet nga shefi i prokurimit, nga sekretari permanent dhe nga vetë ministri i ministrisë përkatëse. Pa dyshim se kjo masë preventive do të rrisë, jam i sigurt, nivelin e menaxhimit efikas të parash publike dhe të llogaridhënies.

Është e vërtetë se në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit tanimë është duke u zhvilluar një betejë konkrete, e munguar në 10 vitet e kaluara, por të jeni të sigurt se kushdo që është i përfshirë në vepra, qoftë të korrupsionit, qoftë të krimit të organizuar do të ballafaqohet me ligjin. Institucionet nuk punojnë me kanun, por me respektim të kushtetutës dhe të ligjit. Dua të theksoj, gjithashtu, se unë personalisht dhe Qeveria ime do të jemi shumë të përgjegjshëm dhe do të tregojmë rezultate konkrete në zotimin tonë, Për këtë do të bindeni.

Qeveria që e udhëheqë unë, për dallim prej të mëparshmeve, është duke punuar seriozisht në këtë drejtim. E ka filluar e para luftën antikorrupsion dhe antikrim i organizuar dhe dua të sqaroj, gjithashtu, se i gjithë ky proces do të jetë i ndjeshëm, do të jemi shumë rigoroz, shumë të qartë dhe do të përfshijë nga dita e parë e lirisë së Kosovës, nga qershori i vitit 1999 deri sot e tutje. Pra, do të jetë një betejë jo e lehtë, gjithëpërfshirëse në gjithë territorin e Kosovës, pa

dallime etnike dhe do të ketë ballafaqim të të gjitha rasteve korruptive nga 10 – 15 qershori i vitit 1999 deri tani dhe të gjitha rastet e krimit të organizuar, duke përfshirë këtu edhe vrasjet e pasqaruara të pas luftës që kanë ndodhur në Kosovë, por do të vazhdohet që institucionet e Kosovës të jenë ato të rendit dhe të ligjit, të jenë bartëse të kësaj lufte dhe EULEX të jetë lehtësues dhe mbështetës në luftimin dhe suksesin në këtë proces të ndjeshëm, por të pashmangshëm për sundimin e ligjit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe për këtë fitore ndaj të keqes. Pra, ky është fillimi i luftës ndaj të keqes, të cilën do ta fitojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!
Zoti deputet, a ke pyetje shtesë? Demaliaj!

SHUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryeministër për përgjigjen! Në historikun e zhvillimit të legjislativit dhe të formave tjera hynë edhe e drejta kanonike apo Kanuni. Të kisha lutur që kur të dalin ministrat e tu të kuptojnë se tash ne kemi shtet, kemi ligje dhe kushtetutë, e mos t'ia nisin nina-nana para televizorit vëlla e motër e të kuptojnë se nuk janë përgjegjës për familjet e tyre apo për të kaluarën e tyre historike, po janë përgjegjës institucional edhe duhet të jenë jo kanonik, po duhet të jenë përgjegjës institucional edhe të kenë përgjegjësi institucionale për atë çka veprojnë e mos të merren me çështje të së kaluarës, me atë që është thjeshtë dogmatike, nina-nana, që e thoshin para televizionit. Shpresojmë që të jetë ashtu siç kanë thënë, por dyshojmë në këtë çështje dhe besojmë se ligji edhe kushtetuta do të zbatohen në territorin e Kosovës, por edhe mekanizmat tjerë që kanë përgjegjësi të veta në Kosovë do ta çojnë deri në fund këtë çështje. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti kryeministër, nuk e do fjalën. Faleminderit!
Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!
Çështja që do ta parashtroj është se operimet ilegale në Kosovë çdo ditë e më shumë janë duke marrë përmasa më të mëdha në shkatërrimin e ambientit dhe shfrytëzimin e lëndëve të para minerale ndërtimore. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka identifikuar 83 kompani që bëjnë separacione ilegale dhe rreth 50 kompani që ilegalisht kanë shfrytëzuar gurët gëlqerorë dhe rërën dhe zhavorrin. Edhe pse janë lëshuar urdhëresa për ndërprerje të këtyre veprimeve ilegale nga ana e Inspektoratit të KPMM-së, në mungesë të fuqisë së ekzekutimit të tyre, operatorët ilegale vazhdojnë të veprojnë pa ndonjë shqetësim.

Zoti ministër, çka do të ndërmerrni për të ndërprerë veprimin e mëtejshëm të këtyre operatorëve ilegale?

KRYESUESI: Ministri Yagcilar!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuari kryesues,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
E nderuara deputete Myrvete Pantina,
Ne si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor jemi në dijeni për ekzistimin e eksploatuesve të rërës, të zhavorrit dhe të gurit gëlqeror, si dhe të separacioneve të këtyre inerteve. Ne, së bashku me Komisionin e Pavarur për Miniera kemi pasur shumë takime edhe e kemi formuar një komision të përbashkët për bashkëpunimin edhe për zgjidhjen e problemit, por ende nuk janë rezultatet e mjaftueshme. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor

nga të gjitha të dhënat për operatorët legalë ka krijuar evidencën dhe përmes Inspektoratit të Ministrisë jemi duke bërë përpjekje që këta operatorët legalë të zbatojnë kushtet sipas kushteve të dhëna me pëlqime mjedisore. Pra, jemi në aktivitetet permanent që operatorët legalë të plotësojnë kushtet e parashtruara sipas ligjeve. Por, problemi kyç është që operatorët ilegalë që veprojnë në vende të ndryshme, për këtë problematikë shumë serioze të degradimit të mjedisit jemi duke punuar në bashkëkordinim për veprim të përbashkët me komunat, me Komisionin e Pavarur për Miniera, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, po gjithashtu edhe me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Pylltarisë që të veprojmë bashkërisht me një plan të veprimit për të ndërprerë të gjitha këto veprime ilegale. Së shpejti do të bëhet marrëveshje për bashkëpunim, por gjithashtu presim një efikasitet edhe më të madh nga ana e gjykatave, sepse këto çështje janë të ndërlydhura me Ministrinë e Mjedisit, me pëlqimet mjedisore, por janë edhe licencat edhe pëlqimet tjera.

KRYESUESI: Zonja deputete, a ke pyetje? Urdhëro, Pantina!

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër,
Edhe ju e dini që dëmet në natyrë janë të pariparueshme. A keni plan të veprimit deri më tash, a keni pasur dhe kur mund të presim rezultate konkrete, të dilni me rezultate konkrete për të arritura?

KRYESUESI: Ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Me Komisionin e Pavarur jemi permanent në takime dhe besoj që së shpejti edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme do të realizojmë atë memorandumin e veprimit dhe të kemi rezultate të pritura edhe në terren. Por, prapë është shumë i rëndësishëm edhe efikasiteti i zbatimit të vendimeve edhe nga ana e gjykatësve.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Rexhep Hoti, ka pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

I nderuar kryeministër,

Me fillimin e pranverës, Qeveria që ju e drejtoni ka filluar edhe dy projekte gjigante, siç është projekti i autostradës Morinë – Merdarë dhe dhënia e aeroportit me koncesion. Në lidhje me këto dy veprime shumë gjigante të Qeverisë u çua shumë pluhur para dhe pas, mirëpo në këtë drejtim është dashur ndërhyrja e ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të disa përfaqësuesve të kuin-it për të dëshmuar transparencën, ligjshmërinë dhe momentet historike të zhvillimit të popullit të Kosovës përmes Qeverisë që ju e kryesoni.

Megjithatë, ju keni dëshmuar se, në të vërtetë, sapo ka filluar kjo qeverisje dhe privatizimi i gjigantëve të Kosovës, në këtë kontekst edhe investimet e huaja, të cilat do të kenë hapësirë në Kosovë. Jemi para privatizimit të një institucioni shumë të rëndësishëm, siç është Posta dhe Telekomit i Kosovës. Ju lutem, çfarë mund të na thoni për këtë proces kaq fundamental për popullin e Kosovës, në mënyrë që të mos kemi prapë ndikime dhe interferime të zyrave të jashtme për të dëshmuar se në Kosovë vërtetë ka një zhvillim gjigant. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet,
Të nderuar gjithë të pranishëm, qytetarë të Republikës së Kosovës,

E para, dëshiroj të sqaroj diçka se nuk ka pasur asnjë lloj interferimi, ka pasur këshilla, ka pasur rekomandime, ka pasur observim, natyrisht, të gjithë mekanizmit ndërkombëtar me këto procese të rëndësishme, qoftë të Komisionit Evropian, të Bankës Botërore, të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të USAID-it dhe të mekanizmave tjerë të ICO dhe të mekanizmave tjerë mbështetës dhe këshillues në Republikën e Kosovës.

Dëshiroj të sqaroj, jo të sqaroj por të konkludoj se fillimisht dua të potencoj se jam jashtëzakonisht i kënaqur me rrugën se si ka shkuar e gjithë procedura tani, mbi të gjitha me fillimin e punimeve për ndërtimin e autostradës Vërmicë – Prishtinë – Merdare, por edhe me përzgjedhjen e konsorciumit Bechtel & Enka dhe me vazhdimin tjetër të projektit për koncesionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. E kam theksuar dhe e ritheksoj edhe sot fuqishëm, të gjitha këto procese kanë shkuar në një proces të konkurrencës së lirë, të transparencës, në një proces të hapur dhe të mbështetur plotësisht nga të gjithë këshilltarët ndërkombëtarë. Pra, autostrada ka filluar me intensitet të shtuar të punohet, shumë shpejt do të punohet me kapacitetin e plotë sipas marrëveshjeve, ndërsa gjithashtu procesi i koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës do të vazhdojë procesin e vet të sigurt.

Dua të potencoj se këto projekte kanë qenë jashtëzakonisht tërheqëse për investimet e huaja, sepse është krijuar klimë e mirë për investime, është krijuar siguri, është krijuar besim dhe para së gjithash ligjshmëri, transparencë dhe konkurrencë të lirë.

Ndërsa sa i përket pyetjes suaj konkrete, Grupi ndërmintor për shqyrtimin e pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK do të sjellë shumë shpejt rekomandimin në Qeverinë e Republikës së Kosovës për formën dhe strukturën më të mirë për privatizimin e Post – Telekomit të Kosovës.

Unë zotohem që Qeveria e Republikës së Kosovës, pas marrjes së këtyre rekomandimeve do të marrë vendim përkatës lidhur me privatizimin e PTK-së me qëllim që të përmbyll këtë proces gjatë këtij viti, të respektohet pra agjenda e saktë.

Të nderuar deputetë,

Sikur për strategjinë e energjetikës, po ashtu edhe për privatizimin e PTK-së nuk do të jetë vetëm Qeveria që do të marrë vendime, por do të jeni ju, deputetë të nderuar, Parlamenti i Kosovës që do ta aprovojë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe pastaj do të vazhdohet në procesin normal.

Dua të theksoj, të nderuar deputetë, se i gjithë procesi deri këtu ka shkuar në një proces të planifikuar, të menaxhuar shumë mirë me një mbështetje të plotë këshilluese të ndërkombëtarëve, të gjithë faktorëve që i përmenda edhe më herët. Unë jam i bindur se pjesëmarrja e sektorit privat në PTK është e domosdoshme për rritjen e fitimit të PTK-së dhe ofrimin e shërbimeve më të mira, më cilësore, më të lira për qytetarët e Kosovës, por natyrisht do të vazhdojmë gjatë këtij edhe me projekte të tjera për distribuimin e KEK-ut dhe projektin energjetik “Kosova e Re”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, kryeministër!

Deputet, ke pyetje shtesë? Hoti!

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër, desha t’ju uroj një mbështetje të fuqishme në këtë drejtim juve, por edhe mbështetje të fuqishme zyrtare ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, segmenteve të caktuara, të cilat, për fajin tonë shpeshherë duhet ta japin mendimin e prerë se një çështje ka

shkuar apo nuk ka shkuar mirë. Besoj se duhet të mësojmë të gjithë nga pak nga këto gjëra. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër Zharku, po ashtu, më lejoni fillimisht të them se për këtë pyetje kam marrë mbështetje të pa rezervë nga ana e miqve tanë ndërkombëtarë, nga zyrat tona ndërkombëtare, të cilat më përgëzuan për pyetjen shumë të qëlluar, pyetje e cila është konform standardeve evropianike. Çështja është kjo, zotëri ministër: Në Kosovë për momentin janë të akredituara 4 ndërmarrje të cilat merren me analizën e cilësisë së derivateve të naftës. E para, siç e dini, është akredituar KPU Inspect, e dyta Inkos, e treta Derivati dhe e katërta që është akredituar edhe Ballkan Petrol. Por vetëm njëra nga këto kompani, e ajo është Derivati, bën kontrollimin e cilësisë së naftës në pikën doganore të Hanit të Elezit, bile sipas informatave, laboratori nuk është akredituar sipas ISO, IEC-së, 17.020 që është parakusht sipas ligjit në fuqi.

Sa për hir të opinionit, të thuhet se kjo veprimtari është goxha fitimprurëse. Sipas të dhënave, në Kosovë futen diku 120 cisterna në ditë, të cilat paguajnë për kontroll 75 eurove dhe japin dy litra naftë, domethënë rreth 9.000 euro në ditë dhe 240 litra naftë merren nga Derivati, i cili bën prapë monopol, falë juve, zoti ministër dhe Ministrisë suaj, që ju e drejtoni. Pyetja: Pse vepron vetëm një kompani në këtë fushë, kur dihet se Ligji i konkurrencës, që është në fuqi, nuk e lejon monopolin? Deri kur do të vazhdojë kjo situatë, e cila është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, neni 10, i cili parasheh, po e citoj: “Ekonomia e tregut, me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës”. Kështu, pra, thotë neni 10 i Kushtetutës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, Zharku!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,

Më lejoni, së pari, mua më vjen keq që nuk e dini atë lëmi, po megjithatë këto çështje po i sqaroj.

Së pari, më duhet të bëj një korrigjim substancial të pohimeve tuaja në lidhje me numrin e subjekteve të akredituara. Unë nuk e di se ku i keni marrë informatat mbi subjektet e akredituara, por deri më sot Drejtoria e akreditimit ka akredituar 12 subjekte në fusha të ndryshme, prej të cilave vetëm 2 janë subjekte që veprojnë si laboratorë për analiza të naftës dhe të derivateve të naftës. Subjekte tjera, trupa inspektuese nuk është analizë, nuk është laborator, për sqarim të juaj, kurse Ballkan Petroli ka për vajra, nuk ka për naftë dhe derivate të naftës. Kështu që kemi në Kosovë vetëm dy laboratorë, jo katër. Këto subjekte që në fjalorin profesional të infrastrukturës së cilësisë, pjesë e së cilës është akreditimi, njihen si trupa për vlerësim të konformitetit, gjegjësisht laboratorë testues, të cilat janë sh.p.k. Inkos nga Kastrioti dhe sh.p.k. Derivati nga Prishtina. Këto informata mund të vërtetohen nga çdo qytetarë edhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së akreditimit. Por, sipas legjislacionit në fuqi, akreditimi nuk është obligim ligjor, por çështje vullnetare e subjekteve të cilat i qasen këtij procesi për të përmirësuar performancën dhe, natyrisht, për të ngritur reitingun e kompanive të tyre në treg, në mënyrë që rrisin të ardhurat e tyre. MTI me asnjë vendim apo akt nënligjor nuk ka kufizuar veprimtarinë e asnjë kompanie në Kosovë, përfshirë edhe këto dy kompani që i përmenda.

Megjithatë, duke parë interesimin tuaj për këtë lëmi dhe në mënyrë që t’ju ndihmojmë në ngritjen e njohurive tuaja profesionale në këtë sferë, më lejoni t’ju sqaroj se në bazë të Ligjit

2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës, me qëllim të kontrollit të cilësisë së naftës dhe derivateve të saj, gjatë importit në të gjitha pikat kufitare, si dhe në brendësi të vendit, në deponi dhe në pika shitëse, në bazë të nenin 14.3 të këtij ligji është autorizuar laborator “Derivati” që t’i kryej këto analiza. Po ashtu, edhe me Ligjin nr. 03/L-138, datë 25 qershor 2009, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës, kjo e drejtë është përcaktuar në mënyrë decitive me nenin 16.3. Natyrisht që autorizimit i ka paraprirë verifikimi i plotësimeve të kushteve teknike dhe profesionale, të përcaktuara nga ana e komisionit profesional, siç është përcaktuar me Udhëzimin administrativ 2008/21. Prandaj, këtu nuk kemi të bëjmë as me monopolizim dhe as me cenim të konceptit të ekonomisë së tregut, por pasi që nuk ekziston kurrfarë obligimi ligjor që të autorizojë më shumë subjekte për kryerjen e kësaj veprimtarie. Dhe, në fund, natyrisht kjo situatë do të vazhdojë përderisa në fuqi është legjislacioni aktual. Për çështje tjera...

KRYESUESI: Hajde, kryeje më shpejt. O, zoti ministër, kryeje, fol!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Në anën tjetër, për shifra që ju i jepni për import, ato mund të vërtetohen se sa tonë harxhohen, sa tonë hynë në Kosovë, sa është pagesa edhe sa kamionë hynë në ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëro, Tali!

DRITON TALË: Unë shpresoj se zoti ministër e njeh zotin Ibush Luzha, për ata që se njohin është drejtor i Drejtorisë së Akreditimit, i cili ka deklaruar, thotë se janë 4 kompani për kontrollimin e kualitetit të derivateve të naftës në Kosovë. Drejtori, atëherë qiteni prej punës drejtorin...

(Ndërhyrje)

... jo, me letra jam duke folur edhe unë. Dhe, çështja tjetër është, zoti ministër, thuhet se vëllai yt, Ilaz Zharku, është pronar i Derivatit. Sa qëndron kjo dhe për atë ai e ka monopolin në treg. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti deputet, unë mendoj se me fjalë të kafes unë nuk merrem kurrë...

(Ndërhyrje e deputetit Driton Tali)

...jo, me fjalë të kafes ju jeni duke u marrë. Veç pak, nëse ma përmendni vëllanë tim, është me fjalë të kafes, me fjalë të kafes janë ato. Ju lutem, kompania është publike, e merrni kompaninë, veç pak, lëmin nuk e njihni, nuk e njihni lëmin, flasim për Laborator të naftës dhe derivateve të naftës...

(Ndërhyrje e deputetit Driton Tali)

...Po, se di lëmin, unë çka kam për të bërë, po më vjen keq, nuk ju kam faj që nuk e dini çka është trupa inspektuese, nuk ju kam faj që nuk e dini çka është laborator testues, nuk e dini çka është laborator kalibrues. Merreni listën që është në Drejtorinë e akreditimit edhe e shihni sa laboratorë janë. Për ato insinuatat e juaja, ato përfoljet e juaja mendoj që nuk na bëjnë nder, si njerëz nuk na bëjnë nder. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, ka pyetje për ministrin e Jashtëm Skender Hyseni. Ismajl Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Hyseni,

Në Konferencën e organizuar nga Bashkimi Evropian, kushtuar Ballkanit Perëndimor, që do të mbahet në Sarajevë, më 2 qershor të këtij viti, përveç institucioneve të Kosovës është ftuar edhe shefi i UNMIK-ut. Me këtë akt Kosova nuk është trajtuar si e barabartë me shtete tjera.

Zoti ministër, a konsideroni se në situatën e krijuar, ku Kosova prezantohet nga dy përfaqësime, ju duhet të merrni pjesë në këtë konferencë dhe çka ka ndërmarrë ministria juaj dhe ju, që e drejtoni këtë ministri, që Kosova të përfaqësohet vetëm nga institucionet e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, Hyseni!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti deputet, të nderuar deputetë, kolegë ministra,

E mirëpres pyetjen tuaj, sepse jep mundësi për një sqarim, i cili besojmë pak më shumë vënim, pak më shumë vëmendje nuk është vështirë të arrihet në përfundim. Sido që të jetë, Kosova përfaqësohet në këtë samit në nivel të barabartë vetëm pas kemi marrë garancione të plota se do të aplikohet i ashtuquajti format Gimnik, që vendeve pjesëmarrëse ju ofron përfaqësim të barabartë. Kosova ka pranuar të shkojë në këtë samit, që është samiti i nivelit të lartë BE, Ballkani Perëndimor dhe 10 vjet pas samitit të parë në Zagreb, Kosova përfaqësohet denjësisht në këtë samit. Që nga samiti i parë në Zagreb, Bashkimit Evropian i janë bashkuar 12 shtete të reja, nga 15, numri është shtuar në 27.

Çfarë kanë bërë institucionet e Kosovës që Kosova të përfaqësohet në nivel të barabartë? Kanë bërë çdo gjë që është në mundësi të tyre dhe vazhdojnë të bëjnë.

Përfaqësimi i Kosovës që nga Konferenca Gimnik e vitit të kaluar, në Pragë, kur ka marrë pjesë ministri i jashtëm i Kosovës, nga takimi i Bërdos, në Slloveni, ku ka marrë pjesë kryeministri i Kosovës, deri te takimi i Sarajevës, ku do të marrë pjesë kryeministri i Kosovës, janë dëshmi të forta që Kosova në rrafshin ndërkombëtar po konsolidohet si shtet. Ne nuk mund dhe nuk duhet të anashkalojmë faktin se Kosova ende nuk njihet nga të gjitha vendet e botës, Kosova ende është në procesin e konsolidimit ndërkombëtar të shtetësisë së saj. Por, sa i përket samitit të Sarajevës, nuk duhet të ketë askush as më të voglin shqetësim se Kosova nuk përfaqësohet barabar me shtetet e tjera. Ftesa që është dërguar te Ministria e Punëve të Jashtme është po ajo ftesë që është dërguar te çdo ministri e punëve të jashtme të Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë që është krejtësisht në mandatin e organizatorit dhe në këtë rast organizator është Komisioni Evropian, përkatësisht Presidenca Spanjolle, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe është krejtësisht punë e tyre të ta ftojnë. Ajo që i intereson Kosovës, është si ka ardhur ftesa. Kosova ka marrë ftesë drejtpërsëdrejti nga Kryesia Spanjolle përmes Zyrës së ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti deputet Kurteshi, a ke pyetje shtesë? Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Pyetja ime shtesë është kjo: Zoti ministër, nëse ndodh ashtu siç po përflitet këto ditë që juve t'ua japë fjalën zoti Zanier, që është shef i UNMIK-ut dhe vepron në Kosovë sipas Rezolutës 1244, që është një rezolutë tani më e tejkaluar, a do të pranoni ta merrni fjalën në këtë samit? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Unë, sërish nuk e kam ndërmend ta shfrytëzoj këtë foltore absolutisht për të komentuar spekulime të ndryshme, sepse në punën time nuk udhëhiqem nga spekulimet, absolutisht. Në punën time udhëhiqem nga garancionet që kam marrë nga qarqe shumë serioze të Bashkimit Evropian, nga ministri i Jashtëm Fratini, ministri i Jashtëm Francez Kushner dhe nga Komisioneri për Zgjerim, Stefan Fyle. Për mua janë valide vetëm garancat që vinë nga këto qarqe, assesi spekulime të natyrave të ndryshme. Kosova është ftuar përmes Zyrës së Komisionit Evropian, nuk është ftuar përmes UNMIK-ut dhe Kosova do të marrë fjalën vetëm si Kosovë, e assesi si UNMIK.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputeti Danush Ademi, ka pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

Në muajin qershor të viti 2009, ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Sasha Rashiq, së bashku me një delegacion të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale vizituan fshatin Dubravë dhe në këtë rast banorëve të fshatit Dubravë iu premtua që do të bënin rindërtimin e 40 shtëpive për raste sociale. Pas kësaj vizite, më datën 20.8.2009, pranë Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale u nënshkrua edhe një memorandum për ndërtimin e këtyre 40 shtëpive. Pyetja: Të nderuar ministra, pse deri më tani nuk është bërë asnjë hap për realizimin e memorandumit të nënshkruar.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsedavajući,

Poštovani zamenici premijera, kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Dragi poslaniče Ademi, to je absolutno tačno u vezi memoranduma koji je potpisan u to vreme i mi smo još tad objavili kao zvanično u cilju pomaganja tim ljudima koji tamo žive stvarno u izuzetno teškim uslovima. Ali od tog momenta do sad mi nismo dobili dozvolu same opštine da već jednom možemo da krenemo s tim projektom. Ja sam i skoro pre nekoliko dana zvao gospodina gradonačelnika Bajruša, iz Uroševaca, vezano za baš ovu problematiku i on mi je čvrsto obećao da će narednih dana ta dozvola za izgradnju biti obavljena, a to se zna da je kao jedan od preduslova za alociranje sredstava baš upravo dozvolom opštine, tako da smo mi imali faktički vezane ruke, bez dozvole opštine nismo mogli ništa da uradimo. U budućе samim izdavanjem dozvola, mi smo spremni da uđemo u realizaciju odmah i ta komisija koja će biti sastavljena prvenstveno od ljudi iz Ministarstva za rad i socijalno staranje i takođe Ministarstva za zajednice i povratak ćemo napraviti jednu grupu koja će vrlo jasno i tačno moći da utvrdi sve te porodice i sve te kuće koje su oronule i skoro srušene, da za to imaju adekvatnu zamenu. Znači, kratko rečeno, verovatno pri samom izdavanju dozvole od strane opštine Uroševac, mi ćemo reagovati odmah.

KRYESUESI: Deputet, a ke pyetje shtesë? Danush Ademi!

DANUSH ADEMI: ... ministër, vetëm lejen, është nënshkruar një leje më 16.7.2007 për ndërtimin e këtyre 60 shtëpive nga Kuvendi Komunal në Ferizaj dhe nuk di unë çfarë leje duhet për së dyti të nënshkruhet edhe njëherë.

KRYESUESI: Ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Ja bih vas zamolio da dokumenat koji imate, da mi donesete na pauzi jer, kao što rekoh, memorandum jeste potpisan bez dozvole, to svi znaju ovde da bez dozvole ne možemo da pokrenemo implementiranje memoranduma bez odobrenja, odnosno građevinske dozvole, kopije plana same opštine. Prema tome, sve što mislite da možete da mi priložite kao dodatak ili kao dokaz da postoji neka dozvola, možete da mi date, još jednom ponavljam, ja sam sa gradonačelnikom Uroševaca razgovaralo pre 3 dana i on mi je rekao da će, naravno, kroz njegovu proceduru, kroz opštinski parlament pokrenuti to odmah, prema tome mislim da ću biti prvi obavešten kad ta procedura bude završena.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Gani Geci, ka pyetje për ministrin Lutfi Haziri, të cilin nuk po e shoh këtu. Deputeti Gani Geci!

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqë Lutfi Haziri nuk është këtu, është i zënë, ndoshta, duke pirë duhan dhe nuk ka ardhur. Unë nuk kam qare pa e lexuar pyetjen. Ju e dini se gjithçka ka ndodhur pas lufte në Kosovë, po kanë ndodhur gjëra që nuk është dashur të ndodhin. Është uzurpuar korridori i Teatrit Kombëtar të Gjilanit, janë uzurpuar WC-të e korridorit të Teatrit Kombëtar të Gjilanit dhe ato janë të uzurpuara nga një anëtar i PDK-së, faktikisht mixha i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, dega në Gjilan. Unë kërkoj nga ministri që me një urdhër të veçantë të lirohet korridori dhe WC-të, sepse nuk ka kuptim që adhuruesit e teatrit të hynë nga dera e prapme në Teatrin Kombëtar të Gjilanit. Prandaj, ndoshta po më dëgjon ministri, po më dëgjon edhe Qeveria, kishte për të qenë mirë që mos të uzurpojnë më, bile teatrin, të paktin edhe WC-në. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Bahri Hyseni, ka pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Kosovës, në pajtim me strategjinë legjislativë për objektivat dhe objektivat që i ka, Kuvendit të Kosovës i ka përgatitur dhe i ka proceduar për miratim shumë ligje, të cilat tanimë i ka aprovuar edhe Kuvendi i Kosovës, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës, por edhe në zhvillimin ekonomik të vendit, e gjithashtu edhe në funksionalizimin e institucioneve në Kosovë. Unë po i përmendi vetëm disa nga to, siç janë ligjet për zhvillim ekonomik, domethënë Ligji për partneritet publiko privat, Ligji për shpronësimet, ligjet antikorrupsion, ligjet për organizimin e sistemit të drejtësisë, Ligji për Avokatin e Popullit dhe kohën e fundit edhe Ligji për punën.

Pyetja parlamentare e imja është: A do të ketë kapacitet dhe mundësi që Qeveria e Kosovës, brenda vitit legjislativ që jemi, të procedojë Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe të viktimave të luftës dhe Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor. Këto dy ligje do të ndikonin pozitivisht edhe në rregullimin e statusit

të këtyre kategorive të shoqërisë, por do të ndikonin pozitivisht që sado pak ta lehtësojnë jetën e këtyre kategorive shumë të respektuara të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zëvendëskryeministri Kuçi e jep përgjigjen.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Zoti Hyseni, faleminderit për pyetjen!

Më lejoni të them që të dy ligjet janë vërejtur që janë në strategjinë legjislative për vitin 2010. Natyrisht që në Projektligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe të viktimave civile të luftës është në fazën e konsultimeve buxhetore për këtë vit. Ne kemi bërë përgatitjen e draftit të parë dhe, mendoj, pas konsultimeve buxhetore që duhet të bëhen, shpresojmë që brenda këtij viti do ta procedojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ndërkohë, ne kemi bërë një mbikëqyrje apo një kujdes material për këto kategori, duke përfshirë invalidët e luftës për rritje prej që kemi ardhur ne në Qeveri, prej 30 deri në 120%, varësisht për kategoritë e tyre dhe shkallën e invaliditetit, ndërsa për familjet e dëshmorëve besoj që ekziston skema, mesatarja prej 239 euro në muaj, një mesatare e të ardhurave që janë në Kosovë.

Çështja e Projektligjit të dytë për sigurimin pensional dhe invalidor, kemi bërë të gjitha konsultat adekuate edhe me Shoqatën e pensionistëve, edhe me ekspertë të tjerë me Fondin Monetar dhe besojmë që drafti i parë do të miratohet në qeveri brenda dy javësh, do të thosha kështu, dhe do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për këtë ligjin e dytë, tanimë janë siguruar edhe kostot buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Besoj që s'ka pyetje shtesë. Deputeti Adem Hajdaraj, ka pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi dhe ministrin Enver Haxhaj, po ata s'janë. Nëse është pyetja që mund t'i përgjigjet dikush nga Qeveria. Urdhëro, deputet! Adem Hajdaraj!

ADEM HAJDARAJ: Zoti kryesues, unë ia kam drejtuar pyetjen kryeministrit ose ministrit, prandaj ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme, atyre do t'ua lexoj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Deputetja Qamile Morina, pyetje për kryeministrin Thaçi. Qamile Morina!

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Me kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së për debat lidhur me zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës, që është mbajtur 3 muaj më parë, Qeveria asaj kohe ka sjellë në Kuvend një version të shkurtër, e ashtuquajtur Strategji për integrimin e pjesës veriore të Kosovës. Kjo strategji e hartuar në bashkëpunim me ICO ka pasur për qëllim shtrirjen e autoritetit të institucioneve dhe integrimin e pjesës së Kosovës andej lumit Ibër. Fatkeqësisht, zoti kryeministër nuk është këtu, asgjë e re për mitorivicasit dhe qytetarët e Kosovës, përkundrazi ata janë shumë të shqetësuar me indiferencën e institucioneve tona nga vizitat e imponuara, të armatosura me mesazhe kërcënuese për sigurinë e vendit tonë nga liderë të Serbisë. Unë, si deputete e Kuvendit, si dhe qytetare e Kosovës, që vij nga Mitrovica, desha të di për fatin e kësaj strategjie, të cilën unë si deputete, edhe pse i kam shfrytëzuar të gjitha kanalet, si zyrtare, ashtu edhe private, nuk kam arritur të siguroj si një dokument të plotë. Për këtë qëllim, pyetja ime është: A ekziston një strategji, një dokument gjithë përmbledhës, i plotë, i miratuar me

ndonjë vendim zyrtar, qoftë nga Qeveria, qoftë edhe me vendim të veçantë të kryeministrit të vendit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Kuçi, urdhëro zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zonja deputete!

Mendoj se strategjia ka qenë e publikuar në mediat e informimit publik, ka pasur mundësi që të merret edhe në Qeveri, një draft është dërguar në Kuvend. Po, sido që të jetë, strategjia ekziston, natyrisht që është e përbashkët me Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe si e tillë, çdo ndryshim i saj, çdo plotësim i saj dhe realizim i saj duhet të jetë me akter vendorë dhe ndërkombëtarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zonja deputete, a do të bësh pyetje shtesë? Qamile Morina!

QAMILE MORINA: Mua më vjen keq, zoti zëvendëskryeministër, por unë këtë strategji nuk kam mundur ta marrë, edhe pse kam pasur kërkesa nga të gjitha kanalet, që thashë, zyrtare dhe private. Nëse ekziston një strategji e tillë, atëherë çfarë po bëhet për zbatimin e saj dhe pse ajo nuk iu ofrohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që janë të përzgjedhur të popullit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Haki Demolli.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministri ka deklaruar publikisht dhe ka përsëritur disa herë se pa reforma të thella në sistemin e drejtësisë, nuk do të ketë ecje përpara as në fusha të tjera. Pyetja: Zoti ministër, ju dhe Ministria që e drejtoni çfarë hapash ka ndërmarrë dhe deri ku keni arritur me procesin e reformave në sistemin e drejtësisë, edhe pse është një kohë e shkurtër që e keni marrë këtë detyrë ta drejtoni këtë ministri? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar zoti kryesues i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Ymeri,

Ministria e Drejtësisë, në kuadër të kompetencave të veta kushtetuese dhe ligjore është duke u angazhuar në reformimin e sistemit gjyqësor të Kosovës në tri drejtime. Konkretisht, në drejtim të infrastrukturës ligjore, në të cilën fushë është duke bërë përgatitjen dhe dorëzimin e draftligjeve më të rëndësishme për reformimin e sistemit ligjor. Konkretisht, është fjala për Draftligjin mbi gjykatat e Kosovës, pastaj Draftligjin mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Draftligjin mbi Prokurorinë e Kosovës dhe Draftligjin mbi Këshillin Prokurial të Kosovës, të cilat draftligje janë në procedurë e sipër dhe së shpejti pritet të aprovohen nga ky Kuvend. Përveç kompletimit të infrastrukturës ligjore, Ministria e Drejtësisë është duke punuar edhe në përmirësimin e infrastrukturës materiale. Së bashku me Komisionin Evropian është në ndërtim e sipër apo është në procedurë e sipër ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë, i cili pallat do të ketë diku 5 objekte 5 - katëshe, me 27.000 metra katrorë, në të cilin do të vendoset një pjesë e

madhe e Gjyqësorit dhe Prokurorisë së Prishtinës dhe Kosovës. Përveç Pallatit të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë është në ndërtim apo përfundim e sipër të ndërtesës së Prokurorisë Publike në Prizren, po ashtu është në fazën e ndërtimit apo procesit të ndërtimit të Prokurorisë në Pejë, si dhe Prokurorisë në Gjilan. Dhe, si segment i tretë në të cilin është duke u angazhuar Ministria e Drejtësisë në drejtim të reformimit të sistemit gjyqësor të Kosovës, është funksionalizimi i institucioneve ndihmëse të Gjyqësorit, të cilat institucione do të shkarkojnë Gjyqësorin e Kosovës nga një varg lëndësh të grumbulluara. Fjala është për Institucionin e Noterisë, si dhe për Institucionin e Ndërmjetësimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë! Nuk ka.

Koha për pyetje për sot është kryer, 60 minuta i kishim, 10 më shumë se herëve të tjera. Vazhdojmë tutje.

Deputetë të nderuar,

Unë ju thashë, ne kemi në rend dite një nen për Rregullore të Kuvendit. Ju lutem shumë, ne i kemi dy çështje që i kërkojnë 80 vota. Çështja e parë që vjen në rend dite, është një nen që duhet të rivotohet, më mirë të them të fshihet, që është i dyfishuar në Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që të bëhet e plotfuqishme në gjithë tekstin e saj të plotë. Unë mendoj që është mirë që sot të bëhemi komplet një 80-ësh, që të votohet kjo. Nëse momentalisht nuk janë brenda 80, e nuk janë, atëherë unë i them regjisë, le t'i thërrasë deputetët që mund të jenë në korridor ose poshtë.

(Ndërprerje e incizimit)

Në seancë kemi 72 deputetë, do të thotë pikat që kërkojnë 80-shin, nuk i nxjerrim tash, normalisht. Vazhdojmë me rendin e ditës.

Kemi dy pika që kanë mbetur për t'u votuar, janë kryer në seancën e kaluar.

Qes në votim Raportin e Agjencisë së Privatizimit, me elektronikë bëhuni gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 47 vota "për", 2 abstenime dhe 18 "kundër", votohet Raporti i Agjencisë së Privatizimit.

Tash e kemi votimin për Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore, bëhuni gati për votim me elektronikë, votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota "për", 8 "kundër" dhe 2 abstenime, votohet Programi i Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore.

Tash kemi në rend dite pikën që e kemi pranuar dhe votuar sot si pikë të re të rendit të ditës, të propozuar nga LDD-ja dhe të përkrahur e të votuar në Kuvend.

- Cenimi i integritetit, të sovranitetit të Republikës së Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë

Ftoj paraqitësin e kërkesës, ta marrë fjalën.

E bëjmë ne pauzën, por një paraqitje duhet ta dëgjojmë, një fjalë të qeverisë e vazhdojmë. Zonja Gaxherri e ka fjalën!

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra, që jeni prezentë,
Edhe e papranueshme mosprezenca e kryeministrit sot në këtë debat.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është organi më i lartë i këtij farë shteti tonë demokratik, e të ashtuquajtur sovran. Në mars të vitit 2010, po ky Grup Parlamentar ka ngritur debat për gjendjen dhe mosrespektimin e kushtetutshmërisë në Republikën e Kosovës, e kam marrë transkriptin sot me vete. Në prononcimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare sot për të futur këtë në rend dite, më zhgënjeu duke thënë se pajtohem për debat, por njëri prej tyre tha: “nuk besoj se do të dalë ndonjë gjë nga ky debat”. Ju pyes, fatkeqësisht nuk po kam kë ta pyes, sepse duhet të jetë ekzekutivi këtu sot, sepse unë nuk e di që ka çështje më të rëndësishme se sa kur të shkelet integriteti dhe sovraniteti i vendit çdo ditë, kur të fyhet e të poshtërohet një vend shtet demokratik e sovran dhe desha ta pyes kryeministrin se në çfarë forme duhet reaguari për çështjet e caktuara? Ne, mendojmë, si grup parlamentar, që e vetmja formë për të reaguari, kundërshtuar është përmes Kuvendit. Përndryshe, të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës, çështja ose gjendja në Kosovë është në eskalim. Për të eskaluar gjendja, jeni ju ata të cilët e keni prurë situatën në këtë nivel. Unë nuk e di sot, në fjalën time hyrëse a ta përsëris, ta lexoj transkriptin që e kemi pasur në mars apo çfarë të themi se gjendja reale është më e rënduar se sa në mars, kur ne kërkonim të merrnim masa konkrete që vërtetë mos të na ndodh kjo që po ndodh sot, që vërtetë mos të na hynë liderët serbë të armatosur me deklaratat dhe me programet konkrete të tyre, që ne do të bëjmë spastrimin etnik të Mitrovicës duke blerë pronat e shqiptarëve dhe Qeveria jonë prononcohet me deklarata qesharake, duke thënë nuk do të përdorim dhunën. Të nderuar zotërinj, kush thotë të përdorim dhunë. Ne kërkojmë të respektohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, të cilën ju nuk jeni në gjendje ta implementoni dhe ta mbronin e respektoni. Pse rrini ulur ju në institucionet e Kosovës? Pse s’ju vjen turp juve të dilni prej shtëpisë, e lëre më të vini e të uleni këtu.

Mos u qeshni, mos u qeshni, se mua do të më kishte ardhur turp! Zotëri, unë kisha dhënë dorëheqje, i nderuar, kisha dhënë dorëheqje! Ty po të shkelet sovraniteti i vendit, integriteti i vendit, ty po të hyjnë çdo ditë për t’i kontrolluar institucionet e Kosovës për korrupsion. Për çka jeni sot aty, për çka? Mua do të më kishte ardhur turp të ulem aty në vendet ku, vërtetë, e keni marrë votën ta udhëhiqni këtë vend krejt ndryshe, jo kështu. Dhe, prandaj bëhet ky debat në mënyrë institucionale, se nesër mund t’ju eskalojë situata dhe s’keni qare, se vinë populli, ua zë derën dhe ju përçan nga këtu. Ne i respektojmë institucionet prandaj, ju lutem, keni kujdes se po bëjmë debat, nuk po bëjmë shaka. Në qoftë se po ju duket qesharake dhe asgjë që është shkel integriteti i vendit, atëherë ne s’kemi koment, s’kemi çka të diskutojmë këtu. Kosova po përjeton krizë të brendshme dhe të jashtme, falë një udhëheqjeje krejt të pa dinjitetshme, një udhëheqje që vërtetë na qiti faqen e zezë në të gjitha aspektet.

Të nderuar kolegë,

Nëse i përsërisim edhe diskutimet e mëparshme, po them edhe transkriptet, unë mendoj që bëhet tepër. Lidhja Demokratike e Dardanisë krejt në mënyrë institucionale kërkon sot që ky vendim për herë të fundit para se të eskalojë situata në Kosovë, të marrë qëndrim, të dalim me qëndrim që zgjedhjet që mbahen nga Serbia, në të vetmin shtet në botë, ndodhë kjo në Kosovë, të ndalohen me qëndrim të unifikuar, të nderuar kolegë deputetë, sepse të gjithë e pranuat debatin, të mos bëhemi qesharak me vetveten, të mos debatojmë dhe të dalim e të themi se ne e bëmë një punë, sepse me deklarata na u mbytem çdo ditë. Kuvendi është organi më i lartë i këtij vendi, ka obligim të marrë sot qëndrim operativ, domethënë, të ndalohet, të bëjmë vendim për operativë, së bashku me faktorin ndërkombëtar, i cili njëjtë e ka përgjegjësinë sikurse institucionet tona këtu, se faktori ndërkombëtar e ka përgjegjësinë me Kushtetutën e këtij vendi, që nuk guxon t’i shkelet sovraniteti Kosovës. Ndërsa edhe nga faktori kombëtar

janë deklarata qesharake, ata nuk merren vesh me institucionet e vendit, ata nuk i shohin kur iu hyjnë liderët serbë në kufi që nuk di ku janë ata edhe Kosova është kështu si është, vjedh kush çka të dojë, hyn kush kur të dojë, plaçkit kush çka të dojë dhe kjo është realiteti. Andaj, ju lutem, të nderuar kolegë deputetë, t'i thërrasim arsyet se, fundi i fundit, secili nga ne veç e veç ka përgjegjësinë morale kombëtare këtu se e kemi marrë votën. Dhe, unë në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kërkoj që debati nga Kuvendi të dalë me qëndrim konkret operativ duke i marrë përgjegjësitë e veta edhe faktori ndërkombëtar që zgjedhjet e organizuara nga Serbia në veriun e Kosovës, të mos mbahen. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Komisioni funksional i lëmit, nuk është paraqitur. Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e donë fjalën në emër të Grupit?

Deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: I nderuar kryesues,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është jashtëzakonisht e mirë që njerëzit nga opozita kanë një hapësirë të pafundme ta shprehin mendimin bash ashtu si atyre ju teket, pa një herrije më të vogël intelektuale. Sidoqoftë, është meritë e kësaj Qeverie që ju sot e keni gjithë hapësirën e nevojshme për t'i ofruar mendimet e juaja për këtë çështje.

(Reagim nga salla)

Mirëpo, qëndrimi i juaj nuk do të thotë që Qeveria dhe Kuvendi që e ka shumicën të shkojë në lajthitje. Qeveria e Kosovës nuk ka nevojë të marrë vendim për një çështje që është me Kushtetutë dhe me ligj. Qeveria e Kosovës ka strategji të qartë për veriun e Mitrovicës dhe për pakicat në përgjithësi. Ne kemi deklaruar me përgjegjësi të jashtëzakonshme se unë jam edhe zëdhënës i Qeverisë, kur jam këtu si deputet.

Kemi deklaruar me përgjegjësi të jashtëzakonshme se qasja ndaj komuniteteve do të jetë qasje shumë adekuate edhe pa përdorimin e asnjë mjeti të dhunës. Në qoftë se Qeveria e Kosovës ka hartuar projektin për strategjinë e veriut, është Qeveria e Thaçi. Në qoftë se në veriun e Mitrovicës ka filluar ndërtimi i shtëpive, është Qeveria Thaçi. Në qoftë se ka filluar punimi i tokës në pjesën veriore të Kosovës, për të cilën ju po flitni, është Qeveria Thaçi. Ky fakt neve na gëzon jashtëzakonisht, ka shumë punë për të bërë, por më shumë se angazhimi i punës së Qeverisë Thaçi, neve na gëzon segmente të caktuara të opozitës të cilat janë ngritur në një nivel për t'u interesuar për çështjen nacionale. Dhe kjo është jashtëzakonisht e jashtëzakonshme dhe shumë e mirë, sepse ata deri dje kanë ditur edhe ndryshe, por, në qoftë se dje dikush ka luftuar për këtë vend, sot ne nuk kemi ndërmend t'ua bëjmë qejfin atyre për të cilët mendojnë se tash ne duhet ta përdorim dhunën dhe t'i mbysim të tjerët. Komunitetet pakicë, në veçanti pjesa e veriut, kërkon kohë dhe mund për të na **informuar** këtë problem. Ndërkaq, ne dimë edhe pak më shumë se sa opozita, kam ndërmend të punojë në këtë drejtim. Ne i dimë dosjet mbi të cilat do të bëjnë krimin më të madh ekonomik në atë pjesë.

Në këtë drejtim, nga kjo foltore i kërkojmë EULEX-it, ashtu si i kemi lejuar ta bëjë kontrollin e të gjitha dyshimeve të mundshme, në çfarëdo niveli qeveritar, t'i nxjerrë dosjet dhe të merret me çështjet e krimeve ekonomike, ku shefat e opozitave zënë vendin kryesor. Ju faleminderit shumë dhe i uroj pozitës një qasje edhe shumë ...

KRYESUESI: Në emër të LDK-së, kush e donë fjalën?

Eqrem Kryeziu e ka fjalën.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ma ka ndie zemra që ke për të më apostrofuar me emër e mbiemër. Edhe, si zakonisht unë po kërkoj lejen tuaj që t'i përshëndes zëvendëskryeministrin, ministrat tuaj dhe patjetër edhe kolegët e zonjat e dashura deputete edhe zotërinjtë e nderuar, natyrisht.

Tani, meqë unë u vonova pak, t'ju them të drejtën nuk jam krejt komod, po më duket, por nuk është kjo krejt ende e qartë për mua, por po më duket se ndonjëherë Parlamenti i nënshtrohet një ankandi të patriotizmit. A e kam mirë, a jam i trullosur, unë me të vërtetë nuk e di, mirëpo ju lutem, prandaj po them, unë me sa di, dy herë na bëjmë lëshime duke pasur një mirëkuptim tepër të madh për LDD-në dhe pa procedura i fusim në rend dite temat për debat.

(Reagim nga salla)

Me të vërtetë dua të them që patriotizmi është patriotizëm, por qe besa edhe procedurat janë procedura edhe sa i përket drojës, sepse ka do zhvillime objektive atje, pa marr parasysh mirëkuptimin tonë të Kryesisë, e kam fjalën për kërkesat e LDD-së, a natyrisht disa fenomene zhvillohen atje. Unë do t'i quaja më tepër çështje policore, se sa, kryesisht policore se sa politike, sepse secili fis ka drejtë ta zgjedhë "pogllavicën" e vet që i thoshin përpara, ajo nuk është ku ta di sa shqetësuese. Tash sa do të jenë legjitime ato zgjedhje, varet prej institucioneve demokratike edhe shoqërisë demokratike të Kosovës. Mos ta harrojmë, deputetë të nderuar, sepse krejt esenca është kështu. Në qoftë se ne konkurrojmë, siç jemi betuar edhe zotuar se do të bëjmë një shoqëri demokratike, atëherë ato zgjedhje dhe përpjekje mbetën për muze. Mos harrojmë gjithashtu se madje edhe diktatura e Millosheviqit ka qenë tolerante ndaj përpjekjeve të tilla. Ne shpesh po harrojmë, por dallimi ndërmjet Millosheviqit dhe Kosovës, është sepse ne po e bëjmë një shtet demokratik dhe prandaj perspektiva e këtyre përpjekjeve është e kotë, për dallim nga ajo periudhë e Millosheviqit që ishte totalitare dhe kjo përfundoi. Kështu që, në këtë aspekt, në qoftë se veç nuk është ankand i patriotizmit, atëherë po propozoj që t'i shikojmë gjërat në këtë formë, natyrisht duke qenë tolerant, të mos i imitojmë kurrësi modelet që i ka dhënë Millosheviqi, qe besa edhe politika serbe për një kohë shumë të gjatë. Ju faleminderit! Besoj se ju kënaqa juve, kryesues i dashur edhe këta të tjerët.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu!

Meqë të gjithë këtu po i interpretojnë çka ndien e çka nuk ndien, megjithatë nëse procedura është demokraci, sot e kemi ushtruar demokracinë deri në pikën prej A deri ne Zh dhe besoj që këtu jeni të gjithë të pranishmit, e dini çka ndodhur ashtu, me procedurë.

Fjalën e merr përfaqësuesi i AAK-së. Kush do të flas në emër të AAK-së? Zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Po mendoj që ka tendenca për ta degraduar dhe për ta dezorientuar këtë debat shumë të rëndësishëm dhe për ta zbritur nivelin e Kuvendit. Konsideroj që të kemi pak respekt, më së pari për vetveten, mbasandaj edhe për kolegët. Nuk vihet në dyshim që mosveprimet e Qeverisë në raport me Mitrovicën po e degradojnë shtetësinë e Kosovës dhe po e dërgojnë mesazhin e skeptikëve që Kosova nuk është e aftë të funksionojë si shtet. Ka kohë, po thuaj se tri vjet që tentojmë që të përkrahim sadopak rrugën për shtrirjen e ligjit, të rendit në mbarë territorin e Kosovës, duke kërkuar nga kjo Qeveri dhe duke ofruar platformën tonë si parti politike. Kemi përmendur shumë herë hapjen e nënstacioneve policore, të cilat janë përkrahur nga EULEX-i, por jo nga Qeveria e Kosovës, ndërtimin e objekteve madhështore në pikat 1 dhe 31, për të mos lejuar që kriminelë dhe banda të hyjnë e të dalin sa herë të donë në

Kosovë, vendosjen e targave të KS-së dhe një numër të rekomandimeve të tjera të cilat kjo Qeveri nuk i ka marrë parasysht, por në fund luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë dhe me theks të veçantë në veri të Kosovës, dhe çka kemi si rezultat?

Qytetarë të Kosovës,

Të nderuar deputetë dhe Qeveri,

Edhe më tutje po ballafaqohen me një krijesë të Partisë Demokratike të Kosovës, me një strukturë të inteligjencës nëntokësore, e cila së fundi është thënë edhe nga Komiteti Kombëtar i Politikës së Jashtme, me emrin SHIK, që ende po funksionon në Kosovë dhe në bashkëpunim me bandat kriminale serbe po grabitin qytetarët e Kosovës, po kontrabandojnë, me theks të veçantë, në veri të vendit, duke inkasuar miliona euro. Dhe këtë nuk po e thotë vetëm Aleanca, e kemi thënë shumë kohë më parë të brengosur për gjendjen në të cilën është katandisur Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj, por kemi hasur në vesh të shurdhër. Kjo së fundi është konfirmuar edhe nga, po e citoj: Komiteti Kombëtar i Politikës së Jashtme Amerikane, në raportin e tij për Kosovën dhe kjo, të nderuar deputetë, është Qeveria Thaçi. Përderisa ju dhe më tutje keni shërbime të inteligjencës kriminale të cilat drejtpërsëdrejti ju raportojnë, të cilat brenda vitit inkasojnë qindra miliona dollarë, euro çka do qoftë, në bashkëpunim me kriminelë serbë, ju nuk keni asnjë mandat, nuk keni fuqi, nuk keni vullnet politik për të stopuar në fakt këtë në veri të vendit, për të shtrirë në territorin e Kosovës rendin, ligjin dhe funksionimin e Kushtetutës, për këtë arsye kemi këtë abstenim të Qeverisë, këtë frikë për të ndërmarrë hapa dhe veprime konkrete në mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës. Për këtë arsye, kemi lejin e mbajtjes së zgjedhjeve serbe, të Serbisë në Republikën e Kosovës, për këtë arsye kemi dhunimin e kufirit të Kosovës dhe nuk kemi asnjë reagim, asnjë ndërhyrje, nuk kemi asnjë mbrojtje nga kjo Qeveri. E keqja, lajm i keq për qytetarët e Kosovës, është që kjo do të vazhdojë, derisa kjo Qeveri e cila është pjesë e këtij krimi, të jetë në pushtet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin Kuvendor të AKR-së, Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Po më vjen shumë keq që kjo temë po degradohet vazhdimisht dhe po përshtatet me temat paraprake, me gjenocidin i cili është zhvilluar më herët, mirëpo unë mendoj që politikën, të cilat duhet t'i udhëheqë shteti jonë demokratik dhe detyrat e tij që i ka si shtet, nuk përkojnë me politikën që i ka udhëhequr Millosheviqi. Millosheviqi ka ushtruar gjenocid mbi popullin tonë, ndërsa ne nuk po kërkojmë gjenocid, por po kërkojmë të marrim masa, të cilat ne duhet t'i marrim përmes Kushtetutës, të cilat i kemi, me Kushtetutën e Kosovës. Andaj Kushtetuta jonë e mbron sovranitetin dhe integritetin e shtetit dhe ne duhet t'i kemi funksional këta mekanizma, duhet ta kemi Ministrinë e Punëve të Brendshme, po ashtu bashkëpunimin me EULEX-n. Nuk po shohim masa konkrete. E dini që kohëve të fundit edhe strategjia për veriun veç është përfolur dhe asnjëherë nuk ka filluar as së zbatuari. Ku jemi si shtet? Nëse ne në Kuvendin e Kosovës i banalizojmë këto tema, nëse ne nuk e shohim të arsyeshme që në Kuvendin e Kosovës të bisedojmë për këto tema, atëherë nuk e di se ku duhet të bisedojmë për këto tema, sepse është temë madhore. Ne e kemi nënshkruar atë Kushtetutë, ne e kemi miratuar atë Kushtetutë dhe ne duhet ta mbrojmë.

Më vjen keq që nuk është pjesa dërmuese ata të cilët marrin vendime në Qeverinë e Kosovës, të jenë prezentë dhe ta shohin edhe popujt tjerë edhe populli i cili edhe shteti i cili po tenton të ndërhyjë në shtetin e huaj, shteti i Serbisë, i cili çdo ditë bën hapa për të ndërhyrë dhe për të marrë një pjesë të territorit të Kosovës. A thua të nderuar deputetë, ne kemi të drejtë si shtet

të mbajmë zgjedhje në Serbi, a na lejohet neve një gjë e tillë, a na lejohet neve që të armatosur të hyjnë politikanët tanë në Serbi, nuk lejohet dhe as propaganda politike? Andaj pse mos të marrim masa që edhe ne si shtet ta tregojmë performacën dhe t'ju tregojmë edhe të tjerëve që jemi të interesuar edhe të debatojmë edhe të marrim masa konkrete edhe të veprojmë, sepse duke iu ikur edhe debateve edhe përgjegjësive të cilat i kemi si shtet, unë mendoj se nuk do të shkojmë askund. Andaj ne e përkrahim dhe duam të dalim me një vendim konkret nga kjo seancë plenare, që shteti i Kosovës, Parlamenti i Kosovës, Qeveria, pozitë- opozitë jo vetëm pozitë, por edhe ne si opozitë jemi përkrahës që të bëjmë diçka para se të eskalojë situata, sepse për të gjitha, barrën e marrim ne si shtet, ne si shoqëri dhe familjet tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Grupi “7+”, a ka? Nuk ka. Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Mi smo mislili, kada je uvrščena ova tačka u dnevni red, da će biti rasprave koja bi ponudila neka rešenja koja bi dala neke predloge. Međutim, iz ovoga što smo do sada čuli, sve je to neka krivica jednih i drugih, pitanje severnog dela Kosova, i ne samo severnog, ovde se ograničavamo na sever. Izbori se organizuju i u Novom Brdu i na drugoj teritoriji, znači nije samo sever u pitanju, nije to pitanje od 2008. godine ili 2007, od kako ova Vlada ili neka druga, ovo pitanje je od 99-te godine do danas, stalno isto ili je približno isto. Nikada institucije Kosova nisu imale svoje vlasti, da kažem, gore na Kosovu. Ponekad se govori o paralelnim strukturama na severu, neko je neki dan rekao nisu to paralelne strukture, paralelne bi bile kada bi postojale druge kosovske. Tamo postoje samo jedne i to više nisu paralelne nego jedne, a da bi bile paralelne, potrebno je da postoji kosovske, a pošto naše ne postoje, onda tamo nema paralelnih struktura nego su to u ovom trenutku jedino, jedine „legalne strukture“. Mislim da nije korektno da se za sve što je loše okrivljuje ova vlast. Sigurno da ima deo odgovornosti, ali ne može biti odgovorna za nešto što ne raspolaže, odnosno nešto što ne može da završi u ovom trenutku. Moguće je da nije reagovala na najbolji način, preko EULEX-a u početku, kasnije mislim da su se neke stvari ispravile.

Pitanje severnog dela Kosova je veoma osetljivo pitanje. Parlament mora da napravi, da približi svoje stavove. Ne možemo mi danas izaći sa stavovima ukoliko naj taj način govorimo jedni o drugima. Ovo nije partijsko pitanje, ovo je državno pitanje, ovo je pitanje na koje treba da se postigne neki konsenzus, gde bi se izašlo sa nekim stavovima. Ovako kako vidim, ne znam kako ćemo, možda ćemo ispričati se, izdebatovati, ali na kraju ne verujem da ćemo imati neki konkretan rezultat.

Možda je bilo potrebo da se uvrsti ova tačka u dnevni red, ali da se naprave određene pripreme, da dobijemo neki izveštaj ili Vlade ili nekoga drugog, pa da se na tom dokumentu raspravlja. Ja ne znam koji će biti zaključci sa ovog sastanka. Mislim da smo nespremni ušli u ovu debatu, valjda će kasnije diskutanti, neki biti pametniji od mene pa će dati konkretne predloge. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për SLS-në, Petar Miletij.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Mi smo na početku ove sednice bili protiv da se ova tema uvrsti u dnevni red i dosadašnja diskusija nam je pokazala da smo bili u pravu, da će ovo ipak biti debata samo radi debate, da će poslanici koristiti ovu temu za svoju političku promociju i da se iznesu teške reči. Nećemo ulaziti u temu zato što smo bili, kažem protiv ove debate i kao što reče kolega pre mene, kolega Sadik, da iz ove debate neće proizaći neko rešenje. Za neko ozbiljnije rešenje na

severu Kosova, obzirom da sam ja jedini poslanik u ovoj Skupštini koji živi u severnoj Mitrovici, to mogu reći sasvim otvoreno i slobodno da je potreban mnogo, mnogo ozbiljniji rad, ozbiljnija debata i uključenje mnogo više faktora nego što je Skupština. U svakom slučaju, hteo bih da pozovem kolege onako kolegijalno da se uzdrže teških reči, kako bi debata poprimila onakav ton kakav bi trebao da ima. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për Grupin për Integrim, nuk ka të paraqitur. Unë tash ju informoj që kemi 18 të regjistruar deri tash që donë të bëjnë debat për këtë temë. Unë mendoj që para dreke është e pamundur të shteren gjithë këta diskutues, ashiqare, mendoj që është koha ta bëjmë një ndërprerje, të shkojmë në drekë dhe të kthehemi në orën 14:00. A pajtoheni? Vazhdojmë në orën 14:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze, në orën 14:00

KRYESUESI SABRI HAMITI: Ju lutem deputetë, uluni në vendet e juaja për ta vazhduar bisedimin. Kuorumin e kemi.
E ftoj ta marrë fjalën deputeten Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Jemi pak a shumë në një situatë të zhvillimit të politikave të një absurditeti dhe groteske në politikën tonë qeverisëse, prandaj është bukur vështirë edhe çfarëdo që thuhet që të zërë vendin e vet, sepse problemet kanë shkuar aq larg sa që çdo fjalë është më e vogël dhe është më e dobët se sa realiteti, por fatkeqësisht i keq që po ndodh në vendin tonë.

E kam thënë edhe herëve tjera dhe do ta përsëris se me këtë Qeveri të komprometuar dhe të inkriminuar në korrupsion dhe në krim të organizuar, nuk mundesh për të pritur ndonjë sjellje tjetër nga sjellja e cila realisht po ndodh, qoftë me veriun, qoftë me hyrjen e zyrtarëve serbë këtu, qoftë edhe me të gjitha problemet të cilat e preokupojnë vendin tonë.

Populli thotë se “ua ka zënë rrota bishtin” edhe unë po them se qeveritarëve ua ka zënë rrota bishtin edhe për ta ruajtur lëkurën e vet, janë në gjendje për të bërë gjithçka, janë në gjendje për të pranuar gjithçka edhe, ndoshta për të shkuar edhe deri në ekstrem, jo veç të falin gjithçka, por edhe ta humbin krejt atë çka e kemi ndërtuar, mos të them me dekada, po mbase edhe me shekuj. Ne e kemi pasur të qartë se EULEX e ka thënë shumë qartë se janë institucionet e Kosovës dhe Policia që e ka mundësinë dhe të drejtën për t’i ndaluar ata persona aty që hyjnë pa leje dhe pa njoftim në Kosovë dhe Qeveria jonë nuk e ka bërë një gjë të tillë. Qeveria jonë ka pasur të drejtën dhe mundësinë ta bëjë një kërkesë dhe një njoftim edhe në Interpol për këta persona, por as këtë nuk e ka bërë.

Zotëri kryesues, unë do të përmend një fjalë që e di se nuk lejohet në Parlament, do të them që kryeministri këtu gënjeu dhe kërkoj falje, sepse në këtë Kuvend nuk lejohet të thuhet gënjeu, por lejohet për gënjyer dhe unë mendoj që është fat i keq për këtë popull kur lejohet të gënjejë kryeministri. Dhe tha që po e luftojmë korrupsionin, po e luftojmë krimin e organizuar e tjerë, e tjerë në kohën kur një komitet shumë i rëndësishëm i Qeverisë amerikane jep të dhëna alarmante, jep të dhëna tepër të rënda për një qeverisje, në këtë rast do të thosha edhe për një shtet, siç është vendi jonë, në një qeverisje fatkeqe me përfitime prej 200 milionë dollarëve në vit nga krimi i organizuar që e bën SHIK-u, bashkë me zyrtarët e PDK-së. Dhe unë nuk e di, kjo Qeveri, mbase shumë shpejt, a ka mundësinë ashtu siç disa prej ne deputetëve kur fillimisht jemi përpjekur që ta zhveshim këtë Qeveri dhe këtë qeverisje nga ajo mburojë e saj gjëja për qeverisje të mirë, se një qeverisje në fakt e inkriminuar dhe për ta

klasifikuar dhe kualifikuar edhe me epitetet shëndetësore, të shëndetit mental dhe nuk di kjo qeverisje a do të thotë që edhe Komiteti Amerikan, apo anëtarët e atij Komiteti kanë probleme mentale, sepse kanë thënë që në Kosovë 200 milionë euro, SHIK-u i merr nga krimi dhe nga marifetet tjera të cilat bëhen bashkë me zyrtarë të PDK-së, domethënë e ka thënë shumë qartë me të PDK-së.

Unë mendoj që minimumi i dinjitetit për qytetarët dhe institucionet e Kuvendit, është që të mos lejohet mbajtja e zgjedhjeve të paralajmëruara serbe në Kosovë. Është shumë e çuditshme që janë edhe disa serbë mbase, unë mendoj që keni mundur t'i dëgjoni edhe ju dhe të informoheni, janë edhe disa serbë që e kundërshtojnë, madje e kundërshtojnë edhe në emër të Rezolutës 1244, mbajtjen e këtyre zgjedhjeve dhe, nëse mbajtja e këtyre zgjedhjeve edhe sipas asaj Rezolute, nuk mund të bëhet, qohen zyrtarët tonë të partive politike në pushtet dhe japin një përkrahje jo të çuditshme, jo absurde, po tmerruese për vendin, tmerruese për qytetarët e Kosovës. Kjo vërtet nuk ka asnjë shpjegim, përveç ndoshta ka ndonjë fuqi tjetër mbinatyrore që mund t'i japë shpjegime të caktuara krejt kësaj. Pozita po thotë se është mirë për t'i mbajtur këto zgjedhje. Njëri prej zyrtarëve të tyre, madje e barazoi këtë qëndrim tonin që duhet për t' i lejuar ato zgjedhje, duke barazuar këtë me kohën e Millosheviqit.

Duke i përzier ndjenjat e popullit për liri, me veprimet e kriminelëve apo një grupi kriminel apo të bandave në vendin tonë të pavarura a? Ne kemi shpallur pavarësinë dhe po themi se jemi sovran dhe këtë për fat të keq e bëri në emër të LDK-së dhe hiq nuk ka rëndësi a jam unë pjesë e LDK-së apo jo, por mendoj që LDK-ja nuk meriton një fyerje të këtillë.

Qytetarët e Kosovës nuk meritojnë një fyerje të tillë dhe do të ishte mirë që një diçka e tillë të ndalohet. Unë mendoj se kjo Qeveri është shumë e paaftë edhe duhet të shkojë. A do të shkoj para apo pas datës së paralajmëruar për mbajtjen e atyre zgjedhjeve, nuk e di, por do t'i preferoja që është më mirë të shkojë përpara, dëmet do të jenë pak më të vogla për vendin, sepse zgjatja e mëtutjeshme, do të krijojë dëme të pariparueshme për kohën ndoshta tepër të gjatë për vendin tonë. Dhe krejt në fund, të nderuar deputetë, unë nuk mendoj se është mirë ky Parlament si institucion i qytetarëve të Kosovës të bëjë debat për hir të debatit. Mendoj që definitivisht duhet të merren qëndrime që i obligojnë institucionet e vendit në mënyrë decitive që të ushtrojnë pushtetin dhe ta konsiderojnë këtë debat një ndihmesë për ta, një ndihmesë ndoshta, do të thosha krejt të fundit, sepse nuk ju ka mbetur edhe shumë hapësirë, madje as për të folur as për të vepruar, por le ta marrin si një ndihmesë që Parlamenti i Kosovës iu bënë për mos mbajtjen e zgjedhjeve serbe të paralajmëruara për të dielën. Ju faleminderit shumë!

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: E merr fjalën si diskutues, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vërtet, në fillim menduam se do të jetë një debat për çështjen që u shtrua dhe me të drejtë u shtrua këtu dhe nuk do të jetë një debat akuzues dhe vetë akuzues, thuaja se të gjitha problemet qenkan në mesin tonë dhe këtu në këtë Kuvend dhe jo jashtë kësaj. Dhe debati sikur rrëshqiti në një segment krejt tjetër, sikur ne këtu po e akuzojmë një parti ose partinë tjetër. Diçka dua t'ju them, ju e dini vitin e kaluar, ka pasur të arrestuar në regjionin e Mitrovicës, pikërisht për kontrabandën që është kryer në ato pjesë dhe njerëzit kanë qenë dhe janë akoma, dikush në ndjekje, dikush në burg shtëpiak, dhe ju e dini shumë mirë se cilët dhe kush janë ata që qëndrojnë prapa tyre. Kjo çështje le t'i mbetet organeve hetuese.

Unë nuk dëgjova, janë njerëz të partisë suaj, që ata njerëz që sot ndiqen, e kam thënë edhe një herë, por po e përsëris për herën e dytë, që në ditëlindjen e Ramush Haradinajt, për dhuratë i qojnë nga 100 mijë euro në pliko, unë ia them edhe emrin e mbiemrin njeriut që ndiqet dhe që është arrestuar dhe është lëshuar në shtëpi dhe që i ka sjellë te ju dhe që merret, pikërisht merret me kontrabandën e karburanteve në vijat kufitare të pjesës veriore. Lypeni, gjejeni ju kush është ai, unë e thashë, ua dhashë adresën, janë emrat.

Çështja tjetër, po e them, nuk dëgjova nga asnjë diskutues, përkundër asaj që është keq që na sillen vërdallë nëpër tokën tonë, nëpër terrenin tonë, nëpër vendin tonë, nëpër shtetin tonë njerëz të paautorizuar, të armatosur dhe jo të armatosur me misione humane dhe johumane dhe të flasin dhe nuk dëgjova asnjë propozim që të thuhet se çka dhe cila është ajo mënyrë, ai mjet, ajo formë që ne të dalim nga ajo gjendje dhe vërtet të bëhemi kontrollues të vijave kufitare tonave, por gjithmonë duke akuzuar se kjo bandë ose ajo bandë ose ajo tjetra. Nuk doli me propozim që të thotë Kuvendi, që s' është detyrë e Kuvendit, por e Qeverisë, që të dalë me një listë me një listë të autoriteteve serbe që nuk kanë të drejtë të hyjnë dhe ajo listë të shpërndahet nëpër të gjitha pikat kufitare dhe natyrisht, të merren organet që ruajnë kufijtë dhe mbrojnë kufijtë.

Ju e dini, ne kemi pasur arrestime të njerëzve tanë edhe në shtete tjera, janë ndalë nëpër kufi, janë mbajtur me 3-4 ditë ose dy-tri ditë, sepse Serbia i ka shpërndarë ato lista se kush duhet të ndalet dhe kush nuk duhet të ndalet. Prandaj, nëse është dashur të kërkohet, është dashur të kërkohet nga Qeveria që të bëhen vërtet lista të tilla të njerëzve të padëshiruar për Kosovën këtu dhe ato lista t'u adresohen edhe kombëtarëve edhe ndërkombëtarëve që janë përgjegjës për ruajtjen e kufijve dhe në momentin kur këto autoritete nuk merren me zbatimin e vendimeve që dalin nga autoritetet qendrore, atëherë t'i shtrojmë çështjet edhe për debat edhe për diskutime edhe për përgjegjësitë të secilin që është dhe gjendet kudo nëpër pozita që ka përgjegjësi për çështje të caktuara. Të flitet këtu se SHIK-u po marrka 200 milionë se kjo parti qenka prapa saj, kjo nuk i kontribuon as gjendjes, as situatës as kurrkujt.

Zonja Tërmkolli, i dimë ne të bëmat edhe të Tërmkollëve edhe të Kocëve, edhe të Avdi Tërmkollit, edhe tuajat edhe të gjithë të tjerëve. I dimë lidhjet edhe të djeshit, edhe të sotit edhe të nesërme të secilin kush me kënd është.

KRYESUESI: Është përmendur emri Tërmkolli.
Melihate, i ke dy minuta!

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk përmenda emra, por pasi zoti Koci, tash po ia përmend emrin e mori barrën e SHIK-ut mbi vete, unë përmenda SHIK-un dhe PDK-në, në fakt nuk e përmenda unë, por e thashë atë që e ka thënë Komiteti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pas një analize që e ka bërë se SHIK-u, bashkë me PDK-në, në Kosovë po mbledhin para, po mbledhin para, me korrupsion, me krim të organizuar, me tjerë, 200 milionë dollarë në vit. Këtë nuk e kam thënë unë, e kanë thënë ata, Prandaj, nëse ke ndonjë problem, shko dhe demantoja. Sa u përket Tërmkollëve, zotëri, unë e thashë edhe më herët, ti nuk e ki për nder hiq për ta përmendur emrin dhe po me vjen keq, por përndryshe jam shumë krenare edhe për Melihaten, edhe për krejt familjen, jam tepër krenare për punën që e kam bërë, po ua përsëris edhe një herë, kur Melihate Tërmkolli ka punuar për t'i hequr këto banda serbe, ju keni shitur farmerka, për të mos thënë, tash po ua them – edhe keni vjedhur, tash po ua them – edhe keni vjedhur. Ju faleminderit shumë!

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, ua tërheq vërejtjen. Zonjë, ulu se me bërtitme s' mbërrin kurrgjë. Ulu, njëherë prit!

Zotërinj e zonja, kolegë deputetë,

Tema për të cilën po bisedojmë dhe të cilën e votuat të gjithë, me përjashtim të dy njerëzve këtu, është cenimi i integritetit dhe i sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë. Unë e di që ju hidhëroheni për ta komentuar, s'do të komentoj kurrgjë tash, kur të më vjen koha, ndoshta edhe e komentoj, por po ua tërheq vëmendjen, me Rregullore kur iket nga tema, unë do t'ua bëj vërejtje, nuk është çudi që edhe ua marr fjalën. Ju lutem shumë, nëse të gjithë e keni votuar këtë temë, hiqni dorë nga temat tjera dhe lëni, se do të ketë kohë të bisedohet për të gjitha, sepse unë e konsideroj temën tepër serioze dhe, nëse ju vullnetarisht rrëshqitni në tema të tilla, ta dini që vullnetarisht po i ikni temës që e keni kërkuar. Ju faleminderit!

Fjalën e merr Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, është një temë mjaftë e prekshme edhe për qytetarin edhe për ne si deputetë dhe të gjithë e dinë që Qeveria e Republikës së Serbisë nuk e mendon asnjë të mirë për Republikën e Kosovës. Meqë Qeveria e Republikës së Serbisë nuk e mendon asnjë të mirë për Republikën e Kosovës, shtrohet pyetja domosdoshmërisht: Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet t'i mendojë të mira Republikës së Kosovës dhe nuk dua të mendoj si Qeveria e Republikës së Serbisë dhe meqë nuk po u dashka Qeveria e Republikës së Kosovës të mendoj si Qeveria e Republikës së Serbisë, atëherë duhet të përgatitet t'i kundërshtojë të gjitha parregullsitë që janë krijuar pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Do të thotë, ne në rend të parë nuk kemi sovranitet, ne në rend të dytë nuk e zhvillojnë sovranitetin e 25% të territorit tonë. Në rend të tretë, në bashkëpunim, jo pa bashkëpunim, po në bashkëpunim komuniteti serb me komunitetin shqiptar dhe një pjesë e komunitetit shqiptar, fatkeqësisht janë anëtarë të PDK-së. Nuk kisha pasur qejf, por i kemi këtu plot njerëz që i njohin, e kemi ministrin e Punëve të Brendshme që i njohin. Unë nuk po dua t'jua përmend me emra, por do t'jua marr një shembull.

Të nderuar deputetë,

Në pjesën veriore të urës së Ibrit, është një pompë e benzinës që e shtet 60 cent litrin e benzinës dhe të naftës. Në pjesën jugore, në hyrje të Suhadollit, është prapë një pompë e benzinës që e shet 60 cent naftën. Dhe unë rastësisht kam shkuar e kam pyetur atë shqiptarin- a e ke çelur ndonjë bunar që po të del naftë, a ku po e merr që po mundesh për ta shitur kaq lirë dhe po ju them sinqerisht, ai më thotë: e kemi bërë pykë me ata të tjerët. Po ju them tash edhe një herë, ai, fatkeqësisht ka qenë punëtor i UDB-ës, fatkeqësisht është bërë pjesëtar i UÇK-së, fatkeqësisht është punëtor i SHIK-ut dhe fatkeqësisht punon me punëtorin e UDB-ës, bashkë në atë anë, fatkeqësisht. Pajtohem me zotëri Gani Koci, që edhe më herët edhe tash, ka pasur kontrabanda edhe prej Qeverisë së kaluar dhe prej të tashmes, por unë po flas me fakte, që doni, unë ua përmend emrin se ua di emrat, domethënë unë ua di emrat, mirë. Ia di edhe atij që e ka pompën në këtë anë edhe në hyrje të Suhadollit, e di kush e ka pompën edhe emrin qysh e ka edhe çka ka bërë pas lufte edhe çka ka bërë në luftë edhe çka ka bërë edhe emri ku ju ka gjendur fill pas luftës, ku iu ka gjendur emri, e di mirë, domethënë, nëse doni ua përmend.

Prandaj, jo, jo nuk po dua, por e din, ministri i Punëve të Brendshme e dinë për ke e kam fjalën, dhe një prej deputetëve këtu, edhe Gani Koci e di për kënd e kam fjalën, por nuk po dua për të hyrë andej. Meqë nuk po dua të hyj andej, unë po ju them, ne po kërkojmë dalje, po

kërkojmë dalje nga kriza që e ka kapluar, po kërkojmë dhe për me pasur dalje, duhet për të propozuar diçka.

Ne, fatmirësisht para nja 3 muaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë e ka propozuar një rezolutë dhe ju të gjithë këtu e keni injoruar rezolutën, e kemi bërë bashkë një deklaratë, ajo deklaratë është: “fol e rruaj ve” dhe atë deklaratën që e kemi bërë ne së bashku, që nuk ka qenë obligative për askënd, tash na ka dal prapë problemi që Vojsllav Koshtunica vjen me armë, me duar në xhepa deri te ura dhe thotë: “këtu është Serbi” dhe nëse Vojsllav Koshtunica vjen deri te ura me duar në xhepa dhe thotë: “këtu është Serbi” dhe ne e marrim jo seriozisht këtë punë, kjo s’ ka kuptim. Unë kam, e përgëzoj Lidhjen Demokratike të Kosovës për fuqinë që e ka. Ju japtë Zoti fuqi, për fuqinë që ka që mbështet këtë qeverisje, hallall i qoftë, më zor nuk ka, po por po e mbështet. Unë i gëzohem sinqerisht ku po e marrin këtë fuqi për ta bërë këtë mbështetje të kësaj Qeverie që Vojsllav Koshtunica të vijë te ura, me duar në xhepa, me persona të armatosur dhe ne të themi që kjo mund të jetë e barabartë me do regjime tjera. Ju lutem, ju zoti Gani, keni kërkuar që ne të dalim me propozime. Ne kemi propozuar, e kemi propozuar një rezolutë. Rezoluta i ka nja 5 pika e tri nënpika. Unë mund ta lexoj vetëm një: “Kuvendi i Republikës së Kosovës, kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që në tërë territorin e vendit, të vendoset rendi, ligji duke garantuar kështu funksionimin e sistemit juridik dhe politik të Republikës së Kosovës”. Kjo është një prej pikave, do të thotë, kemi kërkuar, nuk kemi kërkuar deklaratë. Ju atëherë, e futet në pikën e rendit të ditës një deklaratë që nuk e obligon kërkon. Dhe fill më vonë, dolët me një strategji dhe nëse ne nuk kemi pasur nevojë për rezolutë, ne nuk kemi pasur nevojë as për strategji, sepse kemi Kushtetutë, dhe në momentin që një shtet ka Kushtetutë, nuk ka nevojë për letra. Por kur nuk zbatohet Kushtetuta, kur nuk zbatohen ligjet, tani grupet parlamentare e kanë edhe atë detyrë të dalin, t’ i përmendin të këqijat. Ne si opozitë, pozitës dhe ju i keni për detyrë me i përmendur të mirat e juaja. Fatkeqësisht po keni pak të mira dhe populli po e sheh që shumë pak të mira. Pse nuk keni të mira, sepse fatkeqësisht keni hyrë në korrupsion të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm, por unë dua me ua marrë një shembull që parja të le pa mend dhe juve, dikujt që nuk ka pasur asnjë pare në xhep, i ka lënë pa mend kur ka bërë pare, kështu që nuk i kanë pasur metë hiq dhe kanë vjedhur sa kanë mundur, mandej kur o dol EULEX-i dhe ka thënë keni vjedhur ju po doni për të trenuar neve, nuk jemi bre burrë Qeveri, domethënë, këtu është problemi, nuk kemi faj na. Unë si deputet i Republikës së Kosovës që jam në këtë mandat, nuk kam faj bre burrë as për mandatet e tjera dhe, nëse unë kërkoj që Qeveria e Republikës së Kosovës të japë llogari para qytetarit të Republikës së Kosovës, nuk jam fajtor unë, ose, nëse opozita kërkon dhe i gjen të këqijat e pozitës, kështu e ka demokracia në tërë botën, mos u hidhëroni ju, sepse ne duhet t’i gjejmë të këqijat që të përmirësoheni, dhe këto që po ua përmendim, janë për t’u përmirësuar. Nuk jemi ne që po domi për të luftuar tash me Serbi se edhe nuk mundemi, me dashur nuk mundemi, nuk na e qon rrota se e kemi provuar për të luftuar me Serbinë, pa ardhur ata për të na ndihmuar nuk kemi mundur. Kështu që ne po kërkojmë që në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar që e kemi edhe në rezolutë kur e kemi propozuar, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar t’ ua ndalojmë hyrjen serbëve të cilët kanë qenë edhe të akuzuar për krime lufte dhe tani hyjnë lirisht në Kosovë dhe shesin qellëm se Kosova është Serbi. Nëse e pranoni që Kosova është Serbi, atëherë edhe unë nuk kam çka të bëj, se nuk mundem vetëm, por unë besoj që ju nuk do ta pranoni, sepse e kemi bërë Kushtetutën. Nuk lejon Kushtetuta e Republikës së Kosovës që të ketë dy territore, veri dhe jug. Nuk ka Kosovë veriore. Rreziku qëndron në termin Kosova veriore. Nëse ne i themi Kosovë veriore, paska edhe një Kosovë jugore, nëse ne i themi sistem paralel, paska edhe një sistem tjetër, por tjetër nuk kemi ne, asnjë komunë nuk ka sistem tonin atje, veç sistemi i Serbisë. Nuk ka sistem paralel as në Leposaviq, nuk ka as në Zveçan, nuk ka asnjë sistem paralel atje, atje është sistemi i Serbisë, funksionon Kushtetuta e Republikës së Serbisë, funksionon UDBA, dhe UDBA është e lidhur tërthorazi me punëtorët e SHIKUT që nuk po kam qejf të jenë, por janë,

janë çka kemi për të bërë edhe ju e dini që janë dhe nuk janë ata të lidhur për patriotizëm, por për para, janë të lidhur për naftë. Dhe nëse themi ne që një Institut Kombëtar Amerikan, nuk është shqiptar, ne e dinë që nuk është shqiptar, por është amerikan dhe ne gjithnjë kemi thënë që amerikanët kanë bërë gjithçka për Kosovën, dhe institutet kombëtare amerikane janë ato që po na i hapin sytë neve:” Hapni sytë se keq po shkon puna në Kosovë” e ne tash po hidhërohemi, s’ po flasim në mes vetit për shkak të kritikave me vend, për shkak të kritikave me argumente. Kush i ka argumentet, e ka argumentin në xhep, shtini duart në xhepa e rri se nuk ke çka bën.

Tash po ju them sinjerisht, ne e kemi në rend dite shkeljen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, dhe shkelja e sovranitetit dhe integritetit territorial po bëhet në të gjitha format.

Ministri i Punëve të Brendshme e dinë ku është Dudi Kërshi. Te Dudi Kershin ndalen kamionë e kamionë, pa tabela dhe me tabela dhe e shkarkojnë mallin, e mbushin nëpër kombi dhe e bien në territorin tonë, në jug qysh po i themi, e bien brenda te shqiptarët dhe Qeveria e Republikës së Kosovës i ka qitur doganierët te varrezat ortodokse. Të gjithë e dinë ku janë varrezat ortodoksëve, në hyrje, kush do aty i sheh, por edhe prej varrezave ortodokse po u ngrite pak në këmbë ose po të hipësh në një shtëpi, e shohim Dudi Kershin dhe i shohim kamionët. Nuk po i shoh veç unë, i sheh edhe UNMIK-u edhe EULEX-i edhe Qeveria e Republikës së Kosovës edhe Policia e Republikës së Kosovës edhe KFOR-i, të gjithë i shohin. Po nëse shkojmë në Kushtovë, e kemi pikën doganore, pikë lëvizëse doganore që e ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe pak më tutje, e kemi pikat 1 dhe 31 që nuk funksionojnë, që i kanë do kamera dhe vjen, shkon kush donë i kallë

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë veç po dua t’ia përkujtoj kolegut tim Koci që tha pse askush prej pozitës nuk kërkoi që Qeveria të përpilojë një listë të personave që nuk mund të hyjnë në Kosovë. Unë po i them zotëri Koci, po i shtroj pyetje: A duhet ata persona të armatosur që vijnë prej Serbisë me hyrë në stacion brenda për me i arrestuar policia. Ma jep këtë përgjigje të lutem kur të vjen radha në replikë.

Koleg, disa herë ne kemi shfaqur shqetësimet tona përkitazi me shkeljen e sovranitetit dhe të integritetit territorial të vendit nga ana e Serbisë, por asnjëherë këto shqetësimet tona nuk janë marrë seriozisht nga ana e ekzekutivit. Edhe dy vite pas shpalljes së pavarësisë, një pjesë e territorit të vendit po administrohet akoma nga një shtet tjetër, ndërkaq institucionet vendore, nuk kanë arritur që të vendosin institucione shtetërore. Serbia për të satën herë me radhë, papengueshëm organizon zgjedhje për komunat me shumicë serbe në Kosovë, ndërkaq institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare në Kosovë, po bëhen sikurse nuk po ndodhë asgjë.

Këtë herë vetëm dëshiroj t’ia përkujtoj kreut të Qeverisë, deklaratë që nuk është këtu, deklaratën e tij nga zgjedhjet e fundit që i patë organizuar Serbia në Kosovë, ku patë thënë, po citoj: “Këto janë zgjedhjet e fundit që organizon shteti i Serbisë në Kosovë”, sipas kësaj nuk po del që kanë qenë të fundit. Ky tolerim paraqet lusim kundër rendit juridik të Kosovës i sanksionuar edhe me nenin 108 të Kodit Penal të Kosovës.

Të ndruajë kolegë,

Qeveria e Republikës së Kosovës edhe pa këtë debat, e ka për detyrim kushtetues që të garantojë integritetin dhe sovranitetin e vendit dhe për këtë të fusë në veprim të gjitha instrumentet shtetërore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 2, ku flet për sovranitetin, po flas vetëm alineja 2, thotë: “Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës, është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj”. Ne nuk kemi kërkuar asgjë më shumë nga Qeveria se sa të fusë në veprim Kushtetutën e Republikës së vendit dhe ligjet.

Me këtë, Qeveria po tregon mosrespektim ndaj dokumentit më të lartë juridik të vendit dhe po mundëson shkeljen dhe cenimin e integritetit të vendit. Vizitat e zyrtarëve të lartë politikë e shtetëror të Serbisë, të cilat akoma sillen me logjikën dhe mentalitetin millosheviqian, janë bërë të përditshme, ndërkaq autoritetet vendore dhe ndërkombëtare bëhen sikur nuk po ndodhë asgjë. Kjo, të nderuar kolegë, është fyerje për Kosovën edhe popullin e saj. Këta zyrtarë të Serbisë, që në mes të Kosovës na fyejnë e na kërcënojnë, shoqërohen nga persona të armatosur, të cilët as që donë ta dinë për Kosovën dhe për ligjet e saja dhe autoritetet e sigurisë në Kosovë, në veçanti pjesëtarët e Policisë së Kosovës, fajin ua hedhin të tjerëve pse nuk i paskan njoftuar për këto vizita.

Policisë së Kosovës po dua t’ia përkujtoj, nëse nuk e din, detyrimet e saja kushtetuese të përcaktuara me nenin 128, ndër të tjera thuhet, paragrafi 1: “Policia e Republikës së Kosovës, mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës”, dhe paragrafi 5: “Policia e Republikës së Kosovës, mban përgjegjësinë për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare”. Me këto tolerime policia e Kosovës nuk po i shmangë incidentet sikur ka deklaruar ministri i Punëve të Brendshme, para disa ditësh, përkundrazi po e rrezikon sigurinë në vend dhe po tregohet e paafte për ta zbatuar Ligjin. Kjo i bie sikur kriminelit të hyjë në familje, ta dhunojë gjithë familjen, anëtarët e familjes, ndërsa ti të strukesh diku në një qoshe dhe të mos veprosh, sepse kësioj shkakton incident.

Nuk i duhet Policisë së Kosovës asnjë urdhër as politik e as ndonjë natyre tjetër për të vepruar, ashtu sikurse ka thënë ushtruesi i detyrës të drejtorit të përgjithshëm të Policisë, sepse armëmbajtja pa leje është vepër antiligjore, andaj duhet ndërmarrë masa, pa pritur urdhër politik prej askujt. Nëse autoritetet e Policisë së Kosovës paskan të drejtë ligjore, se do të bëj një krahasim, që depërtojnë nga Kosova njerëz të mjerë që lypin lëmoshë nëpër rrugët e Kosovës, atëherë po e shtroj pyetjen se si nuk paskan të drejtë t’i ndalojnë, t’i arrestojnë apo t’i dëbojnë nga Kosova politikanët të një shteti tjetër që hyjnë të armatosur në Kosovë, me çka jo vetëm nxisin urrejtje, por kërcënojnë me pastrim etnik të një pjese të territorit tonë. Kjo vërtet nuk do koment.

Me këtë rast, ministri për Punë të Brendshme dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të Policisë së Kosovës, do të duhej të jepnin sqarime dhe përgjegjësi për moszbatim të ligjit.

Qeveria e Kosovës duhet që të pamundësojë mbajtjen e zgjedhjeve të një shteti tjetër në territorin e Kosovës, t’i kushtëzojë vizitat e zyrtarëve serbë me vizitat zyrtarëve kosovarë në Luginën e Preshevës, pra të ketë veprime reciproke, të fusë në zinxhirin komandues Policinë e Kosovës në tri komunat veriore që sot nuk i përgjigjen zinxhirit të Drejtorisë së Policisë.

EULEX-i duhet të ushtrojë mandatin e vet karshi dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës, me të cilat rregullohet veprimi i EULEX-it në Kosovë dhe të lejojë veprim të plotë të institucioneve të Kosovës në çdo pjesë, e në veçanti në pikat doganore 1 dhe 31.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar, është e detyruar që të parandalojë mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, dhe jo vetëm të mjaftohet sikurse po deklarohen zyrtarët e Qeverisë në mosnjohjen e rezultatit të këtyre zgjedhjeve. Vetë mbajtja e zgjedhjeve serbe në territorin e Kosovës, brenda Kosovës, paraqet cenim dhe shkelje të integritetit dhe sovranitetit të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Veç ngadalë! Koci, a do t'i përgjigjesh? Të lutem, një minutë. Ju mund ta luani atë lojë, ta thirrni njëri-tjetrin e ta zbritni krejt bisedën, për ta humbur objektin. Të lutem, një minutë Gani, shkurt. Një e gjysmë, Gani...

GANI KOCI: Një e gjysmë, dy është. Ju faleminderit zoti Makolli. Do të ishte mirë që të ishim unë e ti në polici atje, ta udhëheqshim policinë atje dhe pastaj të shohim se si do të kishim vepruar unë e ti edhe në rastin e futjes së Koshtunicës dhe të tjerëve me armë dhe pa armë deri në Mitrovicë, ndoshta edhe në këtë anën tjetër. Unë vetëm një çështje do të kërkoja. Ne para një debati që është shtruar më herët, që është nxjerr një deklaratë këtu, kemi pasur një strategji dalëse prej, ose përmirësimin e gjendjes në pjesën veriore të Mitrovicës dhe ne do të ishte mirë të shtrojmë këtu ku është Qeveria, deri në çfarë shkalle dhe deri në çfarë mase kanë shkuar me zbatimin e asaj dhe realizimin e asaj strategjie dhe cilat janë mjetet që i kanë realizuar ose i përdor për... Të gjithë e dimë ku janë pengesat, zoti Makolli dhe të gjithë i dimë edhe detyrat e Policisë e ato kushtetuese dhe jo kushtetuese edhe të EULEX-it, prandaj nuk duhet të thirremi shumë në dispozita. Ju e dini edhe te pakoja Ahtisarit atje çështja e pjesës veriore të Mitrovicës, është pak më specifike, kuptoni pak specifikat, por kjo nuk do të thotë që autoriteti i pushtetit kushtetues të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: S'ka kundër replikë.

(Nga salla reagon Ibrahim Makolli, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: Me Rregullore, unë po të them që me Rregulloren, që e kam unë këtu, nuk ka kurrfarë kundër replike, se ju mund të shkoni deri në pakufi. Po ta jap fjalën, Makolli, dhe trego çka nuk di. Edhe një herë, pra, Makolli.

Fjalën e ka Makolli, a e do apo nuk e do? Merre fjalën! Makolli, replikë për Kocin.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti kryesues, më së pari po dua të replikoj me juve, për atë çka di unë dhe çka nuk di unë, është çështje e imja dhe unë jap përgjegjësi për...

KRYESUESI: Me mua nuk mund të replikosh pa ta dhënë të drejtën unë...

IBRAHIM MAKOLLI ... jo para jush, sepse a di unë a nuk di, është çështje e imja, nuk është çështja e juaja dhe ju këtu nuk jeni për të na treguar neve a dimë a nuk dimë.

Zoti Koci, seriozisht, jeni mjeshtër i mashtrimeve. Këtë popull po e mashtroni. A e ushtroni Kushtetutën, a ushtroni autoritet të vendit a jo? Në njërin anë po thoni ushtrojmë dhe kemi institucione, në anën tjetër përpiqesh për të na mashtruar se përpiqeni me një pako të Ahtisarit. Pakoja e Ahtisarit nuk thotë që Qeveria e Kosovës e shtrin autoritetin deri në urën të Ibrit. Nëse Policia e Kosovës është e paaftë, nëse kjo Qeveri është e paaftë, duhet të thuhet - është e paaftë dhe nuk po mundemi më shumë, por mos na mashtroni të flisni diçka tjetër dhe

të veproni diçka tjetër. Unë po te them - a duhet të vijmë në Skenderaj ose në Prishtinë njerëzit....

(Ndërhyrje)

... të lutem, para 10 vjetëve , nuk po më intereson, unë po flas për sot, po flas për sot. Ju e keni hequr. Ju faleminderit që e keni hequr, por prapë na u ka kthyer dhe kësaj jo në Mitrovicë, por ka për t'u kthyer në Prishtinë. Unë po them, a duhet të vijmë njerëz të armatosur në Prishtinë për t'i arrestuar a jo?..

(Reagime nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

... E, po atëherë, është diçka krejt tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Më lejoni të dal unë t'i them dy fjalë.

SABRI HAMITI: Kolegë, tepër të respektuar, nga ana ime respektin le të marrë secili atë që meriton, unë ua jap livadh, gjerë secilit. Unë nuk dua ta përmend askënd, sepse unë e kam parë që këtu është një lojë shumë naive që kujt do që t'ia përmendësh emrin, do të...

(Reagime nga salla)

.... Kolegë të nderuar,

Unë jam deputet dhe po jap mendimin tim. Unë jam deputet dhe duhet ta shpreh mendimin tim për temën ekzistuese.

Zotëri deputet, qetësohu se unë e kam kohën time.

Revolta nuk është mjeshtër edhe aleat i mirë i rezonit. Ne sot po bisedojmë për një temë që s'është as e një partie, as e një legjislature dhe unë bashkë me ju, zotërinj deputetë, nëse e adresojmë si problem të një legjislature, një partie, një pozite apo të një opozite, bëjmë gabim të madh dhe e mashtrojmë vetveten dhe zgjedhësit tanë, sepse gati të gjitha partitë që i kemi sot në Parlament, janë parti që për këto vite, tri legjislaturave kanë qenë ose pozitë ose opozitë.

Zotërinj dhe kolegë deputetë,

Asnjëherë pas luftës Kosova nuk e ka pasur nën kontroll atë që quhet veri dhe të cilin nuk po duam edhe në mënyrë figurative ta quajmë veri. Prandaj, nëse sot në mënyrë konsesuale kemi vendosur të bisedojmë për këtë temë të fortë, plagë të politikës aktuale të Kosovës, do të thosha unë, duhet të udhëhiqemi nga rezoni i shtetit, jo nga emocionaliteti, sepse të gjithë kemi emocione dhe emocionet nuk do të na prodhojnë zgjidhje. Prandaj, kur është caktuar për rend dite sot, unë jam përpjekur t'ju them si moderator atje ku kanë qenë duke udhëhequr që është mirë që temat e tilla, të bisedohen në mënyrë konsesuale brenda grupeve para se të prodhojnë një ide të përbashkët.

Ai vend, ai territor Kosove, nuk ka qenë nën sovranitetin e Kosovës, as kur ka udhëhequr UNMIK-u, kur ka administruar, as që dy vjet që Kosova është shpallur e pavarur. Kushtetuta e Kosovës, këtu citohen nene, ju lutem është tekst integral dhe ka edhe pjesë kalimtare. Ju lus të gjithëve, lexoni Kushtetutën nga neni i parë e deri te i fundit dhe do të shihni ku jemi, në cilën fazë jemi ne si Parlament sot, Qeveria e Kosovës dhe misionet ndërkombëtare të cilat janë në Kosovë, me ftesë institucionale të institucioneve të Kosovës. Ajo që unë dua të theksoj këtu sot rreth këtij problemi, është që Parlamenti si institucioni më i lartë përfaqësues, kur diskuton për një problem të madh të këtij vendi, të kërkojë që edhe institucionet e Kosovës

dhe institucionet ndërkombëtare që janë këtu të ftuara institucionalisht nga Kosova, ta kryejnë mandatin e vet dhe të marrin përgjegjësitë për mandatin e vet. Këtë duhet ta kërkojë Kuvendi, dhe po të shtrihet kjo kërkesë, ne jemi brenda Kushtetutës dhe brenda kërkesave reale që i shtrojnë zgjedhësit tanë, populli i Kosovës, Kuvendi, Qeveria dhe institucionet ndërkombëtare që janë në Kosovë, sepse me ato nene kalimtare të Kushtetutës, që i ligjësojnë këto prani ndërkombëtare, ne e dimë që një pjesë të funksioneve që do të duhej t'i luajtshin institucionet legjitime të Kosovës, janë të deleguara te institucionet tjera, kam parasysh konkretisht EULEX-in për punë që kanë të bëjnë, me kufijtë, me doganat, me drejtësinë.

Edhe për zgjedhje u tha këtu disa herë. Nuk është hera e parë që mbahen zgjedhjet, kështu që s' kemi çka i gjuajmë pingpong njëri- tjetrit. Serbia zgjedhje jo legjitime në Kosovë, ka mbajtur gjithë herë. Ne gjithmonë kemi thënë që janë jo legjitime dhe rezultatet e tyre nuk i pranojmë, siç po themi edhe sot. A është në gjendje Kosova, pos deklarimit voluntar, parlamentar sot këtu, t'i ndalojë ato zgjedhje, unë them jo, sot për sot, ju po më thoni, jo po ky tash çka po thotë. Unë jam real. Për ta ndaluar një punë të tillë, ti duhesh të kesh vullnetin për ta përdorur forcën, filozofinë për ta përdorur forcën besa edhe ta kesh atë forcë. Unë sa shoh sot, ne, asnjërin prej këtyre të triave nuk e kemi. Prandaj, duhet të këqyrim atë, që edhe një herë po e quajmë sjellje kushtetuese, sjellje me rezon të shtetit.

Unë edhe nga propozuesi, u përpoqa, shënova atje sa munda, e kish një frazë që e kisha, sepse mocion shkrimi s' ka pasur, por ka pasur kërkesë për debat, që të shikohet pengimi i zgjedhjeve dhe një formulim tjetër e pata nga një grup tjetër që tha: "të shikojmë, të bëhet diçka", pak a shumë kështu në thonjëza e thashë... Unë nuk parashoh as nuk po paragjykoj asgjë. Unë po flas si deputet edhe një herë, njerëzit mund ta perceptojnë si të donë fjalën time. Ky është mendimi im. Por, për ta përfunduar, për të qenë serioz ne si Kuvend, se nëse s' diskutojmë në mënyrë serioze, ne zbresim vetveten, ne nuk mundemi ta zbresim kërkend, është mirë që këtu të ketë më pak propagandë e më shumë koncentrim në zgjidhje. Qeveria të raportojë më shumë për rezultate se sa të bëjë propagandë, sepse edhe propaganda është pjesë e qeverisjes. Edhe opozita të ketë më shumë alternativë se sa mohim, atëherë pak a shumë do t'i ofroheshim njëfarë diagonaleje që jap rezultate, problemet të cilat i kemi të mëdha. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka zoti, Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, kryesues!

Unë pajtohem në tërësi dhe shumicën e fjalëve m'i mori, deputeti veç sa e kreu fjalën, zotëri Sabri Hamiti. Pajtohem në tërësi me fjalën e deputetit. Po dua ta saktësoj një punë. Pavarësia e vendit tash dy vjet e sa po bëhen, edhe Kushtetuta e Kosovës janë jo më të vjetra se aq, prandaj nuk mund të flasim për shkelje të Kushtetutës, sepse Kushtetuta dhe pavarësia e vendit, veriu e Kosovës e ka gjetur në pozitën që është.

Ne, sot po dëgjojmë këtu për të krijuar rezoluta, për të krijuar kërkesa. Unë po e them se është e kotë, sepse nuk çka të krijohet kërkesa. Krejt çka duhet të kërkojmë ne, duhet të kërkojmë të krijojmë kushte, t'i funksionalizojmë institucionet, mekanizmat e shtetit që duhet të veprojnë, duhet t'i bëjmë funksional në atë pjesë të vendit. Ne e dimë që ende nuk është funksionalizuar Kushtetuta. Kushtetuta e ka gjetur vendin, në atë pjesë të Kosovës jofunksionale edhe policinë e vendit edhe mekanizmat tjera shtesë.

Krejt çka mund të temë unë tash, unë mund të them sikur të gjithë të tjerët, si kryetar i Komisionit, ju e dini se kemi qenë si Komision Parlamentar për Punë të Brendshme dhe

Siguri, kemi qenë të zëshëm edhe kemi bërë vërejtje shumë herë në veprime dhe në operime të shtetit fqinj që i ka bërë në vendin tonë, qoftë në pjesën veriore të vendit, qoftë në pjesët tjera të vendit tonë. Duke e kuptuar se mekanizma të rinj dhe ende s'po mundemi për t'u funksionalizuar. Në kohën e fundit ne si Komision, kemi vërejtur se qasja dhe mënyra për veriun e Kosovës dhe për funksionalizimin dhe rendin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Jepja fjalën deputetit që është duke folur ose Mustafa, se t'u ka ndërprerë.

.... Desha të them, ne si Komision edhe unë personalisht kam vërejtur se në kohët e fundit qasja, mënyra e qasjes së territorit ku tashmë është jashtë kontrollit të institucionit të vendit, ka ndërruar dhe të gjitha ato strategji që janë të punuara që mundem të themi që nuk janë të funksionalizuara, ne kemi parë shenja se donë, do të ndërrojë politika, do të ndërrojë qasja ndaj asaj pjese të vendit edhe do të funksionalizohen shumë shpejt.

Na gëzon fakti se ministri po i qaset ndryshe, më së pari kemi parë një komunikim me komunitetin e atjeshëm që është esenciale po mendoj për kohën. Ne së pari duhet t'i legalizojmë problemet që janë aty, nëse arrijmë me përpjekjet e ministrit, por edhe tonat, them në përgjithësi, t'i legalizojmë ato probleme që janë në veri, unë besoj se do t'i kontrollojmë shumë më lehtë problemet edhe do ta bëjmë rendin dhe ligjin funksional në gjithë vendin.

Unë mbetem në situatën e mëparshme dhe do të jem tepër kërkues ndaj ministrit edhe ndaj të gjithë mekanizmave funksional, që ende kanë çka të prodhojnë mësim për vetveten, për neve, për mekanizmat që drejtojnë se si të merren vendimet dhe t'i shtyjmë proceset më përpara. Nuk është koha e fundit, por është kohë e duhur që ne duhet t'i vëmë në funksion mekanizmat të cilat kanë dalë nga ky Kuvend. Unë nuk e shoh të arsyeshme edhe një herë po e them që thërrasim të bëjmë rezolutë apo të bëjmë diçka të re, përveç ajo ekzistuesja që është, ne duhet ta funksionalizojmë dhe duhet të jemi insistues që t'i bëjmë punët tona, secili në punën e vet. Ne tash nga gëzon rasti që mekanizmat e vendit kanë filluar. Ne e shohim në gjithë vendin, ka pasur ndërhyrje të policisë së vendit në krim të organizuar edhe në korrupsion në gjithë Kosovën. Ka pasur në pjesën e Mitrovicës, në Gjakovë, Prizren, Ferizaj. E urojmë ministrin dhe mekanizmin e Policisë që të vazhdojë e dhe më tutje dhe ne do të jemi prapa tyre në çdo moment në luftimin e këtyre dukurive negative, të cilat pavarësia e vendit, bashkë me pavarësinë e vendit edhe kjo Qeveri, nuk i prodhon, por i gjen kur vjen në pushtet në vendin tonë.

Unë ndej obligim të prononcohem edhe për një debat të panevojshëm krejt, dy ose tre debutues më herët e përmendën fjalën SHIK. Kam lexuar një raport që ka dalë, raportet janë sikur raportet tjera që kanë dalë, herë kanë qenë të mirë, herë kanë qenë të dëmshëm. Unë po dua të them kështu, nuk duhet të keqpërdoret foltorja edhe nuk duhet të bëhen krahasime në mes organizmave të ndryshëm që kanë vepruar pas Kosove. Organizimi i Shërbimit Informativ të Kosovës, flas për kohën e luftës, ka qenë mekanizëm kombëtar që u ka shërbyer interesave të vendit, për më vonë, unë nuk e njoh. Unë e di që edhe publikisht është mbyllur historia e atij mekanizmi dhe nuk kemi nevojë për t'i vënë në debat ato mekanizma, aq ma tepër kur atakohet një parti, subjektit të cilit, në këtë rast i takoi edhe vetë, Partia Demokratike e Kosovës, që është parapara tij. Ne e dimë që ai nuk ekziston, nëse dikush din diçka, janë organet e hetuese dhe le të shkojë. Nuk kemi nevojë për ta prishur situatën e mirë, qoftë debutuese, qoftë tjetër në Kuvendin e Kosovës dhe duhet të jemi më konsekuent dhe duhet të flasim më afër ngjarjes në të cilën po jetojmë dhe po ecim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e merr deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, drejtues i seancës!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Përshëndetje dy ministrave,

Vetë tema dhe zhvillimet politike, mendoj që e ka ngritur në këtë moment edhe debatin, që mendoj që kërkesa edhe objektivi që u shtrua është shumë me vend, por neve duhet që interesimeve tona t'ia japim edhe peshën edhe dimensionin politik që e ka kjo çështje në Parlament dhe më pastaj mekanizmat e tjerë siç është Qeveria pra, të veprojnë me autoritetin e vet për atë që ka mbetur kohë për temën për të cilën jemi duke debatuar.

Nuk ka dilemë kur flitet për sovranitetin politik, për Kushtetutën, për çështjet juridike, cenimin e tij, ato janë çështje më të ndjeshme për një shtet, për një vend dhe kjo drejtpërdrejt e tangon ose e prek edhe Parlamentin, edhe Qeverinë dhe shoqërinë tonë në përgjithësi.

Por ne sot jemi të vetëdijshëm se i kemi dy veprime paralele që po e bëjnë garën në Kosovë, jo vetëm sot, por edhe më herët siç u tha këtu pra, mes asaj që bën Qeveria e vendit lidhur me planin e veprimit pas shpalljes së pavarësisë, si dhe Strategjisë, pra që ka të bëjë me pjesën veriore, në mënyrë të veçantë, meqë është aktuale çështja e mbajtjes të zgjedhjeve të një shteti tjetër në territorin e shtetit tonë. Dhe padyshim që këtu duhet t'ia japim përkrahje të plotë Qeverisë me gjithë mekanizmin ose autoritetin që e ka Parlamenti, qoftë deklaratë, qoftë vendim tjetër politik, me të cilin e forcojmë rolin edhe për atë kohë sa ka mbetur brenda dy ditëve dhe unë mendoj që kjo duhet të jetë edhe një mision i debatit të sotëm për ne si deputetë.

Për momentin kemi edhe planin tjetër pra, programin e Qeverisë të Beogradit e cila me organizimin e zgjedhjeve, nuk ka dilemë që po ka synimet e saj strategjike, pra, ndoshta edhe deri te aneksimi i kësaj pjese. Pasojat politike janë të mëdha, prandaj edhe vendimi e debati jonë sot, duhet të jetë se çka mundemi të bëjmë, realisht që të pengojmë mos mbajtjen e këtyre zgjedhjeve dhe të gjejmë konsensusin parlamentar, por edhe me Qeverinë edhe me EULEX-in, në mënyrë që realisht kjo të mos ndodhë, nëse këtë mundemi ta bëjmë si Parlament që e kemi si mandat politik.

Nuk duhet të jenë pjesë e këtij debati sot dhe temat tjera që kur kanë të bëjnë me krimin e me çështjet e tjera siç u cek këtu, sepse na del boll, na mjafton kjo temë që e kemi sot pra cenimin e sovranitetit ashtu qysh u tha këtu.

Mesazhi tjetër, në shenjë përkrahje nga Parlamenti duhet drejtuar pra edhe Këshillit të Evropës apo Bashkësisë Evropiane, e cila po ashtu nuk njeh organizimin dhe mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, por mendoj që ka mbetur i mangët që nuk e ka detyruar EULEX-in, të cilin e kemi ftuar ne, pra mekanizmat e tij për rendin dhe sigurinë në vend, që të mos lejojë mbajtjen e tyre. Prandaj edhe Parlamenti i Kosovës sot, mendoj që me deklaratën të cilën duhet ta punojmë bashkërisht, duhet ta adresojmë sot aktivitetin që duhet të ndërmerret brenda kësaj kohe që realisht, me masat tona politike dhe me masat e Qeverisë dhe të EULEX-it, bashkërisht të mos lejojim mbajtjen e zgjedhjeve në pjesën veriore të shtetit tonë nga një shtet tjetër.

Prandaj edhe zona e debatit duhet ta ketë këtë vlerësim, sepse këtu jemi në tekstin tonë politik dhe qëndrimi i Parlamentit duhet të jetë jo pra për mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë. Ndër rekomandimet që do t'ia përmendja në këtë rast, në kuadër të këtij debati, bashkë me deklaratën kundër mbajtjes së zgjedhjeve, duhet pra që bashkërisht Kryesia e Parlamentit,

grupet parlamentare dhe Qeveria të bëjnë pra punën e tyre, të gjejnë po ashtu konsensusin që së bashku me EULEX-in, t'i marrin të gjitha masat politike dhe të tjera që kjo të mos ndodhë në Kosovë, në qoftë se bashkërisht e kemi aprovuar Kushtetutën, planin e Ahtisarit, shpalljen e pavarësisë dhe të gjitha zotimet dhe detyrimet tjera kushtetuese që dalin për neve dhe për institucionet relevante ndërkombëtare që janë pjesë pra e këtyre aktiviteteve politike dhe qeverisëse sot në Kosovë. Kështu mundemi pra t'i ndalojmë, të mos prodhohen pasoja më të mëdha për vendin, ndërsa, sa i përket dhe të forcojmë normalisht shtetin demokraci, shtetin ligjor dhe atë çka e kemi objektiv dhe synim tonin politik.

Në anën tjetër, misioni ynë politik dhe patriotik që u përmend këtu, qoftë i deputetit edhe i ministrit, është nganjëherë se si duhet të sillemi në Parlament ose si nuk duhet të sillemi. Dje, sot dhe nesër kur nuk bëhet vonë të bëhesh patriot, të punosh për vendin, por nuk je patriot as deputet e as ministër i mirë asnjëherë, në asnjë kohë në qoftë se bën hangarë me Parlamentin, me Qeverinë, në qoftë se je pjesë e krimit, në qoftë se je pjesë e hajnisë, e vjedhjes, e në qoftë se me kohë nuk i merr vendimet parlamentare të Qeverisë dhe të tjera, të cilat kanë të bëjnë pra me atë punë për të cilën ne jemi të mandatar. Dhe unë mendoj që asnjëherë nuk bëhet vonë për askënd që të punoj mirë dhe mbarë për vendin e tij. E kemi një shans edhe ne si parlamentar, si grupe parlamentare, si Lidhje Demokratike, pra ta japim kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, ju njoftoj që janë edhe 23 kërkues për fjalë. Unë nuk do t'ju sugjeroj asgjë. A ua merr mendja që ta bëjmë një kohë të kufizuar më të vogël për diskutim apo mendoni që të shfrytëzohet koha deri në limite?

(Reagime nga salla)

... Jo, jo me rregullat në fuqi për pa u ndryshuar koha, është 10 minuta, ta kemi të qartë. Jemi edhe 23 veta. Do ta merr fjalën gjithkush që e ka lypur, a ua merr mendja që është më racionale ta zëmë, ta bëjmë 5 minuta. Nëse ju nuk doni, vazhdojmë, po ky është një...

A pajtoheni që të diskutojë 5 minuta çdonjëri. Kush është për? Ju faleminderit, Kush është "kundër"? Me 7 "kundër", me shumicën "për", u vendos që nga 5 minuta. Unë besoj që kanë me qenë të mjaftueshëm, sepse janë 23, 24 vetë dhe pak a shumë fillojnë edhe të përsëriten sendet. I lutem regjisë, diskutimi është 5 minuta. Fjalën e ka Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për të gjithë,

Më lejoni pra që të jap një kontribut në debatin që është shtruar sot, të cilin debat e mbështes në plotësi, si një çështje urgjente cenimi i integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë.

Sipas mendimit tim, krejt kjo që po ndodhë është nga mos puna e kësaj qeverisjeje, papërgjegjësisë, jo transparencës, kështu që kërkoj një qasje serioze politike nga ju qeveritarë dhe përgjegjësi dhe një llogaridhënie në Parlament të kësaj qeverisjeje të Republikës së Kosovës. Shtrohet pyetja, kujt t'ia parashtruar këtë pyetje kur për momentin qeverisja shumë është e mangët, po mendoj anëtarët e Qeverisë shumë pak janë prezentë, duke u nisur nga fakti as kryeministri nuk është prezent, ku shihet se ky debat u vlerësua nga të gjithë se vërtet është një çështje shumë urgjente. Por, para se gjithash prapë duhet t'i parashtrojë pyetjet, besoj që na dëgjojnë.

Cilat janë angazhimet tua konkrete që kanë të bëjnë me cenimin e integritetit dhe sovranitetit të vendit tonë? A mendoni se vizitat e kohëve të fundit nga shteti i Serbisë e lëndojnë funksionimin e jetës te ne në Kosovë? Shtrohet pyetja tjetër- Si është e mundur që në një shtet sovran dhe të pavarur, me kufi të garantuar të organizohen zgjedhje lokale nga një shtet tjetër? Si ka mundësi, të nderuar qeveritarë që shumë kryetarë partish nga një vend tjetër të armatosur dhe që dihen qëndrimet e tyre për popullin dhe shtetin e Kosovës, të mbajnë tubime elektorale në shtetin tonë? A jemi shtet, a kemi institucione shtetërore, a kemi Kushtetutë dhe ligj? Fatkeqësisht, gjendja në terren flet se institucionet e Kosovës nuk janë në gjendje të kryejnë punën e tyre që kanë obligim kushtetues, ligjor dhe mandat nga populli ynë i respektuar. Andaj, se çfarë shteti jemi dhe këto institucione të shantazhuara ku po e dërgojnë këtë vend dhe këtë popull? Krejt kjo që po ndodh, është nga paaftësia e kësaj qeverisje për t'u përballur me realitetin, ku po mbetet vendi ynë, Republika e Kosovës, e cila e ka integritetin territorial të saj të garantuar me Kushtetutë.

Edhe përkundër faktit se mjaft po përpiqeni ta arsyetoheni me fraza, duke dhënë deklarata se situata është nën kontroll. Vallë, Kosova i kontrollon kufijtë e vet, po nëse i kontrollon pse lejoni qeverisje e Kosovës cenimin e sovraniteti, se si dhe në çfarë mënyre hyjnë e dalin pa u pyetur institucionet e vendit, për ne si deputetë por edhe si popull është e papranueshme? Ju qeveritarë të nderuar keni dështuar. Përgjegjësia për këto dështime politike bie mbi ju Qeveri aktuale e këtij vendi. Me këtë degradim politik, institucional, me këtë shkelje të integritetit territorial të vendit tonë dhe me këtë model qeverisje, po e shkatërroi qeverisjen e vendit. Nuk e keni prioritet zhvillimin e këtij vendi dhe ruajtjen e sovranitetit, por disa gjëra të tjera për të cilat dua të besoj si dhe shumica e qytetarëve të Kosovës, se do të jepni llogari para tyre dhe drejtësisë e cila do të vijë së shpejti. Andaj, kërkoj urgjent që në Kosovë të funksionojë ligji dhe të merren qëndrime rreth mos mbajtjes të zgjedhjeve të paralajmëruara nga një shtet tjetër dhe të zbatohet Kushtetuta e vendit tonë plotësisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, zotëri Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Natyrisht e kërkoja fjalën për arsye se disa herë u përmend Ministria e Punëve të Brendshme dhe e ndjeva si obligim, respekt ndaj Kuvendit që t'i bëjë disa sqarime, jo të bëjë politizime, natyrisht unë nuk jam anëtar i Kuvendit dhe nuk e kam kartelën që ta kërkoj fjalën, prandaj ju falënderoj për këtë mundësi që ma dhatë.

Natyrisht që si krejt ju parlamentarë të nderuar, qytetarët e Kosovës edhe unë i ndaj shqetësimet me ngjarjet që ndodhen në pjesën veriore. Unë edhe pak më tepër për arsye se mosfunksionimi i plotë i disa institucioneve qendrore lidhur me Ministrinë, të cilën unë e udhëheq.

Dua veç t'ju përkujtoj se edhe Ministrinë që e udhëheq unë, por edhe Qeveria pjesë e të cilës jam, jemi shumë të përgjegjshëm, të kujdesshëm dhe shumë të vendosur. T'ju përkujtoj se mu në këtë Parlament kur u shpall pavarësia e Kosovës, pra unë isha si mysafir, për ardhjen deri te ky akt, është dashur një koordinim shumë i mirë me faktorin ndërkombëtar që ajo pavarësi që shpallet të vlerësohet dhe të shkojmë përpara. Pa një koordinim të tillë, ne kemi mundur ta shpallim, të jemi të izoluar dhe të merremi me vetveten.

Natyrisht që Kushtetuta e sheh funksionalizimin e plotë me aktin juridik. Na jemi shtet i pavarur dhe sovran në aspektin praktik. Në pjesën veriore për arsye dhe objektive nuk është arrit të shtrihet funksionimi i plotë i disa segmenteve, në këtë rast edhe të policisë, gjyqësisë,

doganave e tjerë. Dua po ashtu vetëm t'ju tregoj se jeni ministër i përgjegjshëm pavarësisht nga kërkesat, asnjëherë nuk do të marr një vendim të pamenduar mirë, unilateral sa i përket situatës së sigurisë dhe rendit dhe ligjit për pjesën veriore, ku nuk i kemi kapacitetet e plota dhe ku kompetencat janë të përbashkëta dhe do t'ju shpjegoj me cilat segmente. Nuk jam ai njeri që donë të bëjë për opinion publik një urdhër, një aventurë dhe të bimë në kundërshtim edhe me EULEX-in edhe me KFOR-in, të rrezikojmë, po e përsërisë edhe jetën e policëve të Kosovës edhe të EULEX-it edhe të KFOR-it edhe të qytetarëve në pjesën veriore. Prandaj, sado që ju duken që këto janë të guximshme, unë përkundrazi mendoj se janë shumë të mençura dhe të vendosura këto veprime që bëhen.

Vetëm t'ju informoj se hyrja 1 dhe 31, në aspektin e policisë kufitare edhe më tutje është e drejtë ekzekutive e EULEX-it, që është transferuar drejtpërdrejtë nga UNMIK-u. Policia e Kosovës është prezent aty, por e drejta ekzekutive është e tyre. Kërkesën ne e kemi bërë jo gjithmonë nëpërmjet mediave që ta zbatojnë atë dhe t'i ndalojnë hyrjet, jo për persona privat, por për hyrje zyrtare dhe të paparalajmëruar në formë grupesh dhe kur kanë qëllime politike, me bë fushatë politike jo legale, për zgjedhje jo legale.

Në fillim nuk kemi pasur harmonizim të mirë dhe para dy ditësh, me ardhjen e shefit për operacione civile në Evropë, në prezencën e z. Iv de Kermabo, të gjitha gjërat janë sqaruar dhe është marrë vendimi që këta të ndalohen. Mund të thuhet pse EULEX-i ka kërkuar nga Policia e Kosovës që ata të bëjnë, pra një kompetencë të veten ekzekutive pak a shumë e ka dhënë te Policia e Kosovës, që botërisht dihet se janë shumica nga komuniteti serb, ka edhe shqiptarë pak dhe të gjithë nuk e kryejnë punën e vet si duhet. Kjo do të jetë edhe një test për ata dhe në të ardhmen ku shkelet disiplina, puna, do të ketë mundësi edhe të ndërrimeve. Megjithatë, disa rezultate kanë filluar edhe pse janë të vonuara. Realisht, është shumë vështirë nëse nuk e përdorë represionin, të ndalen komplet këto zgjedhje dhe nuk është synimi ynë që me represion t'i ndalim këto zgjedhje.

Edhe një informatë sa për ju, edhe çështja e bashkëpunimit me Interpolin...

(Ndërrprerje nga regjia)

KRYESUSEI: Jepni edhe pak kohë, edhe një minutë jepja ministrit.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI:... Edhe kjo është një prej 4 kompetencave ekzekutive të EULEX-it, pra ne nuk jemi anëtarë të Interpolit, punojnë edhe njerëzit tanë në atë, mirëpo bashkëpunimin e bën EULEX-i. Natyrisht, që unë shumë e çmoj çfarëdo vendimi që ju bini dhe, edhe unë jam plotësisht edhe institucionet tona të gjitha kanë qenë kundër këtyre zgjedhjeve që janë jo legale dhe nuk do të kenë implikime juridike, megjithatë është edhe provokim edhe të gjitha ato. Po ashtu edhe protestat që janë paralajmëruar për të dielën, i përkrahim por të qeta në atë mënyrë kundër këtyre zgjedhjeve. Sigurisht edhe çdo deklaram i juaji, do të merret dhe ajo çka mund të realizohet në koordinim të ngushtë me EULEX-in, KFOR-in, do t'i bëjmë dhe nuk do të ndalemi në këtë drejtim. Mirëpo, megjithatë në këtë...

(Ndërrprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hajt, hajt, kryeje Bajram!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: ...Pra, u shprehën shqetësime se gjendja do të eskalojë dhe ky është agresion. Agresion nuk është, çdonjëri e di çka domethënë agresion. Tentimet e tensionimit të eskalimit të gjendjes ka, ajo nuk do të ndodhë, kështu që sa i përket agresionit

ose ndonjë rreziku të madh të eskalimit, flini të qetë dhe mos keni dert se nuk do të ndodhë një gjë e tillë.

KRYESUESI: Fjalën e ka, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Ministra dhe deputetë të respektuar,

Se çështja e pjesës së Mitrovicës që ndodhet në veri të vendit tonë është shumë komplekse, ndër të tjera e ndër të tjera, fakt është edhe ky faktor. Po e zëmë, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, të Organizatës të Kombeve të Bashkuara 1244/ 99, e garanton sovranitetin edhe integritetin territorial të Kosovës. Asnjëherë strukturat ndërkombëtare nuk kanë ndërmarrë masa sa për afërsisht të nevojshme për ta siguruar implementimin e këtij dokumenti që, tek e fundit është një dokument që gjithnjë është në fuqi deshëm e nuk deshëm. Rrjedhimisht, sa i përket rendit juridik të Kosovës, sovraniteti e integriteti po dihet se nëpërkëmbën në mënyrë më se violente jo njëherë pothuaj se suksesivisht. Përmende strukturat paralele, ato nuk janë struktura paralele, ato janë struktura ilegale se, nëse do t'i quanim pareshtur struktura paralele, praktikisht na do t'i legalizonim se do të dilte se janë paralele, ato këto edhe tek e fundit më pastaj kush duhet të ketë primat.

Aktualisht, pa fije të dyshimit ka arritur pika kritike. E marrim ne, ju lutem disponimin e qytetarit të rëndomtë, qoftë edhe të filozofit superior. Kjo është pikëpamje, domethënë që është fjala pikë kritike, sepse provokime të rënda janë, irrituese, por nuk përfilllet absolutisht entiteti legal në Kosovë. Në anën tjetër, sa i përket Qeverisë, pa fije të dyshimit ka limite, sa i përket kapaciteteve këtë të gjithë duhet ta dimë edhe e dimë ajo jo, ka edhe limite edhe restriksione sa i përket nivelit të politikave ndërkombëtare, por gjithsesi unë do të isha angazhuar, i bindur se kam të drejtë në këtë rast që ta miratojmë na Rezolutën, sepse, domethënë, në këtë diksion që u propozua edhe më parë, sepse do ta fuqizonim obligimin e Qeverisë, ashtu e kështu Qeveria është ekzekutiv, mirëpo, domethënë, këtu është fjala për një impuls edhe stimulues të karakterit politik se Qeveria duhet të bëjë shumë më tepër se sa bëri deri me sot. Ju lutem, është fjala për aktivitetet politike ndërkombëtare në relacionet me faktorin ndërkombëtar.

Do të duhej që të rishikohej me një vlerësim analitik, kritik e quajtura strategji për Mitrovicën. Ju lutem, ai është një dokument i rrallë, është një dokument si shkumë e sapunit, nëse duam të flasim pak me fjalë të tjera. Nuk garanton asgjë, do të duhej ai dokument të rishikohej edhe në konformitet me realitetet aktuale të përcaktoheshin disa objektiva edhe në mënyrë shumë më serioze, flas për qeverisës, i ka kapacitetet, e ka infrastrukturën se edhe institucionet tjera të bënte maksimumin e mundshëm që do të duhej të bëhej në favor të çështjes së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Ministra, kolegë deputetë,

Kur flasim për masat që duhet të merren për veriun, sigurisht që fjala është për masa institucionale edhe askush nuk e ka fjalën për përdorimin e dhunës ushtarake, policore apo për ndonjë operacion të kësaj natyre.

Unë i dëgjova me vëmendje ato që u thanë lidhur me debatin këtu. Është shumë i mirëseardhur dhe nuk është mirë që ai të aprovohet vetëm sa për formë dhe duhet të dihet pse, sepse çështja

e strukturave të Serbisë, shtetërore në Kosovë, duhet të ketë zgjidhje institucionale, është fjala, domethënë jo zgjidhje të rrugës, duhet të ketë zgjidhje në Kuvend, në Qeveri, në të gjitha institucionet përkatëse të vendit tonë.

Për më tepër, ky debat, duhet të jetë serioz edhe qasja duhet të jetë serioze, sepse nuk është për të bërë humor ose për të qeshur këtu në Kuvend, në kohën kur shumëçka nuk është në dorë të institucioneve të Kosovës, por edhe të EULEX-it. Ju mund të mos keni dëgjuar, nuk e keni dëgjuar qytetarë, shoqata kanë caktuar një protestë më sa e di unë në fund të javës, të kësaj jave tash për çështjen që na këtu po debatojmë lidhur me cenimin e sovranitetit të vendit. Edhe kjo, për mendimin tim flet shumë. Ata dëshirojnë të flasin, sepse këtu nuk po flitet, shiko debatohet për një çështje shumë të rëndësishme, respekt për ministrin e Punëve të Brendshme, që edhe ky po shkon, ne jse por duhet zgjedhje institucionale nuk mundet t'i gjendet kësaj çështjeje duke braktisur Kuvendin, Kabineti qeveritar në kohën kur deputetët që kanë marrë votat nga populli, flasin për këtë çështje.

Unë e mbështes gjithë përpjekjen e Qeverisë që ka bërë për gjetjen e rrugëve të ndryshme, por duhet që zbatimi për strategjinë e Kosovës, të gjejë zbatim jo vetëm të thuhet, të thuhet është lehtë për një çështje për duhet t'i gjendet zbatim. Mendoj se në kuadër të masave që po duket që nuk janë të mjaftueshme, duhet të forcohen masat për rritjen, shikimin e mundësive për rritjen investimeve për rregullimin e jetës, infrastrukturës edhe bërjes interesante të kthimit në normalitet të jetës atje, sepse atje nuk ka jetë normale për njerëzit, luftimin e korrupsionit, të kriminalitetit, trafikeve, krimin të organizuar, kontrollit të integruar të kufijve. Na e kemi edhe një agjendë për integritet evropian dhe kjo agjendë është e ndërlidhur me këtë çështje. Kontrolli i shtuar i kufirit edhe bërja e këtij kontrolli në mënyrë integruese edhe në bashkëveprim me të gjithë faktorët që merren me çështjet e sigurimit në vend dhe jashtë vendit, duhet ta mundësojë në qasje të tillë që të ketë sukses e gjithë ajo strategjia që është shumë e mirë, por për të cilën, nëse nuk punohet mbetet letër e shkruar edhe kurrë më tepër, kështu që ftoj që ne të gjejmë zgjidhje, gjithashtu edhe të natyrës të sigurisë.

Mua më erdhi shumë keq që disa deputetë këtu u shprehën kundër...

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Shumëçka u tha nga parafolësit lidhur me gjendjen në një pjese të territorit të Kosovës, i cili është jashtë kontrollit të institucioneve të vendit, por ajo çka duhet të themi se, në qoftë se Republikën e Kosovës e kanë njohur 69 vende, të gjitha këto vende të mëdha e të vogla, të fuqishme, më pak të fuqishme, e kanë njohur me këtë Kushtetutë, me këto obligime që dalin nga pakoja e Ahtisarit, me këtë integritet dhe sovranitet territorial. Prandaj, askush mos ta ndiej veten indiferent sikurse në kohën e protektoratit kur në qoftë se kërkon të zbatohet ligjshmëria, të zbatohet, të ushtrohet sovraniteti prej institucioneve të Kosovës, dikush të ka klasifikuar si radikal apo njeri i cili pretendon ta radikalizojë situatën politike. Mirëpo, të nderuar deputetë, shumë kohë më parë e kemi denoncuar edhe publikisht se pas transformimit të UNMIK-ut, në veri të vendit, strukturat e UNMIK-ut janë bashkëdyzuar me organet e pushtetit serb dhe kanë penguar kthimin e shqiptarëve në pronat e tyre. Këtë e kemi thënë publikisht edhe pse nuk është marrë seriozisht qoftë nga institucionet vendore apo edhe ato ndërkombëtare.

Për dhjetë vjet të funksionimit, gati të UNMIK-ut, faktori relevant politik ndërkombëtar i vendosur në Kosovë, e ka përshëndetur gjithmonë punën e atyre institucioneve ndërkombëtare se çështja e veriut të vendit është çështje e ndjeshme, merr kohë, donë maturi e kështu me radhë. Por, sot jemi dëshmitarë se po këto institucione relevante ndërkombëtare që janë të vendosura në Kosovë, e pranojnë një fakt që UNMIK-u për dhjetë vite me radhë nuk ka bërë asgjë për atë pjesë të vendit dhe jemi në një pozicion çfarë jemi. Komisioni ndërkombëtar përmes misionit evropian EULEX-i ka përgjegjësitë shumë qartë të definuara edhe me Kushtetutë, edhe me përgjegjësitë që rrjedhin prej pakos dhe nga ato përgjegjësi nuk mund të ikë, por është pjesë e përgjegjësisë së institucioneve të vendit të Kosovës që t'i ushtrojnë kompetencat e plota në përputhje me dispozitat kushtetuese për ushtrimin e këtij sovraniteti të vendit. Në qoftë se u thanë, patriotizëm të merret me çështjen e sovranitetit dhe kushtetutshmërisë, unë do ta thosha se sot patriotizmi është lojaliteti ndaj shtetit dhe ndaj kushtetutshmërisë, prandaj është momenti i fundit që institucionet e vendit, Kuvendi, presidenti dhe Qeveria ta trajtojnë problematikën e sovranitetit dhe të integritetit e vendit në kuptimin meritore. Nëse mendojnë se duhet të mbyllemi nga ballafaqimi me opinionin apo të mbyllemi e të mos debatojmë për këto çështje të ndjeshme, atëherë këto çështje do të debatohen në rrugë, nëpër kafiteri dhe nëpër tryeza të cilat i organizojnë të tjerët dhe ne vendosim në pikëpyetje pjesëmarrjen a do të jemi a s'do të jemi, a do të bëjmë mirë apo keq. Ajo çka duhet si Kuvend të nxjerrim një përfundim, një qëndrim dhe qëndrimi të jetë shumë eksplicit në kuptimin e zbatimit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë në atë pjesë të territorit. Në fund të debatit, Grupi parlamentar i LDD-së do të dalë me një qëndrim, i cili korrespondon me realitetin ekzistues. Realiteti ekzistues nënkupton veprimin e mekanizmave kompetentë në ndalimin, në ndalimin e organizimit të zgjedhjeve të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës. Krejt kjo është gama, alfa dhe omega e krejt problematikës që aktualisht e mundon dhe po e tensionon situatën në vend. Në qoftë se këtë nuk e bën Kuvendi....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo, unë jam paraqitur në fillim. Faleminderit shumë zoti kryesues!

KRYESUESI: Këtu, çdo deputetë thotë unë më herët jam lajmëruar. Unë po them se e kam listën përpara dhe do t'ju thërras me listë.

BAHRI HYSENI: Unë kërkoj të ma respektoni pak kohën, sepse edhe kështu i morëm 5 minuta kohë. Absolut, por së paku këtë kohë që na takon. Ne votuam me vëmendje të veçantë që sot të debatohet për zgjedhjet në pjesën e veriut dhe ishte dëshira më e madhe si deputet të japim kontributin ndoshta me diskutime, mirëpo nga ajo që pamë, realisht nuk na mbetet asgjë tjetër, pos të kuptojmë që Kuvendi dhe njerëzit, të cilët, në emër të zgjedhjeve, në emër të patriotizmit, nuk e kanë fort problem pse po mbahen zgjedhjet në pjesën e veriut, por po e shfrytëzojnë rastin të atakojnë, të keqpërdorin foltoren, t'i quajnë njerëzit kriminelë, t'i quajnë njerëzit banditë, që nuk na shkon as si deputetë, as si Kuvend, por as si njerëz nga të cilët qytetarët presin me të vërtetë t'i mbrojmë. Dhe, për njohuri të këtyre njerëzve, duhet t'ua bëjmë të qartë se Koshtunica dhe shumë koshtunica të tjerë janë futur në Kosovë, edhe në familje, kanë dhunuar e kanë masakruar dhe këta njerëz kanë qenë gjallë. Ka qenë dashur për të qenë të guximshëm, sikur sot që po janë të guximshëm dhe t'i dëgjojmë, ta merr mendja se nesër vetëm ne kemi mbetur që ne mund t'i ndalim për një minutë. Realiteti është pak më ndryshe. Hajt të flasim pak realisht. A mundem t'i ndalim, a s'mund t'i ndalim dhe kujt po i konvenon sot, kur Kosova e ka këtë qetësi, kujt po i konvenon për ta prishur këtë rend dhe qetësi? Serbisë, po! Ne po e kuptojmë, Serbia çdo ditë do të punojë, për çdo ditë do

të punojë për ta prishur rendin dhe qetësinë, por mua po më intereson kujt po i konvenon nga shqiptarët të dalë sot ndoshta Policia e Kosovës apo ushtria të ndërmarrë hapa konkretë për të... Kjo është situata. Dhe, unë po pyes edhe diçka tjetër, në fillim e shtrua dilemën, çka mund të nxjerrë Kuvendi, cili akt ka fuqi më të madhe se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, çfarë vendimi, çfarë rezolute, çfarë deklarate do ta bënte më të fuqishëm që Kuvendi apo ekzekutivi i vendit mos të lejojë për t'u mbajtur zgjedhjet në Kosovë. Cila rezolute, unë s'po e kuptoj, ndoshta ka, por nuk e kuptoj që akt më me fuqi se Kushtetuta nuk ka.

Edhe një çështje tjetër. Asnjë qytetar i Kosovës, asnjë politikan, asnjë shqiptar, nuk do të dëshironte dhe nuk dëshiron asnjëherë që këto zgjedhje të mbahen, por të flasim pak realisht, këto zgjedhje nuk janë duke u mbajt për herë të parë, janë mbajt edhe në shumë komuna të Kosovës, ku sot e njohin realitetin dhe punojnë për institucione të Kosovës. Po! Ne po presim, ju lutem, unë ju kam dëgjua me vëmendje, po presim moment, edhe një herë e përgjithmonë ta harrojmë që ne me patriotizëm, me fyerje, me këto sa për opinion nuk mund të bëjmë asnjë punë të mirë për Kosovën. Punët e mira për Kosovën bëhen duke punuar, duke respektuar ligjin, Kushtetutën, duke respektuar njerëzit të cilët kanë kontribuar. Ne e dimë që s'kemi pas mundësi për të punuar, shumica s'kemi pasur mundësi për të punuar dhe e dimë që shumë njerëz kanë punuar edhe para vitit 98, bile shqyr që ka shkuar ai pushtet, se shumica e njerëzve që sot janë duke punuar, kurrë nuk kishin pasur mundësi për të punuar, sepse s'e kanë pasur as babë as babagjysh në struktura, të cilat unë nuk po dua t'ua përmend emrin, por e dinë mirë dhe nuk kemi pasur rastin për të punuar as nëpër autobusa të "Kosovatransit", por na ka ardhur rasti, këtë rast e kemi bërë me djersë, me gjak dhe duhet ta respektojmë. Ata njerëz që sot po i atakoni, më së shumti janë ata të cilët më së tepërmi kanë kontribuar që sot, se edhe këto fjalë që po i thoni sot, nuk i kishit thënë, por ndoshta ishit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj!

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të them të drejtën, nuk e pata në plan të flas, jam i nxitur pak dhe i shtyrë. Në radhë të parë dua të them se nuk po i gëzohem fatit dhe realitetit që është në Kosovë sot. Kjo është e vërteta e madhe. Më vjen mirë prej disa qëndrimeve të deputetëve këtu, kolegë që jemi, që po dalin kush është më patriot se shoqi edhe do tjerë kush ka vjedhë më pak. Realiteti në Kosovë është pak më ndryshe dhe në veriun e Kosovës qytetari i Kosovës nuk ka nevojë të dijë kush ka vjedhur më pak e më shumë, kush ka qenë më pak patriot a më shumë patriot. Kosova ka nevojë për ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe stabile dhe jo të atyre patriotëve të mëdhenj që kanë ndej në Slloveni, a në Rudner, a ku ta di se ku dhe tallen me ndjenjat e njerëzve që kanë halle sot. Aq më keq, nga një deputet që udhëheq një komision shumë me rëndësi, që kisha për t'i thënë, t'ia jap një falënderim dhe një kompliment për disa informata që ka sjellë sot këtu për kontrabandim të derivateve, e unë mund t'i them policit sherif që duhet bashkëpunuar me organet nëse nuk është i implikuar vetë drejtpërdrejt, e ai është Gani Koci. Fjala publike është fjalë publike, atë që e ke thënë, duhet t'i qëndrosh prapa, s'është hera e parë, e po ta përsëris. Duhet të qëndrosh dhe të rrish prapa atyre fyerjeve dhe akuzave.

Unë konsideroj se për këto zhvillime të cilat kanë ndodhur ditëve të fundit, Kryesia e Kuvendit është dashur të ketë një bashkëpunim më të afërt me Qeverinë e Kosovës dhe me presidentin. Dhe, nëse asgjë më shumë nuk kishim mund të mbërrijmë, së paku për qytetarin do të ishte një lajm i mirë dhe një informatë e mirë se organet e vendit, organet më të larta të shtetit, ekzekutivi dhe Presidenca e Kuvendi janë bashkë dhe bashkëpunojnë me të gjitha

organet tjera relevante që janë dhe mekanizmave tjerë ndërkombëtarë që janë në Kosovë, në mënyrë që të mos ketë hamendje dhe të mos ketë humbje të besimit në këto zhvillime të cilat po ndodhin në Kosovë.

Një shqetësim tjetër që na përcjell në Kosovë është se Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ndan buxhet për komunat serbe në Kosovë, në këtë radhë me veriun e Kosovës, po edhe me Novo-Bërden, por e vërteta është se nuk kemi auditim dhe nuk kemi raport të shpenzimit të mjeteve në këto komuna. Në të njëjtën kohë, prapë një shqetësim që mund ta nxjerr ose mund ta nxjerr një paralele tash në këtë rast, është se pronat e serbëve dhe të malazezve të cilat janë në pjesë të ndryshme të Kosovës, bashkëpunimi i organeve vendore komunale me bashkësinë ndërkombëtare ka bërë që të paguhet qiraja ose tatimi për pronat të cilat nuk janë në pronësi të qytetarëve shqiptarë në pjesë të ndryshme të Kosovës, ndërsa pronat të cilat i kanë shqiptarët në veriun e Kosovës as nuk marrin qira dhe sot e kësaj dite edhe tash e dhjetë vite, çka do të thotë se është një injorim nga organet vendore, organet komunale që janë në veriun e Kosovës, çka do të thotë se me një strategji të përbashkët ndoshta kishim mund ta mbërrijmë një kompromis dhe së paku ta kemi të drejtën e barabartë të drejta pronësore. Ndoshta nuk thashë atë që duhej thënë, por duhet pasur kujdes, duhet pasur shumë kujdes në fjalën publike, prapë po e them, edhe për Hotin edhe për Kocin. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Gani Koci, replikë, shkurt, një minutë!

GANI KOCI: Zoti Selmani, unë nuk kam thënë asgjë më tepër se çka kam deklaruar vitin e kaluar. Ju lutem, rishikoni cilat janë lidhjet e njerëzve tuaj dhe të partisë tënde me kompaninë Banjskatrans dhe njerëzit e asaj kompanie dhe të disa kompanive dhe njerëzve të tjerë që janë nën hetime të EULEX-it që nga viti i kaluar dhe deri më tani. Nëse do edhe një fakt, urdhëroni hulumtoni se cili nga doganierët që kanë qenë pikërisht në këto pika, është kërcënuar dhe është dashur të largohet dhe e ka ikur familjen e vet për 6 muaj ditë nga vendi ku ka banuar, që ka qenë i kërcënuar drejtpërdrejt prej njerëzve tuaj, të partisë tënde, krejt të tanëve, vëllezërve të kreut të partisë tënde.

KRYESUESI: Hajde, Selmanaj, një minutë!

IBRAHIM SELMANAJ: Nuk do të luaj rolin e avokatit, sepse nuk kam nevojë dhe janë për keqardhje këto shpifje edhe niveli i diskutimit, edhe forma e trajtimit, edhe mënyra e qasjes dhe më vjen keq prej të kaluarës së zotit Koci, kam respekt për të kaluarën që e ka pasur aq të mirë, por është i frustruar keq, edhe këto janë shpifje për të cilat ka përgjigje në çdo formë, në çdo minutë dhe në çdo kohë. Për të ndoshta mund të jetë edhe shërbim edhe ajo që ka ndodhur para 3-4 viteve se diçka ka pas këtu, se ajo se mëzdraku në thes nuk hyn asnjëherë. Këto janë ato që e kanë prurë deri në këtë situatë që edhe nga niveli i kryeministrit të dërgohet në Hagë, por këto janë ato që janë shkuar dhe të presim ditë më të mira, mos të lëshohemi në këto tema se nuk është mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministër, deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë duke pasur parasysh se sa ndryshime të qëndrimeve dhe vendime të faktorit ndërkombëtar kanë ndodhur reshtur që nga pavarësia e Kosovës, arritja e Serbisë që të shtyjë idenë e statusit neutral duke shfrytëzuar pasivitetin dhe indiferencën e institucioneve tona e që rezultoi me 6 pikëshin e Ban Ki Munit, që në të vërtetë është plan i pranimit të ndarjes de facto të vendit dhe po paraqet një sulm drejtpërdrejt në integritetin e

shtetit tonë, kjo ka shtyrë Lidhjen Demokratike të Dardanisë që tre muaj më parë të iniciojë në Kuvend debatin për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Propozimi i rezolutës që u propozua nga grupi parlamentar kishte për synim që të obligonte Qeverinë që të merrte masa në parandalimin e ushtrimit të veprimtarive rrënuese të Republikës së Serbisë dhe të konfirmonte zbatueshmërinë e Kushtetutës, që do të thotë do të ndalonte edhe mbajtjen e zgjedhjeve në veri të Kosovës, por fatkeqësisht as deklarata e miratuar aso kohe në Kuvend nuk është respektuar fare.

Deputetë të nderuar, ajo që duhet theksuar dhe pranuar sot, është se institucionet tona, si Qeveria dhe Presidenca, ka kohë që po përballen me legjitimitetin e dyfishtë. Nga njëra anë, ata në mënyrë të vazhdueshme veprojnë duke u justifikuar në sy të bashkësisë ndërkombëtare, ndërsa në anën tjetër deklarohen dhe vetëm deklarohen gjithmonë për konsum të brendshëm, duke llogaritur atë që populli kërkon dhe pret nga këto institucione dhe sot Kosova është ku assesi nuk do të duhej të ishte, është e mbërthyer me trende të zhvillimeve negative që sfidojnë dhe cenojnë shtet ndërtimin e një shteti të pa përfunduar. Deklarimet naive se këto zgjedhje nuk janë legjitime apo mos reagimi i autoriteteve ka pasur për qëllim që mos të shkaktojë incident, është më shumë se cinike duke pasur parasysh politiken agresive vepruese të Serbisë karshi vetëm deklarimeve tona boshe. Prandaj, lejimi i mbajtjes së zgjedhjeve në pjesën veriore të Kosovës konfirmon pushtetin real të Republikës së Serbisë në veri, si dhe do të vërtetojë gjendjen e ndarjes faktike para bisedimeve të paralajmëruara ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Kuvendi si institucion i përfaqësuesve të qytetarëve të Kosovës duhet ta ketë të qartë se mbajtja e zgjedhjeve serbe në Kosovë rrënon themelet e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së vendit dhe paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të sovranitetit. Deklarimet e përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare se nuk do të pranohen rezultatet e këtyre zgjedhjeve janë duke ngritur shumë dilema tek qytetarët tanë, duke pasur parasysh që Kosova është katandisur në një kaos juridik. Së pari, Kushtetuta që u miratua në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar dhe që do të duhej të zbatohet nga institucionet tona, pastaj fakti që përfaqësuesi civil ndërkombëtar, zoti Piter Feith është dashur të mbështesë dhe të zbatojë pavarësinë e Kosovës dhe planin e Ahtisarit, kurse në anën tjetër për përfaqësuesit e EULEX-it zotin Iv de Kermabo qasja ndaj Kosovës është status neutral, si dhe rudimenti i UNMIK-ut në veri, me qasje selektive ndaj neutralitetit.

Andaj, përkundër deklarimeve të institucioneve ndërkombëtare se këto zgjedhje nuk do të pranohen nga bashkësia evropiane, shqetësimi ynë i arsyeshëm mbetet nga implikimet që këto zgjedhje mund të kenë në të ardhmen e vendit tonë. Dhe, së fundi, institucionet tona duhet të jenë këmbëngulëse që në koordinim me praninë ndërkombëtare në Kosovë me çdo kusht të ndalojë pastrimin etnik në veri të Kosovës që proklamohet nga liderët serbë, të sigurojë respektimin e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës, ashtu siç kërkojnë jo vetëm dokumentet më të larta ligjore të shtetit të Kosovës, por edhe dokumentet ndërkombëtare mbi të cilat janë vënë themelet e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet deputeti Arsim Bajrami.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Unë do të futem drejtpërdrejt në temë. Kisha pasur dëshirë që Qeveria të ketë qëndrim unik, që të jetë e vendosur dhe ta bëjë një sqarim në dy pika kryesore: a e ka zgjedhur qëndrimin e vet që ta ketë injorimin e zgjedhjeve, apo pengimin. Në rast se e ka zgjedhur që të jetë injorimi si mjet, gjë që e ka bërë edhe në të kaluarën, atëherë injorimi duhet të ketë afat, edhe sa do t'i injorojmë zgjedhjet serbe në Kosovë. Nuk po them se cila metodë do të ishte më e mira, por mirë është t'ju tregohet qytetarëve të Kosovës se çka kanë zgjedhur të bëjnë, e jo

veç të jepen deklarata boshe që për momente të caktuara herë-herë nuk kanë as kuptim. Ndoshta herë-herë keqpërdoren edhe për t'i mbuluar aktivitetet tjera të sundimit të ligjit në Kosovë. Për shembull, siç është rasti me udhëheqësit e Kuvendit të Kosovës, ku pas bastisjeve në Ministrinë e Tregtisë dhe Telekomunikacionit deklarojnë se EULEX-i më mirë të ishte marrë me Mitrovicë se sa me ministri. Kjo është kërkesë për vendosjen e vatrave problematike nga një terren në terrenin tjetër. Edhe në diskutimet e tjera ne shpesh e kemi potencuar, nuk është mirë të vendoset në pazar krimin e organizuar me siguri në vend, sepse nuk ka person, nuk ka njeri që mund të vendos tyxharllëk në pazar të vetin sigurinë e Kosovës për t'iu lejuar marifetllëqet dhe manipulimet me paranë publike. Edhe ashtu e kemi thënë disa herë, sepse demokracia është dekontaminuese. Me fjalë të tjera, ndoshta edhe veriu i Kosovës i ka metodat e veta me të cilat do të mund të integrohej. Njëra prej metodave do të ishte kontaminimi demokratik. Me fjalë tjera, të zhvillohet demokracia në pjesë tjera të Kosovës dhe të luhet si shembull i mirë. Përderisa luhet me shembuj të këqij dhe kur e dimë se siguria është drejtpërdrejt e lidhur me zhvillimin demokratik, atëherë veprimet që ndodhin në pjesë tjera të vendit, nuk lënë shumë për të dëshiruar dhe normalisht që krijojmë edhe situata të tilla. Ndoshta herë-herë edhe përdoret situata e veriut për t'i ndërprerë proceset që ndodhin në pjesë tjera. Për shembull, nëse rastësisht vendosim, nëse kemi ne tash, po shihet që është prioritet i të gjitha institucioneve vendore, ndërkombëtare, së paku edhe ato vendore gojarisht po e thonë se jemi për sundimin e ligjit, askush s'është mbi ligjin, atëherë normalisht që presim që Serbia është e interesuar që të krijojë një ambient, një klimë në të cilën sundimi i ligjit nuk ekziston nëpër pjesë tjera dhe kjo na reflekton, mua personalisht më reflekton se krimi i organizuar mund të jetë edhe regjional. Me fjalë të tjera, kurdo që i nevojitet krimi, paraqiten akterë nga pjesë tjera të shteteve tjera dhe futen në lojë për ta zhvendosur vëmendjen e sundimit të ligjit gjithkund nëpër Kosovë.

Gjithashtu, ne e cekëm, e kemi cekur edhe disa herë, shumë e shumë herë nëpër seanca tona në Kuvend, unë personalisht e kam cekur pozicionin e kryetarit të Kosovës. Kryetari i Kosovës garanton funksionimin kushtetues të vendit. Si ke mundësi të kërkoesh funksionim kushtetues të vendit, kur je i pari që nuk e respekton. Absolut, nuk ka kush në botë që mund t'ia fusësh në mendje. Përderisa kryetari i vendit është model i keq për funksionimin kushtetues të vendit, atëherë edhe pritjet zvogëlohen.

Gjithashtu, do të ndalem pak edhe në sqarimet që i dha ministri i Punëve të Brendshme, sqarime që nuk mjaftojnë vetëm shqetësimet të deklarohen, shqetësimet shterpe, ndoshta është edhe mungesë e kreativitetit për zgjidhjen e problemeve politike. Në politikë ka nevojë edhe për kreativitet, luftimin e krimi apo edhe shpjegime mbi funksionimin. Besoj se të gjithë janë të vetëdijshëm, edhe qytetarët që na dëgjojnë e dinë se si funksionet në Kosovë, po ka nevojë që të jemi më të vëmendshëm dhe që të jemi më këmbëngulës në luftimin e krimi të organizuar nëpër pjesët tjera të Kosovës, se të gjithë e dimë që krimi i organizuar është pikërisht ai që i bashkon të gjithë, njerëzit e të gjitha etnive. Edhe Kosova është vend i qytetarëve, nuk ka nevojë të ndahen diskutimet në serbë apo shqiptarë, është vend i qytetarëve të Kosovës, sepse ky do të ishte patriotizmi më i madh. Faleminderit për dëgjim!

KRYESUESI: Fjalën e merr deputeti Arsim Bajrami, të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Padyshim se ky debat, çështja e Mitrovicës do të ishte një mundësi e mirë që ne të demonstrojmë para zgjedhësve tanë sa jemi në funksion të përgjegjësive publike që i kemi

marrë, sepse të diskutosh për çështjen e Mitrovicës, do të thotë të diskutosh për një çështje fundamentale të shtetit tonë të ri. Fatkeqësisht, opinioni do të dëshpërohet në qoftë se e ka përcjellë këtë debat, sepse ne kemi treguar se nuk e kuptojmë këtë çështje si çështje shtetërore, por më tepër si një mundësi për shfrytje politike, për veprim opozitar dhe mendoj që edhe vetë sponzorizuesit e këtij debati nuk do të donin që ky debat të rrëshqet në një debat krejt opozitar dhe në kritika të pakontrolluara ndaj Qeverisë, sepse çështja e Mitrovicës nuk është vetëm çështje e Qeverisë, por është çështje e krejt shtetit tonë, një çështje komplekse që e ka një histori të vetë dhe një çështje që do një qasje shumë serioze shtetërore për t'u zgjidhur dhe për t'u menaxhuar në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në kuptim të sigurimit të veprimit të plotë të autoritetit të Qeverisë së Kosovës në tërë territorin e Kosovës dhe autoritetet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mendoj që çështje e fundit që ne duhet politizuar, do të ishte çështja e Mitrovicës, nuk është e ndershme edhe ndaj qytetarëve të vet qytetit të Mitrovicës që po na shohin dhe që po shohin një debat, do të thosha shterp, të cilin e kemi parë nga 5-6 herë në këtë Parlament, sepse 5-6 herë është diskutuar dhe mendoj që duhet të demonstrojmë një qasje krejt tjetër. Ne duhet ta adresojmë përgjegjësinë konkrete tani 2 vjet pas pavarësisë, përgjegjësinë konkrete dhe mundësitë tona reale për të mundësuar që ajo pjesë e Kosovës të integrohet dhe të vendoset nën ligjin e Republikës së Kosovës.

Çështja e integritetit apo e cenimit të integritetit, si e ka quajti sponzoruesi, është shumë komplekse dhe ajo manifestohet në disa segmente, por mendoj që motivi ka qenë që në vigjilje të mbajtjes së zgjedhjeve kjo çështje të shtrohet edhe pse ka disa dimensione, është dimension i cenimit të rendit kushtetues me paralajmërimin e zgjedhjeve lokale serbe, është dimension i mosfunksionalitetit të plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe veprimet e institucioneve të paligjshme, jo paralele, pajtohem me profesor Smakën, jo paralele por institucione të paligjshme jokushtetuese dhe dimension i krimit të organizuar që atje po vepron, siç u cek. Ne nuk duhet tash të merremi vetëm me përshkrimin e situatës. E tha ministri i Punëve të Brendshme, ne nuk do të preferojmë një zgjidhje represive. Është e vërtetë që ne nuk do të preferojmë zgjidhje represive, por duhet ta prevenojmë situatën, sepse nuk është njëjtë situata tani ose kërcënim i zgjedhjeve lokale e njëjtë sot, si para 6-7 vitesh, sepse ne tani kemi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kemi ligjet e Kosovës dhe kemi në mënyrë të qartë të adresuara përgjegjësitë edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse në dispozitat kalimtare që ju profesor Hamiti i cekët, në dispozitat kalimtare në mënyrë shprehimore ceket përgjegjësia e autoriteteve ndërkombëtare për të mundësuar implementimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës është shumë e qartë, ajo siguron pacenueshmërinë, integritetin territorial dhe zbatimin e Kushtetutës në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Është e vërtetë se në atë pjesë të Kushtetutës adresohen përgjegjësitë e shtuara për prezencën civile dhe për misionin e EULEX-it dhe ne duhet të kërkojmë që ato funksione dhe ato përgjegjësi të ushtrohen, të ushtrohen në mënyrë të plotë dhe duhet të kërkojmë që vërtet autoritetet ndërkombëtare të sigurojnë implementimin dhe zbatimin e plotë të Kushtetutës, sepse në një mënyrë ato edhe kanë qenë pjesë e procesit të hartimit të Kushtetutës, ndërkaq Qeveria e Kosovës po bën përpjekje për herë të parë përmes strategjisë për veriun, ka paraqitur një vizion të parë dhe mendoj se ky vizion duhet të mbështetet dhe ne duhet të kërkojmë prej Qeverisë të jetë shumë këmbëngulëse dhe të intensifikojë përpjekjet për të realizuar për herë të parë një strategji konkrete, e cila është e afatizuar me veprime konkrete, në mënyrë që ne të zgjidhim këtë problem që është një problem shtetëror. Pra, krejt çka mundet Parlamenti, është që të mbështesë këtë përpjekje të Qeverisë dhe të kërkojë nga prezenca civile ndërkombëtare, nga autoritetet ndërkombëtare që ato të realizojnë misionin për të cilin edhe kanë ardhur në Kosovë, sepse një nga misionet e tyre është edhe

implementimi i plotë i Kushtetutës, implementimi i pakos së Ahtisarit, e ne të gjithë e dimë se pakoja e Ahtisarit ka bërë një kompromis politik sa i përket pozitës së veriut të Kosovës dhe është obligim kushtetues i këtij Kuvendi që të kërkojë që ato përgjegjësi të ushtrohen në mënyrë që të sigurohet integriteti i plotë territorial i Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Fjalën e merr deputeti Armend Zemaj, të përgatitet kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, profesor!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

T'ju them të drejtën, është një çështje komplekse, e cila po vazhdon pothuaj se ndoshta vetëm i ndryshon ritmi dhe e cila mbetet po ashtu problem kryesor në aspektin e cenimit territorial të kufijve, po edhe në atë që ne po e quajmë dëmtimit ekonomik dhe zhvillimit ekonomik të vendit tonë, duke marrë parasysh sepse po shihet qartë se nuk kemi një kontroll të detajuar në aspektin ekonomik të hyrje-daljeve nga ai territor. E them edhe unë që duhet të respektohet apo të përshëndetet edhe kërkesa e zëvendëskryeministrit, i cili i ka dërguar EULEX-it për ndërprerjen e hyrjes ilegale të zyrtarëve shtetërorë serbë, por kjo duhet të zbërthehet dhe të shihet se si do të implementohet në të ardhmen, sepse e kemi të qartë dhe kemi parë edhe skenat vizuale, tentimin e zyrtarëve të tjerë dhe të cilët në çfarë forme janë dëbuar nga policia e Kosovës. Në rast se bëjmë politikë me këtë problem, nuk është e drejtë, nëse nisemi nga arsyeja e shëndoshë, atëherë mendoj që duhet të respektohen normat demokratike edhe nga ata që janë të frustruar, në këtë rast komuniteti i asaj pjese apo që keqpërdoren nga pushteti i Serbisë në vazhdimësi dhe këtë po e shohim si dëshirojnë apo ta shndërrojnë edhe Kosovën në problem rajonal dhe deri aty se si duhet të funksionojë një shtet apo të thirret se si nuk funksionon ky shtet.

Në aspektin ekonomik, unë mendoj se kjo gjendje i konvenon dikujt apo do të dëshiroja që mos t'i konvenojë. Nëse na pengojnë njerëzit që merren me aktivitete të paligjshme, për shembull me supermarkete që financohen nga Kariqët dhe importi i gjërave ushqimore është më i madhi, domethënë nga aty, duhet të shikohen t'i parandalojmë. Nëse na pengojnë njerëzit që janë bosë të kazinove në Kosovë dhe për çdo ditë, domethënë, si këpurdhat zbërthehen në territorin e Republikës së Kosovës, atëherë ta shohim se si cilët hapa duhet tash edhe Qeveria, edhe institucionet e rendit po edhe Kuvendi se cilat masa duhet t'i marrim. Edhe deri te ata që i përmendi kolegu im i nderuar, bosët e naftës, të cigares, a po e pengojnë këta apo na nuk e kemi vullnetin që t'i pengojmë ata. Cili është interesi këtu politik. Mos të thirremi vetëm në një aspekt tash, që e quajmë ne atë që vetëm Serbia tenton me zgjedhje apo pa zgjedhje ta destabilizojë edhe këtë pjesë, po edhe Kosovën si tërësi, po së paku të thirremi edhe nga vetvetja, edhe nga ata njerëz që janë të implikuar dhe i përgatitin terrenin këtyre qasjeve dhe këtij problemi. Këtë e them me shumë sinqeritet dhe pa ndonjë ngarkesë të madhe dhe mendoj që çdo njëri, edhe i qeverisë së kaluar, po edhe i qeverisë së tashme, edhe deputetët të kaluar, edhe deputetët e tashëm ta ndjejnë një përgjegjësi të madhe ndaj këtij problemi. Edhe këta të komunitetit serbë, kolegë të nderuar që janë, se tha shefi i grupit, unë tha jam i vetmi që jetoj në atë pjesë, po këtu kemi njerëz që e kanë shtëpinë në atë pjesë, janë deputetë dhe asnjëherë nuk guxojnë të shkojnë, prandaj edhe në këtë aspekt duhet ta kemi një koordinim të sinqertë bashkërisht institucional dhe ta shohim zgjidhjen e këtij problemi, mos të thirremi veç se Serbia po na atakon, po vjen Nikoliqi dhe tash do të dalin këtu njerëz patriotë që do t'ia ndalojnë dhe do ta ndjekin edhe me thupër, nëse është e nevojshme. Prandaj, të bëhet politikë në këtë aspekt, është shumë e lehtë, të bëhet biznes, po shihet se dikujt po i konvenon, është shumë e lehtë, edhe me ndonjë tenxhere cepter edhe me

ndonjë send, është shumë e lehtë. Por, unë mendoj se duhet t'i qasemi seriozisht, mos të bëjmë politikë me këtë problem, po bashkërisht të kërkojmë zgjidhje adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, në rend pastaj është deputetja Nekibe Kelmendi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë e kam theksuar shpesh se sa i përket çështjes së Mitrovicës, realisht në asnjë rrethanë nuk duhet të na ndajë profili partiak apo interesat e ngushta partiake, por duhet të funksionojmë si institucione të Republikës së Kosovës dhe si politikë shtetërore e Kosovës.

Dëshiroj të theksoj se gjendja në veri nuk e bën për t'u krenuar askënd nga ne, e as angazhimet e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, por ne të gjithë jemi këtu që të punojmë për t'i zgjidhur problemet dhe jo për të krijuar probleme të reja. Në këtë drejtim, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës është duke punuar ngushtë me të gjitha autoritetet relevante ndërkombëtare në Kosovë që të ecet me një ritëm të avancimit më afirmativ, mund të themi, të zgjidhjes së problemeve edhe në veri, për herë të parë, do të thotë, këtu hyn edhe NATO, edhe ICO, edhe EULEX-i, edhe komuniteti evropian i cili e ka hapur një zyrë në atë pjesë. Duke përfshirë nga viti 2008, 2009 dhe viti 2010, mund të them se kemi investime për ndërtimin e shtëpive të reja, për kthimin e njerëzve në shtëpitë dhe pronat e tyre dhe banesat e tyre dhe tanimë disa prej familjeve janë kthyer dhe jetojnë një jetë të re në Mitrovicë, të sigurt, dhe ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ne kemi arritur suksese për t'i integruar komunitetet, në veçanti me organizimin e zgjedhjeve të lira, për herë të parë, lokale, do të thotë zgjedhjet e para lokale në Kosovën e pavarur, duke integruar komunitetin serb edhe në Shterpcë, edhe në Kllokot, edhe në Graçanicë, edhe në vendbanime tjera dhe duke arritur ose shpërbërjen e plotë ose minimizimin e rolit të strukturave paralele dhe ky është një sukses i vlerësuar nga të gjithë. Qeveria e Kosovës është duke investuar si në të gjitha komunat tjera në projekte edhe në këto komuna të dala nga reformimi i pushtetit lokal apo decentralizimi apo plani i presidentit Ahtisari.

Në veri jemi duke vazhduar që të punojmë bashkërisht në mbështetje të plotë dhe unanime e unike ndërkombëtare për strategjinë, e cila është harmonizuar, është aprovuar dhe ka filluar të punohet, një – për sundimin e ligjit, për formimin e komunës së re, për rendin demokratik në tri komunat dhe për zhvillimin ekonomik.

Sa i përket sundimit të ligjit dhe fenomeneve, dukurive, fenomeneve negative të cilat u përmendën këtu, qoftë të korrupsionit, qoftë të kontrabandës, qoftë të fenomeneve tjera të cilat janë të paraqitura atje nga grupet radikale apo ekstremiste, dua të potencoj para të gjithë juve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, unë jam kryetar edhe i Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe jam i kufizuar të shprehem me deklarime politike për angazhimet dhe projektet të cilat janë duke u realizuar dhe informacionet të cilat posedojmë, por e them me përgjegjësi të plotë se duhet t'i japim mundësi, të krijojmë mundësi dhe mbështetje të plotë unike të gjithë spektrit politik dhe institucional të Republikës së Kosovës për drejtësinë, që drejtësia të japë fjalën e vet për këto dukuri atje, se kush është i involvuar, drejtësia do ta prezantojë, jo politika, jo betejat politike, jo shpifjet, jo akuzat, jo veprimet aventuriere e as folklorizmi patriotik.

Nëse Parlamenti i Republikës së Kosovës mendon se Qeveria e Kosovës duhet të jetë më e angazhuar në kuptimin e veprimeve që u dëgjuan këtu, unë e them, nuk është situatë për t'u

krenuar as prej vendorëve e as prej ndërkombëtarëve. Angazhimet tona janë të (ndërprerje e incizimit) ... bashkërisht me komunitetin ndërkombëtar, por jam sot përsëri për të shprehur zotimin tim se çdo vendim i juaj që mendoni se duhet bërë më tepër në këtë moment, merrni vendimin, unë do ta implementoj. Fjala është e juaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotni kryeministër!

Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi. Meqë deputetët, secili kujton që është vetë i pari, unë po ua lexoj emrat me rend, qysh janë. Driton Tali, Gani Buçinca, Ismajl Kurteshi, Kaqusha Jashari, Suzan Novobrdaliu, Edita Tahiri, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Rexhep Hoti, Esat Brajshori, Branislav Grbiq, Zef Morina. Mbani mend! Fjalën e ka Nekibe Kelmendi, natyrisht, fjalën e merr pas saj Driton Tali.

NEKIBE KELMENDI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra,

Shumëçka u tha sot dhe diçka ishte e tepruar, diçka ishte me vend, por më lejoni që edhe unë, si deputete, të jap një kontribut timin rreth temës për të cilën po debatojmë.

Sot po debatojmë për një çështje me interes për shtetin tonë dhe popullin e tij. Mu për këtë arsye, është dëshirë e imja që me debat konstruktiv të kontribuojmë që debati të përfundojë me një qëndrim të përbashkët unanim, si të opozitës, ashtu edhe të pozitës. Dimë se sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës është i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mirëpo për ruajtjen e integritetit territorial, për një pjesë të Kosovës, fjala është për veriun, patjetër na nevojitet edhe ndihma ndërkombëtare, që edhe ashtu është e paraparë edhe me pakon e Ahtisarit.

Na shqetësojnë të gjitha ngjarjet që e cenojnë sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës. Aktualisht, një cenim po ndodhë nga shpallja dhe organizimi i zgjedhjeve lokale nga Republika e Serbisë në një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Tubimet elektorale po mbahen nga liderët partiakë dhe ministra të Serbisë, të shoqëruar nga persona të armatosur të institucioneve shtetërore të Republikës së Serbisë. Aq më tepër, këto po na shqetësojnë kur po dëgjojmë kërcënime nga më të ndryshmet, madje edhe kërcënime për krime kundër njerëzimit, siç është spastrimi etnik i pjesës së territorit të Kosovës.

Që të mund t'i funksionalizojmë institucionet shtetërore, e në funksion të eliminimit të këtij cenimi në atë pjesë të Kosovës dhe për t'i evituar provokimet e ndryshme, siç janë edhe zgjedhjet që parashikohen të mbahen, do të kërkoja që debati të përfundojë me marrjen e një qëndrimi, i cili do të parashihte, ashtu siç i kam menduar unë, këto pika:

1. Të ndalohen vizitat e zyrtarëve të Republikës së Serbisë për vizita private dhe zyrtare pa lejen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Ndalohet organizimi i zgjedhjeve të shpallura nga Republika e Serbisë në pjesë të territorit të Kosovës, sepse nuk është vetëm veriu, por është edhe Novo-Bërda.

3. Ftojme Qeverinë e Kosovës që me ndihmën e autoriteteve ndërkombëtare, në kuadër të misionit për sundimin e ligjit dhe për zbatimin e pakos së Ahtisarit, që nënkupton edhe ruajtjen e integritetit dhe të sovranitetit territorial të Kosovës dhe funksionalizimin e institucioneve atje, që kjo të ndodhë sa më shpejt.

4. Së fundi, t'u kthehen pronat qytetarëve të Mitrovicës si në veri, ashtu edhe në jug të qytetit dhe të kurajohen qytetarët e veriut të Mitrovicës, ata të komunitetit shqiptar apo të përkatësisë shqiptare që mos t'i shesin pronat e tyre, që si pasojë do të kishim edhe spastrimin etnik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Nekibe Kelmendi! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, të përgatitet Gani Buçinca.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndonëse shumë sende u thanë, megjithatë mendoj se atë që i nderuari zoti Emrush Xhemajli e tha se ky debat patjetër duhet të bëhet në formë institucionale, se përndryshe na del nga dora dhe e bëjnë të tjerët, bëhet më ndryshe dhe ajo nuk është në interes tonin.

Unë po them, u thanë shumë gjëra dhe shtrohet pyetja se a jemi kah flasim gjëra të reja apo janë këto klishe të cilat s'kanë ndryshuar fare. Të paktën këto dy vitet e fundit, ne kemi pas tentuar në prill, nëse ju kujtohet, një seancë, ky legjislacion, një seancë të tillë ta organizojë, ta nxjerrim një rezolutë dhe ajo më në fund hyri në ujë, u tkurr, na doli një deklaratë përshëndetëse në atë stilin, veç mungonte edhe një pikë muzikore. Dhe, çfarë ndodhi, ne e kemi këtë situatë çfarë e kemi. Këtë që po tentoj ta them, është se nëse ne sillemi kështu, siç jemi sjellë këto dy vitet e fundit, në realitet këto dhjetë vitet e fundit, situata nuk do të ndryshojë, ne do ta kemi edhe pas dhjetë viteve një situatë të tillë dhe përsëri do të merremi me njëri-tjetrin se kush bëri më shumë e kush bëri më pak. Pra, ajo thënia jonë e moçme se "shtëpia po kallet, gjyshja po krihet".

Në kohën e fundit edhe EULEX-i e dha një deklaratë, madje edhe ata ma çuan një nostalgji të vitit 2008, nëse ju kujtohet, i famshimi Rycker në prill të vitit 2008 i folte edhe disa fjalë më të sërta se këta të EULEX-it, që thanë se nuk i njohim ato zgjedhje, ai bile ishte i pari i cili e farkoi atë termin – struktura paralele të papranueshme për UNMIK-un, se ishin në kundërshtim me 1244-shin e kallëzonte përralla tjera, bile ishte dhe shumë i zëshëm kur u vandalizuan dy pikat kufitare, ishte më i zëshëm se ne bile. Dhe, pas një muaji, shefi i tij Ban Ki Muni na e çoi atë letrën e famshme që, njërin ia adresoi presidentit Tadiq, kurse tjetrën zotëri apo doktor Sejdiut, pra jo president Sejdiut, dhe na rekomandonte që të bisedojmë për 6 pikat, sepse situata kishte ndryshuar, domethënë atëherë zgjedhjet ilegale të Serbisë më nuk u bënë ilegale, nuk quheshin, por thoshin zgjedhjet e 11 majit dhe ai vandalizmi u shndërrua në ngjarjet e shkurtit në pikat kufitare. Atë që po dua ta them është se me këtë mënyrë, ne përsëri pas nja dy-tre vjetësh do ta mbajmë edhe një seancë të ngjashme, do të merremi me vetveten dhe situata do të vazhdojë ajo që është. Bbase dikush, ndonjë diplomat i jashtëm, që veç tash na ka kuptuar se ne kënaqemi me disa deklarata boshe, pak edhe me pasion, dhe ato i përdorim varësisht se kujt dhe si i shkon në interes, qoftë pushteti i tashëm do t'i përdorë për atë se ne po bëjmë diçka, opozita do t'i përdorë se ju s'jeni duke bërë kurrgjë dhe megjithatë, do të thotë, situata nuk do të ndryshojë.

Unë po them, bile prej 2008 situata është përkeqësuar nëse marrim parasysh faktin se megjithatë në fuqi ka hyrë kjo kushtetutë, thirremi në atë kushtetutë, është krijuar Policia e Kosovës, s'është më e UNMIK-ut, por zinxhiri komandues ne e dimë se policët atje në veri të Mitrovicës nuk e respektojnë zinxhirin komandues, pastaj tash për ko incidencë apo si ndodhi, së pari KEK-u ua ndali rrymën atyre atje dhe pastaj e pësoi, iu fut në terren të gatshëm, nuk do të doja të besoj se është bërë në koordinim, por konsekuencat janë të tilla. Dhe, çka më tutje? Unë mendoj se sinjerisht është koha që të bëjmë më shumë presion dhe të kemi një strategji të mirëfilltë, por jo kjo strategji që sot zëvendëskryeministri disi u krekos me të, por

sinqerisht ajo strategji nuk është për t'u krenuar, sepse aty në strategji, atë që na e keni dërguar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Gani Buçinca, të përgatitet Ismajl Kurteshi.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Debatin e sotëm, t'ju them të drejtën, e prita me njëfarë entuziazmi dhe me njëfarë dëshire që, më në fund, në Parlamentin e Kosovës të diskutohet me seriozitet për një temë e cila i preokupon të gjithë qytetarët e Kosovës dhe, pa dyshim, edhe shtetarët e Kosovës dhe miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët janë këtu për të na ndihmuar që në këtë fazë të shtetndërtimit t'i kalojmë sa më me lehtësi problemet. Mirëpo, zhgënjimi erdhi papritmas për shkak të nivelit të ultë të debatit nga ana e opozitës, përkatësisht niveli i ulët intelektual dhe politizimi i skajshëm i këtij problemi për përfitime partiake, duke e shfrytëzuar këtë problem të Kosovës për qëllime elektorale. ... që temat e këtilla të këtij karakteri që qoftë në kohështrirje, qoftë nga përmasat dhe për nga ndjeshmëria e tyre janë shumë të vështira, do të ishte mirë që të na bashkojmë dhe të kemi një unitet më të madh si deputetë. Kurse për temat tjera, mund të hapim debate në ndonjë seancë tjetër parlamentare.

Unë padyshim jam ithtar i një politike pragmatike në integrimin e veriut, jam ithtar i mospërdorimit të dhunës kundrejt strukturave të instaluara të Serbisë atje, jam ithtar i asaj që të bëjmë investime politike, të jemi një çik të durueshëm që mos të përdorim dhunë, të mos përdorim një gjuhë ekstremiste, mos të prodhojmë situata që pastaj vështirë mund të kontrollohen dhe vështirë mund të riparohen pasojat politike të tyre. Unë mbështes përpjekjen e Qeverisë dhe të bashkësisë ndërkombëtare këtu që gradualisht, në mënyrë pragmatike të integrojnë atë pjesë të Kosovës. Ne i kemi të gjitha instrumentet juridike në dorë dhe të gjitha ato instrumente juridike dhe politike na japin mundësi që pas një kohe, pas shumë përpjekjeve, me faktorë, bashkë me faktorët ndërkombëtarë të arrijmë në vendimin politik për përdorimin e dhunës në këtë pjesë të Mitrovicës, Mitrovicës së veriut, unë e them, jo Mitrovicës së Kosovës, por Mitrovicës së veriut deri në kufi me Serbinë.

Për fat të keq, ne e kemi një shtet i cili ndjek politikë destabilizuese në rajon dhe, për fat të keq, ky shtet me gjithë këtë joshet nga organizmat evropianë për t'u integruar pa asnjë kusht, edhe pse është faktor destabilizues në Ballkan. Unë megjithatë kisha shfrytëzuar rastin, pasi e kemi edhe kryeministrin këtu, që t'i paraqes disa sugjerime për Qeverinë dhe faktorin ndërkombëtar, që sigurisht është i interesuar që të na ndihmojë në këtë proces.

Deklaratat – mospërdorimi i dhunës në emër të ligjit, ma merr mendja se i inkurajojnë ekstremistët në veri. Inkurajimi i ekstremistëve në veri padyshim ngjall ekstremizëm edhe në pjesë të tjera të Kosovës dhe është e pashmangshme në rast se një ekstremizëm kaq i madh në veri, kjo arrogancë e pushtetit serb atje dhe disa strukturave kriminele atje, paraqiten dhe e manifestojnë arrogancën në këtë mënyrë publikisht, që mos të ngjallim ekstremizëm edhe në pjesët shqiptare të Kosovës. Kjo për mua paraqet një rrezik.

Pastaj, mosndëshkimi i Serbisë nga ana e Bashkimit Evropian për politikën që po e ndjek karshi Kosovës dhe rajonit në përgjithësi, mua ma merr mendja se do t'i hakmerret vetë Bashkimit Evropian për arsye se ata i krijojnë ... qeverisë serbe në Serbi, të cilat gjithnjë

vijnë në emër të nacionalizmit në pushtet dhe kështu e mbajnë peng tërë rajonin me atavizmat nacionaliste dhe nuk janë premtuese për demokratizimin e rajonit. Besoj se Qeveria e Kosovës sikur deri më tani, koalicioni qeveritar në bashkëpunim me të gjithë organizmat ndërkombëtarë që kanë qenë këtu dhe që na kanë ndihmuar për të ardhur deri këtu, edhe gjatë luftës, edhe pas periudhës së luftës, pavarësisht lëshimeve që kanë mund të ndodhin në Kosovë, besoj se gradualisht do të integrojnë edhe këtë pjesë, megjithatë përparimet

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Ismajl Kurteshi, të përgatitet Kaqusha Jashari.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit kryesues!

Përhëndetje për Kabinetin qeveritar, për deputetët!

Sot kur vendosëm të diskutojmë për këtë çështje kaq të rëndësishme, kam pritur që të reagojmë si Kuvend i Kosovës dhe jo të ndahemi në pozitë dhe opozitë sepse kjo na godet të gjithëve njësoj.

Të nderuar deputetë, gjatë 11 viteve të kaluara po eksperimentohet me Kosovën për shkak të tolerancës së tepruar të të gjitha qeverive dhe të atyre që kanë qenë në pozitë gjatë kësaj kohe dhe qëndrimit seleksionues të faktorit ndërkombëtar në sferën e respektimit të ligjeve.

Pa hyrë në detale dhe pa i përmendur të gjitha anomalitë që po ndodhin, propozoj që Kuvendi i Kosovës të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që menjëherë, atje ku nuk ka ndodhur gjer më tani, ta fillojë ushtrimin e të drejtave dhe obligimeve të saj kushtetuese, sidomos në mbrojtjen e integritetit dhe të sovranitetit të vendit dhe në trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të komuniteteve që jetojnë në të sepse privilegjimi dhe toleranca ndaj një komuniteti shkakton me automatizëm edhe nervozë, por edhe dëme komuniteteve të tjera, kurse Kuvendi duhet të kërkojë nga EULEX-i t'iu jap fund praktikave të qëndrimit seleksionues sa i përket angazhimit të tij për respektim të ligjit. Ne në parim dhe në esencë e përkrahim angazhimin deklarativ të EULEX-it – askush mbi ligjin, por duhet të themi se jemi kundër veprimeve selektive të EULEX-it mu në këtë fushë. Është e papranueshme që t'u vihet zjarri pikave doganore, gjykatës në Mitrovicë, instalimeve të ndryshme të operatorëve legalë dhe askush të mos përgjigjet dhe EULEX-i të mos marrë asnjë masë. Është e papranueshme që EULEX-i t'i ndjek protestuesit paqësorë e të lirojë vrasësit, siç ka ndodhur me policët rumunë para disa vitesh. Është e papranueshme që në Kosovë edhe më tutje të lejohet qarkullimi i automjeteve me regjistrime dhe tagra të skaduara para 10 vitesh. Është e papranueshme për qytetarët e Kosovës që pjesëtarët e një komuniteti të caktuar të tolerohen të mos paguajnë tatim, të mos paguajnë rrymë, ujë e të tjera dhe asgjë të mos ndërmerret.

Kolegë të nderuar,

Është koha e fundit që të kërkohet nga EULEX-i, nga UNMIK-u dhe nga të tjerët që t'i marrin me seriozitet dhe t'i kryejnë obligimet e tyre kushtetuese ose sipas marrëveshjeve të tjera dhe sidomos të angazhohen në mbrojtjen e sovranitetit dhe të integritetit territorial të Kosovës dhe respektimin e ligjeve. Duhet po ashtu të kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që ta mbrojë sovranitetin e vendit dhe ligjshmërinë me mjetet që i lejon Kushtetuta e Kosovës ose me mjetet me të cilat cilido vend demokratik do t'i mbronte në rast se një shtet tjetër do të organizonte në territorin e saj zgjedhje, siç është rasti me Serbinë që po organizon zgjedhje në territorin e Kosovës. Nëse aktualisht Qeverisë së Kosovës i mungojnë kapacitetet e nevojshme, gjë që edhe është e mundur, mendoj që Kuvendi edhe duhet të përkrah, edhe

duhet të kërkojë nga Qeveria që këto kapacitete t'i ndërtojë sa më parë dhe të mos lejojë që të vihet në pikëpyetje sovraniteti i vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Kaqusha Jashari. Pas saj e merr fjalën Suzan Novobrdaliu.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kryeministër, Kabinet qeveritar dhe kolegë deputetë,

Edhe unë kam qenë një prej atyre që kam menduar se është mirë të diskutojmë për këtë temë, por kam menduar se diskutimi duhet të jetë shumë më real edhe për situatën e krijuar, por gjithashtu duhet të shikojmë edhe në aspektin real edhe mundësitë tona, çka më tutje. Nuk jam prej atyre që duhet të shfrytëzojmë rastin t'i sulmojmë institucionet vendore – Qeverinë, por gjithashtu nuk jam as që ta mbrojmë apriori për diçka çka mendojmë se ka mund të jetë edhe ndryshe.

Unë vetëm po filloj me këtë konstatim se kemi thënë të gjithë se hyrja e zyrtarëve të shtetit fqinj të Serbisë është cenim i sovranitetit territorial, por me siguri cenimi i sovranitetit është edhe më i madh mbajtja e zgjedhjeve lokale të shtetit fqinj dhe ky është fakt që nuk mund të them se nuk është dhe askush nuk e konteston, por shtrohet pyetja, për shembull, pse Qeveria e Kosovës nuk ka autoritet shtetëror në këtë pjesë. Unë s'po them autoritet të veprimit, sepse e kemi programin dhe në këtë drejtim në këtë pjesë të Kosovës punohet shumë, por autoritetin shtetëror Qeveria nuk e ka. Dhe, s'po them që s'po do ta ketë, por me siguri janë do pengesa tjera në raport me ndërkombëtarët.

Gjithashtu, EULEX-i vepron jo si neutral qysh ka deklaruar, por unë po them që punon dhe mundëson mbajtjen e zgjedhjeve, se kjo e fundit që ka qenë letra e tyre që i jepet urdhër policisë të mos lejojë hyrjen, nuk është EULEX-it, por këtë duhet ministria jonë ta japë. Prandaj, janë do përzierje të kompetencave që Qeveria duhet t'i sqarojë me EULEX-in.

Atë çka më së shumti mua po më shqetëson, është veprimi jo i përbashkët në këtë pjesë. Ndoshta ky vlerësim imi është për shkak të mungesës së informatave, nuk kam pse të mos besoj që kryeministri ka thënë se e kanë të shkëlqyeshëm bashkëpunimin, por edhe dy ditë i kemi deri te mbajtja e zgjedhjeve dhe unë po shtroj pyetjen – çka më tutje. Unë s'besoj se për dy ditë mund të ndryshohet diçka. Por, kurrkush nuk po diskuton në lidhje me pasojat. Unë më shumë e kam shqetësimin te pasojat. Më herët sikur të kishim diskutuar për këto zgjedhje, unë kisha qenë prej atyre që mos të lejohet mbajtjen, por për dy ditë s'e di çka mund të bëhet. Po ku janë pasojat? Pas të 30-tit, organet lokale të shtetit fqinj ekzistojnë, ne s'mund të themi se jo. Deklaratat që nuk janë legjitime, deklaratat që nuk janë valide, që s'kemi pasur bashkëpunim, krejt është në rregull, por ato organet do të punojnë vetë atje. Unë jam e sigurt që kanë për të pasur ndikimin në këtë pjesën e vendit tonë, që kanë për ta penguar mbajtjen e zgjedhjeve tona lokale atje. Çka, atëherë? Kemi për të pasur pengesa shumë – shumë të mëdha. Ne jemi futur në situatë shumë delikate. Ne mund ta pranojmë ose mos ta pranojmë, por ne jemi futur në situatë shumë-shumë delikate. Vetë pranimi në atë kuptim të heshtjes që zgjedhjet le të mbahen, por nuk janë për ne valide, në një mënyrë është tërheqja jonë. Unë ashtu e konsideroj. E në qoftë se tërhiqemi edhe më tutje, unë po frikohem mos po krijohet një realitet i ri, e çdo realitet i ri, po mendoj për të keqen, e realitet i ri në favor tonin është i mirë, por në qoftë se krijohet realitet i ri që mund të hapë edhe opsione të reja për zgjedhjen e çështjes së Mitrovicës, ka për të qenë një tension shumë-shumë më i vështirë. Më vonë ...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet Edita Tahiri!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër, të nderuar qeveritarë,

Të nderuar kolegë,

Ende pa kaluar tre muaj nga debati që u zhvillua në këtë Kuvend lidhur me zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e vendit tonë, ne po bëjmë edhe një debat tjetër. Personalisht, do të dëshiroja jashtëzakonisht shumë që në këtë debat të diskutohej për rezultatet që ekzekutivi i Kosovës me institucionet përcjellëse i kanë arritur pas atij debati gjashtë orësh dhe miratimit të asaj deklarate politike me të cilën Kuvendi e ftoi Qeverinë dhe të gjitha institucionet që të shtojnë përkushtimin e tyre për zbatimin e Kushtetutës dhe ruajtjen e tërësisë territoriale në Kosovë.

Sot, pas tre muajve, ne jo që nuk po diskutojmë për rezultatet eventuale pas asaj deklarate dhe strategjisë së ashtuquajtur për verim të Kosovës, sepse të tilla nuk ka, por përsëri po debatojmë për cenimin e integritetit dhe të sovranitetit të shtetit tonë dhe, fatkeqësisht, nuk është çfarëdo cenimi. Ky shtet të cilin do të duhej ta shihnim vetëm si një shtet fqinj, për herë të dytë, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës po i organizon zgjedhjet në territorin e Kosovës, duke cenuar drejtpërdrejt integritetin dhe sovranitetin edhe ashtu shumë të brishtë.

Të nderuar kolegë,

Neve na ndajnë vetëm edhe 3 ditë nga dita kur shteti serb do t'i mbajë zgjedhjet edhe në territorin tonë dhe këtë, siç thashë edhe më lartë, për të satën herë. Ditëve të fundit, në territorin tonë zyrtarë serbë kanë hyrë të armatosur dhe kanë zhvilluar fushatë elektorale me gjuhë shumë fyese dhe me projekte të spastrimit etnik. Ndërsa, qeveria çfarë bën? Asgjë, sepse po frikohet se çfarë do veprimi me qëllim të ushtrimit të sovranitetit dhe sundimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, do të shkonte në llogari të politikës serbe.

Të nderuar kolegë, për mua ishin jashtëzakonisht shqetësuese të gjitha deklaratat që i kanë dhënë zyrtarët më të lartë shtetëror të këtij vendi.

Zotëri të nderuar, ushtrimin e sovranitetit dhe të sundimit të ligjit në këtë vend duhet ta bëjnë institucionet tona dhe nuk duhet të heshtim deri sa të tjerët po veprojnë. Neve nuk duhet të na gëzojnë deklaratat se këto zgjedhje janë ilegale dhe nuk do të njihen. Lejimi i mbajtjes së tyre po ndikon negativisht në integritetin e mundshëm të qytetarëve serbë në vendin tonë, më mirë të them në integritetin e mundshëm të qytetarëve serbë në vendin tonë, ndërsa po e ndihmon afrimin e tyre të mëtejshëm me Beogradin. Kjo gjendje në të cilën jemi ne tash, është rezultat i menaxhimit të gabuar që ua ka bërë Qeveria e Kosovës proceseve pas pavarësisë së vendit.

Kërkoj nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që ta ndalojnë mbajtjen e zgjedhjeve serbe në territorin e Kosovës dhe të parandalojë të gjitha dukuritë tjera negative. Përndryshe, qeveria do të ishte mirë të deklarojë paaftësinë e vet për të menaxhuar me territorin dhe sovranitetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr zonja Edita Tahiri! Të përgatitet Hydajet Hyseni.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të flas si deputete.

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, kolegë ministër dhe të nderuar deputetë, kolegë të mi,

Tema e sotme dhe vetë natyra e çështjes së ndërhyrjes ilegale të Serbisë në Kosovë, që nga përfundimi i luftës, është një çështje strategjike dhe unë do të kisha dashur që sot ne të

kishim orientimin strategjik dhe të mos lëshoheshim në suaza tjera, sepse mendoj që sot në radhë të parë duhet të fokusohemi te origjina e këtij problemi dhe origjina është e qartë – është Serbia vetë, e cila edhe pse e humbi luftën në Kosovë, ja që po provon edhe disa episode të fundit që edhe këto e kanë fundin, fundja ne 100 vjet ishim të pushtuar, qëndruam, përballuam, luftuam, e mposhtëm Serbinë, edhe këtë segment të ndërhyrjes do ta mposhtim së shpejti.

Për këtë arsye, po ju flas nga përvoja, nga angazhimi si luftëtare për këto çështje dhe një person që e njeh kompleksitetin e proceseve politike dhe të sigurisë. Prandaj, mendoj se nëse nuk arritëm që gjatë debatit të jemi unikë, së paku të dalim me qëndrime unike si Kuvend i Kosovës dhe si institucion më i lartë i shtetit tonë. Dhe, më lejoni të kaloj drejt në rekomandimet e mia, pa hyrë në histori, sepse ne në këtë Kuvend kemi debatuar shumë herë për problemin e strukturave ilegale serbe, për ndërhyrjen, për përpjekjet tona që t'i zbëjmë këto struktura dhe të integrojmë plotësisht komunitetin serb në Kosovë, realitetin e Kosovës, institucionet e Kosovës sepse ata janë qytetarë të Kosovës. Prandaj, porositë e mia janë këto:

E para, t'i japim porosinë Serbisë se ka marrë fund pushtimi serb këtu. Edhe ky segment i ndërhyrjes ilegale do të marrë fund së shpejti.

E dyta, të ftojme pjesën e serbëve, të cilët ende po hamenden, të ndjekin modelin e pjesës tjetër e cila u integrua, ka gjetur veten, po ndërton rolin e saj në ardhmërinë e shtetit tonë dhe t'i bojkotojë këto zgjedhje, sepse nuk janë në interesin e tyre.

E treta, të kërkojmë nga Qeveria e Kosovës vazhdim të angazhimeve dhe rritje dinamikash për synimet që i kemi që sa më shpejtë edhe kjo pjesë e serbëve të bëhet pjesë e jona dhe Serbia ta gjejë vendin e saj ku e ka, atje te shteti i saj, si dhe ne si Kuvend të zotohemi fuqishëm se do të jemi unikë së bashku krah me Qeverinë në realizimin e synimeve tona.

Po ashtu, një kërkesë tjetër do të ishte kërkesë drejtuar bashkësisë ndërkombëtare që ta kushtëzojë qartë integrimin e Serbisë në BE me mosndërhyrjen në Kosovë dhe me njohje të pavarësisë së Kosovës, sepse fundja edhe për Serbinë besoj se gati janë edhe ata duke u bindur se edhe interesi i tyre është pavarësia e Kosovës, sepse i kontribuon stabilitetit të rajonit dhe mendoj se të gjithë janë të gatshëm të shkojnë në BE dhe, natyrisht, për të ardhur në BE, parakusht janë marrëdhëniet e mira fqinjësore.

Dhe, një tjetër zotim apo kërkesë do të ishte që ne, si Kuvend i Kosovës, mbështesim zgjidhjen e problemit, pra zbërjen e strukturave ilegale në një kornizë e cila ka përparime, bashkëpunimin dhe koordinimin midis Qeverisë së Kosovës dhe aleatëve tanë ndërkombëtarë.

Dhe, natyrisht, për fund mund ta them edhe një fjali: - këto janë zgjedhje ilegale, kështu do të jenë, kështu do të mbeten. Fundja, i vërejtja disa diskutime që shprehin një frikë. Ju lutem, frika ushqen palën tjetër duke menduar se do të ketë hapësira. As s'kemi pas frikë 100 vjet, as s'kemi për të pasur asnjëherë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hydajet Hyseni e merr fjalën, të përgatitet Rexhep Hoti!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur të përshëndes edhe këtë debat, sado që edhe unë kam pritur pak më shumë frymë kohezive, duke pasur parasysh përmbajtjen e debatit.

Megjithatë, nuk do të lëshohem e të bëj krahasime si kanë qenë tonet dikur të kolegëve që atëherë ishin në pushtet e si janë sot. Ka rëndësi që, megjithatë, qoftë edhe vonë, të reflektohet me përgjegjësi. Por kjo nuk do të duhej të çonte në shkarje prej një skajshmërie në një skajshmëri tjetër. Problemi është serioz dhe është i përbashkët, prandaj mendoj që edhe qasja duhet të jetë e tillë. Dhe, për mendimin tim, ka rëndësi së pari të precizohet për çka po bisedojmë. A është problemi te disa vizita dhe disa tone që po dëgjohen nëpër disa aktivitete, apo është te gjendja e rrezikshme që është krijuar? Unë do ta quaja agresion elektoral që po vazhdon ndaj Kosovës. Ka pasur edhe përpara sfida të tilla, por pajtohen besoj të gjithë, se është ndryshe në kushtet kur Kosova është shpallur dhe është njohur në masë të madhe si shtet i pavarur dhe sovran. Nuk është e njëjta gjë. Prandaj, çështja është te ajo ç'po ndodhë me pushtetet në Kosovë. Zgjedhjet bëhen për pushtet. Prandaj, edhe ky agresion elektoral do edhe përgjigjen adekuate. Do të ishte mirë që edhe debati ynë të mos bjerë në pozita ekscesive e tjera, por të ruajë përgjegjësinë, nivelin dhe qasjen parimore. Dhe kjo s'mund të bëhet pa u përqendruar në shkaqet që kanë prodhuar gjendje të tillë. Ne po hiqemi sikur jemi befasuar, por nuk do të duhej të ishim befasuar. Është paralajmëruar kjo gjendje dhe shumë vite më parë, madje është paralajmëruar edhe atëherë kur është miratuar Kushtetuta dhe ajo që i ka paraprirë Kushtetutës – dokumenti i Ahtisarit. Le ta lexojmë propozimin gjithëpërfshirës dhe ne do të shohim formula që praktikisht e kanë lehtësuar këtë gjendje të rrezikshme dhe shpërthyes në Kosovë. Është e vërtetë se është krijuar një frymë ambiguate, e dykuptimshme edhe në dokumentet që i theksova, edhe në Kushtetutë madje, që inkurajojnë qytetarët e Kosovës në pjesë të ndryshme në drejtime krejt të kundërta. Pjesa më e madhe në drejtim të pavarësisht të Kosovës dhe integritit në Evropë, por një pjesë e Kosovës po inkurajohet edhe në drejtim të bosnjizimit të Kosovës dhe pa e vënë gishtin në këtë plagë, unë zor të besoj se mund të gjejmë edhe zgjidhjet adekuate. Ajo gozhda e Nastradinit që është përmendur edhe këtu në Kosovë, po del se ka mananë e saj dhe ne po i shohim pasojat.

Megjithatë, një fakt është evident. Kosova ka pasur dhe ka pavarësinë e saj elektorale, e ka pasur madje edhe kur nuk e ka pasur pavarësinë politike dhe nuk ka asnjë arsye që të tolerohet një agresion i tillë elektoral. Çështja është vetëm si të reagohet. Edhe këtu ne i kemi lidhur duart vetvetes edhe me dokumentin e Ahtisarit, me bartjen e kompetencave dhe pajtimin me ato kompetenca të pranisë ndërkombëtare, sidomos në pjesë të caktuara të Kosovës dhe në fusha të caktuara të funksionimit shoqëror në Kosovë e institucional. Prandaj, mendoj që as nuk mund ta fajësojmë ekskluzivisht qeverinë tonë për ato që objektivisht nuk është tash në mundësinë e saj, as nuk është kompetencë de jure e saj vetëm, por as nuk mund ta amnistojmë e abulojmë, sepse nëse s'mund të kryhet, mund të prodhohet më shumë dhe mund të jemi më të kujdesshëm në deklarime. Nuk mund të arsyetohet, ta zëmë, ajo që kur vjen puna për një protestë paqësore që ka qenë policia jonë dhe i shfrytëzon varrimet e atdhetarëve tanë për të demonstruar vendosmërinë e tjera, që është skandaloze dhe është e çuditshme si po heshtet edhe ajo, kurse kur është puna pastaj për provokime të rënda që i bëhen shtetësisë së Kosovës edhe në sistemin e saj, tash ne bëhemi tepër të moderuar, tepër të kujdesshëm edhe ne, madje edhe miqtë tanë ndërkombëtarë. Si u bëka që EULEX-i të harxhojë gjithë atë kohë, gjithë atë energji për arrestimin e një disidenti të shoqërisë civile...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hydajet! Fjalën e ka Rexhep Hoti, le të përgatitet Esat Brajshori.

REXHEP HOTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Më tepër më habiti diskutimi i fundit i deputetit, i cili ka nënshkruar ligjet, Kushtetutën e këtij vendi, do të thotë tash flet me cinizëm. Dëshiroj t'i jap një lëvdatë të jashtëzakonshme opozitës, e cila ndonjëherë në forma të ndryshme e shprehu gjithë mllefën që ajo konsideron se duhet të rregullohet kjo çështje, ndërsa i ftoj ata të pozitës që të mos jenë cinikë me nënshkrimet që i kanë bërë vetë.

Duke qenë se problemi i komunitetit serb është një problem në vete që nga '99 e deri sot e ka përcjellë gjithë politikën e vendit, mendoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm se kjo çështje nuk mund të zgjidhet në mënyrë shumë të shpejtë. Do kohë, do procese, do një mund jo vetëm të mendjes vendore, por konsideroj që edhe të angazhimit ndërkombëtar. Problemi i serbëve nuk është problem i një veprimi të ligjit. Më shumë se kaq, është problem që shumica, shqiptarët e Kosovës tash kanë përgjegjësi që të jenë në nivel të gjitha mundësive për të krijuar sistemet që pakica serbe në Kosovë të jetë e funksionalizuar në të gjitha nivelet e institucioneve. Kujtoj se në këtë drejtim Qeveria megjithatë ka bërë hapa që duhet mbështetur. Ky nuk është një problem që mund të kufizohet te mbajtja ose mos mbajtja e zgjedhjeve në ndonjë pjesë të Kosovës nga komuniteti serb. Në fakt, është shumë më i madh se sa kaq. Ne duhet t'i inkurajojmë serbët të cilët kanë filluar të funksionojnë në kuadër të institucioneve të Kosovës dhe ata t'i mbështesim fuqishëm në mënyrë që kjo çështje të minimizohet gradualisht. Njëkohësisht, të ftojme Serbinë që të mos bëjë ndërhyrje në shtetin fqinj, siç është shteti ynë Kosova, por le të merret me perspektivën e vet dhe mundësisht në një të ardhme të afërt të bisedojmë si dy shtete për perspektivë më të mirë të popullit tonë. Natyrisht, në këtë pikë kur realisht fjalën kryesore e ka EULEX-i, ne ftojme EULEX-in që të jetë më konsekuent në zbatimin e ligjit. Në fakt, nuk ndaj mendimin se ai duhet ta përdorë ligjin për t'i treguar komunitetin serb se e ke këtë të drejtë apo s'e ke këtë drejtë. Kjo është një çështje, e tha dikush, qindravjeçare. Ne duhet t' shohim këtë problem në sy. E gjithë pakoja e Ahtisarit, njohja e Kosovës sui-generis, vetë standardet që kanë qenë më përpara, gjithë politika në fakt që është krijuar në Kosovë nga '99 e deri më sot, është bërë në radhë të parë në kontekst të funksionalizimit të çështjes serbe në Kosovë, sepse shteti i Kosovës është pikë shumë e ndjeshme që duhet të funksionojë duke bërë rehatimin e tyre.

Nuk mendoj se është komode prej nesh tash të flasim në emër të asaj se çfarë duhet të bëjë ose të mos bëjë Qeveria në kuptimin e një veprimi policor. Mendoj se puna duhet të merret shumë më seriozisht dhe ne të mos jemi cinikë, siç janë disa deputetë që kanë nënshkruar këtë çështje të pozitës, por të kontribuojmë si njerëz me urtësi, intelektualizëm dhe duke dhënë shembuj për respektimin e ligjit në të gjitha fushat e shoqërisë sonë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Hydajet, çka deshe? Unë nuk dëgjova emër! Mirë, s'po di! Atëherë, Hydajeti, replikë!

HYDAJET HYSENI: Zoti kryesues,

Unë nuk dua të merrem me diskutimet si ky që sapo dëgjuam, as s'dua ta cilësoj tash çfarë kallëpi i bie kjo qasje e kolegut tim të nderuar, por dua vetëm të sqaroj se a është nënshkruar Kushtetuta a s'është nënshkruar, dihet dhe s'kam nevojë të bëj sqarim. Theksin unë e vura te anomalitë që janë lejuar dhe ju lutem, të gjithë ata le të lexojnë nenin 10 të propozimit gjithëpërfshirës, të cilin ne e kemi miratuar me hir a pa hir, kush më shumë e kush më pak,

dihet, e të cilit lejohet jo vetëm praktikisht parcializimi i Kosovës në komuna të reja dhe të cilave u jepet pastaj mundësi e bashkëpunimit, të komunikimit me autoritetet e Beogradit, madje edhe duke pasur personel të tyre. Dhe në këtë Kuvend është tërhequr vërejtja, është ngritur zëri. Kush ka pasur vesh, ka dëgjuar. Ata që i fusin veshët në lesh, s'ka kush si t'i ndihmojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, e mbaj në mend atë mbledhje, Hydajet, shyqyr janë fjalët e shkruara, mund t'i lexojë gjithkush dhe s'ka nevojë kurrkush të krekoset as për mirë, as keq. Fjalën e ka Esat Brajshori, të përgatitet Branisllav Gërbiq .

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

U mendova ta marr fjalën apo jo për shkak të gjithë këtij debati kaq të gjerë, por më krijohet ideja sikur a jemi ne të gjithë këta njerëz që jetojmë në këtë vend, a e marrim të njëjtin ajër, a e pimë të njëjtin ujë dhe a e shohim të njëjtin problem siç duhet ta shohim – rastin e Mitrovicës?

Megjithatë, zoti kryesues, unë kam votuar që të futet në rend të ditës kjo pikë për dy arsye: E para, sepse ekziston një problem, e ai quhet problemi i Mitrovicës. Është shqetësim i qytetarëve dhe të atyre pa dallim moshave, që nga i vogli e deri të më i moshuari. Është shqetësim, sepse kemi shumë dilema nëse jemi sovran edhe në Mitrovicën e veriut, siç po quhet, ose më saktë, në shumë raste është dëshmuar se sovraniteti i Prishtinës mungon në atë pjesë të vendit tonë, të garantuar me Kushtetutë dhe ligje.

Dhe, arsyeja e dytë që unë votova të futet në rend dite kjo pikë, shumë e gjetur, shumë e qëlluar – është se kam menduar që ky debat do të prodhojë diçka që do të jetë ndihmesë edhe për vetë Qeverinë e Kosovës, për faktin se nuk ka shumë ditë më parë kur edhe kryeministri pati deklaruar dhe pati shprehur rezervat e tij për ndihmesën, angazhimin, azhuritetin e EULEX-it në këtë pjesë të Kosovës. Në këtë drejtim, mendoj se ky Kuvend dhe ky debat do ta ndihmonte edhe vetë Qeverinë për t'u sqaruar gjërat dhe për të dalë nga i gjithë debati një unitet në drejtim të Mitrovicës.

Nuk e kam të qartë një gjë që përdoret nga krerët më të lartë të Qeverisë, atë që quhet – ne nuk do të përdorim forcën.

Thënë të drejtën, mua më krijon një perceptim të çuditshëm kjo. Nëse mendohet për një forcë e cila është mbi ligjore, mbi kushtetutare, mbi kushtetuese, askush prej shqiptarëve, jo vetëm në Kosovë, por gjithkrah kah jemi, nuk mendon në këtë variant të forcës. Nëse mendohet për një forcë e cila derivon nga ligji dhe Kushtetuta, atëherë ose duhet të jemi për respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve, ose të deklarohejmë që i kemi miratuar kot.

Tani, ne po flasim për zgjedhjet që për 3 ditë a 4 ditë do t'i mbajë Serbia, një shtet fqinj ndërhyr, kapërcen kufijtë dhe mban zgjedhje në një shtet sovran dhe të pavarur. Shembulli është eklatant, nuk kemi nevojë t'i bëjmë moral asnjëri tjetrit, e kuptojmë se realisht ka një lloj agresioni dhe ne mund atë ta emërojmë si të duam, po ka ngjyrimë të agresionit.

Çështja është se këto zgjedhje janë vetëm epilogu i një historie tash e dhjetëvjeçare të Mitrovicës. Dhe ne në këtë seancë nuk do të mundemi ta trajtojmë Mitrovicën në tërësinë e saj, me gjithë problemet e saj, për ta bërë të zgjidhshme këtë çështje sot, por po merremi,

edhe një herë po them, me epilogun e një parahistorie dhjetëvjeçare, që rezulton prapë me mbajtjen, me provokimet e një shteti ndaj shtetit tonë.

Në Mitrovicë ka problem, nuk kemi s'i t'i ikim. Domethënë, nuk ka pse të ndihet keq as pozita në rast se ka ide, ka kreativitet politik nga deputetët për të gjetur një zgjidhje. Unë nuk e kuptoj asnjërin palë as tjetrën në rast se kjo fatkeqësi e kombit, e popullit tonë, që quhet Mitrovicë, përdoret për qëllime politike. Mendoj se në rastin e Mitrovicës duhet të ulen flamujt partiakë dhe duhet të ketë një gjuhë të unisuar, të përbashkët për zgjidhjen e këtij problemi.

Cila është zgjidhja e 3-4 ditëve që do të vijnë e që do të mbahen zgjedhjet serbe? Unë nuk do të hiqesha aq i zgjuar për të thënë se kjo është zgjidhja, por e kam një siklet që nuk po mund ta definoj mirë. Qeveria e Kosovës e ka më problem me EULEX-in për të vu rend e rregull në territorin e vet, apo e ka më problem me shtetin fqinj, i cili i organizon këto zgjedhje. Mendoj se duhet të gjendet adresa e saktë se kush duhet të vendosë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Branislav Gërbiq, të përgatitet Zef Morina.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući na reči...

KRYESUESI: Meqë jemi kah fundi, ju lus që të thirren deputetët që të vinë në sallë.

BRANISLAV GRBIĆ: Hvala još jednom i citirao bih onu vašu izjavu koju ste rekli da je sigurno u interesu svih građana Kosova, ne vezujući za partijske ili druge neke podele. Činjenica je da je problem Mitrovice koji je nagovešten znači za nedelju, je nešto što jedan problem koji već traje na Kosovu od '99. godine i to je nešto što nije ništa novo i to je nešto što je staro. Prema tome, ako sagledavamo problem koji će se desiti, budući razvoj događaja u Mitrovici, to je nešto što bojim se da smo svi kao građani Kosova zapostavili i ostavili nekome drugome da rešavaju probleme.

Pitanje prisustva Srba na Kosovu je nešto što je sigurno zahtevalo daleko ozbiljniju i na neki način bolje shvatanje strategije opstanka i razvoja zajednica koje žive na Kosovu. To je nešto što je sigurno bilo i u planu Vlade Kosova i međunarodne zajednice. Prema tome, bojim se da smo tu pali na tom ispitu jer još uvek nismo rešili poverenje većinskog dela stanovništva Srpske zajednice koje živi na Kosovu. Taj prostor, možemo reći slobodno da je iskoristila Republika Srbija i ujedno osiguravajući neku ekonomsku egzistenciju Srba na Kosovu, pružali mogućnost da i kroz taj parlamentarni rad ostvare neka svoja prava.

Bojim se da u toj činjenici mi nismo imali nešto da ponudimo tim ljudima da bi se vezali za prostor Kosova i da bi Kosovo osećali kao svoju domovinu. To je nešto što sigurno je, biće i permanentni zadatak i budući zadatak ove vlade i budućih vlada. To je nešto što ne možemo da rešimo preko noći i da ugasimo nešto što već traje deset godina, ali sigurno da postoje šanse za to nešto da se reši a to je primenom zakonodavstva, a ne primenom liderstva. Suviše smo vremena posvetili liderima koji su nas zavaravali i obećavali da mogu da reše probleme kroz jednu partiju ili kroz neki zajednički interes. Suviše smo omogućili da pojedincima rešavaju neke probleme koji su zaista strateški i koji opterećuju čitavo kosovsko društvo. U tom kontekstu, prostor koji je omogućen zajednicama kroz kosovske institucije i kroz mogućnost i zapošljavanja i delovanja na ovim prostorima, je zaista mali, tako da ne poštujući principe transparentnosti, principe demokratije, principe zastupljenosti što više

predstavnik zajednica u institucije Kosova i u kosovsko društvo, bojim se da problem samo izbegavamo, a ne da ga rešavamo.

Stvaranjem opština koje smo formirali u srpskim sredinama, gde je većinsko srpsko stanovništvo, je nešto što je sigurno u skladu sa Ustavom Kosova i Ahtisarijevim planom. Međutim, mi već u tim opštinama imamo i paralelne opštine koje funkcionišu unazad ceo period i to je nešto što bojim se da ako samo stvaramo opštine a ne rešavamo probleme, znači to je jedan problem više u toj opštini, tako da činjenice ukazuju da ipak problem Srpske zajednice i stvaranja kontinuiteta i poverenja Srpske zajednice u kosovsko društvo i u zakone Kosova su nešto što ipak zaslužuje i treba se tretirati na jedan ozbiljniji način, jer problem svake opštine nije isti. Ako je problem Gračanice daleko lakše rešiti, sigurno problem Mitrovice je mnogo teže rešiti i ne može na isti način da se rešava. Tako da u tom kontekstu sigurno je stvar strategije opstanka i života svih zajednica Kosova, nešto što je prioritet i strategija kosovskog društva i sve je to vezano i za privredni razvoj i za mogućnost ponude Vlade koje će omogućiti svim građanima Kosova da imaju jednak tretman i u zapošljavanju i u stvaranju nekih beneficija za bolji život na Kosovu. Ujedno vidim da i problem Mitrovice jeste možda politički problem, ali rešavanjem političkog problema mi ostavljamo drugi problem, a to je tehnički problem koji je mnogo važniji nego politički. Tako da u tom kontekstu smatram da ono što je važno, a to je da nam ipak Vlada mora ponuditi jedan koncept zajedničkog života na Kosovu, jedan dijalog koji ne smemo izbegavati jer izbegavanjem istine na Kosovu samo stvaramo probleme a ne rešavamo ih. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Zef Morina. E kam në listë, në fund, edhe Slobodan Petroviqin.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Debatë të cilin sot u pajtuam që të jetë në rend të ditës, sikur në njëfarë mënyre nuk e luajt vërtet detyrën për të cilën edhe e ka dhe për të cilën u pajtuam, sepse devijoi nga pika kryesore për të cilën ne jemi duke diskutuar. Fatkeqësisht, ndoshta kjo është pikërisht edhe për shkak të interesit të disa deputetëve për të paraqitur ose për të krijuar një opinion politik tek qytetarët.

Çështja e veriut të Kosovës, duke përfshirë edhe një pjesë të Mitrovicës, nuk është e sodit, as edhe e para dy viteve, por që nga 99-shi, kur Kosova u lirua dhe Serbia u largua nga Kosova. Fatkeqësisht, Qeveria e asaj kohe e Serbisë nuk u pajtua me realitetin. E njëjta gjë po ndodh edhe tash me Qeverinë e ashtuquajtur demokratike të Serbisë.

Sikur ta kishim dëgjuar fjalën e ministrit të Punëve të Brendshme, zotit Bajram Rexhepi në fillim, sigurisht që edhe një numër i deputetëve do të ishin përqendruar ndryshe në fjalimin e tyre, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm që zgjidhja e çështjes së veriut të Kosovës e ka domethënë formulën, e cila duhet të zgjidhet me kujdes dhe në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar. Në asnjë mënyrë nuk mendoj që në mënyrë të njëanshme, duke i prishur raportet me UNMIK-un ose EULEX-in, meqenëse UNMIK-u ende fatkeqësisht po vepron atje, mund të zgjidhim atë pjesë... Përkundrazi, vitin e kaluar jemi dëshmitarë që pikërisht UNMIK-u e ka penguar ndërtimin e shtëpive të shqiptarëve edhe pse nga kuvendi komunal e kishin lejen e ndërtimit për objektet të cilat ishin të rrënuara gjatë luftës. Kështu që kur i shikon debatet e deputetëve të opozitës dhe të pozitës, të jep për të kuptuar se dikush është i interesuar ta zgjidhë, ndërsa dikush tjetër jo. Kjo është e kundërta. Pikërisht ata të cilët

mendojnë ta zgjidhin në mënyrë të sigurt, është pikërisht strategjia që Qeveria e ka bërë në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe EULEX-in.

Ajo që është vërtet shqetësuese dhe që më parë e tha, po më duket, edhe Kaqusha, pasojat e këtyre zgjedhjeve që po mban Serbia në Kosovë. Nesër sigurisht do të mbahen zgjedhjet të cilat do t'i organizojë Qeveria e Kosovës, sigurisht që ata të cilët sot pretendojnë që janë zgjedhur, ata do të bëjnë pengesa në mbarëvajtjen e zgjedhjeve aty, kështu që ajo që ne duhet të kërkojmë nga Qeveria dhe nga institucionet vendore, është që në asnjë mënyrë të mos lejojmë, meqenëse zgjedhjet nuk po pengohen për shkaqe të veprimeve demokratike, shfrytëzimin e objekteve zyrtare shtetërore të personave të cilët "po zgjidhen", por ato do të shfrytëzohen nga personat të cilët do të zgjidhen nga zgjedhjet që do t'i caktojë Qeveria e Kosovës. Mendoj se kjo është zgjidhja më e mirë, ndërsa ajo që edhe kryeministri e tha dhe zëvendëskryeministri, hyrja e delegacioneve të Serbisë në Kosovë nuk duhet të lejohet pa pëlqimin e organeve shtetërore, gjegjësisht të organeve në bashkëpunim me EULEX-in. Të gjithë e dimë që në pjesët tjera kur kanë ardhur personat ose zyrtarët e Serbisë, nuk kanë mund të hyjnë pa marrë lejen, ndërsa në pjesën veriore kanë hyrë sepse vetë faktori ndërkombëtar i ka lejuar edhe në kundërshtim me kërkesën e Qeverisë, të institucioneve tona të cilat kanë kërkuar që kjo gjë të bëhet në koordinim. Shpresoj se bashkëpunimi i cili vërtet kërkohet nga Qeveria, të jetë në mes EULEX-it dhe faktorit tonë shtetëror, do të vjen deri te një zgjidhje e cila do të jetë fatlume për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Dhe, fjalën i fundit e ka kërkuar Sllobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući! S obzirom da sam poslednji govornik za danas, pokušaću da budem što kraći.

Zameniće premijera, uvaženi ministri, poštovane dame i gospodo, kolege narodni poslanici, predstavnici građana Kosova,

Dozvolite mi da dam ja tok ove diskusije, ja se nadam sigurno u pozitivnom smislu, s obzirom da smo na samom početku bili kao politički klub protiv današnje debate, jer smo smatrali za ovakvu jednu ozbiljnu temu je neophodno jedna posebna sednica, a ne da preko reda uđe ovako jedna bitna tačka dnevnog reda, ali šta je tu je. S obzirom da smo mi kao poslanička stranka imali u periodu iza nas puno izazova, ne samo na našu sreću, nego mislim dobrim delom i u ovom visokom domu smo imali zajedničke rezultate koje nam jednostavno preporučuju da bi i za ovaj jako veliki problem trebali mnogo ozbiljnije da uđemo u realizaciju.

Ono što smo se plašili da će danas da bude, to se i dogodilo, da je samo bila u pitanju retorika. Apsolutno, mi smo stranka i ljudi pre svega odgovorni koji žele da budu deo rešenja, a ne deo problema i zaista se zahvaljujem svim onim diskutantima koji su bili umereni, koji nisu želeli da svojim diskusijama samo još više tako krhku situaciju pogoršavaju. Želim da odam jedno priznanje Vladi Kosova koja u ovako teškim trenucima istraje u jednoj sigurno teškoj, ali dugoročnijoj strategiji, mirnoj strategiji i to je sigurno nešto što je najveći motiv da damo značaj i glas za jednu takvu politiku. Apsolutno, ono što je u mandatu Samostalne liberalne stranke i mene kao čoveka i deo ove institucije, jeste da radim u interesu građana i apsolutno ova diskusija ide u tom pravcu. Želim da svi oni koji su danas imali priliku da diskutuju, da jednostavno daju svoj primer. Ono što je sreća ili za nekog možda druga osobina, mi jedini u Poslaničkom klubu imamo predstavnika sa severa Kosova i to jeste naš šef Poslaničkog kluba. I apsolutno to je jedna više nego simbolična poruka i apsolutno sam svestan činjenice da je problem tako kompleksan, gde sam isto tako realan da znam da je mnogo lakše kritikovati i očekujemo od Vlade, pa čak šta više i samog Parlamenta da reši taj problem jednom debatom, je prosto neprimereno.

Želeo sam samo još jednom da na kraju svoje diskusije svima vama, svestan sam činjenice da ste pre svega ljudi koji pamte delo a ne reči, i svestan sam činjenice da je u ovom parlamentu upravo najveći broj predstavnika građana onih koji su dobili glasove, a ne onih koji su dobili priču, da jednostavno sve ono što preporučujemo, jesu jednostavno garant naša dela. Apsolutno, kao stranka, kao politička opcija, kao deo institucija, ne samo Parlamenta, nego i Vlade, imamo veliki interes da se na tom delu uvede red i zakon. Ali ono što jeste neophodno, da svako da pre svega predlog, odnosno primer. Ono što je za nas trezveno i jednostavno preporučljivo, da se upravo na tom delu angažuju ljudi koji su sa severa Kosova i ne znam da li je nečija sreća ili nesreća, želim da vam kažem da ima puno ljudi koji prate ovu skupštinu, gde ima puno ljudi koji su voljni da budu deo procesa i isto sam želeo da vam i to kažem, da li je sreća ili nesreća da se mnogo više priča o lokalnim izborima u ovom parlamentu nego kod samih učesnika tih izbora, da li je to dobro ili loše, ne znam, ali sigurno sama poruka da mi ne učestvujemo u takvim aktivnostima je sasvim jasna. Želeo bih još jednom da se zahvalim svima vama koji ste danas imali diskusiju i zahvaljujem se zameniku premijera i ministrima koji su našli vremena da slušaju nas danas u Parlamentu.

KRYESUESI: Faleminderit! Tash jemi duke biseduar për këtë temë më shumë se 4 orë. Kanë folur, sa kam evidencë unë, mbi 30 vetë. Diskutimi mbaroi. Nëse dikush nga Qeveria e do fjalën, mund ta marrë. Është e drejtë e tyre, nëse s'e do, atëherë propozuesi i diskutimit e ka fjalën. Urdhëro, zoti Lulzim Zeneli!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, në emër të propozuesit të këtij debati, falënderoj të gjithë deputetët për pjesëmarrje aktive në këtë debat dhe për seriozitetin e treguar në gjitha fazat e zhvillimit të këtij debati parlamentar. Dhe, tash, në emër të grupeve parlamentare më lejoni të propozoj dokumentin për miratim, dokument i cili është arritur me konsensus të plotë nga të gjitha grupet parlamentare dhe që i referohet çështjes të cilën sot e diskutuam me orë të tëra.

Prishtinë, 27 maj 2010

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Duke demonstruar rolin kushtetues dhe vendosmërinë në mbrojtje të kushtetutshmërisë, të integritetit dhe të sovranitetit të vendit, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.05.2010, pas debatit parlamentar merr këtë:

Q Ë N D R I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në koordinim me faktorët relevantë ndërkombëtarë të ndalojë aktivitetet të cilat zhvillohen në territorin e Republikës së Kosovës jashtë sistemit politik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës, duke përfshirë:

a) Marrjen e masave për ndalimin e organizimit të zgjedhjeve lokale dhe ushtrimin e veprimtarive të Qeverisë së Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë ndalimin e vizitave të zyrtarëve të Republikës së Serbisë pa lejen e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe

b) Hartimin e planit aksional në koordinim me faktorët tjerë relevantë për zhbërjen e strukturave të pushtetit të Qeverisë së Republikës së Serbisë në veri të Republikës së Kosovës.

Faleminderit!

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, dëgjuam një tekst të cilin e lexoi propozuesi i debatit. Unë edhe gjatë diskutimeve jam përpjekur të evidentoj propozimet më konkrete të deputetëve. Tash po shoh se ekziston një konsensus i grupeve parlamentare që propozon një dokument që e ka emrin – q ë n d r i m, se edhe ashtu lëvizshin – qëndrim, qëndrim, porosi, rekomandime, këto katër forma. Mua nuk më mbetet tjetër, pos ta hedh në votim, ndonëse në dokumentacionin e Kuvendit s'ekziston termi qëndrim si dokument, por le të jetë qëndrim politik.

Atëherë, në sallë kemi 67 deputetë të pranishëm.

Dëgjuat tekstin e lexuar që është i ndërtuar me konsensus të grupeve parlamentare. E hedh në votim dokumentin. Votojmë tash:

Kemi pra të pranishëm 67 deputetë. “Për” votojnë 57 dhe 1 pa kartelë, 58. Të abstenuar kemi 1. E konsideroj të mbaruar këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e shtatë:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Mund ta kalojmë edhe një pikë, e pastaj bisedojmë. Kemi punë shumë edhe për nesër. Rendi i ditës pra është shumë i madh.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që sot para jush të kërkoj për miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Miratimi i këtij projektligji është një hap tjetër i rëndësishëm dhe i domosdoshëm, do të thosha unë, në drejtim të rirregullimit ligjor dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse të procedurës së emërimit të ambasadorëve dhe të konsujve të përgjithshëm në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Dispozitat e Projektligjit të plotësuar dhe ndryshuar përcaktojnë subjektet të cilave u garantohet e drejta e propozimit, konsultimit dhe emërimit të ambasadorëve dhe konsujve të përgjithshëm.

Ky projektligj, po ashtu ka për qëllim thjeshtësimin e procedurës së emërimit të ambasadorëve dhe të konsujve të përgjithshëm dhe garanton një shërbim diplomatik konsullor, profesional dhe të përgjegjshëm.

Si përfundim, me qëllim të konsolidimit të vazhdueshëm të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës dhe të garantimit të një shërbimi diplomatik profesional, të

përgjegjshëm dhe efikas, ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj të propozuar. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Kolegë të nderuar, ju njoftoj që komisioni funksional e ka diskutuar këtë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit dhe në mënyrë unanime e ka mbështetur.

Njëherësh, në emër të LDK-së e mbështes këtë projektligj. Janë 2-3 nene që rregullojnë një materie, e cila është kërkuar me kohë prej Kuvendit dhe prej shoqërisë.

Në emër të PDK-së, kush e merr fjalën? Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Të nderuar ministra, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe kontributin e tij për pasurimin e tij dhe eventualisht ndonjë korrigjim do ta japë gjatë procesit të amendamentimit.

Më lejoni vetëm të theksoj shkurtimisht se është mirë që me këtë ndryshim po fillon edhe në një mënyrë procesi i korrigjimit të atyre ligjeve të pakos së Ahtisarit të cilat, siç është dëshmuar edhe është konstatuar sa e sa herë, kanë edhe anomali e mangësi të shumta.

Unë do të tërhiqja vërejtjen edhe në një pakujdesi, do të dëshiroja të besoj që në nenin 2 të propozuar, në pjesën ku parashihen kriteret për zgjedhjen e përfaqësuesve diplomatikë të Kosovës, përsëri na është përvjedhur ajo formula e famshme e kontestuar këtu në mënyrë sistematike dhe e ndryshuar në mënyrë sistematike, por çuditërisht që përsëri në mënyrë sistematike na vjen në projektligjet që sillen që përgjithëson të gjithë ata që kanë qenë të dënuar. Dhe për të qenë të qartë, ndoshta do të duhej pyetur ata që punojnë: çka do të thotë nëse është fjala për vepra që kanë qenë të dënueshme dikur në ligje diskriminuese, por nuk janë të dënueshme me ligjin aktual, ligjin e aplikueshëm? Ose, çka nëse kanë qenë kandidatët të dënuar diku në një vend të botës për vepra të cilat në Kosovën tonë nuk janë të dënueshme? Prandaj, edhe është një rekomandim që formula të tilla të mos sillen më në Kuvendin e Kosovës sepse janë kundërshtuar, në parim.

Është edhe një rast ndoshta për ta theksuar – nevojën që ky ligj nuk e rregullon por që për shërbimet tona diplomatike vërtet të krijohen kushtet adekuate për punë, sepse edhe në kontaktet që kemi pasur me ta, konstatohet fakti se shpesh ata janë të detyruar të punojnë në kushtet që praktikisht e bëjnë të pamundshëm integrimin e tyre pa lëre më funksionimin adekuat e dinjitoz institucional. S'mund të kenë kushte të njëjta, ta zëmë, diplomatët si në Paris, si në Shkup.

Besoj që ky rast do të jetë edhe rast për të përmirësuar edhe legjislacionin tonë, por edhe qëndrimin dhe për të krijuar kushtet për një shërbim efikas dhe efektiv të diplomacisë sonë të re. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Hydajet Hyseni! Zylfije Hundozi e ka fjalën, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar plotësimin dhe ndryshimin e këtij projektligji në mbledhjen e grupit parlamentar dhe e përkrah në parim

miratimin e tij. Në komisionin funksional anëtari ynë do të japë kontributin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hundozi! Suzan Novobrdaliu, në emër të Aleancës Kosova e Re.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka analizuar këtë ndryshim të propozuar dhe përkrah miratimin e tij, mirëpo i kemi disa vërejtje. Tek neni 6, pika 1.3. thotë – nuk janë dënuar për kryerje të veprës penale ose nuk janë nën hetime. Këtu kishim propozuar një përmirësim, të jetë sikur në Kushtetutë, të mos jetë – të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me 1 a më shumë vjet burgim.

Pastaj në pikën 1.5. thotë – janë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën. Kjo për ne do të thotë vërtetimi për gjendjen shëndetësore është certifikata mjekësore, gjë që nuk është diçka garantuese. Sot mund të jesh mirë, nesër mund të jesh shumë keq. Do të thotë, unë këtë do ta kisha hequr. Pra, kisha propozuar të hiqet.

Pastaj, në pikën 2., në të vërtetë nën-pika 2.1 thotë – të kenë përgatitje të duhur profesionale. Kishte qenë mirë që kjo përgatitje e duhur profesionale të ceket se cila përgatitje profesionale.

Pastaj, Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë i lihet një kompetencë vetëm konsultative. Mendoj se Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë duhet t'i lihet një kompetencë ashtu që nga ky komision të propozohen 3 kandidatë dhe të jetë një vendim jo konsultativ, por vendim me ndikim. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë besoj, në emër të LDD-së Besa Gaxherri, apo Lulzimi!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim miratimin e ndryshimit dhe të plotësimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik dhe kontributin në procesin e amendamentimit do ta japë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit 7+ Sadik Idriz!

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa “7+” će podržati ovaj Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o inostranim poslovima. Mislim, daćemo svoj doprinos u daljem toku razmatranja ovog nacrta zakona i mislim da ne bi trebalo da član 7.7, ova tačka, figurira da najmanje 50 procenata imenovanja ambasadora da će biti iz dosadašnjeg sastava, ne bi valjalo da bude to u zakonu, možda u nekom završnom nekom članu i tako dalje, ali ne ovde u ovim tačkama. Takođe, mislim da ćemo videti mogućnost da predstavnici zajednica budu imenovani u ambasadama. Za sada nemamo nijednog ambasadora, ima mislim nekog u misijama, ali nema ambasadora. Mislim da je to u interesu i imidža Kosova i videćemo da li postoji mogućnosti da se to zakonski reši, pošto do sada nije bilo to adekvatno rešeno zato što je bilo u onom zakonu putem konkursa i izbegnute su te mogućnosti. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të SLS, Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani zamenice premijera,

Ministri i uvažene kolege narodni poslanici,

U ime Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke i kao član Komisije za inostrane postove, u načelu prihvatamo predlog dopune zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi për Integrime, Branisllav Gërbiq!

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uvaženi zamenice, gospodo ministri,

Narodni poslanici,

U načelu prihvatamo ovaj nacrt zakona i Poslanička grupa za integracije je poslala dopis Predsedništvu za još jednog dodatnog člana Komisije za inostrane postove, tako da nadamo se da će taj naš zahtev biti usvojen i da ćemo u skladu sa radom Komisije za inostrane poslove dati doprinos u okviru ovog zakona i naravno i u okviru ostalih aktivnosti te komisije i Ministarstva za inostrane poslove. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi diskutues të tjerë. Unë ju thërras që ta votojmë këtë projektligj. Votojmë tash:

Në sallë kemi 61 deputetë. Kemi 57 plus Lulzimi s'ka kartelë – 58 “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim. Kalon ky projektligj.

Komisionet:

- Komisioni për Punë të Jashtme, si komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi,
- Komisioni për Buxhet e Financa,
- Komisioni për Komunitete dhe
- Komisioni për Integrime Evropiane.

Ju e dini, si gjithmonë, data e fundit e aprovimit, kur duhet të vijë rekomandimet për lexim të dytë, është dy muaj, por kjo s'do të thotë dy muaj, duhet të jemi më të shpejtë që të vijë më shpejt se sa dy muaj. Unë tash kam dy kërkesa, një kërkesë që të vazhdohet mbledhja dhe një kërkesë të ndërpritet. A jeni të gatshëm të vazhdojmë, apo nesër në 10:00? Nesër në orën 10:00! Faleminderit!

E premte, më 28.05.2010, ora 10:00

Drejton seancën: zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar, ne kemi kuorumin për të filluar vazhdimin e punës së seancës, por më lejoni që në emrin tim dhe në emrin tuaj, para se të fillojmë punën, t'i shprehim përgëzimet Qeverisë së Shqipërisë, institucioneve të Shqipërisë, pozitës, opozitës dhe gjithë popullit shqiptar për rekomandimin e Komisionit Evropian që të hihen vizat për qytetarët e Shqipërisë. Besoj se është një lajm shumë i mirë për Shqipërinë dhe për rajonin dhe shpresojmë që edhe Kosova të hyjë në hartën e liberalizimit të vizave dhe më lejoni që ta them se edhe puna jonë duhet të shkojë kah ajo, të krijohen standarde që të arrijmë këtë leje për qarkullim të lirë në Evropë.

Fillojmë me punën. Pika e tetë e rendit të ditës është:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ripranim

Në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotëri Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Iu bashkëngjitëm fjalëve të urimit për Shqipërinë. Po edhe ne, në këtë rrugë e kemi si prioritet kryesor dhe ky ligj është një ndër kriteret e para dhe ju falënderoj që prej momentit të aprovimit në Qeveri deri në leximin e parë ka qenë kohë shumë e shkurtër, është trajtuar me prioritetin e duhur dhe shumë shpejt para jush do të keni edhe strategjinë për riintegrim, që është po ashtu dokument tepër i rëndësishëm në këtë drejtim.

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për ripranim, të sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Hartimi i Projektligjit për ripranim ka filluar që nga muaji shkurt i vitit 2010. Në përpilimin e këtij drafti kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësuesit e misionëve ndërkombëtare në Kosovë, ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e ICO, i EULEX-it, i ICTP-it, i UNHCR-it dhe Projekti i binjakëzimit, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre kanë dhënë disa rekomandime të cilat edhe janë inkorporuar në këtë projektligj.

Mbështetje të veçantë i është dhënë Ministrisë së Punëve të Brendshme nga ana e Komisionit Evropian përmes sugjerimeve dhe rekomandimeve konkrete. Nevoja për këtë projektligj është e madhe për faktin se ky projektligj është një ndër kriteret kryesore që kërkohet në procesin e përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave në Bashkimin Evropian. E dimë fare mirë se Projektligji do të sjellë angazhime shtesë si në aspektin e kapaciteteve njerëzore dhe do t'i vë në sprovë edhe kapacitetet tona financiare. Konsiderojmë se, marrë për bazë orientimin tonë shtetëror drejt proceseve integruese, i arsyeton në tërësi edhe obligimet shtesë për institucionet tona.

Projektligji ka për qëllim që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për ripranimin e personit i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues.

Projektligji ka katër kapituj me gjithsej 17 nene. Projektligji për ripranim nuk do të ketë efekte shtesë të drejtpërdrejta buxhetore në buxhetin e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme, me buxhetin aktual që e ka aprovuar për vitin 2010, por edhe për vitet 2011 dhe 2012 do të jetë në gjendje të absorbojë koston buxhetore shtesë që mund të paraqitet gjatë zbatimit të këtij projektligji dhe në përgjithësi ta zbatojë këtë ligj pa pasur nevojë për mjete shtesë buxhetore.

Projektligji ka deklaratën e pajtueshmërisë të Ministrisë për Integritet Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e BE-së. Projektligji krijon stabilitet legjislativ për fushëveprimtarinë të cilën e rregullon. Projektligji është i përgatitur në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës Projektligjin për ripranim ta miratojë, në parim. Ju faleminderit për mirëkuptim dhe durimin e treguar!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri ministër! Komisioni funksional për Punë të Brendshme, zoti Rustem Mustafa!

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri ka pranuar nga Qeveria Projektligjin për ripranim dhe zotohemi se brenda afatit do të procedojmë me grupin punues. Unë nuk kam çka t'i shtoj asaj që e shpjegoi ministri, por e kemi pranuar kërkesën për shpejtim të këtyre procedurave, e kuptojmë se ky presion pozitiv vjen sepse na duhet edhe për liberalizimin e vizave, kërkohet edhe në Raportin e progresit. Kemi diskutuar edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Kemi shqyrtuar Ligjin dhe shohim se është bazë e mirë për të punuar më tutje. Ka disa probleme që ne do t'i zgjidhim në vijimësi. Në përgjithësi, përkthimi ka lënë në ligj mangësi, ashtu edhe gjuha juridike në veçanti mbesin probleme serioze për hartuesit e ligjeve. Në këtë kuptim Komisioni zotohet se do të punojë brenda afatit të paraparë me ligj ose mundësisht edhe më përpara do ta procedojmë në Kuvend.

Ne në parim e mbështesim dhe e përkrahim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Komisionet tjera nuk janë paraqitur. Atëherë, ftoj përfaqësuesit ose shefat e grupeve parlamentare. Për PDK-në, kush flet për ligjin? Për PDK-në foli, në rregull! Për LDK-në? Zoti Eqrem Kryeziu e ka fjalën.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni të përshëndes ministrat e pranishëm këtu dhe, natyrisht, Kuvendin e nderuar!

Pikërisht urimi dhe përgëzimi që bëtë ju, zoti kryesues në fillim të kësaj seance, ka të bëjë edhe me këtë projektligj, sepse janë dhënë tashmë edhe për opinionin e gjerë shpjegime për nevojën e këtij projektligji, qoftë nga autoritetet nacionale, si ministër Rexhepi, qoftë nga ato ndërkombëtare, si zoti Renzo Davidi. Prandaj, nga kjo pikëpamje unë besoj se është një rast madje mjaft i kënaqshëm që të kemi mundësinë që ta përkrahim këtë projektligj. Për nevojën, natyrisht e tha edhe ministri Rexhepi në fjalën e vet të hyrjes. Unë vetëm do të kisha ndoshta një vërejtje se te dispozitat kalimtare thuhet, jo vetëm te memorandumit shpjegues, por edhe te dispozitat kalimtare, pra që është njëfarë lloji neni, sado kalimtar të jetë, thuhet se – procedurat e ripranimit të shtetasve dhe të huajve duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën, Konventën e Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollin mbi statusin e refugjatëve të vitit 1967.

Besoj se kjo të paktën s'ka nevojë se është ose nuk është, kështu që me këto vërejtje të vogla ndoshta edhe në atë aspektin çfarë tha zoti Rustem Mustafa për diskursin juridiko formal, besoj se në ndërkohë mund të harmonizohet në tërësi, kështu që Grupi ynë e mbështet katërçipërisht këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu!

Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Zylfije Hundozi!

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Me vendimin e djeshëm të Parlamentit të Evropës që Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina të kenë liberalizimin e vizave, gjegjësisht që qytetarët e tyre të udhëtojnë lirshëm në shtetet e Bashkimit Evropian, Kosova mbetet vendi i fundit në këtë regjion, qytetarët e të cilit nuk do të kenë mundësi që të udhëtojnë pa viza në shtetet e Bashkimit Evropian, kështu që ky ligj – Ligji për ripranim paraqet njërin prej kushteve për liberalizimin e vizave dhe ne shpresojmë që pas aprovimit të këtij ligji, Qeveria ka programe adekuate për riatdhesimin e këtyre njerëzve, gjegjësisht risocializimin e tyre në shoqërinë kosovare.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj në mbledhjen e grupit parlamentar. Ne e përkrahim kalimin e tij sot në pranim dhe anëtarët tanë në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore do të japin kontributin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, ndoshta Suzana Novobrdaliu?

SUZANA NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për të gjithë!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë projektligj duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji.

Ne i kemi disa vërejtje në këtë projektligj dhe tani do t'i cekim: Neni 2, te përkufizimi e kemi ri-pranimin si definicion, është shumë i paqartë dhe është do të thotë në këto kolonat e ngushta, i ka 15 rreshta, në kolonat e gjata i ka gati 6 rreshta, është një definicion shumë i gjatë dhe është i paqartë dhe është mirë që i njëjti të qartësohet.

Tek neni 3, thotë, nuk i përmbush, do të thotë për kushtet bëhet fjalë dhe thotë – nuk përmbush ose nuk përmbush më kushtet në fuqi. Kushtet në fuqi, nuk kisha për t'i thënë ashtu, mirëpo në kushtet, thotë, të kërkuara sipas ligjit përkatës.

Pika 2, përkufizimi është i paqartë. Duhet i njëjti të qartësohet, si dhe te pika 2 thotë – thirret në nenin 28, 29 të Ligjit për shtetësi. Unë këto nene 28, 29 kisha propozuar të hiqen, sepse mund të vjen deri te një amendamentim dhe të ndërrohen ato nene, kështu që kisha thënë vetëm – sipas neneve të Ligjit për shtetësinë.

Pastaj neni 4, titulli, thotë – dëshmia dhe e drejta për shtetësinë e Kosovës, propozoj që të jetë vetëm e drejta për shtetësinë e Kosovës, të hiqet fjala “dëshmi”. Pastaj vazhdohet dhe thotë se “dëshmia dhe e drejta e shtetësisë së Kosovës rregullohet me Ligjin për shtetësinë”. Kjo kishte qenë mirë të jetë pak më ndryshe. Do të thotë, kisha propozuar të jetë – e drejta për shtetësinë e Kosovës duhet të dëshmohet sipas Ligjit për shtetësinë, gjë që nënkupton certifikatën, sepse në Ligjin për shtetësinë i kemi definimet kur është kjo certifikata e lindjes e vlefshme, certifikata e shtetësisë, letërnjoftimi, pasaporta e Republikës së Kosovës. Këto nuk kanë nevojë të cekin, mirëpo kishte qenë mirë fjalia si fjali të përkufizohet dhe pak të jetë më e qartë.

Neni 6, thotë – autoriteti kompetent do të ripranojë në territorin e tyre të huajin.

Mendoj se fjala “e tyre” nuk duhet të jetë “e tyre” por duhet të jetë “në territorin e vet”. Do të thotë, është një gabim i vogël dhe është mirë të përmirësohet.

Neni 8, paragrafi 1, nënpika 1.3. “I huaji i cili e mban një vizë”. Unë mendoj që të hiqet “një” – “i huaj i cili mban vizë”, domethënë pa “një”.

Pastaj, në nenin 9, flitet për dokumentet e udhëtimit, ndërsa titulli është – dokumentet për kthim. Unë kisha propozuar që titulli të jetë – Dokumentet e udhëtimit për kthim.

Pika 2, është një gabim te pika 2, thotë – pas kalimit të afatit prej 5 ditësh të pacaktuar në paragrafin 1, do të thotë është një gabim gjuhësor, është mirë të përmirësohet – “të përcaktuar”, të jetë fjala.

Neni 10, flet për pikat e kalimit kufitar për kthim. Unë pikat e kalimit kufitar për kthim i kisha zëvendësuar te titulli dhe të jetë vetëm: kalimi kufitar.

Këto ishin vërejtjet tona. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Qamile Morina, në emër të Grupit të LDD-së.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se Projektligji për ripranim është i rëndësishë së veçantë duke pasur parasysh që është një ndër kriteret e parë për procesin e përmbushjes për liberalizimin e vizave.

Mendojmë që zbatimi i këtij ligji do të jetë shumë i varur nga programet që do të krijohen më vonë për riatdhesimin e këtyre personave. Dilemat tona janë në çështje me implikimet buxhetore dhe resurset njerëzore, kapacitetet njerëzore. Dilemat, propozimet dhe sugjerimet tona do t'i japim në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “7+”, zoti Sadik Idriz!

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa “7+” se pridruhuje čestitkama Albaniji i Bosni i Hercegovini za približavanje režimu vizne liberalizacije. Nadamo se da će i Kosovo uskoro doći na red i da će se približiti tome. Ovaj zakon je u cilju postizanja tog cilja i mislim da je zakon urađen kvalitetno i da je jedan kratak zakon koji pruža neophodne stvari.

Naslov zakona, ne znam, na albanskom da li je prikladan ili nije, tu ima stručnjaka za albanski jezik, ali mislim da verzija koja je data na srpskom jeziku ne bi valjala. Bolje da ostane Nacrt zakona o readmisiji, jer ponovni prihvati ne mora da znači baš ovu kategoriju, može da bude za bilo koju kategoriju. Kad se kaže o readmisiji, misli se na poseban, znači tačno određuje kategoriju ljudi koji treba da se vrata iz neke druge države, odnosno da se odnosi na strance koji dolaze ovde. Ponovni prihvati može da bude i za lica koja su materijalno nezbrinuta, koja su na teritoriji. Znači, mi ćemo dati to kao predlog i amandman.

Takođe nejasno je koji organ izdaje dokumenta. U članu 9. treba precizirati koji organ treba da izda dokumenta, putna dokumenta, da li organ koji prihvata ili organ koji vrši transport. Takođe nije definisano kakva će biti materijalna podrška licima koja se vraćaju, znači dobar deo lica nema smeštaj gde bi se vratila, ima lica sa posebnim potrebama, ima maloletnika koji mogu da budu vraćeni. Znači, treba precizirati u zakonu ili verovatno u nekom podzakonskom aktu. Kada su u pitanju podzakonski akti, takođe je u članu 15. dato da će Ministarstvo unutrašnjih poslova doneti podzakonska akta, međutim bilo bi dobro da se precizira – u roku od 6 meseci ili u roku od godinu dana da će Ministarstvo unutrašnjih poslova doneti podzakonska akta koja će regulisati ovu materiju.

U svakom slučaju, Parlamentarna grupa “7+” će u načelu podržati ovaj nacrt zakona a u funkcionalnoj i u drugim komisijama daćemo svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e SLS-së, Petar Miletic.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Ovaj zakon reguliše jednu važnu temu, jednu važnu oblast i ne mislim da je on važan samo kao rešavanje još jedne prepreke ka evro-integracijama, već kao nešto što rešava i utiče direktno na sudbine nekih ljudi. Ti ljudi su naši građani i mi moramo da strogo vodimo računa kako ćemo se prema njima uhoditi.

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke u načelu će podržati ovaj zakon. Svoje primedbe ćemo dati kroz komisije. Međutim, koliko sam ja čuo, da postoji i strategija koja će se baviti pitanjima ovih lica koja treba da budu vraćena na Kosovo, tako da ne bi bilo loše, odnosno ja predlažem da Vlada to dostavi poslanicima kako bi eventualno mogli i mi da učestvujemo u toj strategiji ili da damo određene primedbe. Možda ona ne mora da prođe baš kroz skupštinsku proceduru, ali kao informaciju bi bilo dobro da je imamo kako bi svi mi koji smo poslanici mogli da na kraju krajeva i informišemo građane o tome.

Ono što je kolega rekao je takođe, i ja smatram da je naslov ovog zakona na srpskom jeziku neadekvatan, jer kad kažete Zakon o ponovnom prihvatu, to ostaje onako i nedorečeno – Zakon o ponovnom prihvatu koga ili čega, to ostaje nejasno iz naslova, tako da ćemo i na to ukazati kroz amandmane. Još jednom ponavljam, naša Poslanička grupa u načelu podržace ovaj zakon.

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet. Për Grupin për Integritet, deputeti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar për Integritet e ka shqyrtuar këtë projektligj. I kemi nxjerrë disa vërejtje tona, ku bëhet fjalë për riatdhesimin e kosovarëve nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilët rëndojnë edhe më tepër gjendjen sociale dhe ekonomike në Kosovë.

Kosova tashmë ka nënshkruar disa marrëveshje në mes shteteve evropiane në të cilat jetojnë qindra e mijëra qytetarë të Kosovës, e në veçanti komuniteti ashkali, romë dhe egjiptas. Pra, do të ndikojë negativisht në gjendjen sociale-ekonomike të kosovarëve, do të rrisë problemet sociale, prandaj Qeveria duhet të mendojë fuqishëm sepse burim kryesor i disa familjeve në Kosovë – adresa për të mbijetuar është diaspora.

Sipas mendimit tim, do të ishte një barrë e rëndë për buxhetin e varfër të Kosovës riatdhesimi i këtyre familjeve. Ata do të kenë vështirësi edhe në integrimin në sferat ekonomike të Kosovës, ka një sistem ndryshe edhe në shkollim, kështu që prapë se prapë mendoj që Qeveria e Kosovës edhe për një hap duhet ta shtyjë riatdhesimin e kosovarëve, edhe pse ata janë të mirëseardhur në Kosovë, por unë mendoj se ende nuk ka kushte të volitshme për kthim. Nëse ata kthehen, do t'u bashkohen një kolone të gjatë të njerëzve të papunë në Kosovë të cilët presin prej ditës në ditë në skaje të rrugëve.

Marrëveshja e riatdhesimit prej afër 15.000 personave që jetojnë vetëm në Gjermani, 10.000 nga ta janë ashkalinj, romë dhe egjiptas. Një numër i madh i këtyre familjeve nuk do të kenë as ku të strehohen, shumë familje kanë shitur pronat e tyre. Ne deri më tani nuk jemi të njoftuar se Qeveria e Kosovës e ka përgatitur një strategji për riatdhesimin e këtyre

familjeve. Duke marrë parasysh se 70% të familjeve të komuniteteve ashkali, romë dhe agjiptas plotë qe 10 vite nuk kanë pasur mundësi të zgjedhin as strehimin që janë këtu të Kosovës, e po ashtu edhe punësimin. Ne jemi të vetëdijshëm se duhet të bëhet riatdhesimi i këtyre komuniteteve dhe të qytetarëve të Kosovës, por nuk do të kemi mundësi që ta ndalim këtë hap, por para se të kthehen, unë kërkoj nga Qeveria e Kosovës që së paku t'u sigurohet sigurim për këto familje. Faleminderit!

KRYESUESI: Dëgjuam paraqitjet e grupeve parlamentare të cilat të gjitha e përkrahën këtë ligj, në parim. Tash do ta marrin fjalën deputetët sipas radhës së paraqitjes dhe unë ju lexoj menjëherë emrat: Sanije Alijaj, Rexhep Hoti, Riza Smaka, Xhevdet Neziraj, Njomza Emini dhe Adem Hajdaraj. Fjalën e ka Sanije Alijaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Me Projektligjin për ripranimin Ministria e Punëve të Brendshme është duke vazhduar angazhimin për kompletimin e kornizës ligjore sa iu përket politikave të azilit, migrimit dhe menaxhimit të kufijve.

Sfidë kryesore e Raportit të progresit të Komisionit Evropian që ndërlidhet me liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian është edhe Projektligji për ripranimin. Aktualisht, Republika e Kosovës nuk e ka të rregulluar me ligj mënyrën e procedurave të ripranimit të personave për shtetas të Republikës së Kosovës dhe të huajt që qëndrojnë pa autorizim të vlefshëm në shtetin kërkues. As Bashkimi Evropian nuk e ka të rregulluar këtë fushë me akt normativ, prandaj është kompetencë e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve tjera që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian që brenda juridiksionit të tyre të rregullojnë këtë çështje. Në këtë mënyrë edhe procedimi për miratimin e Projektligjit për ripranim plotëson standardet si kriter kryesor për progresin e arritur për liberalizimin e vizave nga BE-ja dhe një prej parakushteve për integrim në Bashkimin Evropian.

Projektligji përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues.

Duke pasur të njohur se është një numër i madh i qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit si refugjatë, shtetet ku qëndrojnë herdokur ushtrojnë kërkesën për ripranim, pas inicimit të procedurës për ripranim nga një shtet kërkues, autoriteti kompetent do të konfirmojë nëse një person që është subjekt i ripranimit se a i plotëson kriteret me ligjet në fuqi për ripranim. Me këtë rast do të kishte qenë më mirë që emërtimi i Projektligjit për ripranim të emërtohej – Ligji për riatdhesim.

Autoriteti kompetent me këtë projektligj obligohet që të njoftojë shtetin kërkues për vendimin e tij në formën e shkruar në afat prej 30 ditë pune pas marrjes së kërkesës. Pas konfirmimit të kërkesës për ripranim, autoriteti kompetent në afat prej 5 ditë pune nxjerr dokumentin e udhëtimit të nevojshëm për kthimin e shtetasit apo të huajt. Me këtë rast do të potencoja se a është kërkuar nga shteti kërkues, nga autoriteti kompetent që të respektojë Protokollin mbi statusin e refugjatëve të vitit 1967.

Ministria e Punëve të Brendshme, përveç përkushtimit për hartimin e këtij projektligji për ripranim, ka filluar negociatat për riatdhesim me vendet e BE-së dhe shtetet fqinje për riatdhesimin e refugjatëve, duke nënshkruar edhe marrëveshje për riatdhesim, pa kërkuar

paraprakisht plotësimin e parakushteve për kthim të dinjitetshëm, pra sigurimin e kushteve themelore për jetesë.

Mirë është që kjo fushë rregullohet me ligj, por shtetasi i Kosovës përveç ripranimit të statusit të shtetësisë kërkon kthim të dinjitetshëm, vend dhe hapësirë ku të qëndrojë ai dhe familja e tij, me programe dhe projekte konkrete. Prandaj, propozoj që Projektligjit t'i shtohen disa nene apo dispozita, ku përveç ripranimit të kërkohej edhe kthimi i dinjitetshëm duke i siguruar qytetarit të Republikës së Kosovës kushte themelore për jetë dhe për punë. Autoriteti kompetent ripranimin e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe të huajt duhet ta bëjë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën e Gjenevës të vitit 1951, si dhe Protokollin mbi statusin e refugjatëve të vitit 1967.

Sipas vlerësimit të memorandumit shpjegues të Projektligjit, nuk kërkon efekte shtesë të drejtpërdrejta buxhetore në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme zotohet se Projektligjin do ta zbatojë pa pasur nevojë për mjete shtesë buxhetore për vitin 2010, por me këtë rast unë vlerësoj se ky projektligj për t'u zbatuar kërkon mjete të mëdha buxhetore, prandaj paraprakisht duhet t'i caktohej nga Komisioni për Buxhet e Financa kostoja buxhetore.

Projektligjin e përkrah në parim dhe shpresoj që në komisionet funksionale do të amendamentohet për t'u bërë më lehtë i zbatueshëm, por shpresoj që Ministria e Punëve të Brendshme me akte nënligjore bën që Projektligji për ripranim t'i plotësojë standardet ndërkombëtare për t'u zbatuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Rexhep Hoti!

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Projektligji që sot paraqesin para nesh nga Ministria e Punëve të Brendshme meriton një përkushtim të lartë jo vetëm për shkak të fushëveprimit që rregullon përmes tij, por edhe nga pesha e obligimeve që institucionet tona detyrohen t'i përmbushin ndaj qytetarëve, shtetit dhe proceseve integruese euroatlantike.

Projektligji për ripranim obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës të fillojë t'i marrë përgjegjësitë për të gjithë shtetasit e vet, kudo që ata janë me vendbanim apo vendqëndrim jashtë vendit. Përmbushja e këtij veprimi në procesin e përmbushjes së parakushteve për liberalizimin e vizave nxjerr në pah dy aspekte themelore. E para, është se përshpejton procesin e negocimit dhe të nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale me shtetet anëtare të BE-së për përmbjlljen e procesit të ripranimit dhe, e dyta, Kosova po e përmbush njërin ndër parakushtet e parapara në procesin e liberalizimit të vizave. Nga ky këndvështrim rrjedh edhe përgjegjësia për menaxhimin e një numri të madh të qytetarëve tanë të cilët presin të rikthehen në shtetin e tyre.

Projektligji, së bashku me strategjinë për integrim dhe planin e saj të veprimit, do të përmbjllë kornizën e nevojshme ligjore në fushën e ripranimit. Me këtë rast gjykoj se të prirë nga Ministria e Punëve të Brendshme, jemi në rrugën e duhur të eliminimit të barrierave formale dhe fizike për një qarkullim të lirë të qytetarëve tanë. Një implementim i njëanshëm i kriterëve për procesin e liberalizimit të vizave vetëm se i ka ndihmuar Kosovës që të marrë një hap në rrjedhat e proceseve integruese dhe një hap me vendet e rajonit sepse Projektligji për ripranim vetëm sa i standardizon procedurat tashmë funksionale të komunikimit dhe të bashkëpunimit në mes të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës.

Projektligji specifikon procedurat, standardet e operimit dhe procesimit të informacioneve relevante në drejtim të identifikimit dhe ripranimit të shtetasve tanë dhe me këtë rast iu ndihmon bartësve të këtij procesi për një kornizë ligjore me standarde evropiane. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Riza Smaka!

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Ky akt ligjor është i nevojshëm dhe si i tillë natyrisht i pranueshëm, në parim. Do të kisha ngritur një shqetësim parimor që i referohet edhe këtij akti ligjor, po edhe të gjitha akteve ligjore e ky është ... Ju lutem, ky dokument, po e zëmë, i ka 27 faqe shtesë, do shkresa, do tjera e tjera. Unë jam ndër deputetët që i analizoj dokumentet, të gjitha. Besoni, këto shkresa asnjëherë nuk i lexoj. Ndoshta është ndokush që i lexon, mirëpo unë propozoj që administrata të meditojë për këtë se 27 faqe here 120, po e zëmë, 2.000 - 3.000 faqe janë, që nuk lexohen fare. Të kursejmë! Kursimi është fisnik, apo jo. Shpenzojmë kur duhet të shpenzojmë, të kursejmë kur mund të kursejmë. Kjo është një. Krejt dokumenti bazë i ka faqe. Ky është!

Tjetër, i kam disa opinione parimore si vërejtje, pos atyre që i theksoi zonja Novobrdaliu.

Një, titulli. Titulli as në gjuhën shqipe, kolegët e ngritën çështjen se nuk përkon as në serbisht, dhe nuk përkon, sepse ky është institut juridik ndërkombëtar dhe njihet si admision, apo jo. Prandaj, përdoret edhe në doktrinë, e ka një kuptim të veçantë që nuk është definuar sa e si duhet as në këtë dokument, do të duhej të plotësohej. Prandaj, angazhohem që ta quajmë – Ligji për admision – re-adminision.

Disa vërejtje parimore të neni 3, 9, 14 dhe 15. Bie fjala, te neni 3, paragrafi 1 – Autoriteti kompetent do të ripranojë në territorin e tij shtetasin i cili nuk përmbush ose nuk përmbush me kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin... Një definim i pa qartë dhe sipas këtij definimi del se imperativisht dhe kategorikisht cilido të ripranohej, që nuk do të duhej të ishte asisoj. Do të duhej të thuhej autoriteti, jo autoriteti por të precizohet i cili organ se po krijohen nebuloza, nuk dinë në praktikë kush është autoriteti. Prandaj, ligji karakterizohet me terminologjinë ligjore që do të ishte precize dhe koncize dhe domethënëse dhe konkrete. Dhe, do të shtoja aty, bie fjala, organi i cili do të ishte konform me ligjin, “I” e vogël, se ka akte ligjore të ndryshme, që i referohen, po e zëmë, kësaj tematike.

Ose, bie fjala te neni 8, paragrafi 6. Mospranimi i kërkesës së ripranimit do të arsyetohet në formë të shkruar. Kjo është një shprehje që nuk mund të qëndrojë në akt ligjor. Më së pari, nuk thuhet mospranim por refuzim, se në përgjithësi nuk thuhet mospranimi. Më pastaj, në formë të shkruar mund të bëhet një shkresë, sipas kësaj, por duhet aktvendim, ju lutem. Aktvendim administrativ! Se është bazë, se vetëm kundër aktvendimit pala e pakënaqur ka të drejtë të përdorë mjete juridike të rregullta, eventualisht edhe të jashtëzakonshme. A nëse do t’i jepej një shkresë me një arsyetim, ai nuk do të ishte akt administrativ dhe do t’i cenoheshin të drejtat elementare për ankesën që e kemi edhe në kushtetutë.

Te dispozitat kalimtare, bie fjala, thuhet – procedura e ripranimit të shtetasve dhe të huajve, duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën. S’ka nevojë të thuhet kjo. Vetëm me ligjin, se ligji medoemos duhet të jetë në harmoni me Kushtetutën dhe të ketë akte ligjore të ndryshme. Më pastaj, thotë – me Konventën e Gjenevës, bile “k” të vogël, a duhet “K” e madhe. E cila

konventë? Ka me dyzina konventa, ju lutem, hartuesit duhet të jenë shumë të përgjegjshëm dhe të thonë e ta precizojnë konventën me emërtim të plotë.

Dhe, neni 15, ku thotë – aktet nënligjore. Ministria e Punëve të Brendshme do të nxjerrë akte nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji. Kjo është detyrë themelore e Ministrisë, e cilëso ministri. Është e panevojshme, tautologji totalisht e panevojshme të thuhet se nëse do të shkonim me këtë qasje, do të duhej t'i shkruanim dhe s'po di sa dispozita krejtësisht të panevojshme. Eventualisht bile ta kishte precizuar se brenda 3 muajve do t'i përgatisë dhe miratojë aktet nënligjore, do të kishte njëfarë kuptimi se do ta sanksiononte, si të them, afatin. Këto janë disa vërejtje parimore. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Xhevdet Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në parim them që këtë projektligj e pranojmë për arsye se u çek nga ministri që është një prej kushteve të liberalizimit të vizave, mirëpo Qeveria e Kosovës duhet të jetë shumë më syçelë në këtë drejtim rreth strategjisë së integritimit – të kthimit të njerëzve, për arsye se edhe pa këtë ligj ka filluar rikthimi i njerëzve nga marrëveshja që ka bërë përfaqësuesi special Shtajner që ka qenë këtu me Gjermaninë dhe është kthyer një numër i konsiderueshëm i njerëzve edhe pa këtë ligj, sidomos pjesëtarë të komunitetit shqiptar dhe pjesëtarë të komunitetit egjiptas dhe besoni që të gjithë që janë kthyer, Qeveria e Kosovës nuk është marrë me ata njerëz dhe janë lënë në pikë të mëshirës.

Ministria për Komunitete dhe Kthim kur i kam bërë një pyetje, ka thënë që nuk merret me to, prandaj edhe s'është marrë me asnjë pjesëtarë të kthyer edhe të komuniteteve pakicë. Prandaj, duhet të jetë shumë i vetëdijshëm se ministri tha nuk ka implikime buxhetore, do të ketë implikime shumë të mëdha buxhetore se njerëzit kthehen, nuk kanë ku të vendosen, nuk kanë kushte të banimit dhe shumë e shumë çka tjetër, për çka Qeveria e Kosovës duhet të gjitha këto t'i ketë për bazë dhe të bëjë një strategji dhe jo vetëm një strategji sa për sy e faqe, sikur që është strategjia për integrimin e komunitetit rom, egjiptian dhe shkali, e cila strategji jo që s'është kah jep rezultate dhe e cila strategji i lë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që s'merret aspak me këta njerëz dhe harxhon atë buxhet dhe asnjë cent s'e ka harxhuar për këto tri komunitete, dhe mandej problemet do t'i hasim në praktikë.

Unë e kam pasur një takim me Ambasadën Gjermane, me ambasadorin dhe kemi kërkuar që të bëhet një kthim shumë i ngadalshëm dhe i përcjellë me donacione e investime për njerëzit që kthehen në Kosovë. Përndryshe, do të ketë shumë probleme dhe do të ketë raste të mëdha sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Njomza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Po ashtu, kolegë deputetë,

Parimisht, unë e mbështes këtë projektligj për ripranim dhe mendoj që ka qenë i nevojshëm të vihet këtu në Kuvend dhe ta shqyrtojmë, duke ditur edhe faktin që sfida kryesore faktikisht e Raportit të progresit të Komisionit Evropian ka qenë edhe ky projektligj dhe duke ditur edhe ashtu procesin e liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian, që është edhe njëri ndër kushtet kryesore për liberalizimin e vizave. Unë mendoj

që këtu është sipas neneve që i lexova, ka disa gabime që u thanë edhe nga kolegët e mi paraprakisht, pro ajo se çka e vërejta unë në këtë projektligj, nuk është përcaktuar kostoja buxhetore. Kërkoj nga kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa apo nga ministri që të na sqarojë edhe pse ishte këtu një sqarim, por jo edhe aq i qartë. Po ashtu, shpresoj që ky projektligj të fillojë të implementohet sa më shpejtë, duke ditur se deri tash shtetasit e Republikës së Kosovës kanë pasur shumë probleme që është dashur të komunikojnë me ambasadat e tyre që kanë qenë jashtë vendit dhe jo ta kenë ligjin që duhet t'i mbrojë edhe qytetarët e Republikës së Kosovës apo edhe të huaj që të precizohet më qartë për ata.

Unë mendoj që ky projektligj do të ketë implikime, siç u tha edhe nga deputetët, implikime buxhetore, por ajo se çka dua të them, është se dua një sqarim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Adem Hajdaraj e ka fjalën!

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryesues,
Ministra dhe deputetë,

Unë dua të them se ligji është i pranueshëm, ky projektligj dhe duhet të kalojë në leximin e parë me vërejtjet që gjithmonë po i japim për gjuhën, me kërkesë që të caktohen njerëzit, lektorët. Unë, sa e di, nuk ka lektorë këtu dhe përsëri dalin me gabime të njëjta edhe në leximin e parë, edhe në të dytin. Sa ka në Ministri nuk di, por vërejtje do të jetë kjo, që të mos ndalem në ndonjë gabim që përsëritet edhe këtu në këtë projektligj. Dua hë për hë të ndalem vetëm te titulli edhe një herë, meqë kolegët i theksuan dhe dhanë disa variante. Unë, të them të drejtën, kur e kam pa Ligji për kthim, unë s'kam ditur për çfarë kthimi bëhet fjalë deri sa e kam lexuar atë, domethënë titulli nuk është i plotë. Duhet të jetë i plotë titulli që të përputhet me atë që është në përmbajtje. Dhe unë mendoj se termi “riatdhesim” bukur fort i afrohet dhe është si term kështu ndërkombëtar, ndërsa atë “riadmision” që e propozoi kolegu Riza, profesori, nuk mund të futet këtu e të ngarkohet Projektligji me fjalë të huaja që nuk janë të domosdoshme për gjuhën tonë. Unë mendoj se titulli më i mirë e më i përshtatshëm do të ishte edhe kuptimplotë ky: Ligji për pranim të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe i të huajve, që do ta përfshinte edhe rikthimin e shtetasve tanë po edhe të të huajve, prandaj assesi nuk do të mbetej, do të thotë, “ripranim”, por “ripranimin e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe të huajve”. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Gani Koci, një shpjegim të shkurtër! Unë regjisë i them – thirrni deputetët se kemi votim dhe le të vinë në sallë. Gani Koci, shkurt, nëse mundeni.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues! Sinqerisht Qeveria sigurisht i ka bërë llogaritë e veta dhe hesapet e veta kur e ka proceduar këtë ligj në Kuvend me këtë kosto kaq të lartë buxhetore. Unë dua të them vetëm atë proverbin: “Ai që e mbaron vegshin, di me ia ngjitë edhe vegët” dhe sigurisht Qeveria do të dijë të gjejë... Ne në buxhetin e Republikës së Kosovës kemi disa linja buxhetore që janë për shpenzimet e pa parashikueshme dhe ndoshta në kuadër të kësaj do të duhej të gjenden edhe këto mjete. Pastaj, kjo është një kusht për plotësimin e standardeve dhe në këtë drejtim sigurisht mendohet edhe në ofrimin e donacioneve të ndryshme, sepse njerëzit që duhet të riadhesohen këtu, sigurisht se do të ketë marrëveshje me shtetet dhe qeveritë e shteteve tjera që në njëfarë mënyre të bartin bashkërisht edhe atë koston financiare të riadhesimit, meqë po e quajmë kështu, të qytetarëve të Republikës së Kosovës që jetojnë dhe nuk e kanë statusin e zgjidhur nëpër vendet tjera jashtë Kosovës. Prandaj, ne kur të vjen në Komisionin për Buxhet e Financa ky ligj në këtë pjesë, sigurisht do të marrim informacionin e plotë edhe nga Qeveria, edhe nga Ministria e

Ekonomisë dhe Financave dhe atëherë ne do të vendosim që të procedohet ky ligj edhe më tutje.

Unë mendoj se paratë duhet të gjenden. Është e nevojshme dhe ato duhet të sigurohen disi.

KRYESUESI: Besoj se njerëzit janë kthyer në sallë. Regjia dhe deputetët le të bëhen gati për votimin për miratim, në parim, të këtij projektligji. Në sallë kemi 64 deputetë. Votojmë tash: Ligji miratohet me 61 vota “për” dhe me 2 abstenime.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ngarkohen këto komisione për punën e mëtejme në Ligj:

- Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, që është komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi,
- Komisioni për Buxhet e Financa,
- Komisioni për Integritet Evropian.

Si gjithmonë, brenda dy muajsh, data është më e fundmja, duhet të kthehen rekomandimet në Kuvend për lexim të dytë.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare

Në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të këtij projektligji, në parim.

Ftoj ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, që ta paraqesë Ligjin në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 02/L-123 për shoqëritë tregtare.

Arsyeja për ndryshimin e Ligjit është përmbushja e objektivave të Qeverisë së Kosovës në lehtësimin e procedurave në fushën e regjistrimit dhe fillimit të punës së bizneseve, si dhe bërjen e këtij ligji më praktik dhe më të zbatueshëm.

Ky projektligj është harmonizuar me ligjet tjera në fuqi, andaj edhe ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj i janë përshtatur legjislacionit të avancuar sa iu përket shoqërive tregtare.

Disa nga ndryshimet themelore të cilat janë propozuar për ndryshim në ligjin aktual janë:

Me rregulloren e UNMIK-ut 2008/26 të nënshkruar nga PSSP, me të cilën është bërë shpallja e këtij ligji me dispozitat shfuqizuese, është shkaktuar konfuzion se cili ligj është një fuqi, duke marrë parasysh se kjo rregullore ka mbajtur në fuqi edhe dispozitat e rregullores së UNMIK-ut 2001/6 si ligj i parë në këtë fushë, nëse janë në kundërshtim me ligjin aktual:

Është përcaktuar obligimi i Agjencionit për regjistrimin e ndërmarrjeve publike, të cilat kanë përfunduar procesin e korporatizimit dhe janë transformuar në korporata.

Janë hequr të gjitha taksat për regjistrim të biznesit, përkundër asaj se aktualisht janë më të ulëtat në rajon. Aktualisht kemi vetëm 7 euro për regjistrimin e biznesit individual dhe 22 euro për regjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Janë shpejtuar dhe thjeshtësuar procedurat e regjistrimit të biznesit ku me propozimet e reja afati për regjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar shkurtohet nga 10 në 3 ditë.

Është hequr obligimi për deponim të kapitalit fillestar prej 1.000 euro për regjistrimin e biznesit si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, kështu që biznesi do të mund të regjistrohet pa kurrfarë kapitali fillestar.

Janë harmonizuar afatet kohore, procedurale në harmoni me Ligjin mbi procedurën administrative dhe në disa raste me qëllim të ekspeditivitetit janë përcaktuar afate shumë më të shkurtra dhe optimale me qëllim të efikasitetit në punë dhe ndaj palëve.

Është përcaktuar mosha minimale që konsiston në moshën madhore të personave fizikë që kanë të drejtë të jenë themelues apo edhe agjentë tregtarë e që nuk ka qenë e paraparë me ligjin në fuqi, ngase edhe personat jomadhore nuk kanë pasur pengesë ligjore për të qenë pronar apo agjentë.

Është përcaktuar obligimi ligjor që për përfaqësim në ARBK i autorizuari duhet të posedojë autorizim të legalizuar.

Është bërë përcaktimi i saktë i përkufizimit person fizik dhe person juridik dhe anëtar i ngushtë i familjes.

Janë përcaktuar të drejtat e palëve kundër vendimeve të Agjencionit dhe është garantuar dyshkallësia në procedurë të ankesave konform Ligjit mbi procedurën administrative.

Kemi zvogëluar shumën e kapitalit fillestar për themelimin e shoqërive aksionare nga 25.000 në 10.000 euro, si dhe kemi hequr obligimin që pagesa të dëshmohet në Agjencion për regjistrimin e biznesit, e cila është vlerësuar si barrierë e panevojshme administrative.

Kemi hequr obligimin e dorëzimit të raporteve vjetore pasi që kjo ka qenë vetëm çështje teknike dhe ngarkesë e panevojshme për bizneset.

Në anën tjetër, për mos dorëzim të këtyre raporteve sipas Ligjit në fuqi parashihet që të iniciohet procedurë e shlyerjes gjë që iu ka mundësuar bizneseve jo aktive që të shlyhen pa procedurë e që ka qenë në kundërshtim me dispozitat tjera ligjore në fuqi për shlyerjen dhe çregjistrimin e bizneseve. Po ashtu bizneset kanë obligim të dorëzojnë raporte financiare sipas ligjeve tjera, kështu që raportimi i dyfishtë është parë i panevojshëm.

Me rastin e përfundimit të regjistrimit, shpërbërjes vullnetare apo bashkimit kemi inkorporuar obligimin që të dëshmohet me dëshmi nga ATK-ja se subjekti i ka përmbushur të gjitha obligimet tatimore, si dhe janë bërë përshtatje të terminologjisë juridike shqipe.

Ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për shoqëri tregtare dhe rregullimi juridik i tij është në të njëjtën kohë edhe një premisë për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve, mbështetjen e fuqishme të biznesit kosovar si dhe lehtësime për investitorët e brendshëm apo të jashtëm për të ushtruar biznes në Kosovë.

Me këto ndryshime do të zvogëlohen edhe më tutje procedurat e nevojshme për fillimin e biznesit në përputhje me rekomandimet e bëra në Raportin by-biznes të Bankës Botërore.

Të nderuar deputetë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në fushën e ekonomisë, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Komisioni funksional, a dëshiron fjalën? Jo. Të tjerat komisione? Jo. Atëherë, kalojmë në paraqitjen e grupeve parlamentare. Thërras përfaqësuesin e PDK-së, Sala Berisha-Shala!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për plotësimin e ndryshimin e Ligjit për shoqëritë tregtare. Gjatë analizimit kemi vërejtur se kanë qenë të nevojshme këto plotësime dhe ndryshime, kemi ndryshime e plotësime edhe të natyrës teknike dhe të natyrës përmbajtjesore. Që të kursehem në kohë e mos ta përsëris ministrin rreth plotësimeve dhe ndryshimeve, ne e mbështesim në parim si grup parlamentar. Kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit për precizitetin, zonja deputete! Fjalën e merr Zef Morina në emër të... Atëherë, Fatmir Rexhepi, në emër të LDK-së!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Kolegë deputetë,

Përshëndetje ministra,

Edhe ne kemi biseduar dhe komentuar lidhur me Projektligjin dhe ndryshimet e plotësimet që ofrohen në Ligjin aktual për shoqëri tregtare. Si grup parlamentar vlerësojmë se objektivi apo synimi i këtyre ndryshimeve është përshtatja në kuadër të kësaj kornize ligjore për një pozitë më të përshtatshme të bizneseve, e po ashtu në ambientin e ri ekonomik, ekonominë e tregut, konkurrencës, në organizimin më të mirë të bizneseve në Kosovë, duke u nisur nga regjistrimi, të drejtat dhe obligimet të cilat u takojnë bizneseve, por edhe shoqërisë a institucioneve tona.

Në kuadër të kësaj, ky objektivi ka të bëjë edhe lidhur me lehtësimet për format e organizimit të bizneseve, ndërmarrjeve apo kompanive qoftë vendore, qoftë të huaja që punojnë këtu ose atyre që duhet të jenë lidhur me bashkimin, me ndarjen, me transferin qoftë të pasurive të aksioneve e kështu me radhë, në një objektivi të vetëm pra që të arrijmë ato standarde dhe ato parime të përgjithshme që kanë të bëjnë me ekonominë evropiane dhe ekonominë e tregut për bizneset që zhvillohen tek ne.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah, në parim, për procedim dhe normalisht do të japim kontributin tonë në ndërtimin e legjislacionit edhe në këtë fushë, që konsiderojmë se

është me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik që nga fillimi i bizneseve e deri te aktivitet tjera që e përcjellin zhvillimin e biznesit dhe të jetës ekonomike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e AAK-së, besoj Xhevdet Neziraj! Urdhëro, deputet!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah këtë ligj dhe përkrah çdo ligj që ka të bëjë me heqjen e barrierave administrative që e kanë ngarkuar regjistrimin e biznesit të firmave të ndryshme në Kosovë dhe e bën këtë projektligj më funksional dhe heq të gjitha barrierat e mundshme dhe lehtëson punën e regjistrimit të shoqërive tregtare. Prandaj, Grupi i Aleancës dhe deputetët do të japin kontributin në komisionin funksional dhe ato kryesore në të cilat do të kalojë ky projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për AKR-në, Myzejene Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për të gjithë që janë në seancë sot!

Dëgjova me vëmendje ministrin gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shoqëri tregtare. Me sa po duket, ministër, është dashur edhe pak më ngadalë të projektohet ose të draftohet, me përgatitje më të duhura dhe ka nxjerrë në pah disa mangësi gjatë shqyrtimit dhe draftimit të projektligjit, të cilat duhet të rregullohen plotësisht nga projektligji i ri i përcaktuar sot. Një ndër risitë që do të duhej të ketë në projektligj është mbrojtja shumë e saktë e palës së tretë. Këtu duhet t'i kushtosh rëndësi pak më të madhe që hyn në marrëdhënie tregtare. Ndërkohë, Qeveria duhet të reduktojë edhe kapitalin minimal që duhet ta ketë kompania sh.p.k. vlera e të cilës minimalisht duhet të jetë 1 euro edhe në bazë të Komisionit Evropian, rregullave të Komisionit të BE-së. Këtë e din mjaft mirë ti. Të drejtat e nevojshme të Projektligjit duhet të jenë mbrojtja e palëve të tretë që të hynë në marrëdhënie me shoqërinë sipas kërkesave të BE-së dhe këtë në mënyrë shumë strikte; reduktimi i kapitalit minimal të sh.p.k. në 1 euro në përputhje me politikat e Komisionit Evropian; mbrojtja e ortakëve të minorancës parashikon instrumente të posaçme në duar të tyre për masa specifike; rregullore të qarta mbi detyrat e menaxherëve dhe detyrimeve, besnikërisë ndaj shoqërisë, rregulla që ndalojnë konkurrencën e pandershme të administratorëve dhe ortakëve; mbrojtja sekrete industriale, ndërsa Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare thuhet se nuk do të ketë implikime buxhetore pasi që ARBK do të jetë në strukturën e MTI-së. Le të shpresojmë që në parim e mbështesim Projektligjin, por duke reflektuar ndryshime dhe plotësime të lartpërmendura për arsye se ju e dini mjaft mirë se cilat kanë qenë vërejtjet për zhvillimin e biznesit në Kosovë nga të gjitha organizatat e huaja. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për LDD-në, deputetja Qamile Morina!

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Edhe LDD-ja në parim e mbështet Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për shoqëritë tregtare. Ne mendojmë se objektiva kryesore e ndryshimit të këtij ligji është që të gjejë ky ligj zbatueshmëri në praktikë dhe njëkohësisht mundëson lehtësimin e regjistrimit të bizneseve që ushtrojnë aktivitete biznesi në Kosovë. Kemi disa vërejtje që janë kryesisht me karakter të terminologjisë në këtë projektligj, që do t'i paraqesim gjatë procesit të amendamentimit në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin “7+” Mufera Shinik.

MÛFERA ŞINIK: Teşekkür ederim,

Kosova Cumhuriyetinin yeniden yapılanmasında tüccaretin önemini göz önümüzde bulundurursak bu Yasa Tasarısıyla ilgili Hükümetin sunmuş olduğu değişiklikler önermelerini, 7+ Parlamenter Grubu olarak kabul etmekteyiz, çünkü verilen değişiklik önermeleri ile birlikte, bu konuda Yasanın daha verimli olabilmesi için şirketin kaydından başlayarak, ileride sürdüreceği faaliyetleri için şirket sahiplerine kolaylıklar sağlamaktadır. Öyleki bu Yasanın, Kosova ticari ortamını uluslararası düzeyine taşıyacak standartlara sahip olduğu görülmektedir. 7+ Parlamenter Grubu kabul etmekle birlikte ikinci okunuşuna kadar fonksiyonel komisyonlarda katkısını sunacaktır.

Teşekkür derim

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem se, gospodine predsedavajući!

Dame i gospodo prisutni,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj Nacrt za izmenu i dopunu Zakona o trgovačkim društvima, međutim tražeći ovaj izvorni zakon, njegov naslov je Zakon o posebnim društvima, ne o trgovačkim društvima, što recimo suštinski menja stvari jer ako govorimo o trgovačkim društvima, sama reč društvo znači skup određenih ljudi koji se bave određenom delatnošću. S tim u vezi, želim da dam jednu sugestiju i mi ćemo to na komisijama da pokušamo amandmanom da ispravimo. U delu 3. samog izvornog zakona piše – privatno preduzeće, odnosno ispod toga u zagradi – lično poslovno preduzeće. Ako se govori o preduzeću, onda moramo da imamo na umu da se radi opet o kolektivu ljudi i nikako ne može jedno lice da bude definisano kao preduzeće i istovremeno u članu 48. tačka 5. kaže se, recimo, da lično poslovno preduzeće nije pravno lice. To ne može da bude slučaj, jer ako je privredni subjekt, onda u tom slučaju ne može da se definiše da ono ne bude pravno lice. U nastavku sledi recimo rečenica da kaže ipak ono može da zaključi ugovore. Po kom osnovu će zaključivati ugovore neko preduzeće koje nije pravno lice, kada znamo da pravni subjektivitet, a samim tim i sticanje i zaključivanje ugovora i svih onih pravila koje važe u poslovnom svetu, potrebna je poslovna i pravna sposobnost a to se stiče dobijanjem svojstva pravnog lica.

Prema tome, naše razmišljanje ide u tome da se član 48. izvornog zakona promeni i da se definiše, da to bude privatni preduzetnik, a ne privatno preduzeće. To je jedna stvar koja suštinski menja ove stvari jer će mnogo pomoći i licima koji su pojedinci, kao što se i definiše da je to vlasnik pojedinac koji organizuje delatnost, koji zapošljava ljude u tom cilju i stiče dobit.

Kažem vam, znači suštinski ne može da pojedinac bude društvo. Definitivno, društvo sačinjavaju društva lica i društva kapitala, a ovo nije to slučaj. Znači, za to Parlamentarna grupa SLS će pokušati da u komisijama da svoj doprinos a samim tim i u članu 1. izmene ovog zakona, stav 2. piše se i kaže – individualno preduzeće, pa se menja u rečima - individualni biznis. Opet to adekvatno ne govori o ovom problemu, pa bih želeo da poštovani poslanici porazmišljaju o ovome, a mi ćemo dati svoj doprinos u radu komisija. Hvala, još jednom!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin për Integritet, deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit zoti kryesues i Kuvendit!

Mi smo takođe sa pažnjom razmatrali ovaj zakon i kao Parlamentarna grupa za integraciju podržaćemo ovaj zakon s obzirom da ga smatramo važnim. Samo bih principijelno napomenuo da Nacrt zakona o izmenama i dopuna Zakona o trgovačkim društvima zaista određuje jedan važan dio koji se odnosi na poslovnost i trgovinu ukupnog društva na Kosovu s obzirom da nam je svima veoma važno da povećamo ukupnu efikasnost kosovskog društva, da pospješimo poduzetništvo na svakom nivou. Naravno, uzimajući u obzir i ove dileme koje postoje vezane za razlike pojedinca privatnika ili poslovnih, odnosno privatnih društava i sva moguća rješenja koja trebaju biti najbolja i najefikasnija, a takođe imajući u vidu da zaista trebamo težiti da ta pitanja ne samo da budu doneta na zakonu, nego da najpre budu jasno u zakonskim određenjima ali i primenjiva u svakodnevnoj praksi, a sve s krajnim i završnim ciljem da povećaju trgovačku poslovnost bilo pojedinaca, bilo poslovnih firmi i da ukupno povećaju društveno blagostanje na Kosovu. To je naš prilog. Hvala vam lepo!

KRYESUESI: Faleminderit! Fillojmë me diskutimet e deputetëve. Deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht që Projektligji është i domosdoshëm, sepse ligji aktual nuk ka qenë i mundur të zbatohet mu pikërisht që janë lëshuar disa gabime të cilat do të duhej të përmirësohen dhe me qëllim që të mos e lejojmë prapë Projektligjin të shkojë me gabime të tilla, unë e mora që t'i diskutoj nga 3-4 çështje të cilat duhet t'i kemi kujdes në komisionin funksional, se e pash që nuk e tha dikush nga komisioni funksional.

Së pari, konsideroj që në nenin 2, në përkufizimin, në paragrafin 3, ku shkruan – thotë: në tërë tekstin e ligjit, shkurtesa “SHKM” shoqëri komandite zëvendësohet me shkurtesën SHKM – shoqëri komandite. Nuk e di, ndoshta vetëm pikat që i ka bërë, mirëpo realisht kjo nuk i ndihmon kurrëgjë në përmbajtje projektligjit. Ka qenë dashur të sqarohet shumë qartë.

E njëjta vërejtje është prapë në nenin 4. Tani në tërë tekstin e Ligjit shkurtesa “SHPK” që ka qenë në thonjëza, thotë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, zëvendësohet me shkurtesën “SHPK”. Prandaj, domosdo duhet komisioni funksional të bëjë amendamente dhe kur po bëjmë amendamente, nuk po i bëjmë edhe ne nganjëherë si duhet, mirëpo edhe ju duhet të keni më kujdes sepse kurrëgjë s'keni ndryshuar në këto dy paragrafe që i përmenda. Vetëm i keni shkruar dhe i keni vendosur si paragrafe.

Të njëjtat situata na ndodhën edhe pak më parë në diskutim, unë nuk desha ta marrë fjalën se disa nga deputetët që ajo mbetet në transkripto, e përziën Ligjin me riatdhesim dhe Ligjin për ripranim, që janë dy çështje plotësisht të ndryshme. Riatdhesimi me ripranimin janë plotësisht të ndryshme.

Unë do të doja të veçoja edhe një aspekt tepër përmbajtjesor. Është çështja në nenin 4, në paragrafin 3. Është e vërtetë që keni bërë një paragraf të mirë, mirëpo në fund për dënimet kundërvajtëse keni kërkuar që ju si ministër të nxirrni një akt nënligjor e t'i rregulloni. Unë vetëm po ju vë në dijeni. Kjo po na ndodh në Parlament që të gjitha projektligjet që po vinë, po parashohin dënime kundërvajtëse dhe kjo po bie ndesh me Ligjin për kundërvajtje. Ne mund të parashohim dënime, por të cilat duhet t'i zbatojë në aspektin administrativ ministria apo institucionet përkatëse. Sapo e kam marrë një letër prej kryetarit të Gjykatës së Lartë për

Kundërvajtje, që ka plotësisht të drejtë, diku nga 20 ligje – 20 ligje duhet të plotësohen dhe të ndryshohen pikërisht për atë që kemi vendosur dënimet kundërvajtëse. Ne nuk mund të parashohim në këtë ligj, ne mund të parashohim kundërvajtjen, por nuk mund të parashohim dënimet, sepse mandej bie ndesh me Ligjin bazik për kundërvajtje. Prandaj, është mirë që në këto raste të lihen dënimet, por ajo procedura e parë duhet të jetë procedurë administrative, sikur që është Autoriteti tatimor i Kosovës, që i shqipton dënimet. Do të thotë, të mos ndodhë situatë që mandej, që unë besoj se po ta kishim lëshuar edhe këtë ligj, prapë do të bie ndesh me Ligjin bazik për kundërvajtje dhe ju e dini që shpejt do ta kemi rastin për nga 20 ligje pikërisht të fushës, kjo që e përmendi, kanë për të ardhur përfundim dhe ndryshim sepse kanë hasur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

Dhe, krejt në fund, e falënderoj ministrin që na e dha sqarimin për dispozitën përfundimtare për t'i shfuqizuar rregulloret e UNMIK-ut, sepse nuk e di edhe kjo si ka kaluar atëherë pa i shfuqizuar ato rregullore, sepse mu pikërisht ajo ka qenë pengesa kryesore për moszbatim të ligjit.

Unë ju falënderoj dhe natyrisht se e përkrah projektligjin në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zef Morina e ka fjalën!

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në parim do të duhej të mbështetej, edhe pse shumica e normave që kanë të bëjnë me plotësim-ndryshimin e ligjit janë të natyrës formale juridike, pa prekur përmbajtjen. Ndryshimi përmbajtësor është kryesisht në nenin 4 të Projektligjit, që ka të bëjë me shkurtimin e afatit në parim për të gjitha rastet nga 60 ditë në 30 dhe nga 30 në 10 ditë. Vlerësoj se është në favor të azhuritetit të procedurave lidhur me biznesin, por ndoshta do ishte e preferueshme që të ceket për secilin rast ngase në parim shkurtimi i afatit sikurse është propozuar për të gjitha rastet, ndodh që në ndonjë rast do të ketë efekt të kundërt. Heqja e taksës për regjistrimin e biznesit, neni 5 paragrafi 4.1 është pozitive dhe në favor të biznesit, por ndoshta do të duhej të hiqet taksa edhe për shërbimet tjera. Domethënë, 4.2 e cila ka mbetur që ministria me akt nënligjor të caktojë taksat sipas vlerësimit të saj. Mendoj se heqja e të gjitha taksave, pa marrë parasysh shërbimin, janë në shërbim të zhvillimit dhe stimulimit të biznesit. Arsye tjetër është ngase përmes taksave për shërbimet tjera me akt nënligjor lihet mundësia e ngarkimit me taksa tjera me qëllim të kompensimit në mënyrë indirekte të lirimit nga taksat e regjistrimit të biznesit.

Vërejtje tjetër është edhe në nenin 4 paragrafi 4 dhe 5. Ushtrimi i biznesit para regjistrimit kualifikohet si kundërvajtje, ndërsa gjobat për këtë shkelje duhet t'i përcaktojë ministria me një akt nënligjor. Kualifikimi i shkeljes si kundërvajtje në këtë rast, mendoj se është i butë dhe për këtë shkelje që bëhet me vetëdije do të duhej të kualifikohet si një vepër penale, ndërsa caktimi i gjobave për kundërvajtje është rregull dhe gjithsesi do të duhej të përcaktohet me ligj e jo me akt nënligjor.

Kam edhe disa vërejtje tjera konkrete, të cilat gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit do të kemi mundësi t'i procedojmë ose rregullojmë. Në parim, e mbështes dhe propozoj që procedurat në shqyrtim të mëtejme të kalojnë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E merr fjalën zonja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare paraqet një ligj të rëndësishëm për sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj iu janë përshtatur rrethanave të reja të krijuara aktualisht në Kosovë. Me anë të këtij ligji janë propozuar ndryshime konkrete që kanë të bëjnë me përcaktimin e llojeve të organizimit të bizneseve që ushtrojnë aktivitet biznesi në Kosovë, përcaktimin e strukturës, të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, krijimin e dispozitave ligjore që lehtësojnë funksionimin e organizatave të biznesit dhe procesin e regjistrimit të tyre.

Projektligji i propozuar në mënyrë taksative cakton parimet dhe procedurat konkrete me qëllim të përmirësimit të funksionimit të shoqërive tregtare në vend.

Me anë të këtij projektligji të propozuar më konkretisht ndryshohen afatet. Afati i paraparë në nenin 19 për 5 vite për ruajtjen e të dhënave dhe të dokumenteve në letër ndryshohet në 1 vit, ndërsa në nenin 14 paragrafi 14 afati prej 10 deri në 60 ditësh ndryshon dhe zëvendësohet me afatin prej 3 deri në 30 ditë.

Ndryshimet tjera i referohen shumës së gjobave, kështu që gjoba në shumë prej 25.000 euro, e paraparë në nenin 127 zëvendësohet në shumën prej 10.000 euro, kurse shuma prej 22.500 euro, e paraparë në nenin 153, zëvendësohet në shumën prej 10.000 eurove. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen dy rregullore të UNMIK-ut numër 2008/26 dhe 2001/6 që e kanë rregulluar lëmin e shoqërive tregtare në Kosovë gjer më tani.

Është me rëndësi të theksohet se këto ndryshime të bëra duhet të jenë më komplete në aspektin e teknikës juridike të dispozitave të Ligjit numër 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nene të cilat duhet riformuluar më mirë me qëllim të zbatimit më të mirë në praktikë, konkretisht të nenit 1, 5, 6 dhe 7. Unë pajtohem me kolegun, i cili paraprakisht theksoi se këto ndryshime nuk janë ndryshime thelbësore, prandaj duhet të korrigjohet në procesin e amendamentimit të ligjit të cilin jemi duke e shqyrtuar.

Duke marrë parasysh rëndësinë e ndryshimeve të propozuara në lëmin e shoqërive tregtare, si dhe rëndësinë e veçantë që ka Ligji për shoqëritë tregtare për ekonominë e tregut për rrethanat aktuale në Kosovë, e mbështes Projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tim profesional do ta paraqes në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Dauti! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit për fjalë!

Përsëritje!

Unë do të shkoj drejtpërdrejt me disa vërejtje. Mirë është që është amendamentuar Ligji për shoqëritë tregtare, iu bën lehtësime bizneseve dhe procedurave për regjistrimin e bizneseve, por megjithatë disa prej vërejtjeve të mira që janë, janë për shembull në nenin 6, paragrafi 11. Nëse certifikata nuk është në gjuhën shqipe, serbe apo angleze, propozoj që të qitet një presje, se presja ia ndërron mendimin, ia ndërron mendimin presja edhe Rregullores së Kuvendit me atë sloganin shumë të njohur – mëso si baba, magar mos u bë! Varet ku e qet presjen dhe ia jep kuptimin. Edhe këtë po dua t’ia cek Kryesisë së Kuvendit, se s’kanë të drejtë ta shkurtojnë diskutimin e Kuvendit prej 10 minutave në 5 minuta, por ndoshta trajtohen... Presjen e kanë qitur në vend të keq. Nëse certifikata nuk është në gjuhën shqipe,

serbe apo malazeze, apo angleze, pa presje kurrkund, s'bën kuptim kjo fjali. Ndoshta me ndonjë vizë në mes kishte bërë kuptim. Në rregull, aty është evidente se shpesh nuk i kushtojmë kujdes gjuhës shqipe kur të shkruajmë.

Gjithashtu, në nenin 5, paragrafi 1, Agjencioni e bën regjistrimin e ndërmarrjeve publike... Regjistrimi i ndërmarrjeve shoqërore të korporatizuara bëhet konform dispozitave të këtij ligji. Mirë kishte qenë të definohet edhe cilat janë ndërmarrjet shoqërore. Nëse është sipas kuptimit të Ligjit mbi Agjencionin Kosovar të Privatizimit, të ceket dhe të kihet parasysh se këtu kemi një dinamizëm, me fjalë të tjera ka lëvizje dhe ligji mbetet, kurse ai sektor mund të..., dinamika e bën që mund të ndryshohet me kohë, kështu që është sugjerim i drejtpërdrejtë.

Gjithashtu, në nenin 5, paragrafi 2.5, mirë kishte për të qenë të jetë i saktë se cila është gjykata kompetente.

Dhe, gjithashtu, propozoj që të vendoset një amendament, sepse në Ligjin për shoqëritë tregtare – ligji që ne po e amendantojmë, në pjesën VI, kur flitet për shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, Kreu I, dispozitat e përgjithshme, është e cekur se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është person juridik, që është juridikisht e ndarë dhe e dallueshme nga pronarët. Mirë kishte për të qenë të vendoset ndonjë amendament, që të bëhet e shpjegueshme, që mos të lihet, për shembull, ministri i Ekonomisë dhe Financave, kur ne i ngritshim shqetësimet tona për ndryshimin e kontratave Dardafon – Dardafon.net të jenë shumë të saktë, të veprojnë konform ligjit, të dinë që ka dallim shumë të madh në mes personit juridik dhe pronarëve të një shoqërie aksionare. Kjo kishte për ta bërë më kuptimplotë më pastaj ligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka!

RIZA SMAKA: Të nderuar kryesues, ministra – Zarku, Shala!
Deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore. Në nenin 2, paragrafi 5 në Projektligjin për shoqëritë tregtare është theksuar se në tërë tekstin LSHT-ja, fjala kompani, zëvendësohet me fjalën korporatë, por nuk është definuar saktë as drejt, as termi korporatë, as kompani. Ndryshe, termi kompani korrespondon me termin shoqëri, ndërsa termi korporatë me nocionin e përgjithshëm referuar organizatave biznesore, të cilat mund të jenë entitete legale biznesore në formë të shoqërive aksionare me përgjegjësi të kufizuar apo të pakufizuar, si dhe të shoqërive aksionare komanditare. Aq më parë, kur ky projektligj iu referohet shoqërive aksionare, por shprehimisht jo edhe korporatave. Madje, titulli i po këtij projektligji konsiston në statusin juridik të shoqërive tregtare, por jo edhe të korporatave.

Në nenin 4 të këtij projektligji, me vend është ofruar zgjidhje juridike më e mirë nga ajo e mëparshme, referuar afateve prekluzive ligjore me të shkurtra, të cilat si të tilla janë konform me praktikën dhe standardet juridike të mira dhe për aq janë konfirmuar në praktikën juridike si më të përshtatshme dhe më në funksion të efikasitetit dhe të eficiencës dhe të ligjshmërisë.

Në nenin 3, paragrafi 3, të Projektligjit për shoqëritë tregtare, për derisa është propozuar riformulimi i statusit juridik të shoqërive tregtare, termi “person juridik” i përdorur aty si i tillë, nuk aplikohet kurdoherë, por përkundrazi, herë ashtu e herë “entitet legal” apo “entitet juridik”.

Për derisa organi individual gjatë vendosjes së çështjeve juridike administrative në procedurë ankimore duhet të miratonte aktvendime, ndërsa organi kolegjial të njëjtin funksion do të duhej ta ushtronte me vendime, me dispozitën e nenit 3, paragrafi 2, alineja 2, nuk është përfillur kjo rregull, por gabimisht akti administrativ i organit individual, në vend të termit “aktvendim” është definuar “vendim”. Është edhe me rëndësi substanciale, sepse kundër vendimit nuk lejohet mjeti juridik i rregullt dhe aq më pak i jashtëzakonshëm, ndërsa kundër aktvendimit po, sepse aktvendimi duhet ta ketë edhe preambulën, edhe diapozitivin, edhe arsyetimin, edhe udhëzimin juridik, ndërsa vendimi nuk kërkohet t’i ketë ato, vetëm petitumin.

Në nenin 3, paragrafi 2, alineja 3 të po këtij projektligji për derisa theksohet se Komisioni për Parashtresa dhe Ankesa, edhe ankesat janë parashtresa, se ankesa është parashtresë, është i autorizuar për shqyrtim të ankesave. Në praktikën juridike do të rezultonte konkluzioni se po ai komision do të kishte autorizim që vetëm nëpërmjet shqyrtimit të ankesave mos të vendoste sipas tyre ose ai organ nuk do të kishte autorizim për vendosje meritore të çështjeve administrative. Do të thotë, do të mund të justifikohet, po zëmë, po e marr një ekstreme – e kemi shqyrtuar çështjen, por nuk e kemi vendosur, e kemi kryer misionin ligjor, ama poenta është që shqyrtimi është çështje paraprake, ta vendos drejtë, ligjshëm çështjen juridike administrative, jo shqyrtimi është, si të themi, një çështje paraprake apo një proces i shkurt i vendosjes.

Rrjedhimisht, kur me nenin 3, paragrafi 2, alineja 3, të këtij projektligji, parashtuesi i ankesës, i pakënaqur me trajtimin juridik, është orientuar në “gjykatën kompetente”, esencialisht në atë mënyrë është ç’orientuar madje krejtësisht, sepse pala në procedurë zakonisht është laike. Madje, si e tillë, konsiderohet me akte ligjore procedurore në kompleksin e gjykatave të niveleve dhe të roleve difference, përfundimisht nuk do të mund të konsolidohet, të mos themi të (riorientohej). Së andejmi, termat, fjalët dhe definimet e tilla të padefinuara, jo vetëm në këtë rast, do të duhej të zëvendësoheshin me shprehje të plota, të qarta dhe konkrete, aq më parë kur kemi sistemin gjyqësor mjaft problematik dhe ndodhet para një riformimi që shprehja e tillë me të vërtetë në start, apriori duhet ta ç’orientonte palën, jo do ta orientonte. Është obligim themelor që palës në procedurë t’i ndihmohet.

Përfundimisht, për derisa me Ligjin 02/L-123 për shoqëritë tregtare nuk është precizuar autoriteti publik i autorizuar për caktimin e sanksioneve për shkeljen e atij ligji, ishte dashur që së paku me këtë projektligj të definohej ai autoritet i cili edhe në këtë rast është lëshuar dhe për aq nëse nuk do të përmirësohej në procedurë kuvendare, do të problematizohet implementimi i masave ligjore kundër shkelësve të tij.

Përfundimisht, kam kënaqësinë që t’i shpreh mbështetje MTI-së dhe ministrit të nderuar Zharku për punën e bërë, për përgatitjen e këtij dokumenti që është i nevojshëm për t’u miratuar dhe për ta përmirësuar Ligjin në fuqi në funksion të implementimit efikas. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E përshëndes edhe këtë ligj dhe praktikën e ndryshimeve në ligjet në legjislacionin ekzistues, por mendoj që disa ndryshime janë të domosdoshme. Së pari, tekste si ky për ndryshimin e ligjeve ekzistuese, mendoj që duhet të shoqërohen edhe me tekstin që ndryshohet, sepse jam i

bindur se shumica e deputetëve qysh tash janë në konfuzion çka po ndryshojmë dhe si duket pjesa e ndryshuar e ligjit.

Vërejtja e dytë ka të bëjë rekomandimet e Agjencionit për Zhvillim dhe Integrim Evropian, të cilat, sa shoh këtu, nuk janë përfshirë. Një nga rekomandimet është harmonizimi i gjuhësorit të terminologjisë dhe unë druaj që marr shumë kohë, por vërtet është një rrëmuje e tërë terminologjike, zoti ministër. Në titull, në shqip është “shoqëri”, në anglisht është “kompani” Me një nen të veçantë kërkohet që gjithkund shprehja “kompani” të zëvendësohet me “korporatë”. Të gjithë e dimë, edhe ne që nuk jemi profesionistë në këtë fushë që kompani dhe korporatë nuk është e njëjta gjë. Për më tepër, në tekst pastaj e gjejmë përsëri shprehjen “shoqëri”. Në gjuhën serbe, madje edhe kur është ndryshuar, diku “preduzeće” që nuk shkojnë në asnjë mënyrë. Ligji duhet të zbatohet në të gjitha gjuhët njëjtë. Edhe disa ndryshime që janë bërë në terminologji, as nuk janë konsistente dhe nuk duken të bindshme.

Dhe për të kursyer kohën, nuk po marr shembuj, por shikoni si duken dy-tri nenet që janë ndryshuar rreth terminologjisë dhe do të shihni se është e domosdoshme një harmonizim i tërë gjuhësor. Nuk lidhen ndoshta drejtpërdrejt me ligjin që po e shqyrtojmë, por është rasti ndoshta për të shprehur një shqetësim të përgjithshëm çka po ndodh me shoqëritë tregtare dhe me pronësinë e tyre. Çka po ndodhë, për shembull, me Tregtinë e Kosovës dhe pronën e saj, me “Eximkosin” e tjera. Nuk pres tash përgjigje, por ligjet si këto do të duhej të kishin synim edhe vënien në rregull, rregullimin me ligj edhe të çështjeve të hapura, siç janë këtu që i theksova. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Lus regjinë që t’i thërrasë deputetët për votim, para se ta marrë fjalën deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Të nderuar qytetarë të Kosovës, unë e shfrytëzoj rastin t’i përshëndes miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët më kanë dhënë përkrahje të pa rezervë ta marrë fjalën sot këtu dhe të cilët kanë bërë aq shumë për lirinë të cilën e gëzojmë sot, andaj unë i përshëndes në mënyrë të veçantë.

Të nderuar të pranishëm,

Unë paraprakisht të deklarohem se e përkrah këtë Ligj, sepse këto ndryshime janë përmirësime ashtu siç u tha, por megjithatë mendoj se është koha që, edhe u prekën këtu nga shumë deputetë, se është koha që të standardizojmë terminologjinë sepse standardizimi tregon profesionalizëm, tregon seriozitet. Ne duhet më në fund të vendosim se cilën terminologji, të cilin ligj do ta përqafojmë, atë kontinental të Evropës, atë britanik dhe të Komonuelthit apo të Amerikës Veriore, sepse këtu te terminologjia shihet se është një koktej i fjalëve të cilat shpeshherë po them, lexuesin profesional e argëtojnë, them kështu, mos te përdori ndonjë fjalë tjetër.

Duke filluar, po them, nga neni 2, këtu është një ndryshim, pra kemi ortakëri të përgjithshme, kemi shoqëri komandite dhe ne duhet të vendosim se a do ta përdorim shoqërinë si termë të Evropës Kontinentale, pra që në gjuhën frëngjishte është societe apo gesellschaft, në gjuhën gjermane apo societa në italishte dhe gjithë rajoni e ka “društvo” apo do të përdorin diku terminologjinë britanike dhe të Komonvelthit, e diku tjetër terminologjinë e Amerikës Veriore. Ne ose duhet t’i themi shoqëri komandite e përgjithshme dhe shoqëri komandite e kufizuar, e jo ortakëri e përgjithshme, sepse ose ke Société en commandite ose Kommanditgesellschaft apo Società in accomandita semplice në italishte, që në serbokroatishte e ke komanditno drushtvo e kështu me radhë, gjersa në gjuhën angleze e ke Partnership, limited partnership apo forma tjera të ortakërisë që t’i përkthejmë në gjuhën shqipe.

Ngjashëm do të ishte edhe te ndërmarrja ose kemi ndërmarrje ENTERPRIS, gjithmonë flas në vokabularin juridik, sepse në vokabularin e përditshëm afarist mund t'i përdorim cilëndo gjuhë, cilindo term, secili folës për çfarëdo çështje që flet ose do të kemi ndërmarrje ose do të kemi kompani ose do të kemi korporatë.

Dallimi në mes kompanisë dhe korporatës është se në Britani ke Copmany Law dhe rrjedhimisht ke kompani. Në SHBA-a, por edhe në Amerikën Veriore ke Coropration Law dhe rrjedhimisht ke korporatë. Pra, është një gjë, por juridikisht e ndajmë. Në shumë shtete të Amerikës, nuk mund t'i regjistrosh kompanitë, por duhet të regjistrosh korporatën. Domethënë, ose do të kemi entepreise dhe societe apo gasellshaft, pra ndërmarrje ose duhet të kemi kompani, e jo diku diku kompani me përgjegjësi të kufizuara. Por, do të ketë ose ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuara, pra societe a risposibilite limite ose do të kemi limited liability company. Po them edhe një herë, terminologjia është koha e fundit që ta përdorim ose ta përqafojmë ligjin kontinental ose atë të Ujdhesës apo të Amerikës Veriore, e mos t'i përziejmë se, sinqerisht, nuk po tregojmë seriozitet profesional, po mendoj.

Po ashtu, këtu u prek ndërmarrja publike dhe shoqërore dhe shtetërore. A di dikush mirë të na shpjegojë çka është ndërmarrja publike, çka e dallon ndërmarrjen publike prej asaj shtetërore apo ndërmarrjen publike prej asaj shoqërore. Ne e dimë se në ish sistemin komunist kemi pasur ndrmarrje shoqërore, nuk kemi pasur ndërmarrje shtetërore, por ato kanë qenë një edhe tash çka është dallimi, është ngatërruar ajo, Public Utilities do të thotë këto ndërmarrje për utilitet publik, siç është Ujësjellësi e tjera e tjera dhe ndërmarrjet tjera shtetërore. Mendoj se duhet ta kemi parasysh terminologjinë. Përndryshe, po them, ka përparime ky ligj, sidomos në regjistrimin e kompanisë apo të ndërmarrjes. Ne kemi ngatërruar, nuk po dimë si t'i adresohemi. Pastaj, e kemi edhe këtë ndërmarrjen individuale, biznes individual. Unë nuk di pse është ndryshuar ose ke ndërmarrje individuale ose atëherë do t'i ndërrojmë për shkak se dallimi në mes ndërmarrjes individuale dhe atyre të tjerave është se aksionari, si në rastin e Dardafonit, me ndërmarrje nuk ndahet, por janë një. Përndryshe, te shoqëritë tjera ndërmarrja është e ndarë nga aksionarët apo është personi i pavarur juridik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka më diskutues. Unë e thërras regjinë dhe deputetët, bëhuni gati për votim. Në sallë kemi 62 deputetë. Votojmë për ligjin. Votojmë tash:

Kemi 62 vota “për” asnjë “kundër”, asnjë abstenim. Kemi miratuar në parim këtë projektligj.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon për këtë ligj këto komisione:

1. Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, që është komision funksional,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete, dhe
5. Komisionin për Integrime Evropiane

Me detyrimin dhe detyrën që Kuvendit t'ia paraqesin raportet më së largu për dy muaj.

Pika e dhjetë:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotëri Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, ta paraqesë këtë ligj para deputetëve.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar anëtar të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush tani të paraqes Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili pothuaj se është harmonizuar në tërësi edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe është pjesë e paketës së programit për të cilin dje në parim u dakorduam me ta, me një ndryshim të vogël i cili besoj se do shqyrtohet gjatë Komisionit në nenin 40, pika 2.4.

Më lejoni që në pika të shkurtra të paraqes përmbajtjen e këtij ligji, ndryshimet karshi ligjit të kaluar dhe avancimet që ka pësuar ky ligj. Bashkë me bashkë-hartuesit e këtij ligji, ka qenë Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe në harmoni të plotë, përkatësisht me asistenten e Fondit Monetar Ndërkombëtar, që konsideroj se është një koordinim mjaft i mirë me të gjitha institucionet e rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare.

Projektligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, e shfuqizon, pra pas momentit të aprovimit nga ana e juaj besoj, Ligjin aktual për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nr. 03-L/074-2008, që tani është në fuqi dhe që ka qenë i rregulluar faktikisht gjatë fazës së tranzicionit, pas shpalljes së pavarësisë.

Nevoja për të përforcuar këtë institucion dhe nevoja për të përparuar në legjislacionin e këtij institucioni shumë të rëndësishëm për stabilitetin financiar dhe ekonomik të Kosovës, ka bërë që ky ligj të harmonizohet edhe me Bankën Qendrore të Komisionit të Unionit Evropian, pra sistemin evropian të Bankës Qendrore dhe është në harmoni të plotë me Traktatin e Komisionit Evropian si dhe Statutin e sistemit Evropian të bankave qendrore.

Qëllimi parësor i hartimit të këtij ligji është përfshirja e të gjitha elementeve të nevojshme të legjislacionit modern rreth funksionimit dhe organizimit të institucionit të Bankës Qendrore. Ky projektligj do të ndikojë në forcimin e mëtejshëm të rolit, rëndësisë dhe përgjegjësisë së Bankës Qendrore në arritjen e ruajtjes së stabilitetit të sektorit financiar dhe në krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen edhe të ligjeve të tjera nga lëmi i sistemit financiar dhe atij bankar në përgjithësi.

Në këtë mënyrë, konsideroj krijohen kushte esenciale për të kompletuar kornizën ligjore për ndërtimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori si dhe do të ndihmojë në qëndrueshmërinë e stabilitetit të Kosovës. Natyrisht, kjo gjë për ekonominë e vendit tonë është e një rëndësie të veçantë. Çështje të cilat janë adresuar në këtë ligj, janë që objektivat, që Banka Qendrore e Kosovës, në nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit të sektorit financiar, në kontributin e arritjes së ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, në mbështetjen e politikave të përgjithshme ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe detyrat që duhet të kryhen nga Banka Qendrore, në detyrim të përmbushjeve të objektivave në ruajtjen e sistemit me bankat komerciale.

Me këtë ligj, gjithashtu për herë të parë do të rregullohen çështjet e rëndësishme që nuk kanë qenë të rregulluara me ligjin paraprak, siç janë: çështja e ofrimit të likuiditetit për banka në rrethana emergjente, pra për banka komerciale, menaxhimi i rezervave dhe i borxhit publik, funksioni i agjentit fiskal është definuar në mënyrë më të saktë dhe në harmoni me standardet më të reja të bankave qendrore, në harmoni me Bankën Qendrore të Komisionit Evropian, rregullimi i qeverisjes së Bankës në pajtim me praktikat më të mira të vendeve në tranzicion, si dhe shumë elemente të tjera: zgjedhja e bordit, shkarkimi i anëtarëve të Bordit e guvernatorit, elemente të cilat konsideroj që kanë sjell një rregullim më të mirë të këtij institucioni.

Po ashtu, konsideroj se përkundër vështirësive dhe pengesave të shumta që ka ekonomia e Kosovës, politikat ekonomike të Qeverisë janë të ndërtuara mbi prioritet kryesore dhe fuqizimi i këtij ligji, përmirësimi i këtij ligji, të këtij sistemi ndikon edhe në rritjen e reputacionit të Republikës së Kosovës në qarqe të rëndësishme ndërkombëtare. Ligji në përgjithësi ka 16 kapituj dhe 81 nene dhe i ka përmbushur të gjitha kushtet për t'u aprovuar dhe unë do të jem shumë i hapur që bashkë me ju, t'i shikojë disa nga elementet të cilat mbase do të ngritën këtu. Një dakordim në parim me Fondin Monetar është që neni 40 pika 2.4 të hiqet nga propozimi dhe do t'ju kisha lutur mirëkuptimin e juaj, në mënyrë që të jemi komplet në pajtueshmëri me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me praktikat më të mira të Komisionit Evropian, të Bankës Qendrore Evropiane dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Është ky edhe parakusht faktikisht i nënshkrimit të programit, andaj, do t'iu kisha thirrur për mirëkuptimin tuaj. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci.,

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne e kemi para veti Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe në memorandum shpjegues janë thënë të gjitha edhe arsyeshmëria dhe qëllimet edhe funksioni që do t'i ketë si autoritet rregullativ në sferën financiare dhe si një institucion qendror financiar në Kosovë. Ministri veç i përmendi të gjitha ato që do të duhej të thuheshin, sepse është një përafrim me Traktatin e Komisionit Evropian dhe Statusin e Sistemit evropian të bankave qendrore, që pretendojmë një ditë të jemi pjesë e këtij institucioni dhe besoj shumë shpejt. Ajo që dua të them, për dallim nga ligji i mëparshëm, megjithatë ky më tepër i është përafëruar një ambienti po them zhvillimor të Kosovës dhe duke pasur parasysh rrethanat dhe kushtet dhe tregun ta quaj financiar në Kosovë, dhe Bankës Qendrore i janë shtuar edhe disa funksione që nuk i ka pasur deri më tani, sidomos në menaxhimin e letrave me vlerë mbi bazë të Ligjit për borxhet publike. Ajo e veçanta që ishte, e përmendi ministri, rreth mënyrës ose ta them asaj strukturës organizative, skemës organizative edhe funksionale të bankës, mendoj që në këtë kapitull, kemi nevojë që të diskutojmë akoma, sepse këtu duhet parë edhe roli i Kuvendit në raport me Bankën Qendrore, përveç i asaj Qeverisë, sidomos në mënyrën e përzgjedhjes dhe të shkarkimit të atyre që menaxhojnë me Bankën Qendrore, sepse ka një parim gjithkund që mënyra e përzgjedhjes ose procedurat e përzgjedhjes të njerëzve, në krye të Bankës atje, duhet të jenë të njëjta me mënyrat e shkarkimit dhe këtu ka një mospërputhshmëri të duhur ... Në Projektligj nuk janë përcaktuar shumë qartë kompetencat e Bordit, që quhet Bord i Bankës, Bordi ekzekutiv i bankës dhe të guvernatorit në këtë rast dhe të zëvendës guvernatorëve. Dhe, në këtë drejtim, unë mendoj që ligji duhet të jetë pak më fleksibil dhe nuk duhet të shkojë me sistemet e mbyllura, por të jenë sisteme të hapura varësisht nga zhvillimet në sferën dhe në sektorin financiar. Dhe në këtë drejtim besoj se bashkërisht me autoritetet që i përmendi edhe ministri edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që ka qenë pjesë e hartimit të këtij projektligji edhe me Bankën Qendrore, por

edhe me Ministrinë e Ekonomisë edhe Financave, do t'i harmonizojmë këto çështje. Dhe mendoj që në këtë drejtim do të duhej të kemi një bashkëpunim, sepse kështu, zgjidhjet që janë ofruar në këtë projektligj, më duket që janë një hap mbrapa nga ligji që e kemi pasur deri më tani, sidomos në përzgjedhjen, emërimin e njerëzve që udhëheqin me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Përndryshe, si tërësi ligji është i mirë dhe duhet të miratohet dhe në kuadër të saj, duhet të them që për të përmbyllur kuadrin ligjor që e mbulon sferën financiare, do të duhej që sa më shpejt dhe besoj është në agjendën edhe të Qeverisë, që ta kemi Ligjin për bankat komerciale, pastaj Ligjin për sigurime dhe sigurimet e detyrueshme, sidomos për sigurimet e detyrueshme, sepse ju e dini cilat probleme qytetarët tanë kanë në këtë drejtim. Pastaj, Ligjin për sigurimin e depozitave dhe meqë me këtë ligj mbulohet një pjesë e asaj që quhet letra me vlerë, do të duhej të rishikohej edhe arsyeshmëria e sjelljes të një ligji të veçantë lidhur me letrat me vlerë, emetimin, përdorimin dhe qarkullimi e tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Para se të vazhdojmë, unë dua teknikëve këtu edhe ju deputetëve t'ju them, 72 kartela janë nëpër banka. Unë ju lus që t'i mbledhin të gjitha këto të njerëzve që nuk janë këtu dhe hera e parë dhe e fundit, të mos ndodhë më kjo. Mblidhni ato kartela të njerëzve që nuk janë këtu. Unë e pashë njërin që e preku një, mos i merrni të huajat. Ata që janë, janë, ata që nuk janë, s'janë. Unë dua që të gjitha kartelat e njerëzve që nuk janë këtu, mos të jenë aty.

Vazhdojmë me punën. Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet të nderuar deputetë,

Ne sot kemi në shqyrtim Projektligjin për Bankën Qendrore. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e ka vlerësuar si projektligj i cili është hartuar mirë dhe duhet vlerësuar dhe duhet përkrahur. Ajo çka është me rëndësi është të thuhet se duhet përsëritet puna e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, e cila është në përmbyllje e sipër të planit legjislativ të paraparë për këtë vit, e sidomos është për t'u vlerësuar puna në hartimin e ligjeve që kanë të bëjnë me rregullimi e sektorit financiar.

Deri më tani, ne i kemi pasur disa rregullore që e kanë rregulluar këtë problematikë, mirëpo Kosovës i kanë munguar shumë ligjet që kanë rregulluar sferën e sistemit financiar. Prandaj, po bëhet mirë që po fillohet me Projektligjin për Bankën Qendrore, i cili mandej iu paraprinë ligjeve tjera të cilat e sigurojnë e rregullojnë sferën e sistemit financiar në Kosovë.

Në këtë projektligj, në njëfarë mënyre rritet roli dhe përgjegjësia e Bankës Qendrore në ruajtjen e stabilitetit të sektorit financiar. Në përgjithësi projektligji i përmban të gjitha elementet e nevojshme të një legjislacioni në përputhje me Traktatin e Komisionit Evropian, si dhe është në harmoni me sistemin evropian të Bankës Qendrore. Projektligji, i cili na është ofruar, është pra në harmoni me standardet evropiane dhe në këtë projektligj krijohen bazat që Banka Qendrore të jetë pjesë e sistemit evropian të Bankës Qendrore dhe pjesë e Bankës Qendrore Evropiane, i cili është edhe synimi kryesor i yni që sa më shpejtë të jemi pjesë e këtyre institucioneve të rëndësishme evropiane.

Në projektligj është përcaktuar apo është rregulluar mënyra e zgjedhjes së bordit të drejtorëve, bordit ekzekutiv, mënyra e dhënies apo e... të licencave për bankat, si dhe metodat e intervenimit në raste emergjente, ku ndonjë bankë komerciale mund të ketë vështirësi. Në përgjithësi, me këtë ligj janë shtuar edhe disa çështje tjera të cilat i përmendi kryetari i

Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të cilat nuk dua t'i theksoj, siç është çështja te letrat me vlerë e disa çështje tjera të cilat janë përgjegjësi të shtuara të Bankës Qendrore, të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e sektorit financiar.

Po ashtu ne kemi disa vërejtje në nenin 34, pika 1 që ka të bëjë me përmirësimin, me mënyrën e përmirësimit të përcaktimit të saktë se kush e përbën bordin e Bankës Qendrore. Aty është, theksohet se zgjedhën edhe tre anëtarë jo ekzekutiv. Ndoshta është mirë që në këtë pikë të përcaktohen se si mund të bëhet përzgjedhja e këtyre tre anëtarëve dhe, ndoshta në këtë pikë të përcaktohet saktësisht, se përpos guvernatorit dhe një përfaqësuesi të Thesarit se kush saktësisht është, janë këta anëtarët tjerë jo ekzekutiv.

Në nenin 35, që ka të bëjë me kompetencat dhe detyrat e Bordit, ndoshta është mirë që të intervenohet edhe aty, disa detyra të qartësohen më mirë dhe disa kompetenca.

Në nenin 38, që ka të bëjë me emërimet, mbetet shumë për t'u bërë në Kuvend dhe sidomos në Komisionin funksional, që të shikohen praktikat më të mira të vendeve tjera që emërimet të jenë në shërbim të efikasitetit dhe efektivitetit të Bankës Qendrore e jo në shërbim të individëve dhe njëkohësisht të ketë harmonizim në mes të mënyrës së emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore.

Në këtë projektligj, po ashtu është rregulluar mbikëqyrja dhe mënyra e licencimit të kompanive të sigurimeve dhe të skemave private pensionale, domethënë është rregulluar më mirë se sa ka qenë e rregulluar më parë, kështu që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah në parim Projektligjin për Bankën Qendrore, kurse kontributin e vet do ta japë përmes anëtarëve të saj në Komisionin funksional për t'i bërë amendamentimet e nevojshme të këtij projektligji, në mënyrë që të jetë sa më i mirë dhe sa më i implementueshëm në Kosovë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Para veti kemi një ligj të institucionit kryesor financiar, pra Ligjit të Bankës Qendrore, që ka një rëndësi të veçantë për arsye se kryen rolin rregullativ në tregjet financiare. Roli i saj është veçanërisht me rëndësinë në tregun e parasë, ku përcaktohet niveli i masës së parasë, lartësinë e normës të interesave si dhe ka rol të veçantë në mbrojtjen e pjesëmarrësve tjerë në tregun financiar.

Banka Qendrore, meqë emiton letrat me vlerë dhe kryen operacione në tregun e hapur, që me këtë kontribuon zhvillimin e tregut financiar. Banka Qendrore realizon funksionet e veta përmes instrumenteve rregulluese të politikës monetare kreditore, siç janë shkallat referuese të interesave, rezerva e obligueshme, përcaktimi i rezervës minimale të likuiditetit, blerja dhe shitja e letrave me vlerë, transaksionet e pagesave dhe përkufizimet e plasmanëve e tjera.

Banka Qendrore në vendin tonë në bazë të Kushtetutës, është institucioni i pavarur dhe autonom, unik, emitues i sistemit monetar të Republikës së Kosovës, përgjegjës për politikën monetare, stabilitetin e valutës, disiplinën financiare dhe kryerjen e punëve të tjera të rregulluara me ligj. Sipas përgjegjësisë, Banka Qendrore kryen edhe funksione të tjera: emitimin e parasë dhe kredisë, zhvillimin e masave të politikës kreditore monetare, mirëmbajtjen e solventitetit të jashtëm, kryerjen e punëve të caktuara të shtetit dhe punëve të tjera. Ligji mbi Bankën Qendrore, duhet të jetë në harmoni me traktatin e Këshillit të

Evropës dhe statutin e sistemit të bankave qendrore të Evropës, me të cilin përcaktohen objektivat dhe detyrat fundamentale të Bankës Qendrore.

Objektivat dhe detyrat e Bankës Qendrore me këtë projektligj nuk janë renditur dhe sistemuar sipas peshës dhe rëndësisë së tyre dhe nuk janë harmonizuar me politikat monetare, si dhe me masat dhe instrumentet e zbatimit të politikës monetare të përcaktuara prej Bankës Qendrore që duhet të definohen qartë në këtë projektligj.

Banka Qendrore do të përcaktojë dhe të zbatojë politikën monetare dhe të valutës në Republikën e Kosovës, pra në pajtim me autoritetin e saj, Banka Qendrore e Kosovës për arritjen e politikave monetare të vendosura dhe të këmbimit valutor, do të caktojë masat dhe instrumentet e nevojshme të rregullimit të aktivitetit të kreditimit dhe likuiditetin e institucioneve të kreditimit, si dhe rregullimin e sasisë së parasë në qarkullim dhe masat e ndërmarra në lidhje me normat e interesit dhe kursin e këmbimit valutor. E të gjitha këto, varësisht nga objektivat e politikës makro-ekonomike dhe harmonizimin e tyre me objektivat e politikës monetare e me qëllim të arritjes së shkallës së lartë të punësimit, shkallës së lartë të prodhimit, normës së lartë të rritjes ekonomike, stabilitetin e çmimeve dhe përcaktimin e instrumenteve për vlerësimin e efikasitetit të politikës monetare, respektive apo ekstensive. Prandaj, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës duhet të jetë e autorizuar për të nxjerrë dhe aktet tjera nënligjore në të cilën bën rregullimin e funksionimit të politikës monetare.

Në kapitullin 4, kapitullin 5 dhe 6, askund nuk figuron politika monetare si funksion i Bankës Qendrore, por janë të përshkruara instrumentet e politikës monetare, pa e përcaktuar politikën monetare kreditore të Bankës Qendrore, të cilat edhe si të tilla, kërkojnë ridefinim dhe harmonizim me politikën monetare, e jo vetëm që të përshkruhen.

Te kapitulli 12, Qeverisja dhe riorganizimi.

Organet vendimtare, Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi ekzekutiv, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe kompetencat dhe detyrat e guvernatorit të Bankës Qendrore, si dhe procedurat për emërimin e tyre duhet të ridefinohen, të bëhet definimi i domosdoshëm i detyrave dhe kompetencave të organit vendimmarrës.

Neni 38, që ka të bëjë me emërimet, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me atë pjesë që ka të bëjë me kompetencat e presidentit, kapitulli 5, neni 84 ku shkurtyt qartë e definuar se presidenti emëron guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, i cili shërben si drejtor menaxhues dhe emëron drejtorë të tjerë të Bordit të Bankës. Me këtë drafatë, kompetencat dhe detyrat e përcaktuara të guvernatorit bashkë me Bordin menaxhues, janë të zgjeruara në dëm të kompetencave të bordit. Si përfaqësues të legjislativit, nëse e analizojmë praktikën e mirë dhe eliminimin e konfliktit të interesave të palëve të ndërlidhura në vendimmarrje, kompetencat për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit, e sidomos për zgjedhjen automatike të drejtorit të Thesarit për anëtarë të Bordit, është shembull eklatant i konfliktit të interesit. E njëjta gjë është edhe me emërimin e vice-guvernatorëve nga ana e Bordit, me propozimin e guvernatorit ku gjithmonë dominon ndikimi i faktorit subjektiv në këto raste propozimi.

Në kapitullin 13, te neni 60, emërimi i shefit të auditimit të brendshëm, i cili pozicion nuk i përgjigjet nivelit dhe sistemit të organizimit të strukturës organizative të Bankës Qendrore për arsye se auditorin e brendshëm e propozon guvernatori, me aprovim nga Bordi, e që është në kundërshtim me rolin dhe detyrat e auditorit të brendshëm. Me këtë formë humbet pavarësia e veprimit të auditorit të brendshëm për mbrojtjen e integritetit dhe pavarësisë, se auditori i brendshëm duhet të emërohet nga Bordi, ndaj të cilit edhe i raporton për punën e vet.

Dispozitat përfundimtare.

Te kapitulli 16, neni 79, pas aprovimit të këtij ligji, guvernatori dhe anëtarët e Bordit konsiderohen të jenë të gjithë të emëruar dhe të vazhdojnë të shërbejnë, që është në kundërshtim me praktikat e mira bankare. Ajo duhet të ridefinohet dhe të parashihet që me hyrje në fuqi të këtij ligji, mandati i të gjithëve pushon dhe se presidenti brenda 30 ditëve emëron guvernatorin dhe anëtarët e rinj të Bordit të drejtorëve, ndërsa, pika e dytë, duhet të fshihet tërësisht. Me të gjitha këto vërejtje dhe duke pasur parasysh se Komisioni ka goxha shumë punë në këtë draft, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoj që në leximin e parë draftligji të kalojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për Grupin Parlamentar të AAK-së, zoti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar me seriozitet këtë projektligj nga fakti se është projektligj që ka të bëjë me një institucion ndër më të rëndësishmit e vendit.

Edhe përkundër plotësimeve, përmirësimeve dhe përparimeve që ky variant i Ligjit për Bankën Qendrore ofron, në krahasim me ligjin në fuqi, prapëseprapë konsiderojmë që nuk i ka përmbushur të gjitha pritjet tona presa i përket kompletimit të funksioneve që ka banka e shtetit. Kjo është pritur, para së gjithash edhe për arsye se tash jemi në vitin e tretë të pavarësisë dhe kur është hartuar dhe miratuar Ligji për Bankën Qendrore, në kohën kur kemi pasur në kuadër të pakos së ligjeve që kemi nxjerrë në prag të shpalljes së pavarësisë, kanë qenë rrethana tjera kur nuk kemi mundur t'i definojmë të gjitha kompetencat që duhet t'i ketë një bankë i një shteti të pavarur.

Unë, po përmend këtu vetëm kompetenca që i mungon në sferën e politikave monetare dhe instrumenteve që duhet ta përcjellin këtë politikë në kuadër të funksionimit të bankës dhe nuk po lëshohem në detale, sepse diçka të ngjashme me ato që i kam evidentuar unë, ka përmendur edhe parafolësi im, zoti Osmani. Kam edhe disa çështje të veçanta për të përmendur që janë lëshime në këtë projektligj, që në veçanti po përmend mandatin e anëtarëve të Bordit jo ekzekutiv, i cili përfundon pas 5 vjetësh dhe ata kanë të drejtë të rizgjidhen edhe një mandat, por jo t'ju vazhdohet mandati me automatizëm, në këtë variant të ligjit, duket se kjo ka qenë, ka mbetur mjaft e padefinuara dhe nënkupton si një vazhdim me automatizëm.

Njësoj vlen kjo edhe për guvernatorin edhe anëtarët e Bordit ekzekutiv. Duket, po ashtu paradoksale që guvernatori të përcaktoj ose të propozoj zëvendës guvernatorët e vet anëtarë të Bordit ekzekutiv. Këta, pastaj gjithmonë në punën e tyre mund të jenë të varur ose të ndikuar gjatë ushtrimit të detyrës.

Procedura e shpalljes dhe e seleksionimit të kandidatëve për guvernator dhe anëtarë të Bordit, nuk duket zgjedhje e mirë pasi që propozohet që Paneli të përbëhet nga vet anëtarët e Bordit dhe guvernatori., Risi në këtë Projektligj kemi, që në vend të inspektorit të përgjithshëm siç ishte deri me tani, do të themelohet institucioni i auditimit të brendshëm i quajtur Komitet i auditimit në krye të së cilit do të jetë shefi i auditimit të brendshëm. Kjo mendoj që është zgjedhje e mirë kur kemi parasysh që auditori i brendshëm është obligim ligjor i çdo institucioni shtetëror në bazë ligjit në fuqi. Por, ajo që mendojmë që duhet të ndryshoj, është që të gjendet një formë tjetër e emërimit të shefit të auditimit të brendshëm e cila i mungon, sepse mënyra siç e përmendi edhe parafolësi, e përcaktimit nga vetë guvernatori e shefit të auditimit, e bënë atë domosdoshmërisht të varur dhe nuk mundet me e kryer funksionin e vet që i takon me ligj. Dhe së fundi, e kam përshtypjen që del nga leximi i fundit të këtij Ligji i

dispozitive kalimtare, që anëtarët e Bordit dhe guvernatori sa herë t'u ofrohet fundi i mandatit, kanë me e propozuar ndryshuar ndryshimin e Ligjit për bankën, sepse me këtë ata i propozojnë veti fillimin e një mandati të ri pa pasur nevojë me kaluar nëpër procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes. Shihni atje e kemi një nen të veçantë ku thuhet që, me aprovimin e këtij Ligji, mandati i anëtarëve aktual të Bordit joekzekutiv të guvernatorit dhe të auditorit të brendshëm, vazhdohet, fillon me automatizëm, pra fillon si mandat i parë dhe mund t'i zgjatë dy mandate nga 5 vite pra plotë edhe 10 vite të plota. Me kusht që këto mangësi të eliminohen gjatë punës në komisione, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: E mbështetë AAK-ja. Për AKR-në, kemi vetëm një emër, Riza Smaka, besoj, nuk ka emër tjetër.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Ministër Shala i nderuar,

Deputetë, kolegë të nderuar

Parimisht e dhe fillimisht AKR-ja, Grupi Kuvendor e suporton këtë dokument, është i rëndësishëm ky ligj, i nevojshëm për Bankën Qendrore, që është një institucion themeltar i shtetit.

Po në këtë kontest, disa nga vërejtjet parimore, ja po e zëmë, në nenin 3, paragrafin 3 të këtij Projektligji, është precizuar se selia e saj do të ishte, bile aty është thënë: "është në Prishtinë në rrugën Gardi Bardi". Precizimi i selisë i Bankës Qendrore apo i cilit do institucion pos vendit që duhet edhe në adresën e plotë, nuk është praktikë ligjore as zgjidhje e qëndrueshme, sepse emërtimet e rrugëve zakonisht ndodhin shpesh, rrjedhimisht me dhe për to, do të duhej të aplikohesh edhe mendimi i dispozitës ligjore, në këtë rast te neni 3, paragrafi 3, i cili sikundër dihet nuk është as i thjeshtë as i pa implikime financiare, në këtë rast krejt paarsyeshëm, një.

Dy. Sipas nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit për Bankën Qendrore, është formuar status juridik i Bankës, absolutisht independent i cili as nuk përkon me nenin 140 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, as nuk do të duhej të caktoj si i tillë madje as me Kushtetutë në anën tjetër. Formulimi i kësaj dispozite rrjedhimisht bie ndesh edhe me dispozitën e nenit 6, paragrafi 2 dhe me nenin 7, paragrafi 3 të po këtij akti ligjor.

Së andejmi, neni 3, paragrafi 2 i Ligjit për Bankën Qendrore, do të duhej të riformulohej në harmoni me diktatin nga neni 140 i Kushtetutës. Me nenin 33, paragrafi 3 të Ligjit për Bankën Qendrore, nocioni për letrat komerciale është definuar papërshtatshëm dhe kundërshtimshëm reciprokisht në të tri gjuhët. Në shqip, në vend të letra me vlerë apo, është thënë letra me vlerë e tregtueshme, ndryshe ka shumë tipe të letrave me vlerë apo komerciale dhe të të gjitha ato janë të tregtueshme, për shkak në literaturën bashkëkohore profesionale përdoret termi letra komerciale commercial papers në english. Në vend të termit Commercial papers është përdorë purchase, purchase negotiable government securities, ndërsa në serbisht në vend të termit adekuat: "hartije od vrednosti" është simuluar termi "prenošlive obveznice" që nuk është, e gjitha këto janë të transferueshme, bile këto transferohen me indoksanim.

Me dispozitën e nenit 34 të këtij dokumenti, është definuar struktura e Bordit të Bankës Qendrore, e Bordit ekzekutiv dhe e guvernatorit të Bankës Qendrore në përbërje të Bordit të Bankës Qendrore dhe të Bordit ekzekutiv, si kryesues i këtij të fundit, sikundër është përcaktuar edhe me Kushtetutë. Në atë mënyrë guvernatori i Bankës Qendrore, do të ishte dhe faktor predominant i Bankës Qendrore dhe për aq i pakkontrolluar nga mekanizmat funksional

të saj, madje as të ndonjë institucioni publik tjetër. Rrjedhimisht dhe në këtë kontekst, është e njohur maksima juridike se kush ka autorizime të gjëra, e në këtë rast edhe të pakontrolluara, kurdoherë ka oportunitete për abuzime për spekulime për arbitrarizma në disfavor të interesit publik. Andaj, në procedurë kuvendare do të duhej të analizohej kritikisht ky definim dhe në përshtatje me postulatin për përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë, të riformulohej përshtatshëm.

Me dispozitën e nenit 35, paragrafi 1, alineja 1 të këtij dokumenti, Bordit të Bankës Qendrore i është adresuar autorizimi për emërimin e auditorit të jashtëm, zgjidhje e cila nuk do të ishte konzistente as adekuate me rolin dhe funksionin e auditimit të jashtëm, sepse atij entiteti, pos super autorizimeve funksionale nga neni 6, paragrafi 2 po i këtij ligji, do t'i mundësohej në vend të revizionimit profesional kompetent dhe indiferent, pa konflikte interesore, pikërisht e kundërta e atyre postulateve, vetë kontrollimi, pra evaluimi dhe estimimi subjektiv, gjithsesi edhe kurdoherë superlativ madje edhe për abuzimet eventuale, pra spekulimet eventuale të mundshme dhe të ndryshme.

Gjithsesi auditorin e jashtëm të Bankës, do të duhej ta emëronte themeluesi i saj, në këtë rast Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëpërmjet ta zëmë Komisionit për mbikëqyrjen e financave. U mur vesh, nuk është propozim kategorik, por gjithsesi po jo nga vetë banka.

Me nenin 39 të këtij dokumenti, ngjashëm dhe me dispozita respektive të Trustit Pensional kursimor, sikundër të miratohej pa modifikime të nevojshme dhe të arsyeshme, do të krijojë bazë juridike për ekstra dhe super shpërblime të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore, e veçanërisht të guvernatorit si dhe rrjedhimisht e anëtarëve të stafit të saj. Tani ne ndodhemi në një pozitë, që po e zëmë për Trustin që e ka një status të tillë, që as Kuvendi as Qeveria, as Ministria, askush domethënë sikur të ishte polisë në Helladën antike. Eh tash, kjo dispozitë po mos të riformuloj, do ta krijofshim edhe një polis të ngjashëm në Bankën Qendrore.

Edhe me dispozitën njëjtë 47, paragrafi 6, me formulim të papresedencë, vritualisht do të jepej autorizim Bordit, Bordit të Bankës Qendrore, po të vendosur edhe pa kuorum, gjë që do të krijoj bazë juridike për vendosje arbitrare e aq më parë kur sipas nenit 34, paragrafi 2 të po këtij ligji, Bordi do të kishte gjithsej 5 anëtarë, nga të cilët së paku 3, kurdoherë do të mund të konvokoheshin.

Ju lutem, kolegë të nderuar!

Aty është propozuar që Bordi edhe kur nuk ka kuorum vendos edhe më pastaj ai vendim do të konfirmohej nga anëtarët e tjerë që do të imponohej apo jo, deshëm e nuk deshëm. Ai Bord po t'i kishte 55 anëtarë, do ta kishte një rezon, por krejt 5 anëtarë.

Te dispozitat nuk po i quaj skandaloze veç problematike të këtij akti juridik, është edhe neni 47, paragrafi 12, sipas të cilit veprimet e anëtarit të Bordit të Bankës Qendrore, do të mbeteshin valide pavarësisht nëse do të zbulohej ndonjë parregullsi gjatë emërimit apo referuar kualifikimit të anëtarit të caktuar të atij bordi. Nëse do të miratohej pa modifikime, kjo dispozitë do të legalizonte edhe aktet, punët dhe veprimet inkompetente, madje ilegale të anëtarit të caktuar të Bordit të Bankës Qendrore.

Të nderuar kryesues edhe kolegë, këto janë disa nga vërejtjet parimore, ndryshe, fillimisht thashë edhe përfundimisht se e mbështesim këtë dokument edhe e përkrahim, zotëri ministrin Shala për aktivitetin edhe angazhimin e bërë për dhënien e ekspozesë të këtij dokumenti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Për LDD-në, Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të mundohem të jem shumë e shkurtër se u tha mjaft. Lidhja Demokratike e Dardanisë, e ka shqyrtuar këtë ndryshim apo plotësim të Ligjit të Bankës Qendrore dhe konsideron se Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është më se i domosdoshëm që të rregullojë sistemin financiar të qëndrueshëm në vend dhe natyrisht t'ju paraprijë pakos ligjeve që rregullojnë fushën financiare në vend.

Po me këtë ligj themelohet Banka Qendrore e Kosovës, si etnitet ligjor, publik me të gjitha kompetencat e nevojshme për arritjen e objektivave të rregullimit të sistemit financiar. Nuk do të hyj në vërejtje në brendinë e ligjit, por realisht Lidhja Demokratike e Dardanisë është shumë e interesuar që ky ligj sa më shpejtë të kalojë nëpër procedurat edhe të fuqizohet dhe në bazë të kësaj, kam parasysh që kjo është e mundur që edhe në vitin 2010, ky ligj të fillojë implementim. Por, duke u bazuar në këtë që po e them, vlerësimi i ndikimit buxhetor pak mua më vënë në lajthitje sepse, po citoj: thoni, Departamenti i Buxhetit ka trajtuar me kujdes këtë vlerësim, por edhe dispozitat e projektligjit dhe si rezultat paraqet se në aspektin buxhetor, ky projektligj nuk pritet që drejtpërdrejtë të ndikojë në buxhetin e Republikës së Kosovës, pse mendohet për buxhetin e Kosovës, nuk do të ndikohet, bazohemi edhe në nenin 2 të këtij projektligji.

Banka Qendrore është pasardhëse e autoriteti qendror bankar në Kosovë, por edhe se Banka Qendrore ka autonomi administrative- financiare dhe menaxhuese. Në qoftë se është kështu dhe që ishte dashur të jetë, atëherë pse ligji nuk mund të gjejë zbatueshmëri menjëherë, duke pasur parasysh që këtu keni prapë sigurimin e mjeteve buxhetore dhe thoni se me buxhetin e vitit 2010, nuk kemi ndarje buxhetore të aprovuar e që ndërlidhen me financimin e Bankës Qendrore, përkatësisht financimin e kostove buxhetore që mund të dalin nga ky projektligj. Me këtë edhe, pastaj na jepni edhe me kuptuar se nuk është shqyrtuar hiq mirë, apo nuk është formuar hiq mirë të jetë decidiv sa ka implikime buxhetore ky ligj, që është shumë i rëndësishëm, edhe një herë po e them. Nuk e keni konkret, domethënë nuk jeni të qartë me vetveten, megjithatë pa hyrë në vërejtjet konkrete, unë po them se ky ligj, duhet të angazhohemi shumë seriozisht dhe ka mundësitë edhe nuk ka asnjë arsye që mos të gjejë implementim që në vitin 2010.

Lidhja Demokratike e Dardanisë, do të japë kontributin e vet edhe përmes Komisionit funksional, siç është ai i Buxhetit dhe kam shpresë se Komisioni i Buxhetit do të angazhojë edhe shqyrtim publik për këtë ligj, do të kemi përkrahje edhe të ekspertëve të kësaj fushe dhe dua të besoj se ky ligj, me të gjitha ato vërejtje që i dhanë kolegët e mi, do të finalizohet si një ligj i mirë dhe do ta vejë në funksion fushën e sistemit bankar të vendit. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Të lutem! Për grupin "7+", Enis Kervan

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Bu Yasa Taslağı ile istikrarlı ve sağlam bir finansman sisteminin oluşması amacıyla diğer ilgili yasalar ile uyumlu olması üzere hedefe ulaşmak ve görevlerin yerine getirilmesi doğrultusunda tüm özel yetkileri ile birlikte kamu bir kuruluş olarak Merkez Bankasının düzenlenmesi sağlanmaktadır. Kosova Merkez Bankasına ait Yasa Taslağının içeriği Avrupa Birliği Sözleşmesi ve Merkez Bankalar Tüzüğü ile öngörülen genel prensiplerle uyum içerisindedir. Dolayısıyla 7+ Parlamenter Grubu olarak Yasa Taslağını kabul ediyor katkılarımızı komisyonlarda sunacağımızı beyyan ediyoruz. Faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kervan! Për SLS, nuk kemi paraqitje. Për Grupin për Integrim, fjalën e merr deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zotëri kryesues i Kuvendit!

Ja bih iznjeo nekoliko zapažanja vezano za sam zakon i o nekim aspektima vezano za neke nepredviđene... u vezi sa implementacijom ovog zakona.

Ako je u pitanju Zakon o Centralnoj banci, složiću se sa većinom prethodnih govornika da je veoma važno da imamo ovaj zakon i da je dobro da on reguliše neka značajne oblasti vezane za finansiranje, a koje se tiču posebno onih aspekata koji su vezani za finansijski sistem Kosova, omogućavanje njegove finansijske stabilnosti, potom stabilnosti cijena, zatim usklađivanje rada sa cijelom regijom, potom ono što je ministar u svom govorio istakao povezanu, snažno povezanu sa Evropskom komisijom, odnosno zajednicom, zatim i Međunarodnim monetarnim fondom i ukupnim međunarodnim finansijskim tokovima.

Naravno da je vrlo bitno da imamo u vidu i to da one dijelove koji će tokom implementacije, da tako kažem zapeti, odnosno zahtijevati nužne adaptacije preinake, da budemo spremniji, da budemo da kažem adaptibilni, da budemo na nivou zadatka i da reagujemo tako da se mijenjaju u toku budućih izmjena u zakonu koji će biti očigledno nuni, bez obzira na to što zakon pruža dobra rješenja oko upravljanja Upravnog odbora, strukture samoga upravnoga tela, počev od guvernera, preko Upravnog odbora i ostalih tjela. U svemu tome, naravno, može biti potrebno i određenih dopuna da bi se omogućio jedan funkcionalan sistem koji je vrlo bitan, s obzirom da Kosovo mora imati dobar politički sistem koji mora biti nužno praćen dobrim finansijskim sistemom, a potom sve to međusobno u čitavoj ovoj povezanosti omogućiti funkcioniranje kosovskog društva.

Ono što bi takođe posebno istakao, jeste da tokom implementacije i budućih godina, moramo takođe imati na umu ne samo tokove novca koji su vezani za regiju i za Evropu, nego moramo imati na umu i jednu globalnu promjenu na finansijskom planu, koji finansijski eksperti u talamba se najavljuju u cijelom svetu a koja izgleda ima malo odjeka na Kosovu, ili se malo razumije, moram tako rečim na Kosovu vezano za krizu evropskog novca, vezano za dužničku krizu koja je očigledna i koja je dovela do finansijske propasti našega neposrednoga susjeda, ne baš neposrednoga, ali eto mogu reći posrednoga, no njeni efekti će očigledno biti prelivanje dužničke krize u zemljama osjetljivim na jugozapadu Evrope, u zemljama koje se već spominju: Španija, Portugalija i mnoge buduće članice, potom neke nove članice koje će usporiti finansijske tokove i gde ćemo mi morati biti spremni da reagujemo s obzirom da Kosovo ima euro, a ako je na djelu dužnička kriza i kriza eura, mi moramo očekivati prelivanje te krize i sa aspekta implementacije budućnosti novca, na Kosovu mi moramo prosto, moramo imati u vidu.

Verujte da sam ovih dana bio u prilici da pomno razmišljam i pratim ova događanja i da neki čak spominjaju i ukidanje eura, dakle mi moramo biti spremni na te dramatične promjene, a malo je čudno da je veliki broj posebno političkih predstavnika shvataju ozbiljnost i događaj i ovo je moj osobni doprinos, sa najboljim namerama da su ove stvari koje trebamo da imamo u vidu s obzirom da svi želimo da Kosovo bude i politički i ekonomski jaka država u ovoj regiji. Hvala vam lijepo!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ky ishte diskutimi i fundit në emër të grupeve. Ne dëgjuam një mbështetje të të gjitha grupeve për këtë ligj, prandaj edhe besojmë që do të votohet, por ne vazhdojmë me deputetët,

tani. Unë ua lexoj emrat që janë paraqitur deri tash: Rexhep Hoti, Fatmir Rexhepi, Naim Rustemi, Driton Tali, Nerxhivane Dauti, Adem Hajdaraj, Armend Zemaj. Besoj që do të jeni më preciz. Para drekës do ta kalojmë edhe këtë ligj.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe unë ju jap komplimente për drejtimin e seancës.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se sot kemi të debatojmë për një projektligj të një rëndësie të veçantë për ekonominë e Kosovës drejt proceseve zhvillimore dhe integruese.

Nëse analizohen mendimet e ekspertëve në nivel vendi, njëra ndër arsyt e mospranimit të ekonomisë së Kosovës, është Banka Qendrore dhe gjithë ajo që lidhet me Bankën Qendrore dhe këtë e themi për shumë arsye. Së pari, nuk ka qenë i qartë koncepti i Bankës Qendrore në Kosovë, së dyti, funksionet bazike të Bankës Qendrore. Së treti, cilat janë objektivat, instrumentet e Bankës Qendrore dhe efektet e saj, të maten në praktikë dhe mbi të gjitha mbikëqyrjen e tregut monetar dhe mekanizmin e politikave monetare në vend.

Në çdo ekonomi të tregut, ekziston bankat qendrore të nivelit të parë dhe i kemi bankat komerciale të nivelit të dytë. Është obligim që Banka Qendrore të mbikëqyrë politikat monetare në një shtet dhe ka lindë më vonë për t'i ruajtur dhe monitoruar bankat komerciale. Në Kosovë kemi hasur në falimentimin e bankave komerciale dhe të kompanive të sigurimeve. Prandaj, këtij projektligji që ne sot po e diskutojmë, po i lëmë hapësirë që të ndodhin edhe në të ardhmen rastet e tilla dhe përgjegjësia të mbetet pa adresë.

Pikë tjetër është pavarësia e Bankës Qendrore. Nga praktika e vendeve evropiane, banka qendrore është e pavarur nga Qeveria, por në rastin konkret, përmes këtij projektligji sa duhet pavarësia e Bankës Qendrore të Kosovës, kur kemi parasysh që tri funksionet bazike që duhet t'i besoj Banka Qendrore është: caktimi i normës së interesit, që në Kosovë nuk ndodhë, rregullimi i ofertës monetare dhe tre, kreditimi i qeverisjes. Ajo që është më e rëndësishmja, cila është procedura e përzgjedhjes së guvernatorit të Bankës Qendrore dhe kohëzgjatja e qëndrimit të tij në këtë post. Për shembull, në SHBA kemi, për shembull një guvernator është zgjidhë për 14 vjet.

Katër, reputacioni i Bankës Qendrore varet nga prirjet e individëve dhe të firmave përmes suportimit nga kjo bankë.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Të ndalemi në një pikë të veçantë që ka të bëjë me objektivat e politikës monetare, synimi i cili është i të gjithë neve, dhe ato janë:

- rritja e qëndrueshme ekonomike,
- stabiliteti i çmimeve,
- punësimi i plotë, dhe
- valutë stabile

Sa ka përmes këtij projektligji fuqi Banka Qendrore që t'i arrijë këto objektiva dhe a ka alternativë, objektiva tjera siç janë, për shembull: norma e interesit dhe oferta monetare, tregun monetar, përfshirë një bashkësi institucionesh dhe agjendësh ekonomikë, ku realizohet shitja dhe blerja e letrave me vlerë dhe ato në formë të aksioneve, obligacioneve dhe bonat e shtetit. Në qoftë se ky Projektligj i mundëson këto mbi funksionimin e Bankës Qendrore në këtë formë, atëherë implementimi i projekteve kapitale me rëndësi shtetërore, nuk do të jetë problem. Paratë e Kosovës do të mbeten në Kosovë, e jo të huazohen jashtë e dhe mbi të gjitha

do të përshpejtohen proceset e legjislacionit që mundëson diçka të tillë. Po s'e arrijmë këto, kontributi ynë i funksionalizimit të këtij ligji, do të matet me këto efekte: Banka Qendrore blen letra me vlerë, rritet oferta monetare, ulet norma e interesit, ulet kostoja e financimit, rriten investimet, shpenzimet dhe rritet GDP-ja, ulet inflacioni dhe rritet punësimi. Mendoj se këtu qëndron e arritura e këtij Projektligji po që se implementohet, ashtu si do të duhej. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, kryesues!

Vetë rëndësia e Projektligjit, na ka bërë që të interesohemi pra dhe t lexojmë por edhe të shprehim opinionet tona sot dhe komentet. Prandaj, unë që në fillim jap përkrahje të plotë edhe ekspozesë së ministrit, jo veç për rëndësinë dhe për objektivat që i ka shtruar këto, por edhe për nevojën e madhe pra që këto plotësime, përmirësime dhe rregullimi i vazhdueshëm i kornizës ligjore dhe aktivitetit të Bankës Qendrore, të jenë në pajtim me nevojat për shkak të ndryshimeve ekonomike që kanë pasuar, ambientit ekonomik por edhe objektivat tona integrale. Prandaj, është përkrahje e plotë, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, të cilat flasin lidhur me pozicionin që ka Banka e Kosovës, kompetencat dhe fushat e veprimtarisë së saj në politika të rëndësishme në sektorin bankar si dhe zhvillimi e sistemit bankar.

Vlerësimi im është se Ligji në tërësinë e tij i jep edhe i njeh autonomi të plotë Bankës Qendrore, dhe ky objektiv strategjik që ofron ligje është në kuadër të forcimit, pra pavarësisë institucionale, transparencës, aktivitetit, besueshmërisë për misionin, rolin dhe politikat që kanë mpaktë të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit, ku të gjitha subjektet e tjera jashtë saj, janë të detyruara të respektojnë autoritetin që ligji i jep Bankës së Kosovës në fushën e veprimtarisë së saj për të operuar në Kosovë, por edhe në marrëdhëniet që duhet të ndërtohen me institucionet tjera ndërkombëtare.

Autoriteti ligjor i kodifikuar brenda 81 neneve, po ashtu ka tendencë që bankës t'i garantohet autoriteti dhe të reduktohet varësia nga politikat e momentit, në arritjen e objektivave kryesore duke mos ndërhyrë në veprimtarinë e saj.

Në pjesë të tij, projektligji saktëson raportet institucionale të Bankës me organet e tjera shtetërore dhe ajo që e veçon, është pra ligji që ka vendosur nivelin më të lartë institucional që banka t'i përgjigjet dhe t'i raporton vetë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kështu, me këtë Banka është vendosur edhe me pushtet të konsiderueshëm në politikat monetare dhe politikat e tjera që kanë impakt në jetën ekonomike të vendit. Por, është ndërtuar edhe llogaridhënia para Parlamentit, si dhe plotësimin e kuadrit të plotë të përgjegjësive që ligji i beson Bankës Qendrore për politikat monetare dhe politikat e licencimit dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare në Republikën e Kosovës, kundrejt të cilave do t'i vlerësohet pra suksesi i punës së Bankës Qendrore.

Ndërtimi i marrëdhënieve ndërmjet Bankës Qendrore dhe bankave tjera në Kosovë dhe jashtë saj, siç ka të bëjë me sistemin evropian të bankave qendrore, me këto standarde që vendosen në këtë projektligj, pra e ofron dhe e bënë kompatibil këtë projektligj, i cili mbulon pastaj të gjitha nevojat e tjera të veprimtarisë së vet. Banka e Kosovës ka detyrim ligjor të përfaqësojë shtetin e Kosovës në të gjitha veprimtaritë bankare, me shtetet, bankat dhe institucionet e huaja. Ky ligj parashikon detyrimet për Bankën e Kosovës lidhur me lidhur me politikat makroekonomike të vendit.

Të gjitha këto pra, krijojnë një autoritet që deri tash nuk e ka pasur me projektligjin në fuqi, por ajo që dua të veçoj me këtë rast dhe për të matur këtë mes pavarësisht dhe monopolit, e cila do të jetë po ashtu një test për ne si deputetë, si komisione parlamentare dhe të tjerë pra, është pjesa e kapitullit që u përmend këtu nga kolegë deputetë të tjerë, që ka të bëjë me organizimin dhe drejtimin e Bankës në Kosovë. Prandaj, dy vërejtjet e mia parimore do të adresohen te forma që e ndërton apo roli që vendoset për Parlamentin, për Qeverinë në kuadër të propozimeve, që nga guvernatori e deri te menaxhimi dhe drejtimi i Bankës në atë pjesë çfarë është ndërtuar brenda këtij projektligji. Pra, lidhur me mandatet, me afatet, me rizgjedhje dhe të tjera që u potencuan këtu. Prandaj këtu do të ishte mirë të shikohen edhe praktikrat e vendeve tjera, ajo çka dallon prej këtij propozimit në fjalë, po ta lexojmë Ligjin e Bankës të Sllovenisë, Kroacisë, Shqipërisë, shihen se ka ndryshime dhe është mirë pra që këtu të merret modeli më i mirë për të garantuar atë që thamë pak më herët, pra edhe pavarësinë e Bankës, por në të njëjtën kohë edhe të mos e teprojmë me disa monopole të cilat nesër do t'i mbesin në dorë për disa çështje të menaxhimit Bankës nga ana e personelit që zgjidhet. Po ashtu, një rëndësi të veçantë në kapitujt tjetër, duhet pra të jetë edhe auditori dhe kontrollimi i brendshëm, i cili mendoj që duhet të rregullohet për shkak të asaj që kërkohet lidhur me transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Kosovës.

Unë personalisht pres një punë me përkushtim të madh nga Komisioni për Buxhet, nga Komisioni funksional për shkak të rolit, pra që thamë këtu e ka Banka dhe realisht të japim kontributin maksimal që të ndërtojmë një ligj i cili do të përmbushë atë çka kërkohet për misionin dhe funksionin që i takon një banke qendrore për impaktet e saj që i ka në politikat monetare dhe zhvillimore të vendit. Ju faleminderit dhe e përkrahim në parim.

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit! Radha është e zotit Naim Rrustemit, të bëhet gati zoti Driton Tali.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues!

Fillimisht po e them se e përkrah këtë ligj, është një ligj mirë i ndërtuar, besoj se e pasuron legjislacionin tonë edhe është një hap përpara, por, megjithatë i kam disa vërejtjeje, në disa prej neneve, vërejtje që nuk janë, që nuk e zhvendosin, nuk bëjnë ndryshime radikale, por ndryshime minore të vogla. Për shembull te neni 40 e drejta për t'u zgjedhur. Personat që kualifikohen për t'u zgjedhur që të shërbejnë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore, do të jenë me integritet të njohur. Njëfarë fjale e kotë edhe pse ne shpeshherë diskutojmë në Kuvend, Kanë diskutuar shumë veta, se unë jo për integritetin e njerëzve. Integriteti do të thotë atë çka e ke thënë, që ke për ta bërë, ta bësh. Me fjalë të tjera, është një faturë që matet, kurse rastet që po tregojnë, kontesti ynë kulturor e bën për të pasur ndryshime të mëdha në autoritetin e Bankës Qendrore në Kosovë, duke pasur parasysh aferat që kanë qenë deri me tani. Edhe rastet i kemi te freskëta.

Dhe, gjithashtu e kam edhe një propozim, që është propozim i drejtpërdrejtë që nenin 43 ta fshijmë krejt – dorëheqja. Nuk është adapt me kontestin tonë kulturor, pa e hequr me zor, nuk del. Rasti më i freskët është rasti i presidentit ku bëhet aq kreativ partia sa tenton për të zbuluar edhe emra të tjerë se post i ngrirë. Me fjalë tjera, po shohim që nuk qenka fjala adekuate, e fshijmë krejt, kurrëgjë nuk bëhet, nuk po bëhet se edhe na ashtu po flasim edhe, megjithatë gjërat nuk po ndryshojnë. Me fjalë të tjera, është një kryeneçësi që edhe në dëm të vendit, megjithatë mbetemi kryeneç në qëndrimet tona të paargumentuara dhe jo të justifikuara as nga aspekti ligjor po as nga aspekti moral.

Gjithashtu, unë do t'i referohem, tash meqenëse është ministri i Financave dhe i Ekonomisë këtu, do t'i referohem nenit 23. Kur e lexova, e pash që paksa i paskemi hyrë në hak ministrit për Financa dhe Ekonomisë, kur kërkonim nga ai që të depozitohet çeku prej 16 milionë e 200 mijë euro, edhe pse nuk është krejt pa faj, sepse udhëheq me Thesarin, por edhe i paskemi hyrë në hak edhe Kuvendit të Kosovës, sepse këtu paska rol edhe Banka Qendrore e Kosovës, 16 milionë e 200 mijë euro, ende mbeten të pa deponuara edhe pse Banka Qendrore paska këtu njëfarë faji, sepse institucionet financiare do t'i sigurojnë Bankës informacione dhe evidenca lidhur me veprimtarinë e tyre për gjendjen financiare dhe kur t'ia shtojmë edhe nenin 30, e shohim se Banka Qendrore qenka bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë.

Shtesë kësaj, kur t'ia shtojmë edhe, se Banka Qendrore po e luan rolin e depozituesit dhe arkëtarit së Qeverisë, po i bëjë ftesë publike që të bashkohen të gjithë ata stakeholder, që të bashkohen të gjithë ata që kanë rol në këtë drejtim: Kryesia e Kuvendit; Ministria e Financave dhe Ekonomisë me tërë Qeverinë, por edhe Banka Qendrore, që le t'i kthejnë le t'i depozitojnë dhe le t'i arkëtojnë 16 milionë e 200 mijë euro, që është e drejtë plotësisht edhe është formë normale, për të treguar që me të vërtetë jemi të përqendruar që të krijojmë një shtet funksional dhe që të tregojmë se udhëheqësit kryesor të institucioneve janë për zbatimin e ligjit dhe për sundimin e ligjit. Ju faleminderit për dëgjim!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Ju faleminderit! Deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Po unë fillimisht kërkoj falje se disi më iku prej mendjes, nuk ju falënderova NATOS për të gjitha atë punë që e ka bërë për Kosovën. Jo, zonja zëvendësministre, e përmirësova këtë gabim. Po ashtu, në Ligjin e mëparshëm ishin disa, nëse më lejohet, ishin disa moskuptime. Unë thashë se duhet të kemi shoqëri komandite dhe shoqëri komandite të përgjithshme, e jo ortaki të përgjithshme, nëse i mbesim lojal legjislaturës evropiane, pra Societe en commandite apo comandit gesellchaft e tjera e tjera, apo societa en komandite. kaq ishte sa i përket asaj.

Tash po kthehem në këtë ligjin këtu dhe, po ashtu, fillimisht edhe unë po i kërkoj falje pak zotit Ahmet Shala për punën e 16 milionë e 200 mijë eurove, se me të vërtetë Banka Qendrore paska më shumë faj aty që nuk e ka lokalizuar atë çek dhe tash po e thërras EULEX-in që ta vizitojë Bankën Qendrore dhe le të shohin se çka po ndodhë atje, sepse edhe fillimisht kur e patëm emëruar apo votuar, ju kujtohet drejtorin e Bankës Qendrore, patën dalë do ndryshime për keq menaxhime të Bankës apo të Autoritetit Qendror që e kemi pasur atëherë-bankier e tjera, e tjera.

Tash po ndalem pak këtu në çështje po ashtu teknike. E përkrah, më lejoni që të deklarojmë, e përkrah këtë projektligj apo këtë ligj, shpresoj se do të jetë shpejt, sepse është shumë më i mirë se ai që na patën imponuar, të cilin, më duhet ta them publikisht se nuk e pata votuar. Atë nuk e pata votuar për shumë sende, por ndër to kryesorja ka qenë, sepse mekanizmi shumë të rëndësishëm të Bankës Qendrore, e që unë nuk e kam pasur të qartë që nga vitit 2002, pse autoriteti bankar qendror kosovar nuk e ka pasur, domethënë, instrumentin e huadhënies si shpresë e fundit apo si burim i fundit apo si kreditor i instancës së fundit që tash me nenin 14 e ka dhe shumë mirë që e ka dhe ashtu duhet të jetë. Pastaj, mendoj se është dashur disa terme të futen në përkufizime në kapitullin 1, për shembull solvent, unë jam i bindur se shumë njerëz nuk e dinë çka është solvent, është dashur të shpjegohet aty. Pastaj, kemi denoniminin, që po ashtu është dashur të jetë aty, sepse është një mekanizëm, të them kështu, apo është një diçka në financa që jep një kuptim dhe nuk e kupton lexuesi po qe se nuk e di se çka është dhe shumë njerëz nuk e dinë. Pastaj, esdiarit i është dhënë këtu një kuptim që nuk

dihet, e në realitet është njësi monetare e Fondit Ndërkombëtar dhe është dashur të jetë në përkufizime, mendoj për lexuesin për t'ia lehtësuar jetën.

Sa i përket letrës në vlerë, nëse ka, ne mund ta përdorim tekstualisht sekuritë, që mbase mund ta debatojnë profesionalistët në këto tryezat e rumbullakëta, por edhe letra me vlerë nuk prishë punë. E mos ta zgjas, janë çështje shumë, shumë teknike për të cilat po them më shumë i takojnë ndonjë grupi të veçantë profesionistë të lëmit, të cilët duhet ta diskutojnë mes vete dhe të gjejnë njëfarë modus operanti bashkëkohor mendoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, profesor!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Sigurisht që edhe unë e përkrah në parim. Është ligj i domosdoshëm i cili pritet që t'i hapë rrugë edhe ligjeve tjera që ato çka janë përmendur për depozita, letrat me vlerë e të tjerë.

Kam dy-tri vërejtje parimore, që kanë të bëjnë me emërimet, ndoshta këtu duhet të sqarohet procedura e emërimit edhe atë që është e thënë edhe në Kushtetutë të Republikës së Kosovës, deri te ajo e fundit që unë nuk e pash edhe te dispozitat kalimtare neni 158, që është i Kushtetutës që duhet të marrë në fund edhe pëlqimin e përfaqësuesit ndërkombëtar civil.

Dhe, e dyta, te anëtarët tjerë, domethënë, përpos dy anëtarëve që dihen automatikisht kush janë anëtarë të Bordit, guvernatori dhe drejtori i përgjithshëm i Thesarit, të tre anëtarët tjerë jo ekzekutiv, nuk është e qartësuar se mënyra e përzgjedhjes apo ai paneli i cili saktësohet, siç duket e kufizon konkurrencën e qartë dhe të domosdoshme që duhet të kemi edhe te ato te integriteti dhe të tjerat që thuhet duhet t'i plotësojnë njerëzit që të jenë të emëruar këtu.

E dyta është te neni 60, emërimi i shefit të Auditimit të brendshëm, ku thuhet se do të emërohet nga guvernatori me miratim të Bordit. Edhe këtu nuk flitet për procedurat a do të jetë konkurs i hapur, a do të jetë konkurs publik dhe në këtë tast, duke marrë parasysh rëndësinë e Auditorit të brendshëm, mendoj që patjetër duhet t'i ketë këto, sepse edhe puna që do ta bëjë, është gati e njëjtë gjatësia, domethënë dhe mendoj që, nëse këto nuk do të hyjnë, atëherë edhe pavarësia e tij edhe shkarkimet mund të mbetet diskutabile.

E treta dhe e fundit që do ta potencoj, është shpërblimi. Shpërblimi thuhet që është një pjesë që i dedikohet këtyre anëtarëve të bordit, por e ka dhe duhet të jetë e tillë që të rekrutohen dhe të mbahen ekspertë dhe zyrtarë të kualifikuar. Pika 2 flet që kjo duhet të parashihet në buxhetin e vitit kalendarik, ndërsa me nenin 64, ku flitet për buxhetin vjetor nuk parashihet shpërblimi mbasi është përmendur edhe me nenin 39. Unë jam pak skeptik, duke marrë parasysh që këtë formë po e përmend Trustin Pensional, për shembull që akoma menaxhojnë me taksën menaxhuese dhe nuk e kemi të qartë mënyrat e shpërblimit, fundin e vitit e të tjerë.

Dhe e fundit, zotëri ministër, pasqyrat financiare dhe raportet vjetore. Neni 59, thotë: Banka Qendrore duhet të përgatisë pasqyrat financiare për vitin e saj financiar. Edhe pika 2 thotë se brenda 6 muajve, pas mbylljes të çdo viti të tij financiar dhe ne nuk e dimë cili këtu nuk është, cili është viti financiar. Pse mos të jetë për shembull si ligjet tjera që është 31 marsi apo një datë e caktuar, caktohet edhe 6 muajshi dhe atëherë e kemi të qartë edhe ardhja e raportit në Kuvend edhe paraqitja e pasqyrave financiare? Nuk po e përmendi edhe bashkëpunimi që e kemi me institucionet tjera publike, ku thotë: guvernatori me ministrin, do me thënë i qartëson disa, ndërsa drejtori i përgjithshëm i Thesarit si pjesë e Ministrisë, është anëtar i bordit.

Ndoshta edhe në atë aspekt duhet të precizohet edhe roli si anëtar i ekzekutiv edhe roli në raport me institucionet publike, konkretisht me ministrin për Ekonomi dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Regjia, le t'i thërret deputetët të hyjnë brenda se janë edhe dy që do të flasin. Nerxhivane Dauti e ka fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për Bankën Qendrore, është një ligj me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës, ligj për të cilin jam interesuar që të shqyrtohet në Kuvend, e për të cilën kam parashtruar pyetje parlamentare, andaj e përshëndes ministrin e Financave për sjelljen e këtij Ligji në shqyrtim.

Projektligji për Bankën Qendrore, përcakton kornizën ligjore të një banke qendrore moderne me të gjitha atributet e nevojshme për arritjen e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në këtë ligj. Objektivi parësor i Bankës Qendrore, është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave, të mbështesë politikat e përditshme ekonomike të Qeverisë.

Ligji mbështetet në parime të rëndësishme, siç janë ai i ekonomisë të tregut të hapur, me konkurrencë të lirë duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve e duke ndaluar në këtë mënyrë konkurrencën jo lokale në treg dhe marrëveshjet monopolistike. Në mënyrë që të arrijë objektivat dhe të përmbushë detyrat e veta, ligji i propozuar i ofron mundësinë Bankës Qendrore që të veprojë në tregjet financiare, me blerje dhe shitje, me huadhënie ose huamarrje të instrumenteve të tregtueshme si dhe të metaleve të çmuara, të kryejë operacione kreditore me bankat dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut që veprojnë në Kosovë, me huadhënie të mbështetur në kolateral adekuat. Ligji i propozuar përcakton shprehimisht se Banka Qendrore do të jetë ekskluzivisht përgjegjëse për rregullimin, licencimin, regjistrimin e mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë.

Projektligji për Bankën Qendrore, është në përputhje me Traktatin e Komisionit Evropian si dhe me statutin e sistemit evropian të bankave qendrore. Ligji të cilin jemi duke e shqyrtuar, është i lidhur edhe me ligjet tjera të veçanta, siç është ai i letrave me vlerë dhe Ligjit për sigurimin e depozitave, ligje të cilat janë në agjendën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë vit, prandaj konsideroj se Ministria për Ekonomi dhe Financa i ka parasysh dhe do të na i sjell në shqyrtim në Kuvend, duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që kanë letrat me vlerë për sistemin bankar dhe sigurimin e depozitave.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, e mbështesë projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë pajtohem me të gjithë parafolësit se vërtetë ky projektligji ka qenë shumë i nevojshëm dhe është mirë që tani e kemi në shqyrtim. Me siguri gjatë amendamentimit, ky projektligj ka mundësi të përpunohet dhe të evitohen mangësitë që i ka, të cilat edhe u vërejtjen dhe u cekën nga diskutuesit këtu.

Unë do të ndalem në disa vërejtje konkrete, do të filloj prej nenit numër 6. Në nenin numër 6, që ka të bëjë me pavarësinë dhe autonominë e Bankës Qendrore, thuhet se Banka Qendre,

anëtarët e organeve vendimmarrëse ose personeli i Bankës Qendrore, nuk do të marrin udhëzime nga ndonjë person apo entitet tjetër, duke i përfshirë entitetet qeveritare. Unë mendoj se këtij neni do të ishte mirë t'i shtohet një paragraf ku do të potencoj se, meqenëse në praktikë mund të ndodhin edhe ndërhyrje, gjë që ka treguar edhe praktika në shtetet tjera, prandaj, do të ishte mirë që të shtohet një paragraf ku do të sqarohet se, në rast se do të ketë ndonjë ndërhyrje, masat që do të ndërmerren.

Neni nr. 8, parasheh detyrat e Bankës Qendrore dhe në këtë nen, pika 1.1, në këtë përcaktohet detyra e parë. Mendoj se në këtë pikë, nuk është e definuar qartë detyra e Bankës Qendrore. Këtu thuhet se detyra parësore e Bankës Qendrore është përcaktimi dhe zbatimi i politikave të një sistemi financiar stabil. Mirëpo, nga kjo lihet të kuptohet ose thjesht të paragjykohej se thjesht politika monetare nuk është, ose hartimi i politikës monetare nuk është detyrë e Bankës Qendrore të Kosovës. Dhe, në realitet politika monetare është pikërisht ajo, do të thotë, kompetencë që do të duhej ta kishte Banka Qendrore e Kosovës, për të mundur për të ndikuar në tërheqjen e parave që gjenden jashtë Kosovës dhe duke e rritur ofertën monetare të ndikojë në normës së interesit.

Neni tjetër, në të cilin do të ndalem, është neni 30, pika 4. Mendoj se duhet të plotësohet. Këtu thuhet "Banka Qendrore mund të operojë regjistër", mungon fjala, do të thotë, duhet të operojë me regjistrin e letrave me vlerë të mbështetura nga shteti. Dhe në fund, është neni 47 në të cilin do të ndalem, është pika 12, ku thuhet se të gjitha veprimet e çdo anëtari të Bordit të Bankës Qendrore, do të mbesin valide, pavarësisht nëse zbulohet ndonjë parregullsi në emërimin për t'u zgjedhur nga kualifikimet e përgjithshme të atij anëtari. Mendoj se ky nen duhet të përpunohet, sepse nuk është në rregull që në rast se zbulohen mangësi, pastaj ato, domethënë, kualifikimin e anëtarëve të Bordit dhe ai do të thotë thjesht ato vendime të mbesin valide. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Është paraqitur edhe Rita Hajzeraj tash. Urdhëro, Rita!

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

E di që jam paraqitur me vonesë, po i kam disa vërejtje të vogla. Sa i përket Bankës Qendrore, e cila e zgjedh vetë auditorin, kjo jashtëzakonisht po më duket konflikt interesi, sepse nuk mundet një autoritet jashtëzakonisht interesant dhe serioz ta zgjedh vetë auditorin, auditorin e brendshëm nuk mund ta zgjedh vet Banka Qendrore, sepse është konflikt interesi. Po ashtu e zgjedh vetë Banka Qendrore auditorin e jashtëm. Kemi, për shembull, kryetarin e Bankës Qendrore, i cili është edhe anëtar i Bordit kryesor edhe po ashtu është anëtar i Bordit ekzekutiv. Unë mendoj në këto dy borde kryetari i Bankës Qendrore duhet të jetë vetëm në njërin prej këtyre bordeve ose kryetar i Bordit qendror, ose anëtar i Bordit ekzekutiv. Nuk mund të jetë edhe anëtar i Bordit qendror, po ashtu edhe anëtar i Bordit ekzekutiv sepse prapë është konflikt interesi, si do ta kontrollojë pastaj punën.

Nëse i referohemi pavarësisë së këtij institucioni, atëherë shohim se është në kundërshtim me nenin e Kushtetutës, i cili është 140, i cili thotë se mbikëqyrjen e këtij autoritetit të Bankës Qendrore është Parlamenti i Kosovës. Ndërsa, sipas këtij projektligji, i jepet një pavarësi totale kësaj banke dhe kjo për mua është e papranueshme. Po ashtu, tek auditorët kur e pata fjalën, jam dakord që auditorin e brendshëm ta zgjedh Banka Qendrore, mirëpo auditorin e jashtëm në asnjë vend të botës nuk ekziston që ta zgjedh Banka Qendrore, dhe këtë autoritet ia jep ky projektligj, me të cilat nuk jam dakord.

KRYESUESI: Faleminderit!

Adem Hajdaraj, e kërkon fjalën, ky është folësi i fundit.

ADEM HAJDARAJ: Kryesues i respektuar, unë e kam kërkuar më herët, ndër të parët, edhe emrat që i keni lexuar më parë, emrin tim e ke lexuar më përpara, nuk kanë qenë edhe dy emra fare. Domethënë, nuk keni të drejtë ta ndërroni sipas partive...

KRYESUESI: Zoti deputet,

Këtu dua një sqarim. Sipas rregullit, rendin e caktoj unë, po unë kam qenë kaq korrekt sa që ju kam caktuar qysh jeni paraqitur. Po ndodhin defekte teknike, nëse i prekni dy herë, anulohet emri. E ke fjalën, urdhëro çka ke për të folur.

ADEM HAJDARAJ: Unë s'e kam prekur, unë e di.

Kryesi e respektuar, deputetë dhe dy ministra janë, se deri tash ishte vetëm një, ju përshëndes! Unë me të vërtetë po mbetem i fundit dhe kur po mbetem i fundit, pastaj edhe s'po di njeriu çka të thotë, mirëpo desha të them përsëri t'i jap do vërejtje, jo ti them ato anët pozitive, sepse i thanë shumë nga diskutuesit e mëparshëm, mirëpo me duket se terminologjia kur shpjegohet në fillim të projektligjit, është plotësisht e gabuar dhe nuk ka kurrfarë arsytimi. Për shembull, thuhet Kuvend nënkupton Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kuvendi, dihet Kuvendi se ligji e ka titullin Republika e Kosovës, Kuvendi. Mandej, çka është edhe më..., president thotë është kryetari i shtetit i zgjedhur sipas Kapitullit V të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Çka kanë nevojë këto sqarime të jepen, dihet kush është presidenti.

E dyta, po veç është fjala për presidentin e Republikës, këtu. Pastaj, ju lutem, mos ndërhyini, unë nuk ju ndërhyra deri më tash. Ministri nënkupton Ministrinë e Financave, pastaj kryeministri nënkupton kryeministrin e Qeverisë. Një kryeministër është, nuk ka tash sqarime të panevojshme këtu të jepen. Unë mendoj që këto vetëm sa e kanë ngarkuar ligjin dhe pajtohem me vërejtjen e Driton Talit, nuk shpjegohen në ligj termat që edhe ashtu nuk kanë qenë të domosdoshëm të përdoren si fjalë të huaja, pra duke mos i gjetur korrespondentët shqip, po megjithatë unë mendoj se ato duhet të shpjegohen, jo këto që janë krejtësisht të qarta. Domethënë, përdoren terma çka është Qeveria, çka është valuta, çka është Kushtetuta. Kushtetua nënkupton Kushtetutën e Republikës së Kosovës, po dihet kur duhet kushtetuta këtu edhe fare s'është e nevojshme ajo. Pra, edhe në fund, për ky çështje që shpeshherë po i them, kjo nënkupton gjithkund sqarohet – nënkupton. Kushtetuta është kjo, kjo, nëse e thua, po nuk është dashur ta thash hiq, ta thoni, zoti ministër. Dy çështje, gjithkund po përdoren kalke, përkthime të fjalëpërfjalshme nga gjuhë të tjera. Për shembull, “mendimi mbi rezervat ndërkombëtare”, jo mbi rezervat, nuk është mbi rezervat, po për rezerva ndërkombëtare, njëqind herë e kemi thanë se kjo është nën ndikimin e serbishte “o”, prandaj duhet “për” ose “rreth”, po ma mirë “për”.

E dyta, të mos përkthehet ligji, po të merret dhe nëse merret si mostër, të gjendet terminologjia shqipe dhe shprehjet adekuate. Sikur na duket se më mirë e themi “presidenti” se “kryetari”, sikur na duket më mirë themi “bordi” se sa “këshilli”. Gjithkund në tekst është përdorë bordi, shiko fjala shqipe këshill, është këshilli i një institucioni, e jo bordi, gjithmonë. Domethënë, kur them unë “Kuvendi”, dihet se është “Kuvendi i Kosovës”, s'kemi nevojë ta përdorim “parlamenti”, se na duket ma e madhe “parlamenti”, na duket ma e madhe fjala “president” edhe më të mëdha këto tjerat, më e madhe fjala “bord” s'është më e madhe, këshilli i një institucioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Kemi mbaruar diskutimin, më nuk ka. Para se të kalojmë në votim, e ka një fjalë ministri. Ministër, shkurt, saktë, shpejt!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I falënderoj shumë gjithë pjesëmarrësit në diskutim, në këshilla, në kritika. Konsideroj që ky është ligji shumë i rëndësishëm për sistemin bankar të Kosovës, për Republikën e Kosovës dhe se vërejtjet e juaja, të gjitha ato që kanë sigurisht validitet profesional dhe kontribuojnë pasurimit të këtij ligji, do t'i inkorporojmë. Sigurisht që do të jem shumë i disponueshëm të punojmë bashkë me komisionet që të përmirësojmë kualitetin e ligjit në të gjitha segmentet të cilat besojmë se janë me vend. Unë dua të sqaroj për disa nga vërejtjet që u dhanë. Disa i kisha sugjeruar që të lexojnë pak më shumë në materien, sepse politika monetare e një vendi mund të zbatohet ose institucioni, Banka Qendrore që ka rolin dominant në politikën monetare, Kosovës i mungon, sepse nuk e ka valutën e vetë. Prandaj, u çudita prej disa folësve, sidomos të sektorit të ekonomisë, kur përmendin se i mungon pjesa e politikës monetare, kur dihet se Kosova s'e ka valutën e vetë, prandaj u befasova pak. Sido që të jetë, konsideroj që disa elemente të këtij ligji janë zbërthyer shumë mirë edhe nga ju, deputetë të nderuar, dhe ekipi im bashkë me ju do të bëjmë gjithçka që është e mundur që këtë ligj ta aprovojmë në kohën sa më të shpejtë të mundshme, është pjesë e paketës së programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Dua të sqaroj që ky ligj, ndryshimi i Ligjit mbi financat publike është vetëm një nen i vogël, Ligji mbi akcizat do të jenë pjesë e paketës, duke përfshirë edhe Ligjin për buxhetin apo rishikimin e buxhetit. Ju falënderoj të gjithëve, dua t'i falënderoj posaçërisht disa deputetë të zëshëm, të cilët arritën ta tejkalojnë veten, të më kërkojnë falje publike dhe kjo tregon madhështinë e shpirtit, sinqerisht, dua ta them shumë sinqerisht, njeriu tregon madhështinë e vetë kur ka kurajë dhe guxim të durojë edhe fjalë nganjëherë kur nuk i takojnë atij personaliteti, por edhe e tregon madhështinë e vetë kur publikisht kërkon falje nga lajthitjet që i ka pasur deri më tani, kështu që i falënderoj shumë. Faleminderit të gjithëve!

KRYESUESI: Unë e falënderoj përfundimisht për këtë diskurs, më shumë miqësor se profesional, në këtë rast, ministrin, ai mu lut që do të vijë, na luti që është mirë ky ligj të kalojë deri më 15 korrik, por më duket e harrove, kështu që lus ta votojmë. 63 deputetë janë, votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota "për", 1 abstenim, kalon ky ligj në leximin e parë.

- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Komunitete dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Presim që me bashkëpunimin me ministrin dhe me Qeverinë ky ligj të kalojë në kohën e dobishme për nevojat e Kosovës, si tha ministri.

Kolegë të nderuar, pushimi i drekës deri në orën 15:00. Ju pres këtu!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: I lus deputetët që të marrin vendet e veta sepse do të vazhdojmë punën! Do të kalojmë në pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. E ftoj ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar, që ta paraqesë projektligjin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim të ndërtimit të infrastrukturës së re ligjore në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, veçanërisht në zgjidhjen e problemeve të mbrojtjes së natyrës në Republikën e Kosovës, sot dëshiroj t'ju prezantoj Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Nxjerrja e këtij ligji është e nevojshme për faktin se me ligjin ekzistues shumë çështje nuk janë të përfshira, duke filluar nga transpozimi i dispozitave nga direktiva për ruajtjen e zogjve të egër, që njihet si Direktiva e parë e Bashkimit Evropian në fushën e ruajtjes së natyrës. Direktiva për ruajtjen e vendbanimeve natyrore, të florës dhe faunës së egër dhe Konventën ... mbi tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Këto kërkesa dhe rekomandime dalin nga vlerësimi i përshtatshmërisë së legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, Raporti i monitorimit të progresit i vitit tretë.

Rekomandimet dhe sugjerimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë janë marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së këtij projektligji. Legjislacionin në fuqi e përbën Ligji për mbrojtjen e natyrës vitit 2006, si dhe rregulloret e UNMIK-ut të cilat janë vlerësuar si të mangëta dhe të pazbatueshme, në një mënyrë janë bërë pengesë për ushtrimin e përgjegjësiive të institucioneve kompetente për mbrojtjen e natyrës.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës të cilin sot po e shqyrtojmë, është hartuar duke u bazuar në standardet e Bashkimit Evropian dhe është plotësisht në harmoni me konventat, direktivat dhe marrëveshjet nga lëmi i mbrojtjes së natyrës, ndërsa teksti është sipas teknikave të reja juridike.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës në mënyrë përmbajtësore dhe të saktë adreson rregullimin e çështjeve lidhur me mbrojtjen e pjesëve të territoreve të vlefshme të natyrës, llojet e bimëve, shtazëve dhe vlerave të trashëgimisë natyrore sipas koncepteve bashkëkohore.

Të nderuar deputetë,

Dispozitat e këtij projektligji lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, zhvillimin dhe përparimin e natyrës rregullojnë: shfrytëzimin racional të natyrës dhe të mirave të saj pa dëmtimin ose degradimin e pjesëve të saj dhe sa më pak dëmtim të përbërësve të saj, mënyrën e parandalimit të veprimtarive të dëmshme të njerëzve dhe çrregullimeve në natyrë si pasojë e zhvillimit teknologjik të vendit dhe sigurimi i kushteve sa më të volitshme të zhvillimit të lirë të natyrës, nxjerrjen e dokumenteve strategjike si: strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitet, planet e menaxhimit për zonat e mbrojtura, planet hapësinore për zonat e veçanta, masat e mbrojtjes dhe dispozitat tjera përcjellëse të cilat garantojnë mbrojtjen dhe shfrytëzimin e natyrës dhe të mirave të saj, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e pjesëve të mbrojtura të natyrës dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre për përfitimet dhe mirëqenien e komuniteteve që jetojnë në ato zona.

Projektligji përbëhet nga XV kapituj dhe ka gjithsej 177 nene. Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese, si dhe për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës në masë të plotë do të ndikojë në krijimin e infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe do të jetë bazë për mbrojtjen e vlerave të natyrës si: rezervati strikt i natyrës, parku kombëtar, zona e veçantë, parku i natyrës, monumenti i natyrës, peizazhi i mbrojtur, monumenti i arkitekturës së parkut.

Projektligji rregullon edhe procedurat e ndërhyrjeve në natyrë ose qarkullimin, tregtinë me llojet e bimëve dhe të kafshëve, si dhe vendos masa ndëshkuese për shkeljet në këtë fushë si për personat fizikë, po ashtu edhe juridikë.

Gjithashtu, me këtë projektligj definohet përgjegjësitë e institucioneve për mbrojtjen e natyrës.

Të nderuar deputetë,

Duke ju falënderuar paraprakisht dhe duke besuar që vërejtjet, sugjerimet nga ana e juaj këtë projektligj do ta bëjnë edhe më të kompletuar, ju përsërisht të gjithëve dhe ju ftoj ta miratoni projektligjin në leximin e parë. Ju faleminderit edhe një herë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Në emër të komisionit funksional, nuk ka të paraqitur, nuk ka në emër të komisioneve tjera.

Atëherë, kalojmë në paraqitjet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të PDK-së, deputetja Elhame Hetemi.

ELHAME HETEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj shfuqizon dhe zëvendëson Ligjin për mbrojtjen e natyrës nr. 02/L-18 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/22. Me këtë projektligj rregullohet sistemi i mbrojtjes dhe i ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe të vlerave të saj.

Projektligji adreson mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore në gjendje të baraspeshës natyrore, përtëritjen e natyrës në zonat e dëmtuara ose të pjesëve të tyre dhe kompensimet për dëmet e shkaktuara, vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, të sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës, çka do të thotë se fushëveprimtaria të cilën e rregullon ky projektligj është mjaftë e gjerë dhe me kosto të lartë buxhetore. Përkundër sqarimeve që na i dha zoti ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se ky projektligj i përafrohet madje edhe sqaron se i plotëson standardet e BE-së, bashkë me projektligjin, të bashkangjitura i kemi edhe dy deklarata: deklarata e ndikimit buxhetor dhe deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së. Sipas deklaratës së pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, në këtë deklaratë thotë se Projektligji në fjalë për kontroll të pajtueshmërisë është dërguar në Drejtorinë e përgjithshme të mjedisit në Komisionin Evropian në Bruksel, të njëjtit kanë proceduar me lëshimin e tabelave të pajtueshmërisë dhe përmbledhjes, ku kanë analizuar përputhshmërinë e projektligjit me legjislacionin e BE-së në fushën e mjedisit.

Si përfundim, mund të themi se projektligji plotësisht nuk është i përafëruar, projektligji, po e përsëris, plotësisht nuk është i përafëruar, e mos të flasim për plotësimin e standardeve me legjislacionin e BE-së, aktet tjera dhe si sugjerim thotë se këto mund të plotësohen në një farë forme me akte tjera normative, të cilat duhet të nxirren me qëllim të respektimit të standardeve në fushën e mjedisit. Ndërsa, sipas deklaratës së ndikimit buxhetor, ky projektligj ka implikime të mëdha buxhetore.

Në përmbajtje, në strukturë juridike, ky projektligj mund të shqyrtohet në procedurë në komisionet funksionale dhe pikërisht këtë punë ne do ta bëjmë, si anëtarë të Komisionit funksional për Mjedis, por mbeten këtu të qartësohen dhe dilemat tona pikërisht janë në mundësinë e zbatimit të këtij ligji në praktikë për çështje të implikimeve buxhetore. Për këto dhe çështje të tjera, në parim e mbështesim këtë projektligj, që të hapim rrugë sepse ky ligj na

është paraqitur edhe në Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe është në Planin e punës së Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, por gjithsesi dilemat tona mbetin këtu, a do të gjejë zbatim ky ligj në praktikë për çështje të implikimit buxhetor dhe standardeve të përafërimit me legjislacionin e BE-së.

Zoti ministër, ne presim që këto sqarime dhe të tjera vërejtje që kemi në projektligj, t'i diskutojmë dhe të konsultohemi gjatë shqyrtimit në komisionin funksional. E përkrahim në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të LDK-së, deputetja Myrvete Pantina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka analizuar me kujdes Projektligjin për mbrojtjen e natyrës dhe mendojmë se Kosova ka nevojë për një ligj që rregullon fushën që ka të bëjë me mbrojtjen e natyrës, me qenë se ligji mbi mbrojtjen e natyrës nr. 02/L-18 nuk e ka rregulluar në tërësi lëmin e mbrojtjes së natyrës, prandaj edhe mendojmë se ky projektligj duhet të miratohet, në parim.

Me projektligjin në fjalë synohet të sigurohen parakushtet për ruajtjen e tërësishme të natyrës, përkatesisht të larmisë biologjike dhe peizazhore, si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të të mirave të natyrës.

Mënyra klasike e konceptit të mbrojtjes së natyrës ka qenë deri në fillim të viteve 1990, por pas nxjerrjes së Konventës për larminë biologjike dhe peizazhore në vitin 1992, koncepti ka ndryshuar dhe kuptimi i mbrojtjes së natyrës është zgjeruar në ruajtjen e gjithë larmisë biologjike dhe peizazhore.

Lëshimet eventuale dhe plotësimet në këtë projektligj, natyrisht se do të mund të evitohen gjatë fazës së amendamentimit të këtij projektligji. Mirëpo, unë me këtë rast do t'i cek disa vërejtje.

Përmbajtja e neneve dhe të paragrafëve pasues në këtë projektligji bie ndesh në disa raste me përmbajtjen e neneve dhe të paragrafëve të mëparshëm, si për shembull neni 11, paragrafi 4, ku thuhet: "Në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës", kurse në nenin 132, paragrafi 6, thuhet: "Për punët dhe ndërhyrjet të cilat kryhen në bazë të planeve menaxhuese për menaxhim në pylltari, gjueti, ekonominë e ujërave, peshkatari dhe xehetari nuk nevojitet leja paraprake në rastet kur planet e menaxhimit përmbajnë kushtet për mbrojtjen e natyrës". Ndërsa, me planet menaxhuese për sektorët e përmendur, përpos veprimeve tjera, veprimet kryesore të parapara janë të natyrës ekonomike. Po ashtu, gjatë fazës së përpunimit të këtij projektligji duhet pasur kujdes në një bashkëpunim më të madh në mes të palëve në interes, si dhe në harmonizimin e këtij projektligji me ligje të tjera. Konkretisht, përkufizimi – mineralet, është definuar ndryshe me Projektligjin për miniera dhe mineralet, ndërsa ndryshe është definuar në Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Ndërsa sa i përket kostos buxhetore, ky projektligj do të ketë kosto shtesë buxhetore, që lidhet drejtpërsëdrejti me themelimin e organeve të reja që janë të parapara të themelohen sipas këtij projektligji, ka të bëjë me mbikëqyrjen inspektuese. Mirëpo, në bazë të këtij projektligji, pritet të realizohen edhe të hyra nga shfrytëzimi i të mirave të natyrës. Por, duke ditur gjendjen aktuale të natyrës në vendin tonë, trajtimi i kësaj fushe nëse vendoset të përkrahet nga buxheti i Kosovës, mund të pritet pra që të jenë ndikime me efekte të larta buxhetore në buxhetin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Në emër të AAK-së, deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim i japim mbështetjen këtij projektligji, mirëpo mbështesim edhe disa nga vërejtjet dhe sugjerimet të cilat dhanë kolegët më herët, posaçërisht mundësinë e implementimit të këtij projektligji. Ne do të dëshirojmë apo do të kërkojmë që ky projektligj mbas miratimit që do të bëhet në Parlamentin tonë, të funksionalizohet posaçërisht që ka të bëjë me çështjen e inspektorateve sepse, ju e dini, një pjesë e mirë e begative natyrore, resurseve të caktuara janë duke u shfrytëzuar në mënyrë jolegale. Prandaj, problemi i parë ishte, ajo që u potencuan më herët, a mundet ky projektligj mbas aprovimit dhe mbas funksionalizimit përmes inspektoratit të kryejë misionin e vet apo do të mbetet ashtu, si shumë inspektorate, të cilat realisht në praktikë nuk po mund të funksionalizohen.

Problemi i dytë që janë edhe ato problemet buxhetore dhe harmonizimi i mëturjes me infrastrukturën tjetër ligjore, është mungesa e një plani hapësinor në vendin tonë. Jemi i vetmi vend, më duket, në këtë pjesë të Evropës që nuk kemi plan hapësinor. Kemi pasur dikur një plan në vitin 1975 dhe Kosova zhvillohet, ecë apo çfarë situatë kemi, nuk kemi plan hapësinor. Kryhen planet në të gjitha nivelet, por Kosova nuk ka plan hapësinor. Prandaj, ky ligj nga ana e grupit tonë do të mbështetet, kërkojmë që të implementohet, mirëpo njëkohësisht hapim disa nga problemet, siç është mungesa e planit hapësinor, çështja e parqeve nacionale. Në parim, e mbështesim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Në emër të AKR-së, deputeti Haset Cakolli.

HESET ÇAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e natyrës ka për qëllim kryesor të rregullojë në mënyrë të përgjithshme mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht të zëvendësojë Ligjin nr. 02/L-18 dhe Rregulloren 2006/22, ku këto dy dokumente kanë rregulluar vetëm disa çështje themelore lidhur me mbrojtjen e parqeve nacionale dhe të pjesëve tjera të mbrojtura të natyrës.

Edhe Grupi ynë Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe përkundër disa vërejtjeve të veçanta dhe të përgjithshme, jemi pajtuar që ky projektligj të procedohet në komisionet funksionale për shqyrtim, ndërsa kontributin tonë do ta japim nëpërmes anëtarëve tanë në komisionet funksionale përkatëse kur do të shqyrtohet ky projektligj, me qëllim që pasi që të aprovohet ky projektligj, të fillojë të zbatohet në praktikë pa vështirësi, duke pasur parasysh vështirësitë të cilat vetëm i përmendën disa nga kolegët tanë. Por, unë besoj se ky projektligj, më në fund, do të fillojë dhe do të zbatohet në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Në emër të LDD-së, deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHAERRI: Me kartelën time, s'ka kartelë!

KRYESUESI: Ani, trego që është me letër të saj, se emri është i Besës.

Lulzim Zeneli!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, trajtimi i një ligji bazik, siç është Ligji për mbrojtjen e natyrës, kur kemi të bëjmë me zëvendësimin e ligjit të vjetër do të duhej që të kemi një argument shumë më të fuqishëm pse Kuvendit të Kosovës i është proceduar ky dokument dhe çka në thelb zëvendëson dokumentin e vjetër apo ligjin që deri tash ka qenë në fuqi.

Duke pasur parasysh se neni 4 i këtij projektligji determinon qartë natyrën dhe vlerat e trashëgimisë natyrore, janë resurs me interes nacional, dhe duke pasur parasysh se qëllimi kryesor i ligjit ka të vendos baraspeshën në mes të shfrytëzimit të kësaj pasurie nga vetë qytetarët e Kosovës, atëherë vetvetiu lind pyetja për deputetët, veçanërisht për të gjithë ata të cilët mendojnë se këto vlera të natyrës duhet të ruhen në përmasat shumë më serioze nga ajo që mund të trajtohen sot. Dhe do të lindte pyetja – çka në fakt, në thelb, përmban ky projektligj nga ai i kaluari, cili është ndryshimi?

Unë dua veç t'ua rikujtoj se nga neni 139, i këtij projektligji deri te neni 150, e trajton vetëm një çështje të cilën nuk e ka trajtua ligji paraprak dhe këtë duhet ta thotë edhe ministri para deputetëve të Kuvendit. Dhe kemi të bëjmë me koncesionimin e resurseve natyrore, të parqeve natyrore. Dua t'ia rikujtoj vetëm ministrit se neni 140, paragrafi 1, koncesionimi nuk mund të jepet në rezervatin strikt, pra në ato hapësirat ku ekzistojnë resurse të veçanta natyrore dhe shfrytëzohen enkas për misione të caktuara në interesin shtetëror. Ndërsa në paragrafin 3, që është një diskrepancë e madhe nga ajo që është thënë më herët, koncesioni në parkun kombëtar dhe rezervatin strikt të natyrës mund të jepet në pajtim me planin hapësinor të zonës, e kështu me radhë, do të thotë, paragrafi 1 e ndalon, paragrafi 3, në kuadër të njëjtit nen, e lejon, kjo është diçka që duhet ta sqarojë ministri para deputetëve.

Çështja tjetër ka të bëjë me shfrytëzimin e këtyre resurseve. Neni 11, paragrafi 4, ndalon shfrytëzimin ekonomik të të mirave të natyrës në kuadër të një parku nacional dhe në veçanti në zonat strikte të mbrojtura, ndërsa në nenin 132, e lejon, prapë është një diskrepancë në kuadër të këtij ligji. Ajo çka neve po na dhemb dhe vazhdimisht se çështjet që kanë të bëjnë me interesin shtetëror, që ne me gojën plotë i proklamojmë vazhdimisht ato resurse, trajtimi përmes disa bërthamave të vogla në ligj, që të kalojnë në suazat e përfitimit të politikave ditore, nuk i bën nder as këtij Kuvendi që mos ta trajtojë seriozisht, mirëpo edhe një projekt të tillë Qeveria duhet ta sqarojë, të ketë përgjigje.

Prandaj, zoti ministër, nëse e keni ndërmend që parqet e natyrës dhe këto rezervate strikte t'i jepen me koncesion, ju duhet ta njoftoni këtë Kuvend se çka fiton Kosova nga ajo dhe a duhet të trajtohen edhe pas miratimit të këtij ligji si zona me interes nacional. Nëse jepen me koncesion parqet natyrore dhe zonat e veçanta të mbrojtura strikt, këto janë në kundërshtim edhe me konventat ndërkombëtare. Ju e dini se në zonat strikte të mbrojtura ekzistojnë specie të caktuara të cilat janë të mbrojtura me konventa ndërkombëtare. Prandaj, shteti ka për obligim që vazhdimisht t'i ketë nën mbrojtje dhe kontroll strikte, përndryshe sikurse Kosova të ishte anëtare e mekanizmave ndërkombëtarë, një çështje e tillë do të trajtohej pak më ndryshe dhe aq më shumë kur mbrojtja e mjedisit është standardë shumë të rreptë në proceset e integritetit euroatlantik.

Prandaj, zoti ministër, gjitha këto të cilat i ceku dhe kjo, edhe një po ju theksoj, koncesionimi i zonave të mbrojtura të natyrës është elementi bazë i cili trajtohet në këtë projektligj dhe që dallon nga ligji i kaluar. Prandaj, është mirë që para deputetëve të këtij Kuvendi të jepet një përgjigje se çka synon Qeveria në kuadër të këtij projektligji. faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Në emër të Grupit “7+”, deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!
Pozdrav svima!

Nacrt zakona koji je danas pred nama je od izuzetnog značaja, jer uređuje jednu jako značajnu oblast. Uređuje sistem održavanja opšte zaštite prirode i njene vrednosti. Odredbe ovog zakona se neće primenjivati u slučaju pretnje neposredne opasnosti po ljudske živote, ljudsko zdravlje i imovinu.

Nacrt zakona je zaista sadržajan i sveobuhvatan, a sve u cilju zaštite životne sredine, odnosno prirode. Organizacija zaštite prirode, po ovom Nacrtu zakona će zahtevati malo duži vremenski period radi izgradnje, odnosno uspostavljanja mehanizama, kao što su institut, prostorni plan nacionalnog parka, parka prirode, zatim gojori se o pravilniku, unutrašnjem redu nacionalnog parka, o upravi koja donosi status, plan upravljanja i još mnogo podzakonskih akata. Međutim, životna i ekonomska dinamika čoveka je dovela do velikog narušavanja prirode i njene ravnoteže, a takođe i izgleda. Svedoci smo svakodnevnog nicanja različitih objekata pored glavnih saobraćajnica, iskopavanja i eksploatacija šuma, čime se narušava priroda i ugrožava biljni i životinjski svet, narušava lepota nacionalnih parkova.

Krajnje je vreme da se zapitamo – da li je neophodna gradnja različitih objekata na prostranim plodnim ravnica na kojima se mogu zasadi razne poljoprivredne kulture. Smatramo da oštrim sankcijama i kaznama možemo doprineti očuvanju životne sredine, naravno i zaštiti prirode.

Inače, Parlamentarna grupa „7+“ podržava ovaj Nacrt zakona, u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Atëherë, dy grupet tjera parlamentare, SLS-ja, s'ka, për Integritet, s'ka.
Kalojmë me diskutimet e deputetëve. Deputeti Rexhep Hoti e ka fjalën.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Projektligji për mbrojtjen e natyrës, i përgatitur me ndihëm e Bashkimit Evropian, plotëson standardet duke ju referuar në këtë rast edhe komenteve të bëra nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, veçmas të atyre të Bashkimit Evropian, në kuadër edhe të mekanizmit përcjellës, si dhe konsultimet e fundit në Bruksel, në maj të vitit 2010.

Nxjerra e këtij ligji është me rëndësi sepse krijon bazën për një mbrojtje më të avancuar të zonave të mbrojtura të natyrës, të llojeve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve, si dhe të vendbanimeve natyrore.

Sfidat me të cilat do të përballemi me ndërtimin e këtij projektligji janë mungesa e mjeteve buxhetore për zbatimin e programeve dhe të planeve për mbrojtjen e natyrës, që parashihen me këtë projektligj të nxirren, kështu që krijimi i Ekofondit do të ishte shumë me rëndësi për suksesin e këtij projektligji gjatë zbatimit të tij. Projektligji në fjalë krijon bazën për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura, si për shembull, parku kombëtar “Mali i Sharrit”, parku kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, zonat e rëndësishme të zogjve e tjera.

Mirëpo, rëndësi e veçantë është edhe mundësia për nxjerrjen e dokumenteve, siç janë Strategjia dhe Plan i veprimit për diversitet 2010 – 2020. Konsiderojmë se është me shumë rëndësi nxjerrja sa më parë e këtij ligji në çdo hap të rrugës dhe të veprimeve të reja për mbrojtjen e natyrës, sepse me këtë na obligojnë edhe përcaktimet drejt integriteteve tona në Bashkimin Evropian. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e merr deputetja Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: I nderuar zoti kryesues,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

Janë dy shkaktarë kryesorë që e shkatërrojnë dhe dëmtojnë natyrën, peizazhin e bukur, baraspeshën e natyrës, si dhe rrezikojnë dhe dëmtojnë llojet e florës e të faunës, sidomos të atyre me interes të veçantë. Këta shkaktarë janë natyra me forcën e saj si tërmetet, erërat e forta me ciklone, reshjet e mëdha me vërshime dhe shkaktari i dytë, më vrastari, i heshtur, është dora e njeriut.

Kosova pas luftës pati fati të shkatërrohet, të digjet deri në themel e të shndërrohet në gërmadha e mbeturina nga një luftë barbare që shkaktoi dora e njeriut vrastar, e që sot po ballafaqohemi me pasoja të saj çdo ditë. Kjo luftë jo vetëm që solli transformimin e natyrës, e shkatërroi, e dëmtoi edhe bukurinë e saj, peizazhin, baraspeshën. Kjo luftë ndryshoi edhe vetëdijen njerëzore, vetëdijen e njeriut e shndërroi nga një njeri që ishte me kulturë për ta ruajtur ambientin, në një njeri primitiv për ta shkatërruar atë, ku dalëngadalë e heshtazi kjo dorë e njeriut Kosovën po e shndërron nga fusha të gjelbëruara dhe peizazhe të bukura në fusha me shtylla betoni. Qytetarët e Kosovës kanë nevojë dhe syri i tyre shumë për hapësirë të gjelbër dhe frymëmarrje me ajër të pastër që është aq i nevojshëm për shëndetin e njeriut, por kjo nuk ndodh në Kosovë. Filtri i frymëmarrjes sonë janë pyjet e Kosovës. Ato sot po shkatërrohen nga dora primitive që për interesat e veta personale e familjare i pret dhe i shkatërron ato, bashkëpunon edhe me kompaninë mafioze vetëm e vetëm për përfitime materiale e personale. Janë bërë shumë padi dhe janë grumbulluar shumë lëndë në organet e drejtësisë që presin zgjidhje, po kush të dënohet, kur këtë shkatërrim të natyrës nuk e bëjnë vetëm njerëzit e thjeshtë, por e bëjnë edhe ata që kanë bërë fushatë për shtimin e zonave të gjelbëruara, e kanë marrë votën e qytetarit, ata që me dorën e vetë kanë nënshkruar dhe dhënë leje për ta shkatërruar bukurinë e Prevallës, Rugovës dhe bukuritë tjera të Kosovës që çdo ditë e më shumë po shndërrohen në zona plehrash e erë tymi.

Të nderuar deputetë,

Shikoni, nuk ka më shumë se 1 – 2 kilometër largësi nga ky parlament dhe mund të arrijmë te Gërmia jonë e bukur, ku qytetarët tanë kanë pushuar, janë relaksuar, edhe sot e shfrytëzojnë, janë shkatërruar bukuritë e saj, janë prerë pishat dhe drunjtë qindvjeçar që veç natyra i ka krijuar dhe janë ndërtuar mure betoni dhe shtëpi me 2000 metër katrorë të betonuara, vetëm e vetëm për 3 dhe 4 persona për të jetuar në te, për t'i realizuar këndjet e tyre. Me leje të kujt – pyesin qytetarët e Kosovës janë ndërtuar këto shtëpi dhe pse këto hapësira të gjelbëruara janë shkatërruar dhe sa zona i shfrytëzojnë ato pa leje. Nuk e di të them – a është turp apo krim! Qytetarit tonë, ata që janë të ndershëm, thonë – edhe turp, edhe krim. Këta njerëz duhet dënuar, kot bëjmë ligje në letra, kur këto ligje i shkatërron dora e atyre që i zgjedh populli për të bërë ligje.

Prandaj, të nderuar deputetë, miratimi i këtij ligji është më se i nevojshëm për jetën e qytetarëve tanë dhe vetë jetën tonë, e cila çdo ditë po dëmtohet nga grimcat e materieve

helmuese që shpërndahen në ajrin tonë e ne e thithim nga djegiet e këtyre materieve. Sipas statistikave, Kosova sot ka ndotje të ajrit nga benzeni, gaz që krijohet nga djegia e benzinës, e që arrin me një përqindje deri 20% në qytetet urbane, ky gaz shkakton sëmundje kancerogjene. Prandaj, duhet të merren masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit në këto hapësira urbane, ku një rol të rëndësishëm e ka ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Drejtësisë, e cila duhet sa më shpejtë, pas miratimit që sot ky ligj do të miratohet për herë të parë, të marrë dhe të organizojë ekipet inspektuese dhe të shtojë kuadro për inspektimin e gjendjes shkatërruese, të ndalen dhe të dënohen. Qytetarët e Kosovës, të nderuar deputetë, kanë të drejtë jetike të gjithë ta shfrytëzojnë bukurinë e natyrës së vet dhe këtë të drejtë duhet ta shfrytëzojnë me bërjen e një ligji sa më të mirë që është në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Deputetja Luljeta Shehu e merr fjalën.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e natyrës ka për qëllim që të krijojë një strukturë ligjvënëse, e cila përcakton dhe vendos sistemin e mbrojtjes së vlerave të natyrës, si të atyre që kanë vlerë të veçantë, si të atyre që janë vlera të tërësishme të natyrës. Sipas këtij projektligjit, që përbëhet nga 277 nene, shumë çështje do të rregullohen, se njerëzit në bazë të dënimeve që mund të marrin nga ky ligj do të kenë kujdes më të madh. Pra, me ligjin e propozuar, në mënyrë të përgjithshme do të rregullohet mbrojtja e natyrës. Pra, rregullohen çështjet lidhur me mbrojtjen e pjesëve territoriale të vlefshme të natyrës.

Në këtë projektligj, ta marrim nenin 31 dhe 32, janë nene shumë domethënëse për mbrojtjen e natyrës, të përfshira në Kreun IV – Zbatimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, rregullohet çështja shumë e përhapur dhe e dëmshme. Ndërrimi i destinimit të tokës apo neni 32 – plehrat dhe pesticidet, të cilat, kur përdoren pa u studiuar zonat ekologjike, mund të krijojnë kundër efekte. Për shembull, rasti i fundit i përdorimit të plehrave artificiale me afat të skaduar, që kanë hyrë dhe janë përdorur nga bujqit, prandaj me këtë do të ketë efekt kontrollimi i skadimit të afatit të plehrave të ndryshme. Njeriu duhet t'i vë vetes detyrë, që në rast se natyrën nuk është në gjendje ta ripërtërijë, të paktën të mos e shkatërrojë më tej. Gjeneratat e ardhshme janë ato të cilat do të jetojnë në mjedisin në të cilin kemi ndikuar dhe ndikojmë dhe një ditë ata do të pyesin se çka kemi bërë ne për ta ruajtur mjedisin, që edhe ata ta të ruajnë.

Ndryshimet të cilat në kohën e fundit po ndodhin në natyrë si pasojë e veprimit të njeriut, janë të shpeshta dhe dinamike. Këto ndryshime janë rrjedhë e eksploatimit të pakontrolluar të resurseve natyrore, të urbanizimit të shpejtë. Obligimi i shoqërisë është që në procesin edukativo – arsimor mbrojtja e natyrës të ketë vend të rëndësishëm.

Nëse e shohim Prizrenin, është një qytet mjaftë i pastër në krahasim me qytete të tjera, ku ende sot e kësaj dite janë duke u ruajtur, si për shembull, Rrapi në Marash të Prizrenit. Mirëpo, nëse e shohim relacionin Prizren – Gjakovë, është një numër i madh i separacioneve dhe natyra është mjaft e ndotur sa nuk mund të jetojë në ato vendet rurale nga pluhuri. Për imazhin e keq të mjedisit të çdo qyteti ose fshatit të Kosovës, janë lënë pas dore ose trajtuar në mënyrë primitive problemet e mbetjeve urbane. Si rezultat i migrimit të popullatës nga fshatrat në qytete për shkaqe të njohura, numri i banorëve të qyteteve është i dyfishuar. Si pasojë e kësaj, kemi shumëfishin e mbeturinave urbane, vendgrumbullimi i mbeturinave ende nuk është

zgjedhur sipas standardeve të kërkuara. Zakonisht, ato grumbullohen në vende të caktuara në sipërfaqe të vogla dhe digjen.

Përpjekjet për të ngritur vendgrumbullime të reja bashkëkohore janë evidente, por ende nuk i përmbushin nevojat. Shpresojmë se këto do të realizohen së shpejti edhe me këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Fjalën e ka zoti Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
Përshëndetje për ministrin që paraqiti projektligjin në fjalë!
I falënderoj edhe deputetët kolegë dhe deputetet!
Po çuditë pak, sikur nuk jemi në Kosovë, po kemi ardhur nga një planet tjetër dhe është për çudi ajo që ndodh sot në Kosovë.

Zoti ministër, a e keni diskutuar ndonjëherë në Qeveri gjendjen reale që është në Kosovë, çka ndodh me shtretërit e lumenjve, pikërisht me shtratin e Drinit të Bardhë, a keni shkuar ndonjëherë prej Xërxe deri në Prizren të shihni se çka ndodh me tokën bujqësore, a e keni parë rrugën për Mitrovicë dhe malet e Berishës, Grykën e Caralevës, të Gllaverës, Zatriqin? A e dini se prej Rahovecit deri në Zatriq 10 deri 12 kilometra është një rrjet komplet privat dhe është një gurthyes që ka leje prej ministrisë suaj.

Po më vjen shumë mirë prej deputetëve se ky ligj që është i harmonizuar me Bashkimin Evropian dhe shumë mirë e ka thënë zoti Tali sot para dite, është një ligj që po na paraprinë edhe po na dërgon neve drejt Bashkimit Evropian, por përderisa nuk ka për të mbetur as shtrat i lumit, as një park kombëtar me të cilin do të mburrimi, atëherë nuk e di edhe çka po na vyen ky ligj.

Thjeshtë, kisha për të qenë i interesuar dhe jam i interesuar, se po jetoj në Kosovë me këto hallet e qytetarëve të Kosovës, por pak më i privilegjuar. A keni pasur takim me kryetarët e komunave ndonjëherë, a jeni ulur ndonjëherë me ministrin e Bujqësisë për t'i diskutuar këto probleme, a i keni diskutuar ndonjëherë se sa është përgjegjësia e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Mjedisit në krejt në këtë mes. Qeveria e Kosovës dhe qytetari i Kosovës duhet ta ketë qartë se po lulëzon një shkatërrim i organizuar dhe natyra në Kosovë po vdes ngadalë me vetëdije të plotë, me një mandat qeverisës që udhëhiqet nga një Qeveri pa plan, pa projekte. Është i vonë ky projektligj, u bënë dy vite, ka mundur kjo Qeveri, keni mundur edhe ju si ministër të keni një strategji, një platformë, nuk është vonë edhe sot, ndoshta me një urdhëresë të veçantë, ta përsëris, nga Xërxa në drejtim të Prizrenit, prej Gjakovë shikoni tokën bujqësore, sa dëmtohet sistemi i Radoniqit, që është ndër sisteme të veçanta, të vetmit të ujitjes në Kosovë dhe bëhet degradim, hiqet dheu për të nxjerrë zhavorr, për të nxjerrë rërë dhe ka mandatar, ka kryetar të komunave, jemi shtet, jemi shtet që po funksionojmë, kemi edhe kushtetutë, kemi edhe ligje, edhe pa këtë ligj, sado që vonohet dhe do të vonojë edhe implementimi, duhet ta kemi një platformë, ta ruajmë natyrën nga degradimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
E ka fjalën Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!
Unë, gjithashtu, përshëndes ministrin dhe i përshëndes miqtë e tanë ndërkombëtarë, po ashtu, për përkrahjen pa rezervë që na japin. Edhe për këtë ligj shpresoj se ua kanë dhënë, edhe ashtu

thatë, përkrahjen pa rezervë. Unë sinqerisht nganjëherë vë në dyshim pse i bëjmë disa ligje. Shikoni, neni 132, nëse nuk gaboj, po ua lexoj, paragrafi 1, thotë: “Në zonën e mbrojtur lejohen ato ndërhyrje dhe punë të cilat nuk i dëmtojnë dhe nuk i ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është e shpallur e mbrojtur” dhe lexoni paragrafet tjera, sheh se kurrfarë veçorie si mbetet zonës mbrojt dhe shtrohet pyetja – pse ti e shpall zonë të mbrojtur. Këtu thotë, përveç kësaj, përveç asaj, përveç kësaj, përveç asaj dhe domethënë e zhvesh në esencë nenin 132, pikën 1.

Pastaj, çka është kjo moda e koncesionimit? Ta japim edhe Qeverinë në koncesion, se edhe ashtu s’është kah i kryen punët, ndoshta i marrin ndonjë para prej tyre. A çdo gjë duhet të privatizohet, ta privatizojmë edhe Qeverinë. Unë shpresoj se miqtë tanë ndërkombëtarë edhe aty do të na përkrahin.

Sinqerisht, unë do ta përkrahja këtë ligj, po të mos ishin neni 139, 140, sepse mendoj që ia humb kuptimin, apo edhe neni 132 e tjera e tjera, se ia humb kuptimin e zonës së veçantë apo parkut nacional e tjera e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
E ka fjalën Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!
Ligjin që e kemi në shqyrtim sot, zëvendëson Ligjin për mbrojtjen e natyrës, të vitit 2006. Është ligj i rëndësishëm, i përgatitur mirë dhe i vëllimshëm, me mbi 200 nene.

Ligji për mbrojtjen e natyrës është ligj bazik, prej të cilit derivojnë edhe shumë ligje tjera dhe me të cilin ndikohen shumë institucionet tona, si Ministria e Mjedisit, ajo e Bujqësisë, e Minierave, e Pushtetit Lokal, komunat, gjykatat, policia e të tjera. Pos tjerash, me këtë ligj rregullohet edhe normativa për funksionimin e parqeve nacionale. Deri tash nuk kemi pasur Ligj për parqet nacionale.

Mirëpo, Ligji për mbrojtjen e natyrës nuk mund të zbatohet pa hartimin e Planit hapësinor të Kosovës, pa hartimin e Strategjisë për mbrojtjen e natyrës, si dhe pa hartimin e Strategjisë për rivitalizimin e sipërfaqeve të dëmtuara, si dhe të disa dokumenteve të tjera.

Prandaj, Ministria e Mjedisit duhet të përgatis sa më shpejt që është e mundur Planin hapësinor të Kosovës dhe strategjitë tjera të përmendura. Faleminderit!

KRYESUESI: Janë edhe këta deputetë që do të flasin: Njomza Emini, Mark Krasniqi, Zylfi Merxha, Gani Buçinca, Armend Zemaj dhe Elheme Hetemi. Fjalën e merr Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Unë, fillimisht dua t’i shpreh pakënaqësitë e mia personale për gjendjen e natyrës në Kosovë, duke e ditur që Kosova ka shumë bukuri natyrore dhe ato nuk janë të mbrojtura. Parimisht, e mbështesë këtë projektligj sepse është i nevojshëm, por dua të shpreh edhe shqetësimet e mia që edhe disa qytetarë të papërgjegjshëm nuk kujdesen sa i përket, do të thotë nuk kanë përgjegjësi apo nuk janë të vetëdijesuar për natyrën që duhet edhe ata të jenë më të kujdesshëm. Kjo ndodh nëpër disa parqe tona, për të cilat duhet ata vetë t’i kenë përgjegjësitë e tyre që t’i mbajnë pastër aty ku janë.

Sa i përket projektligjit, unë mendoj që, zoti ministër, ky është mirë që e keni sjellë këtu, mirëpo deri tash nuk kam parë diçka aktivitete konkrete sa i përket vetëdijesimit, do të thotë, programet që ju si ministri i promovoni edhe vlerat të cilat i ka Kosova sa i përket natyrës, sepse dihet që Kosova me të vërtetë ka bukuri natyrore, po sa ja të mbrojtura ato, nuk po shihen. Edhe sipas turistëve që vinë këtu, shohin që nuk ka hapësirë të mjaftueshme, qoftë edhe për t'i vizituar parqet tona, nuk kanë hapësirë as të rrinë dhe mos të flasim edhe të bëjnë edhe aktivitete tjera.

Ministër, dua t'ju pyes konkretisht juve, deri tani çka keni promovuar tek qytetarët për mbrojtjen e natyrës dhe çka keni promovua ju, si ministri, sa i përket vetëdijesimit të tyre nëpërmjet programeve, sepse e pash edhe në projektligj, nuk keni diçka që duhet sepse ju jeni kompetent sa i përket ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës. Unë nuk do të kisha zgjatë më shumë, sepse u thanë shumë ato çka i mendova, por këto ishin ato për çka unë e pashë të arsyeshme të flas këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit,
Fjalën e merr deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Natyra edhe bota shtazore edhe bimore është një pasuri e përgjithshme, prandaj ne jemi gjithë të interesuar që kjo pasuri të mbrohet jo vetëm me ligje, por edhe me ndërgjegjen e lartë të çdo qytetari. Në qoftë se nuk e përkrahim jo vetëm këtë ligj, por çdo ligj tjetër e do një kulturë të popullsisë, i cili e ka prurë këtë ligj dhe për cilin është prurë, atëherë vetë ligji asgjë s'mund të bëjë. Unë mendoj se në shkollat fillore dhe të mesme duhet të jetë jo si lëndë ndoshta e obligueshme, por të paktën si një lëndë fakultative ose si një kurs disa javësh edhe mbrojtja e natyrës, sepse mjerisht në familjet tona nuk i kushtohet kujdes këtij problemi. Përveç kësaj, dihet se koha e bën të veten dhe familjet nuk e kanë sot atë autoritet ndaj fëmijëve, siç e kanë pasur dikur, megjithëse familja është shkolla e parë në cilën edukohet rinia dhe një popull.

Kur të mbërrihet një shkallë e lartë e vetëdijesimit për mbrojtjen e natyrës e për rëndësinë e saj, sigurisht që ligjet nuk do të kenë nevojë të kenë paragrafe ndëshkuese aq sa i kemi sot, megjithëse edhe ato nuk kanë ndonjë efekt kushedi se çfarë.

Unë kam parë vetë në Amerikë dhe në Slloveni, për shembull, gjatë dimrit familjet atje që janë afër bjeshkëve, afër maleve, i ushqejnë kafshët e egra, sepse në atë kohë janë të rrezikuara që të ngordhin ose nuk kanë ushqim të zakonshëm si e kanë stinëve të tjera. Si për shpezë, ashtu edhe për kafshët e egra, po them, vet kam parë dhe jam habitur sa kujdes kishin. Bile, duke ngrënë darkën në një vend, isha unë dhe u bë aty pyetje – kafshëve çka t'u japin sonte, a ju kemi përgatitur apo jo drekën. Erdhën kaprojtë, unë vetë i kam parë ata dhe ishte një kënaqësi për fëmijë dhe për familjen. Desha të them, duhet ky ligj të përkrahet edhe me edukimin e rinisë, para së gjithash. Ja, merrni, për shembull, rruga kryesore këtu në Prishtinë, vjet ose parvjet janë mbjellë bimët e ndryshme, lisat për t'u bërë dikur, po sot gjysma e tyre nuk janë, i kanë thyer, fëmijët i kanë thyer ato, s'ma merr mendja që dikush i rritur i ka bërë, sepse e ka parë një lis aty ose një krande të vogël dhe hajde ta drejtoj pak ose ta shtrëngoј pak. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, i nderuar kryesues i Parlamentit të Kosovës, ju përshëndes juve edhe stafin e juaj!

I përshëndes dy ministrat, ministren edhe ministrin që e kanë zbukuruar aty, vetëm dy të bukur, ata të tjerët askund s'janë.

Mua po më vjen çudi që para diskutantët e mi aq mirë e dinë, aq mirë kanë folë duke kujtuar se ministri i Ambientit është polic, duhet zhavorrin ta ruaj, duhet malet mos të prehen, duhet rrugët të këqyren, duhet këto... Ai nuk është polic, ai është ministër. Për atë është policia, për ato janë tjera gjëra që i këqyrin. Pse nuk thonë se para këtij ligji i kemi pasur do ligje shumë të ligshhta që s'kemi mundur të përparojmë kurrësesi, i kanë zënë krejt parqet, i kanë zënë krejt rrugët. Tash është bërë ministër për një kohë të shkurtër dhe lypim krejt ta bëjë Kosovën xhenet. Nuk bëhet menjëherë xhenet, le të presin pak. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Merxha na ka sjellë ndër mend vërtet që po bisedojmë për ligj, e nuk është interpelancë për ministrin. Fjalën e merr deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndes ministren dhe ministrin që janë këtu!

Pikërisht desha ta nis diskutimin te parafolësi, te zoti Zylfi, i cili vërtet foli pak, por foli gjëra shumë të sinqerta dhe që kishin të bëjnë edhe me vetë përmbajtjen e ligjit dhe qëllimin e këtij ligji që e ka sjellë Ministria e Ambientit. Tashmë është bërë modë që çdo ligj që vjen në Parlament apo çdo debat që shtrohet në Parlament, të shfrytëzohet për linçimin e Qeverisë, për diskreditimin e Qeverisë nga një pjesë e opozitës destruktive, e cila po tregon shenja të qarta të patologjisë politike si shkak i frustrimeve për shkak të vogëlsisë, kompleksit të vogëlsisë, kompleksi të inferioritetit në shoqëri. Mirëpo, sido qoftë, kështu e ka jeta parlamentare dhe ne do të mësohemi edhe me eksponime dhe ligjërime të tilla politike të cilat fare nuk janë në interes...

KRYESUESI: Zoti deputet, në ligj, në materie!

GANI BUÇINCA: Është një formë e hyrjes paksa intelektuale, mirëpo që në thelb është materia aty. Dhe, si duket, është edhe formë e ligjërimit politik dhe nuk mund t'i ikim në këtë fazë të ndërtimit të institucioneve tona demokratike por, sidoqoftë, vetë kompromitimi është shumë më i madh nga mënyra se si i prezantojnë gjërat në opinion, sesa dobia që e kanë nga kjo mënyrë e destrucionit politik. T'ju them të drejtë, është pak për keqardhje një formë e tillë e zhvlerësimit të përgjegjësive politike ndaj çdonjërit që jemi këtu, mirëpo ja që kështu po ndodhë.

Sa i përket ligjit të cilin po e trajtojmë, është një ligj me rëndësi të veçantë për të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm për brezin tonë, por edhe për brezat që do të vinë dhe ne, si deputetë, kemi përgjegjësi që këtë ligj të mundohemi ta bëjmë sa më të mirë. Aq për sa e kam shikuar unë, unë kam parë që ligji avancon shumë nga ligji paraprak dhe me ndihmën e deputetëve mund të përmirësohet në aspektin përmbajtjesor dhe mund të jetë shumë më i përshtatshëm.

Unë desha t'i them vetëm disa fjalë në lidhje me shfrytëzimin e zonave të veçanta të parqeve nacionale, ku ka një farë lloj konflikti në mes të asaj si duhet të shfrytëzohen ato për qëllime ekonomike. Unë mendoj se nga praktika e shteteve të cilat kanë një vetëdije më të lartë ekologjike, ato zona mund të shfrytëzohen për qëllime ekonomike, mirëpo përfitimet mund të futen ekskluzivisht në mirëmbajtjen dhe ruajtjen e këtyre zonave, domethënë, sipas ligjeve në fuqi. Ta zëmë, për shembull, në Slloveni ekziston një ari, i cili është shumë i veçantë dhe shpesh mund të shpallet ndonjë konkurs ndërkombëtar që shoqatat e gjuetarëve të vinë dhe të vrasin një ari të tillë dhe jepen shuma të mëdha marramendëse parash që një gjuetar anglez ose

gjerman ta ketë në trofeun e vet edhe këtë. Edhe një ari të Koçelës, për shembull, që është një specie e veçantë në botë. Mirëpo, ato bëhen, lejohen me ndihmën e ekspertëve të caktuar të cilët vendosin çfarë veprimtarie të gjuetisë, për shembull, mund të zhvillohen në ato zona. Kështu vlen edhe për veprimtari të tjera, jo vetëm të gjuetisë dhe turizmit. Ne nuk mund t'i lëmë këto zona të pa shfrytëzura pa i futur në funksion të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Desha t'ju them se unë nuk pajtohem me diskutuesin i cili fajëson fëmijët në Kosovë se ata janë përgjegjës për këtë gjendje kaotike që e kemi në ambient. Ne duhet të bëjmë fëmijë, të rrisim fëmijë, se dëmet e fëmijëve në ambient janë shumë, shumë të vogla dhe minore në krahasim me dëmet që i bëjnë, për shembull, ekonomia, teknologjia jo e përparuar, e cila është në kundërshtim me ambientin.

Unë e përshëndes këtë nismë dhe do ta votoj me kënaqësi ligjin, në parim.

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Unë i them regjisë t'i thërrasë deputetët, sepse jemi kah fundi. Fjalën e merr Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti profesor!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Është e qartë që kjo është fushë pak komplekse dhe më shumë ta quaj shkencore. Prandaj, ndoshta edhe për neve na duhen pak më shumë shpjegime në këtë rast. E çmojmë edhe punën e ministrit që ka ardhur deri te një ligj i tillë, por me të vërtetë në përbërjen apo në strukturën e ligjeve janë disa tituj apo aty ku mungojnë tituj në disa nene, prandaj edhe kjo ndoshta na jep një keqkuptim dhe mos ta kemi të qartë.

Unë po i përmendi 2 – 3 shembuj, për shembull, 2 – 3 tituj, që është neni 59 – Ruajtja e livadheve, e flet për diçka tjetër, apo neni 68 - Banka e gjeneve. Unë mendoj që ruajtja e gjeneve do të jetë. Akti për rendin e brendshëm, që flet prapë për pyje dhe neni 96, që është futja pa qëllim, tash me qëllim apo pa qëllim, është futje, është fjala e çkafit, duhet të definohet e çkafit, këtu po mbetet domethënë shumë e pasqaruar.

Vërejtja kryesore, zoti ministër, mund të diskutohet tani edhe në komisionin funksional, është te dispozitat ndëshkimore, nene këto që janë përcaktuar me gjoba, se me këto gjoba, me këto ndëshkime, po të mbeten vetëm në nivel të kundërvajtjes, keqpërdoruesit vetëm do të vazhdojnë me avazin i cili është duke ndodhur deri më tani, sepse ne e kemi parë edhe në praktikë, e përmendën edhe kolegët, me të mirë apo me të keq në forma të veta, kemi parë ne, Kosova është një vend i vogël. Po të kishim territor me mija, qindra mija metra katrorë, atëherë do të ishte mundësia që mos të shihet, po ne çdo ditë shohim natyrën duke u shkatërruar. Unë po e marr një shembull nga komuna nga ku vijë unë, e Deçanit. Në fshatin Strelle, pamja më kryesore tash, pamja më kryesore e një bjeshke, ku ka qenë e njohur, për shembull, po e quaj për gëllia, është shkatërruar totalisht dhe aty ma ka kujtuar atë fjalën që puna e hanë bjeshkën, po nuk e kam pritur që puna e paligjshme e hanë bjeshkën dhe keqpërdoruesit e përdorin vetëm për interesa personale, jo për të mirë publike.

Në komunën tonë e vetmja zonë ku të kënaq syri për ta shikuar, është zona te kisha ortodokse, ku nuk ka gëzua askush dhe ka qenë e ndaluar. Prandaj, këtu po mbetet, nëse mbetet vetëm me këto dispozita ndëshkimore dhe vetëm nëse mbetet në moralin dhe etikën e njerëzve, ato do të shkatërrohen. Ai fakt mua më sjell, sepse vetëm me ndëshkime dhe me masa ndëshkimore dhe aty ku nuk guxohet, po e quaj bukvalisht, aty nuk guxon të preket natyra edhe në këtë rast,

konkretisht, e vetmja natyrë e mbrojtur ka mbetur rreth manastirit të Deçanit, ndërsa po të kalohet më tutje, nuk mund ta gjesh një bredh, si quhet për ilaç, e kemi diskutuar këtu shkatërrimin e pyjeve, duke filluar nga Peja atje, deri në Batushë. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit!

Të tjerë diskutues nuk ka. Fjalën e do ministri, shkurt. Edhe njëherë i thirrni deputetët, për votim!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Edhe një herë falënderoj të gjithë deputetët për sugjerime dhe përmirësime, që sigurisht në procedura të mëtutjeshme do të përmirësohet. Sigurisht që çdo ligj nuk është prefekt, ndodhin edhe gabime teknike edhe gabime tjera. Unë jam duke analizuar ligjin dhe sa i përket tri pyetjeve kryesore. Buxheti, unë thashë edhe në shpjegimin, nuk nevojiten shtesa buxhetore të mëdha, sepse e gjithë struktura edhe me ligjin e vjetër ekziston, por për të realizuar dhe implementuar dispozita të reja, do të nevojiten mjete buxhetore, por nuk janë të papërballueshme.

Sa i përket planit hapësinor, vërtet në mandatin e kaluar ju kujtohen të gjithë deputetë të cilët kanë qenë në vitin 2007, është dërguar Plani hapësinor në Parlament, por për fat të keq nuk ka kaluar në procedurat parlamentare për aprovim, kështu që është dashur ta kthejmë Planin hapësinor dhe të inkorporojmë sipas kushtetutës edhe ndryshime me planin e Ahtisarit, po gjithashtu edhe me komuna të reja të inkorporojmë këto ndryshime të reja. Tash është në Qeveri, ku duhet ende të rishqyrtohet nga ministritë tjera, është në fazën e debatit publik, por shpresojmë që së shpejti brenda vitit do të dërgohet ose do të vijë në parlament, për aprovim.

Sa iu përket dallimeve me ligjin e vjetër, vërtet te koncesionet edhe unë nuk jam përkrahës, ka një gabim teknik, të cilin sigurisht do ta përmirësojmë në komisionet parlamentare, sepse janë gabime teknike, të cilat nuk është dashur të kalojnë, por kanë kaluar, tash nuk mund të jap shpjegime tjera, sepse nuk kam informata të mjaftueshme, por janë dallime edhe për parqet nacionale, sepse me ligjin e vjetër nuk ka qenë përfshirë sa janë të nevojshme parqet nacionale, tash është ndoshta një kapitull krejt i ri vetëm për parqet nacionale. Ndërsa në procedurat e mëvonshme do të procedohen vetëm ligjet për shpalljen e parqeve nacionale, së pari parku nacional “Malet e Sharrit”, ndoshta në të ardhmen edhe “Bjeshkët e Nemuna”, por gjithashtu edhe dallimi është te transpozimi i dispozitave, të cilat i kam lexuar prej dispozitave, kështu që edhe një herë ju ftoj, unë jam i gatshëm me ekipin tim të jemi në bashkëpunim edhe me komisionet parlamentare edhe të rregullojmë ligjin sipas direktivave dhe të bëhet i implementueshëm. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI. Faleminderit, zoti ministër!

Kolegë deputetë, ju njoftoj që në sallë janë 55 deputetë, që nuk është numër i mjaftueshëm për të votuar për një ligj. Unë mendoj që nuk është e dobishme të vazhdojmë të diskutojmë pikat e rendit të ditës, sepse që të gjitha kërkojnë votim të kualifikuar, me një përjashtim të pikës 15 që ka të bëjë me njoftimin e Kuvendit për ndërrimet në komisionet parlamentare. Unë mendoj që këtë pikë duhet ta kalojmë sot, janë tri parti që kanë ndërruar anëtarët në komisione parlamentare: PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, në mënyrë që komisionet të kompletohen. Pra, e marrim në dijeni. Nëse doni, t’ju lexoj emrat sipas të gjitha kërkesave. A doni t’i lexoj krejt kërkesat, apo jo? Pra, merren në dije këto plotësime dhe ndryshime që këto tri parti i kanë bërë për grupet parlamentare. Mbledhja vazhdon të hënën. Mirupafshim, faleminderit për bashkëpunim!

E hënë, më 31.5.2010, ora 10:00

Vazhdimi i seancës plenare të datës 27 maj 2010.

Drejtën seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të filluar më 27 maj 2010.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë që do të thotë janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Vazhdojmë me votimin dhe miratimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Kush nuk ka kartela “për”?

Konstatoj se me 55 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe - ----- Planifikim Hapësinor, si Komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropiane.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Duhet ta kalojmë harmonizimin e nenit 47, për shkak se nuk i kemi 80 deputetë.

Atëherë kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

12. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2009.

Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Raportit të Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi apo raportuesin e Komisionit. Fjalën e ka deputetja Selvie Halimi.

SELVIE HALIMI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për ndihmë juridike dhe ashtu si e cekët edhe ju i ka rekomanduar seancës plenare që ta aprovojë këtë raport.

Sipas Komisionit, institucionalizimi i sistemit të ndihmës juridike, në veçanti falas për qytetarët e Kosovës, të cilët nuk kanë mundësi të mjaftueshme financiare për qasje në drejtës, tregon përkushtimin e institucioneve të vendit për ngritjen e nivelit të zbatimit të ligjshmërisë, gjegjësisht për sundimin e ligjit në vend.

Komisioni për ndihmë juridike deri më tash është themeluar dhe funksionon në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2006/36. Gjithashtu, ky Komision është i përcaktuar edhe si kategori kushtetuese sipas nenit 31, paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe sipas nenit 142, është i përcaktuar si Agjencion i Pavarur. Sipas raportit të këtij komisioni të vitit 2009, shihet se Komisioni ka bërë një punë mjaftë të mirë dhe ka realizuar planin e vet për vitin 2009, 90%. Gjithashtu, si rezultat i një marrëveshje të mirëkuptimit me NDP-n ka hapur edhe 5 zyra të reja për ndihmë juridike në 5 komuna të Kosovës. Ajo çka është më prioritare tani për tani për institucionin e ndihmës juridike është Projektligji për ndihmën juridike falas për qytetarët e Kosovës, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili projektligj është tani më në procedurë. Përmjet këtij projektligji Komisioni, po gjithashtu edhe Grupi Parlamentar i PDK-së, mendon se duhet të ndryshojë strukturimi i këtij komisioni, gjegjësisht shndërrimi i këtij Komisioni në agjenci të pavarur dhe të bëhet edhe një riorganizim i punës. Ajo çka duhet të jetë synim i këtij projektligji është rritja e numrit të përfituesve nga ndihma juridike falas me synim në qasje në drejtësi në vend.

Gjithashtu edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim Raportin e Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2009. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetari për Buxhet dhe Financa a e do fjalën, ani merr fjalën ke të drejtë, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Komisionit për ndihmë juridike dhe ka konstatuar se është shpenzuar mbi bazë të asaj që është marrë vendim në Kuvend lidhur me buxhetin për vitin 2009. Unë e mora fjalën vetëm për një fakt të cilën e tha edhe parafolësja ky Komision vepron disi pezull, vepron mbi bazë të një rregulloreje dhe është më se e nevojshme dhe më se e domosdoshme që nëse nuk ka iniciativë ligjore nga Qeveria lidhur me këtë Komision, së paku Kuvendi të marrë një iniciativë që të bëjë Ligjin për Komisionin për ndihmë juridike. Rregullorja është shumë e paqartë edhe për sa i përket çështjes së financimit edhe për sa i përket përgjegjësi, edhe mënyrës së raportimit dhe prandaj mendoj se është nevojë urgjente që të hyhet punës në hartimin e Ligjit për Komisionin për ndihmë juridike. U tha se është kategori kushtetuese dhe si e tillë nuk guxon të na mbetet akoma me Rregullore të UNMIK-ut.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë radha e kryetarëve të grupeve parlamentare, mendoj që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e kreu. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Komisionit për ndihmë juridike. Njëkohësisht është për t'u përshëndetur, sepse është një raport i hartuar mirë dhe pasqyron punën dhe objektivat e paraqitura gjatë vitit 2009 të këtij komisioni.

Duke marrë parasysh se ky komision ka për detyrë që t'u ndihmojë apo t'u ofrojë shërbime juridike njerëzve të cilët janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe njëkohësisht u siguron ndihmë juridike, e kemi të paraqitur në raport shumë të efektshme, efikase dhe gjithëpërfshirëse.

Prandaj, edhe për ne mbetet brengë edhe pasi që është në strategjinë legislative Ligji për Komisionin për ndihmë juridike, i cili duhet të përmbush statusin kushtetues të cilin e ka edhe ky Komision, pasi që është edhe kategori kushtetuese. Prandaj, ajo çka pasqyron si aktivitete të përmbledhura është e paraqitur në regjione, do të ishte mirë të ishte në bazë të komunave, sepse kemi edhe pjesë që është më e nevojshme paraqitja në bazë të komunave, duke marrë parasysh se çfarë shërbimesh ofron edhe për komunitetet, si dhe sensibilizimi i opinionit që të njihet me këtë komision dhe shërbime të cilat i ofron edhe në gjuhë të cilat nuk janë zyrtare.

Prandaj, ne si raport e përkrahim dhe i japim mbështetje në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Gjylnaze Sylja, e ka kërkuar fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i punës së Komisionit për Ndhmën Juridike 2009, është një raport i gjithë aktiviteteve të cilat i ka zhvilluar realisht Komisioni për Ndhmën Juridike në vitin 2009. Kjo kategori është kategori kushtetuese e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por është edhe përmbushje e obligimeve tona ndërkombëtare, duke u bazuar në parimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe në Kartën Evropiane të Drejtave Themelore.

Ekzistimi i këtij komisioni është unik në rajon me qenë se një lloj i tillë i komisionit nuk ekziston në rajon. Tash unë isha përqendruar më tepër në aktivitetet e komisionit, me qenë se komisioni vepron dhe funksionon në bazë të një Rregulloreje të UNMIK-ut 2006/36, është e qartë se kjo rregullore ka shumë zbrazëti, të cilat nuk mund të arrijnë qëllimin kryesor të ekzistimit të këtij komisioni, e që është ofrimi i ndihmës juridike, sidomos grupeve të cënueshme siç janë: gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, ata të cilët ekonomikisht janë të dobët e tjerë.

Duke marrë parasysh situatën aktuale në Kosovë ku ekziston një varfëri e madhe, e qasja në drejtësi dhe sigurimi i kësaj të drejte për qasje në drejtësi është më se e rëndësishme. Ajo çka bie në sy në këtë raport është se ekzistojnë numra se sa çështje janë trajtuar por atë çka duhet Komisioni të marrë përsipër është me të vërtetë cilësia e trajtimit të këtyre çështjeve do të thotë se sa është arrit në këtë aspekt që të trajtojnë këto çështje dhe cila është rezultati i këtyre çështjeve.

Një punë tjetër që ka marrë për vitin 2010 ky Komision është sidomos puna që janë duke bërë në rritjen e efikasitetit të vetë në ofrimin e shërbimeve juridike për qytetarët dhe kjo është

ekzistimi i planit të punës, pastaj i strategjisë për zhvillimin e punës por edhe një organogrami. Duke marrë parasysh këtë për të ritë efikasitetin e këtij Komisioni është më se e nevojshme që të kemi Ligjin për ndihmën juridike dhe prandaj duhet të jetë një ndër punët që duhet të realizoj Qeveria ashtu siç e ka paraparë edhe në strategjinë legjislative.

Një çështje tjetër është lidhur me efektshmërinë e Komisionit se sa ka mund të jetë ky Komision i efektshëm duke marrë parasysh edhe buxhetin e tij si dhe çështjet të cilat i ka trajtuar. Duke marrë parasysh nevojën të cilën kanë qytetarët e Kosovës për të pas qasje në drejtësi dhe një qasje të drejtë për të gjithë qytetarët e Kosovës në parim e përkrahim këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të grupit Parlamentar të AKR-së, për fjalë është lajmëruar deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Përsëendetje për të gjithë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar këtë raport, në tërësi pajtohem me fjalët e parafolësive të mi se është një lëmi e rëndësishme dhe duhet të rregullohet me ligj. Andaj shpresojmë se sa më shpejtë do ta kemi këtë ligj në duart tona dhe do ta miratojmë.

Në parim do ta përkrahim thash, mirëpo i kemi disa vërejtje, për shembull tek faqja 18, edukimi dhe ngritja e vetëdijes së publikut, këtu thuhet se ka pas emitime mbi ndihmën juridike në tri gjuhë, shqip, sërish dhe boshnjakisht, mendojmë që kishte qenë mirë edhe të kishte qenë edhe në gjuhën turke. Mirëpo këtu është mangu kohëzgjatja do të thotë për sa kohë, periudha kohore për sa kohë ka pas emitime si dhe sa herë në ditë, domethënë sa ka mundur opinionin të njoftohet në lidhje me këtë punë apo me këtë ndihmë juridike e cila i ofrohet qytetarit falas.

Në faqe 28, kemi lëmin penale, ndihma e cila është dhënë qytetarit për lëmin penale. Nuk e kemi të qartë edhe pse në raport thuhet se ka pas përfaqësime, mirëpo më intereson sa ka pas përfaqësime sa i përket lëmit penal t'u marrë parasysh se përfaqësimet do të thotë që nuk kanë të bëjnë me avokatët të cilët përfaqësojnë gratis në këtë situatë të cilat ofrojnë ndihmë Komisionit janë shumë të larta, do të thotë janë pa kurrfarë limit dhe për një përfaqësim në lëmin penale shkojnë dhjetëra mijëra euro kështu që kjo kishte me qenë mirë të rregullohet me tarifën e Odës së Avokatëve, mirëpo në këtë rast kishte qenë mirë mu parapa lëmia penale sa më shumë të ndihmohet sepse është një lëmi e cila paguhet shumë e shtrenjtë qysh thashë edhe më herët.

Uroj do me thanë për marrëveshjen e mirëkuptimit të cilën e kanë bërë me Odën e Avokatëve të Kosovës, gjithashtu është paraqitë edhe raporti statistikor apo ma mirë me thanë tabelë, i kemi ndihmat të cilat janë ofruar qytetarëve, e referimi tek avokatët thuhet në numra sa janë referua qytetarët tek avokatët. Mirëpo qysh e thashë edhe më herët unë kisha dashtë në këtë tabelë të kem përfaqësimin e qartë në lëmin penal -civil dhe më shumë penale numrin e përfaqësimeve sa ka qenë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Gani Geci, e ka kërkuar fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për ndihmë juridike, raport të cilin në parim e përkrahim me disa vërejtje. Dihet se Komisioni për ndihmë juridike është themeluar në vitin 2007 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut dhe ne mendojmë që do të duhej të bëjmë një ligj sepse ky Komision për ndihmë juridike sepse ky Komision për ndihmë juridike është një Komision i cili ofron ndihmë juridike personave që kanë bërë vepra penale civile po edhe administrative dhe të cilët nuk kanë fuqi për të paguar mjete për avokatë.

Në këtë kontest unë kisha propozuar ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të shfrytëzojnë ndihmën juridike nga ky Komision, sepse ky komision është i formuar si kategori kushtetuese, prandaj, ministrat të cilët deklarojnë se zero centë i kanë keqpërdorur të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe parat e shtetit të Kosovës, do t'ju duhej një ndihmë juridike falas dhe nuk do të kishte nevojë të formojmë fonde të ndryshme të cilat më vonë po na dalin si fonde shpëlarje parash dhe ne kemi edhe raste në gjyq për këto gjëra. Dhe ne si grup Parlamentar mendojmë që në parim duhet të përkrahet ky raport i këtij komisioni dhe më vonë mendojmë që duhet të bëhet një ligj, sepse boll kemi punuar me Rregullore të UNMIK-ut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati, e ka kërkuar fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala predsedniče!

Pozdravljam sve prisutne!

I Parlamentarna grupa „7+“ je takođe razmatrala izveštaj Komisije za pravnu pomoć i na čelu da podržava. Iz izveštaja se može uočiti i da je Komisija za pravnu pomoć i tokom 2009. godine pružala direktnu besplatnu pravnu pomoć građanima sa teškim materijalnim stanjem, a takvih nažalost ima puno u našoj zemlji.

Komisija za pravnu pomoć pruža pristup pravdi i besplatnu pravnu pomoć najugroženijim i najosetljivijim grupama društva. Najznačajnija aktivnost ove komisije tokom prošle godine bila je potpisivanje sporazuma sa NDP u cilju otvaranja kancelarija za pravnu pomoć u Gračanici, severnom delu Mitrovice, Dragašu, Uroševcu i Đakovici, realizacijom projekta nazvan pristup pravdi. U cilju edukacije i podizanja svesti javnosti za sistem pravne pomoći formirane su i dve pravne klinike.

Komisija za pravnu pomoć je formirala i određene komitete, ad-hoc radne grupe za saradnju sa nevladinim organizacijama, kao i disciplinsku komisiju. Komisija za pravnu pomoć je zakonski obavezna da održi najmanje jedan sastanak mesečno, ali je u 2009. godini održala 18. sastanaka i donela 80 odluka. U izveštaju su opisane aktivnosti okružnih biroa za pravnu pomoć u različitim oblastima: građanskoj, upravnoj i krivičnoj. Zatim saradnja Komisije sa Advokatskom komorom Kosova, sa nevladinim organizacijama. Međutim, Komisija u svom radu suočava se i sa izvesnim poteškoćama i izazovima u sistemu pravne pomoći kao što je nedostatak broja osoblja, nedostatak materijalnih sredstava i slično.

S obzirom da se radi o jednoj jako značajnoj instituciji, neophodno je obezbediti bolje uslove za rad ove komisije kako bi njene usluge bile što kvalitetnije i efikasnije. Takođe, neophodna je izrada Nacrta zakona o besplatnoj pravnoj pomoći koji bi regulisao ovu oblast. Smatramo i da je neophodno da u kancelarijama za pravnu pomoć bude i prevodioca koji će biti na usluzi građanima, pripadnicima pojedinih zajednica kojima je potrebna pravna pomoć da bi lakše ostvarili svoje pravo na pravnu pomoć. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së a e do dikush fjalën? Jo. Vazhdojmë. Në emër të Grupit për Integritet, fjalën e ka kërkuar deputeti Danush Ademi. Te unë veç Danush Ademi, ka qenë.

VEZIRA EMRUSH: Karticu imam.

KRYETARI: Mirë.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam predsednika i sve kolege u sali, kao i prisutni ministre!

Danas je pred nama jako važan izveštaj jedne jako važne komisije. Komisija, svi znamo da je prvo funkcionisala na ime UNMIK-ove uredbe od 2006. godine, da je u 2007. godini isto funkcionisala kada je preuzela Vlada Kosova 2009. godine sa namenom da se da pravna pomoć kategoriji građana koji nemaju da finansiraju sami postupak prilikom ostvarivanja prava preko suda. Jako važan izveštaj, ja sam imala dosta vremena da ga analiziram, moram da kažem da se jako malo bavila Kancelarija sa sobom da je skromno dala jedan izveštaj kao što je i skromni budžet same kancelarije. Ovo je obaveza, svi znamo za ovakve kancelarije vlade, da moraju da ostvaruju, da je to pravo na pristup pravdi i na pravedno suđenje, opširno je i ono mora da bude obuhvaćeno i od strane svih vlada u regiji, kao i od strane naše vlade na ime Međunarodne konvencije i sporazuma o ljudskim pravima.

I na direktan način mi znamo da smo sve konvencije priznali putem Ustava Republike Kosova te i imamo obavezu da ovu Pravnu kancelariju ne samo posmatramo kao zakonsku obavezu, nego i pospešivanje same kancelarije radi boljeg pristupa građana koji imaju takvu potrebu. Jako važno kod ovoga jeste da se ova besplatna pomoć u građanskoj i administrativnoj oblasti finansira sama kancelarija od strane budžeta vlade i od strane nevladinih organizacija, vidimo da veliku podršku ima od NDP, a istu taku podršku i u na čelu bi trebalo da damo i mi ovde, posebno vlada.

Vlada je značajan uspeh učinila sa usvajanjem ove kancelarije i samo moram da dam prigovor da je jako skroman budžet da mi moramo više za ovakve oblasti da izdvajamo više iz budžeta, budžet je negde 265 hiljada, tako da je jako mali budžet i kada vidimo organizaciju samih kancelarija, u pitanju su samo 12 kancelarija u pojedinim mestima. Ja moram da podržim posebno kancelariju koja je za Gračanicu, Dragaš, Prizren. Zašto ovo kažem? Tamo gde ima više entiteta mi moramo da pospešujemo ovakve kancelarije, da pristup imaju građani svih govornih područja, kao što govorno područje Albanskog, Srpskog, Bosanskog, Turskog, čak i pristup svim zajednicama, kao što je zajednica Aškalija, Roma, Egipćana da mogu da imaju pristup i svoje službenike u ovom kancelarijama. To neće puno da košta nas i posebno vladu i budžet, ali će imati jako velike efekte na terenu, gde će ljudi imati svoje pravo da se obrate ovim kancelarijama za pravnu pomoć, gde će im se uraditi postupak utuživanja. Vidimo iz samog izveštaja da Komisija daje do znanja da nije mogla da posmatra svaki slučaj iz materijalnih razloga. Zašto ovo kažem? Iz velikog broja postupaka za koje su se građani obraćali, vidimo da je ukupno bilo 1790 postupaka pokrenutih pred ovom kancelarijom, da je samo negde oko 861 postupak rešen, dok je za rešavanje ostalo još 940 ovakvih postupaka, što bi bio i pritisak da ova kancelarija, molim za pažnju, ova kancelarija bi vršila na jedan indirektan način koordinaciju između sudova i građana, pratila bi, nadgledala bi i pravni, kada ima pravnog zastupnika, gde svaka stranka građana nije imala iz jednog razloga sa napomenom da nema finansijska sredstva, bila bi pravno zastupljena te procesi u sudovima ne bi trajali po 10. godina. Ovo kažem iz razloga zato što sam ja imala pravnu pomoć 2004. godine od ove kancelarije, kao obična građanka, i zahvaljujem se ovakvoj humanitarnoj pomoći za koju trebamo da imamo sluha i smisla i normalno para iz budžeta.

Mi podržavamo ovu kancelariju, radi ćemo na tome kao grupa da damo praktične napomene gde bi mogla biti funkcionalnija u kojim sredinama i gde na terenu da postoji zbog rađana a ne zbog sebe ili zbog vlade ili zbog zakona koji je neophodan za pravnu pomoć. Toliko od nas kao grupe. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, për përfundimin e fjalës!

Kemi të lajmëruar për diskutim edhe dy deputetë, nga Lidhja Demokratike Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Institucionalizimi i ndihmës juridike në Kosovë tregon vullnetin e institucioneve të Republikës së Kosovës, për t'ua bërë të mundur qytetarëve të Kosovës qasje në drejtësi si dhe ngritjen e nivelit të sundimit të ligjit në Kosovë. Raporti vjetor për vitin 2009, pasqyron historikun e themelimit të komisionit për ndihmë juridike, mënyrën e organizimit si dhe shtrirjen e aktiviteteve të tij në disa komuna të Kosovës.

Bazuar në Rregulloren 2006/36 në të cilën e mbështet veprimtarinë ky komision, Komisioni për ndihmë juridike nuk ofron mbrojtje të drejtpërdrejtë juridike për personat që kanë nevojë. Ky komision shqyrton dokumentet e atyre që kanë nevojë për ndihmë dhe në mbështetje të tyre i udhëzon palët ku duhet drejtuar ankesat. Pra, Komisioni ofron ndihmë, por nuk u përcjell rastet tutje për shkeljen e të drejtave të njeriut për të cilat qytetarët tentojnë të gjejnë zgjidhje.

Funksionalizimi i ndihmës juridike realizohet përmes tri mekanizmave, Komisionit për ndihmë juridike, Zyrës koordinuese për ndihmë juridike dhe byrove të qarkut për ndihmë juridike.

Komisioni në përbërje prej 9 anëtarëve, punën e vet e bazon në parimet themelore që garantojnë të drejtat e njeriut, duke i ofruar qytetarëve ndihmë juridike falas, por edhe në Rregulloren e sipërmëndur.

Komisioni veprimtarinë e vetë e ushtron përmes 6 komiteteve të cilëve u delegon përgjegjësi të veçanta duke përfshirë buxhetin dhe financa, cilësinë e kontrollit, ankesat, burimet njerëzore, tërheqjen e kontributeve nga donatorët dhe edukimin juridik publikë.

Zyra koordinuese gjatë vitit 2009, ka vazhduar t'i kryejë punët operative ditore dhe është përgjegjëse për administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe mbikëqyrjen e byrove të qarkut për ndihmë juridike.

Byrotë e qarkut funksionojnë në pesë qendra kryesore të Kosovës. Ndër të arriturat më të rëndësishme gjatë vitit 2009, është nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit mes NDI-së dhe Komisionit për ndihmë juridike, ku janë përcaktuar obligimet dhe të drejtat e palëve nënshkruese për projektin e ashtuquajtur "qasje në drejtësi", me qëllim të hapjes së zyrave për ndihmë juridike në komunat e Graçanicës, në veri të Mitrovicës, Dragash, Ferizaj dhe në Gjakovë.

Nga raporti kuptojmë se Komisioni për ndihmë juridike me kapacitetet ekzistuese, qofshin ato njerëzore, organizative, ligjore, në veçanti ato buxhetore, nuk mjaftojnë për t'i përmbushur standardet në drejtësi të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me konventat

ndërkombëtare për realizimin e të drejtave civile, administrative dhe penale. Edhe përkundër këtyre pengesave Komisioni si organ i pavarur për të mbikëqyrë sistemin e ndihmës juridike, efikasitetin e punës ka tentuar ta rrisë në mes trajnimeve për stafin e saj të ndihmuar nga USAID-i, NDI, Instituti i Administratës Publike të Kosovës, Ambasada Amerikane dhe të tjerë.

Përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes së publikut përmes prezantimit të objektivave të punës në tryezat e organizuara dhe në media. Komisioni veprimtarinë e vetë e bazon në parimet themelore që garantojnë të drejtat e njeriut duke iu ofruar ndihmë juridike falas në lëmin e çështjeve civile për 739 raste, që krahasuar me vitin e kaluar po thuhet se është dyfishuar.

Në lëmin administrative për 95 raste, kryesisht në çështjet sociale dhe për realizimin e të drejtës së pensionit. Në lëmin penale është ofruar ndihma juridike për vepra penale për 96 raste, për shkak të mosgatishmërisë për bashkëpunim të Këshilli Gjyqësor të Kosovës për ofrimin e ndihmës në çështje penale, përkatësisht përcaktimin e avokatëve **ex officio**, Byroja e qarkut për ndihmë juridike ka dhënë vetëm këshilla për ndihmë dhe për përpilimin e shkresave.

Komisioni për ndihmë juridike edhe në vitin 2009 vazhdon realizimin e marrëveshjes së mirëkuptimit me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe për vitin raportues ka angazhuar 404 avokatë. Komisioni në raport informon Kuvendin e Republikës së Kosovës se gjatë vitit 2009 janë kryer 861 raste, pra lëndë që janë drejtuar këtij komisioni me ndihmën e tyre, kurse në procedurë janë edhe 939 lëndë.

Ky komision për ndihmë juridike që të jetë efikas, kërkoj nga Qeveria konkretisht nga Ministria e Drejtësisë, që të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të bashkëpunojnë me Komisionin për ndihmë juridike që t'i zgjidhin çështjet civile, administrative se është parakusht për sigurimin e hapësirave, mjeteve materiale dhe stafit të domosdoshëm.

Me këtë rast do të veçoja se pagat e personalit janë jo stimuluese për ekspertët e kësaj fushe që rrezikojnë largimin eventual të personelit ekzistues për ngritjen profesionale të cilëve Komisioni ka mobilizuar të gjitha mundësitë që ka pasur për trajnimin e tyre. Përkrah rekomandimet e Komisionit të prezantuara në raport, por edhe rekomandimet e Komisionit për Gjyqësi dhe Legjislacion, që ndër të tjera është edhe procedimi i Ligjit për ndihmë juridike që komisioni ta programojë punën e vet në bazë të ligjit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe diskutuesi i fundit është deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
Zotëri zëvendëskryeministër, ministre,
Deputetë të respektuar,

Do të përpiqem për qenë më konciz. Fillimisht vetë raporti që është referuar, me titullin nuk përkojnë. Ja pse? Sepse është titulli bombastik, që do të thotë për ndihmë juridike, po në qoftë se i marrim funksionet e këtij komisioni, del se kurrfarë ndihme juridike ky komision as që e ka dhënë as që mund të japë në këtë performancë, pa u bërë një ta quajmë kësaj riformatizim esencial, duhet të rregullohet me ligj. Nuk është ndihmë juridike, të nderuar kolegë, udhëzimi i tipit të policit të trafikut, atje është rruga, atje është adresa. Tek atje fillojnë peripecitë për palën e painformuar juridikisht, madje edhe juristët të konsiderueshëm me njohuri nuk mund të gjendet në kompleksin e akteve ligjore të cilat janë në aplikim se le më palët të cilat janë laike,

a shumica absolute e palëve janë laike, madje konsiderohet edhe juristi, juristja e diplomuar palë laike në procedurë, nuk është kjo pra.

Më pastaj, nuk ka kurrfarë kriteresh, ja një ekzemplar, po si mund të bëhet bie fjala që Prishtina t'i ketë 2 juristë, një asistent që gjykohet se i ka 500 mijë banorë, Graçanica t'i ketë 2 juristë, një asistent, Dragashi 2 juristë, një asistent, Deçani e kështu me radhë. Do të thotë kurrfarë kriteresh elementare për objektivizim si të them të sistemimit nuk ka. Prandaj, unë do të kisha shfrytëzuar edhe këtu këtë rast, por edhe në procedurë të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit do të përpiqem që t'i japim udhëzim Qeverisë për ta përgatitur Ligjin për ndihmën juridike e më te do të duhej të bëhej një riorganizim, një ristrukturim edhe konceptual edhe funksional edhe më pastaj të shohim se si do të punonte. Ju falënderohem.

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe një deputete është lajmëruar për diskutim. Vetëm po ju tërheq vërejtjen, jemi duke shqyrtuar Raportin e Komisionit për ndihmë juridike. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonjusha ministre,

Për rëndësinë e këtij komisioni nuk duhet shumë të flasim, me që ndihmën juridike ky Komision e ushtron falas, dhe po të mos ishte ky Komision atëherë çka do të bënte klasa aq e varfër e popullatës kosovare, si do të mundte të arrinte ta realizonte drejtësinë? Dhe është shumë mirë që numri i lëndëve civile administrative, sociale e të tjera për të cilat këta kanë mandatin të përfaqësojnë, është aq i madh, por ai numër nuk varet nëse ngec një numër tjetër i pashqyrtuar i lëndëve, nuk varet nga ky komision, por varet nga puna e organeve të drejtësisë apo e administratës dhe e organeve të drejtësisë apo e administratës dhe të institucioneve tjera relevante, se ky Komision ka një rëndësi të veçantë fletë fakti se është kategori kushtetuese, dhe jo vetëm kaq, por është edhe kategori e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Prandaj, për të mund ky Komision, në mënyrë kualitative dhe më efikase për ta kryer misionin e vet, mendoj se duhet mbështetje institucionale më shumë se që e gëzon tani.

Në këtë sens kisha propozuar, përveç që e mbështes raportin, por kisha propozuar që në të ardhmen të zhvendosen nga objekti privat dhe të vendosen në objekt publik. Kjo është nën një. Nën dy, të ngritën pagat në mënyrë që në këtë komision të angazhohen njerëz ekspertë, të cilët vërtetë, në mënyrë efikase do ti mbrojnë të drejtat e qytetarëve para gjykatave.

Dhe nën tre, Ligji gjithsesi duhet të nxirret dhe duhet të jetë plotësisht në harmoni me standardet, në mesin e të cilave bie edhe Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Prezent janë 71 deputetë. Me kartela prezentë janë 80 deputetë. Por i kemi nja dy pika, së paku që na duhet votimi i 80 deputetëve "për". Unë po kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që janë këtu, që vërtet të kërkojnë që në seancë të marrin pjesë mbi 80 deputetë, mendoj se është e rëndësishme që këto pika, sidomos pika 16, që të jenë 80 vota "për".

Pasi nuk kemi të lajmëruar për diskutim, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Votojmë Raportin e punës së Komisionit për Ndhimë Juridike.

Me 65 vota "për" asnjë "kundër", 3 abstenime, Kuvendi miraton Raportin e punës së Komisionit për Ndhimë Juridike për vitin 2009.

Pika e radhës është:

13. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009

Komisioni Funkcional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Konkurrencës për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar pjesën financiare të Raportit të Komisionit të Konkurrencës për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Sipas radhës, ftoj kryetarin e Komisionit funksional, Myzejene Selmani apo raportuesin e Komisionit për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë që janë prezentë në seancë,

Në pajtim me rregullën 41 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni Funkcional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur me 11 maj 2010, e shqyrtoi raportin vjetor të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, të datës 24 mars 2010 dhe vendosi Kuvendit t'ia paraqes këtë:

R E K O M A N D I M

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbështes dhe ta miratoj raportin vjetor të punës për vitin 2009 të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, të datës 24 mars 2010.

Duke marrë parasysh se Raporti ka marrë edhe dritën e gjelbër brenda Komisionit Parlamentar, atëherë mbetet të shqyrtohet dhe të miratohet në këtë Seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, a e donë fjalën? Deputeti Gani Koci, e ka fjalën.

GANI KOCI: Nja dy tri fjali. Ju faleminderit, zoti kryetar!

Po e shfrytëzoj këtë rast që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, të përkrah raportin e Komisionit të Konkurrencës. Për sa i përket pjesës financiare, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka pranuar në tërësi raportin e tillë. Kemi pasur fillimisht një raport jo të plotësuar sipas rregullave të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe kemi kërkuar raportim shtesë, të cilën gjë Komisioni i Konkurrencës e ka bërë dhe si të tillë, i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë në tërësi.

Unë dua të theksoj faktin sepse, sikur ne akoma nuk po e kemi idenë dhe njohurinë se është një nga komisionet më të rëndësishme dhe që ka një funksion dhe detyrë dhe përgjegjësi shumë të rëndësishme në kuadër të institucioneve të përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe si i tillë, as nga Kuvendi dhe as nga institucionet tjera, akoma nuk është trajtuar dhe nuk është kah trajtohet. Këtij komisioni së pari i mungon hapësira për punë, gjë që Kuvendi ka ofruar diçka, por është tepër e pamjaftueshme ajo dhe duke pasur parasysh përvojën e komisioneve të ngjashme në vendet tjera, sinqerisht them se ky komision po të vazhdohet me

këtë trajtim, qoftë në aspektin buxhetor, qoftë në aspektin e përkrahjes për ambientim të mirëfilltë, nuk do të mund ta kryejë misionin dhe funksionin e vet që e ka mbi bazë të ligjit. Prandaj, le të jetë kjo edhe si kërkesë.

Ne e kemi diskutuar shumë qartë edhe këtë çështje në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe rreth saj ndoshta është dashur Komisioni Funkcional më shumë të flasë edhe për rolin edhe për rëndësinë edhe për anën funksionale që ka ky komision, gjë që është mirë ne si deputetë ta dimë se cili është roli dhe funksioni dhe misioni i këtij Komisioni, në mënyrë që të trajtohet në mënyrë adekuate.

Edhe një herë po e përsëris që ky Komision, do trajtim të veçantë. Ne po e quajmë Komision, por është një nga agjencitë me të rëndësishme që e rregullon konkurrencën e përgjithshme brenda në Kosovë. Kam pasur një material të një komisioni të një komisioni të ngjashëm të Republikës Federale Gjermane, dhe po ju them sinqerisht po të krahasohet me trajtimin që i bëhet edhe nga Bundestagu edhe nga mekanizmat tjerë qeveritarë këtij komisioni, jemi shumë larg asaj dhe ne vetëm e kemi formuar sa për të thënë dhe deri me tani, akoma nuk po i shohim rezultatet e punës, përgjegjësitë dhe detyrat që duhet t'i ketë ky komision. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Kosovar të Konkurrencës, për të cilin do të paraqes opinionin si më poshtë.

Objektivi kryesor që ka ky institucion, është të ruajë dhe të nxisë konkurrencën duke mbrojtur lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve të ndryshëm në treg. Objektiva tjetër të përgjithshme janë, gjithashtu parandalimi i abuzimit me pozitën dominuese të kompanive, gjegjësisht fuqinë e tre në treg. Puna për mbrojtjen e konkurrencës do të ketë ndikim të drejtpërsëdrejti se në çfarë mase do të arrihen objektivat të Ligjit të konkurrencës.

Komisioni Kosovar i Konkurrencës, është krijuar me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 7 nëntor 2008, por punën e ka filluar në mars të vitit 2009. Realisht, ky raport përfshinë punën disamujore, nga marsi gjer më 31 dhjetor 2009.

Në bazë të Ligjit për konkurrencën, ky Komision ka për detyrë t'i kontrollojë ndërmarrjet në treg si ato private, ashtu edhe ato shtetërore, përcaktimin e rregullave të konkurrencës, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për funksionimin e vet institucionit. Në raport janë paraqitur edhe vërejtjet që Komisioni ka hasur me rastin e shqyrtimit të zbatueshmërisë të ligjit, gjegjësisht nxjerrjes së rregulloreve dhe udhëzimeve administrative nga ana e institucioneve tjera.

Sipas Komisionit, neni 3.3 i Rregullës 3 të Autoritetit Qendror Bankar, vërehet se është në kundërshtim me Rregulloren 2001/25, mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit. Gjithashtu, Komisioni kosovar i Konkurrencës, ka vërejtje në Udhëzimin administrativ nr. 2008/13 të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Post-telekomunikacioni që ka të bëjë me funksionimin e qendrave të kontrollimit teknik të automjeteve, me të cilin udhëzim kërkohet që kontrollimi teknik i automjeteve duhet të kryhet në qendrën e cila është në territorin e kuvendit komunal, banor i së cilës është edhe pala.

Meqenëse qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve nuk janë thjeshtë vetëm ndërmarrje me qëllime profitabile, por janë të detyruara të funksionojnë më shumë në interes të qytetarëve dhe të ruajtjes së sigurisë në komunikacion, Vërejtja e Komisionit të Konkurrencës nuk është me vend dhe se Udhëzimi administrativ 2008/13, i lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Postë-telekomunikacionit, është i bazuar në Ligjin mbi sigurinë në komunikacion dhe duhet të zbatohet në praktikë. Andaj, kërkesa e Komisionit nuk duhet të pranohet.

Grupi Parlamentar i LDK-së, e përkrah raportin me këto vërejtje që u thanë më lartë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit, Zef!

Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotëri Ethem Çeku, e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar këtë raport të Komisionit dhe po ashtu edhe në Komisionin tonë parlamentar dhe në parim i japim mbështetje një komisioni të ri, i cili është krijuar dhe që dëshirojmë të funksionalizohet, mirëpo duhet ta dimë se politikat të cilat aprovohen në këtë Parlament, në shumë raste e eliminojnë mundësinë e veprimit të një komisioni të tillë në mënyrë efikase.

Në qoftë se e marrim disa sektorë dhe e shohim se ky komision a ka mundur të funksionojë, a ka mundur politikat e veta t'i implementojë, e shohim se jo? E marrim për bazë sistemin bankar, do të thotë a mundet ky Komision me politikat e tij të ndikojë në sistemin bankar? Pra, kemi parë që fare nuk ka mundur. Ka mundur të ndikojë diçka te bukëpjekësit për problemet e caktuara, por në sistemin bankar më të rëndësishëm në aspektin zhvillimor, kemi vendosur një monopol në çështjen e dhënies së kamatave dhe ky Komision i ngratë nuk ka mundur as të troket në ato dyer të atyre institucioneve. E marrim sektorin energjetik dhe kur flasim se ky Komision duhet ta ruajë konkurrencën, duhet ta mbështesim me politikat tona që i aprovojmë në Parlamentin e Kosovës dhe me kolegë bashkërisht, shohim se ne e kemi mbyllur çështjen e konkurrencës në sektorin energjetik. Prandaj, në aspektin politik, ky komision përmes mekanizmave tanë të cilët përafërsisht i kemi vendosur me politikat në Parlamentin tonë, ia kemi pamundësuar të funksionojë. Kur i marrim edhe ato që e thanë disa kolegë se është një komision i cili nuk ka shumë mbështetje në aspektin teknik e profesional e tjera, del se gati konkurrenca në Kosovë, në shumë fusha është pezulluar, e pamundshme të realizohet. Ndoshta në një shtet të ri, në një ekonomi të tranzicionit edhe që është edhe vetë çështja e konceptit të konkurrencës, është shumë diskutabile, megjithatë ne si grup parlamentar i japim mbështetje këtij komisioni, duke kërkuar nga institucionet që të mbështetet dhe vërtetet në Kosovë të hyjë koncepti i konkurrencës në shumë sektorë, sepse deri me tani shihet se nuk kemi ndonjë konkurrencë të mirëfilltë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Çeku! Në emër të Grupit Parlamentar AKR, fjalën e ka Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Përsëritet për të gjithë,

Duke marrë parasysh se raportimi i agjencioneve të pavarura dhe është obligim edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, atëherë Grupi Parlamentar i AKR-së, ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009 dhe mund të them se në bazë të kushteve në të cilat funksionon kjo agjenci apo ky Komision i pavarur i cili i rëndësisë së veçantë të shtetit të ri të Kosovës, mund të them se ka pasqyruar në Raportin vjetor të tij, se nuk është raport vjetor duke marrë parasysh kohën shumë të shkurtër të funksionimit të këtij komisioni dhe vendosjen e tij në Kuvendin e Kosovës, në dy zyra, me një staf prej 11 vetash, mund të them se ky raport pasqyron punën shumë të mirë të këtij komisioni në bazë të Ligjit të konkurrencës kosovare.

Sa është i aftë ky komision kosovar të bëjë punën e tij me stafin në të cilin ekziston, atëherë mbetet përgjegjësi e këtij Kuvendi të Kosovës, i cili ia ka dhënë miratimin e Bordit të këtij Komisioni që të caktojë edhe punën, të caktojë hapësirën dhe e vendit të punës të këtij Komisioni Kosovar të Konkurrencës. Shihet se puna rreth zbatimit të Ligjit në praktikë, për konkurrencë të lirë dhe ekonomi të lirë në Kosovë, do të mbetet opsion edhe në të ardhmen. Në qoftë se merret raporti në të cilin e cekë Komisioni Kosovar i Konkurrencës, që ka hasur në jo konkurrencë, atëherë të jap për të treguar se ky komision ka shumë punë, se shteti i ri i Kosovës, i cili është shtet i centralizuar ekonomik, tash duhet të kalojë nga ekonomia e lirë e tregut, nga decentralizimi i tregut në të cilën është edhe në aktin më të lartë të shtetit në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 119, ku thotë se Republika e Kosovës, siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, për lirinë e aktivitetit ekonomik dhe për sigurinë e pronës publike dhe private.

Problemi është se ne duhet për së afërmi me sistemin ligjor të BE-së, të ofrojmë ligjet tona, zhvendosjen e monopoleve në ekonominë e tregut, për një konkurrencë të shëndoshë, duhet punë e këtij komisioni në hulumtimin e monopoleve në ndërmarrjet e vendit tonë. U cek se në raport ka pasur një hulumtim të furrtarët, të kompanitë e sigurimeve, të Banka Qendrore, mirëpo i gjithë legjislacioni duhet ta, të Ministria e Transportit për regjistrimin e automjeteve, ku do të thotë se Komisioni i Konkurrencës ka atakuar shumë mirë çështjet e monopolit, mirëpo duhet të bëhet edhe draftimi i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, e cila do të japë mundësi dhe hapësirë më të madhe këtij komisioni, që të kryejë punën e tij.

U cek edhe nga parafolësi i mëparshëm, nga kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, që duhet t'i kushtohet një rëndësi mjaft e madhe këtij komisioni apo këtij autoriteti apo agjencioni të pavarur, që të mbështetet në mënyrën më të duhur që Kosova të shkojë drejt një ekonomie të lirë të tregut dhe të jetë në afërsim me shërbimet e caktuara për qytetarët, të largohen nga monopoli dhe të punojë në interes të qytetarëve të Kosovës.

Në përgjithësi mund të them se duhet edhe një punë edhe një mbështetje e madhe edhe nga Kuvendi edhe nga Qeveria për këtë Komision për funksionimin e tij sa më adekuat në shtetin e ri të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Selmani!

Nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, e ka fjalën Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Ky është raporti i parë i Komisionit Kosovar të Konkurrencës në Kuvend, ngase ky komision është krijuar me vendim të Kuvendit në nëntor të vitit 2008, por në fakt punën ka filluar në mars të vitit 2009.

Andaj, pjesa e parë e këtij raporti kryesisht bën një përshkrim të themelimit të këtij Komisionit, organogramin e tij shumë të kufizuar që përbëhet nga vetë punonjës. Gjithashtu në këtë raport, paraqiten synimet e këtij komisioni për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, duke precizuar nenet që kanë të bëjnë në përmbushjen e kërkesave të nevojshme, që ligji të jetë më i zbatueshëm. Në këtë kontekst, theksohet domosdoshmëria e përfshirjes së Institutit të përqendrimeve dhe kontrollit të tyre me ligj, duke eliminuar mundësinë e mëtejme të shtrembërimit të konkurrencës dhe krijimit të mundësive të rritjes së kalimit të disa shoqërive në pozita dominuese.

Pjesa e dytë, paraqet angazhimi e këtij komisioni për ta përmbushur misionin e tij në kuptim të hetimit, analizimit si dhe vlerësimin e kushteve të tregut. Në këtë drejtim, janë paraqitur tri hetimet e kryera vitin e kaluar nga ky komision, natyrisht këto janë aktivitete të para të institucionit të ri. Hetimet janë kryer në Shoqatën e Furrtarëve në lidhje me marrëveshjen e caktimit të çmimit të bukës, pastaj hetimi i marrëveshjes midis kompanive të sigurimit mbi Pulin kufitar të nënshkruar nga viti 2003, si dhe hetimi lidhur me vendimin e udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit për kontrollin teknik të automjeteve. Gjatë hetimit dhe analizës së informatave, sipas raportit është vërejtur moszbatimi e gjer të shkelja e dispozitave të Ligjit për konkurrencën, andaj edhe rekomandimet konkrete, u janë dhënë këtyre shoqërive që kanë qenë objekt i hetimeve.

Ne konsiderojmë se mbrojtja e konkurrencës nuk është një detyrë e thjeshtë dhe shpesh kjo krijon kundërveprime nga aktorët e ndryshëm në treg, përfshirë bizneset, e shoqatat e tyre apo institucionet e ndryshme publike apo private dhe grupet e ndryshme të interesit.

Duke pasur parasysh sa e rëndësishme për vendin tonë është mbrojtja e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të pjesëmarrësve në treg duke nxitur konkurrencën edhe gjithashtu parandalimin e abuzimit me pozicionimin dominues, Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se duhet mbështetur fuqizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve administrative, të afta për zbatimin e ligjit, duhet krijuar kushte të favorshme pune për këtë komision, ngase mendojmë se ky komision i konkurrencës mbron tregun tonë dhe promovon zhvillimin e kulturës së konkurrencës në vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zonja Morina, unë i lutem regjisë që t'i thërrasë deputetët, sepse janë vetëm 38 të pranishëm në sallë, që do të thotë se as debat nuk mund të zhvillohet.

Ju faleminderit, Ibrahim! Erdhe tamam. Atëherë, në emër të Grupit “7+”, e ka fjalën Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedavajući!

Trebali ste da se zahvalite prisutnim poslanicima (ja vas čekam da me slušate) i trebali bi ste da se zahvalite prisutnim poslanicima, jer zaista zahvalnost pripada ovima malobrojnim koji su ostali ovde. Evo, nažalost, dolazimo u situaciji kad nemamo kvorum ni za raspravu a ne za odlučivanje. Veoma rano smo se umorili, tek je pola dvanaest sati, a prvi je radni dan u nedelji. Mislim da je ovo vrlo loša poruka našim biračima i ne znam koje mehanizme imamo, ali evo ja pozdravljam jednu počasnu članicu Vlade koja je prisutna ovde, gospođu Editu, da nije nje, ne bi smo imali predstavnika Vlade, pa evo, ja im šaljem jedan daljinski pozdrav. Mi ih nismo zaboravili, ako su oni nas, ali mislim da je ovo zaista nedopustivo. Ovakvo nikakvo interesovanje za problematiku o kojoj govorimo, ovo je direktno iz oblasti trgovine i industrije, direktno iz oblasti ekonomije, međutim nema nikoga, ali eto pošto u prazno govorimo, evo da se ja pridružim mojim kolegama koji su dosada govorili u prazno.

Zaštita konkurencije je nova oblast koja počinje na jedan zakonodavni način da se reguliše, i to nije jednostavan zadatak koji stoji, (i malo smo, ali se i ne slušamo, gospodine Geci. Jel hoćete da mi stvorite mogućnosti da govorim predsedavajući)?

KRYESUESI: Këta e kanë autonominë të bëjnë, janë njerëz të zgjedhur. Ju vazhdoni të flisni, nuk po flisni as për mua, as për kolegë, por për opinionin. Të paktën, unë jam tip vizual edhe transkriptin e lexoj, hiq nuk dëgjoj çka po thoni. Urdhëroni!

DŽEZAIR MURATI:...dobro, u redu, malo ironije, dobro je nekada i ironija, ali ironija treba da ide onima koji zaslužuju, a ne koji je ne zaslužuju. Zaboravljamo da imamo pravo, jednako pravo na javnu reč, i vi kao predsedavajući, i ja kao poslanik i šef Parlamentarne grupe. Ja sam započeo, ali sam tražio od vas mogućnost da mogu normalno da govorim. E, hvala vam! Nije bilo potrebo da me upućujete na transkript, jer ja malo više pratim od mnogih.

Vidite, zameniće predsedavajućeg, mi kao Parlamentarna grupa, bez obzira na ove izlete koje ste imali vi i ja, pozdravljamo Komisiju konkurencije naše države koja se učlanila u nekoliko međunarodnih mreža konkurencije, jer je na taj način u prilici da jača i tehnički i stručni, i stručne sposobnosti u ovoj, po nas novoj oblasti, tako da prisustvom na međunarodnim konferencijama i seminarima, mislim da se stiče neko početno iskustvo, tako da pred nama je jedan zaista izazov na razvoju kulture konkurencije i kulture i mnogo čemu još u našoj zemlji, a informisanje javnosti u ovom pravcu će imati posebnu važnost.

Smatramo da je svrsishodno postojanje ove komisije koja će pozitivno doprinositi daljem uspešnom procesu tranzicije i promenama koje će uticati na zdrav razvoj naše privrede. Mi ovaj izveštaj u načelu prihvatamo.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati! SLS nuk ka të paraqitur për fjalë, ndërkaq Grupi Parlamentar për Integrim, zotëri Danush Ademi.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa! Ja samo koristim karticu kolege, kome se zahvaljujem. Javljam se povodom Izveštaja Komisije za konkurenciju. Danas imamo isto tako jako važan izveštaj i ja bih htela samo da komentarišem, kada je u upitanju sam izveštaj ovih komisija, mi moramo da znamo da komisije postoje zbog rada, a ne zbog izveštaja. Iz ovog izveštaja znamo da je obaveza Komisije, na ime Zakona o zaštiti konkurencije, da je to obaveza komisije, da vidimo iz ove organizacione šeme da komisija ima samo 11 člana, da ima jako skroman budžet od 205 hiljada eura i sama komisija bavi se mnogo više, mnogo više u ovom izveštaju sa obeležjem da je obaveza Vlade za ovu komisiju.

Mi moramo da podignemo svest, mi sami kao poslanici i Vlada i svi na našem tržištu ne samo kada je u pitanju konkurencija i zaštita ovog zakona, nego u svim sferama, svoju svest preko ovih rada ovih komisija koje praktično nadgledaju zakone. Ako mi ne ojačimo ove komisije, nemamo od toga ništa, tako da je svaka komisija funkcionalna samo ako je u funkciji posla koju vrši. Ova Komisija, čuli smo od prisutnih kolega da je namenski postavljena radi zaštite potrošača, radi zaštite tržišta, radi zaštite od monopola, radi zaštite kvaliteta, kvantiteta i svega u regiji da bi bili mreža ne samo na domaćem tržištu, nego da stvorimo puteve i mrežu na tržištu u regiji i u svetu.

Mi iz ovog Izveštaja vidimo da nema komisija nikakvu nadglednost u koordinaciji horizontalno i vertikalno. Zašto ovo kažem? Zato što nije posmatrala sve oblasti, nije imala mogućnosti, jer je imala jako mali budžet, ali to znači da mi nismo kao Vlada imali jaku političku moć, jako političku volju i moć da potpomognemo ove komisije da budu

funkcionalnije. Ova komisija praktično se bavi sa nekoliko preporuka, kada je u pitanju proizvodnja hleba, kada je u pitanju kontrola vozila, tamo gde je bilo monopola, međutim ona se ne bavi puno sa monopolom kada su u pitanju javna preduzeća. Ja ne vidim ovde iz izveštaja da je bilo kontrole, znači nije prepoznala aktere gde se najviše vrši zloupotreba, kada je u pitanju Zakon o konkurenciji. Konkurencije najviše postoje, praktično ne postoje u monopolskim društvima, ne kontroliše puno bankarski sistem gde počinje zloupotreba kontrole i zloupotreba zakona, tamo da se uskladi sa tržištem, to što sam rekla, gde bi bilo smanjenja i efekata za sve građane oko pristupa fondovima i korišćenja bankarskih uslova, kao što su kamate, provizije, krediti za građane, znači ne posmatra onaj deo gde su donacije koje država mora da daje, da donira da bi imala isti balans u regiji.

Ne posmatra osiguravajuća društva, koja isto drže monopol, ne posmatra javna preduzeća i mogu da kažem i sam kvalitet i kvantitet svih usluga koje dolaze na kosovsko tržište. Ne bih puno dužila, mi moramo da radimo puno na ovim komisijama, da dajemo prave preporuke i kada su u pitanju, i kada je u pitanju ljudski faktor, i kada su u pitanju sredstva koja moramo da izdvajamo da bi u regiji bili prepoznati i kod građana da želimo jednu dobru institucionalnu državu koju imamo obavezu pred građanima da gradimo. Ovoliko od naše grupe. Ja ću se lično potruditi da u grupi prolistam kako ostale komisije u regiji rade, da bi imali prave preporuke koje mi moramo po funkcionalnim komisijama jako ozbiljno da odradimo. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Emrush! Tani e kemi listën e atyre që janë paraqitur për të dhënë kontributin e tyre për këtë pikë të rendit të ditës dhe në pajtim me transparencën ... më të madhe. Po ua them edhe listën. Zonja Sala Berisha Shala, zonja Sanije Alijaj, zotëri Driton Tali, zonja Novobrdaliu, zotëri Abdyl Ymeri, zonja Pantina, zotëri Luzha edhe zotëri Ibrahim Gashi.

E ka fjalën zonja Sala Berisha Shala, të bëhet gati zonja Sanije Alijaj.

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëendetje zonja ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe ju të pranishëm,

Mbrojtja e konkurrencës nuk është detyrë e thjeshtë dhe e lehtë. Në ekonomitë në tranzicion, siç është Kosova, veprimtaria për mbrojtjen e konkurrencës, përballet me spica shumë specifike.

Kosova është përcaktuara për ekonomi të lirë të tregut dhe konkurrencë korrekte. Fillimisht, bazuar në Ligjin për konkurrencën, neni 24, paragrafi 1, është themeluar edhe Komisioni kosovar i Konkurrencës, i cili për çdo vit kalendarik, është i obliguar të përgatitë dhe të dorëzojë Kuvendit raportin vjetor në të cilën analizohen aktivitetet në fushën e konkurrencës dhe monitorimin e tregut në Kosovë.

Siç dihet, Komisioni kosovar i Konkurrencës, është themeluar me 7 nëntor të vitit 2008. Veprimtarinë e vet e ka filluar në mars 2009. Ka punuar në kushte jo të favorshme përkundër ballafaqimit të pengesave të ndryshme siç është ajo më elementarja se që e cekën edhe kolegët e mi, mungesë e hapësirave të punës, e tjera pengesa, ka arritur që ky institucion të identifikojë problemet me të cilat duhet të merret vetë institucioni.

Problemeve të tilla u janë qasur me një përkushtim dhe gatishmëri që t'i zgjidhin. Siç dihet, objektivi kryesor i këtij institucioni, është ta ruajë dhe ta nxisë konkurrencën duke mbrojtur lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve në treg. Objektivat tjera të përgjithshme të

politikës së konkurrencës janë: parandalimi i abuzimit me pozicion dominues, përkatësisht fuqinë në treg, ndërprerja e marrëveshjes me pasoja të rënda për konkurrencën, që në raport i paraqesin me radhë identifikimet për këto parregullsi ligjore, mandej mbrojtja e konsumatorëve, respektimi i konkurrencës së lirë e tjera.

Puna për mbrojtjen e konkurrencës do të ketë ndikim direkt, duke parë se në çfarë mase mund të arrihen objektivat e Ligjit të konkurrencës pa u detyruar të kufizohen apo të bien ndesh me objektivat e ligjeve tjera, duke rritur kështu mirëqenien e konsumatorit vendas. Dihet se konkurrenca ndihmon konsumatorët po aq sa konsumatorët mund ta ndihmojnë konkurrencën, duke pasur kështu një marrëdhënie, mbështetje të ndërsjellë. Ligji i konkurrencës mbron tregun duke shmangur dhe penguar jo vetëm praktikatat e parregullta të subjekteve private, por edhe nga ndërhyrjet e shtetit përmes akteve normative që ndërmerr vetë shteti.

Baza e Ligjit të konkurrencës është kryesisht parandalimi ose ndalimi i tri llojeve të praktikave:

1. Marrëveshjet antikonkurruese, në veçanti kartelet që fiksojnë çmimin ose ndajnë tregjet,
2. Abuzimi me pozitën dominuese ose thënë ndryshe monopolizmi,
3. Bashkimet antikonkurruese apo përqendrimit.

Për Komisionin e konkurrencës, por edhe për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, nuk është i mjaftueshëm vetëm ekzistimi i Ligjit për konkurrencën pa instrumentin përkatës zbatues. Në raport thuhet se problem serioz, është krijimi i kapaciteteve për të zbuluar, hetuar dhe eliminuar sjelljet antikonkurruese të pjesëmarrësve të tregut, ashtu që të përmirësohet funksionimi i tij.

Në faqe 8 të këtij raporti, është pasqyruar puna e Departamentit të Çështjeve Juridike, që ky Departament, në radhë të parë studion legjislacionin që bie ndesh me konkurrencën, analizon informacionet mbi pengesat juridike që kufizojnë dhe deformojnë konkurrencën në treg. I propozon pastaj institucionit ndryshimet përkatëse ligjore për arritjen e një konkurrence efektive. Pikërisht ky Departament, ka propozuar iniciimin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit të konkurrencës duke parë zbrazëtitat në ligjin ekzistues.

Kështu në këtë raport prej faqe 8 deri 14, jepen arsyeime plotësisht për plotësim dhe ndryshim të ligjit. Në vazhdim të këtij raporti, është paraqitur studimi, analizimi dhe vlerësimi i kushteve të tregut. Këtu Komisioni i Konkurrencës ka pasur një qëndrim aktiv në zbatimin e ligjit. Si rezultat i kësaj kanë arritur të shfuqizojnë marrëveshjen e furrtarëve për caktimin e çmimit të bukës. Mandej, t'i kryejnë aktivitetet mbi hetimin e marrëveshjeve në mes kompanive të sigurimit mbi poll, të sigurimit kufitar. Këto marrëveshje ishin në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit të konkurrencës.

Në këtë rast, Komisioni ka komunikuar me shoqatat e kompanive të sigurimeve dhe me subjektet që kanë shkelur Ligjin. Mandej vlen për të përmendet vendimi i Komisionit të konkurrencës për mospranimin e kërkesës së Bankës Qendrore të Kosovës, për të përjashtuar nga ndalimi marrëveshjen mbi themelimin e Pulit të sigurimit kufitar nga 9 kompani sigurimesh që veprojnë në Kosovë.

Mandej, i rekomandon Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit që të shfuqizojë nenin 36 të Udhëzimit administrativ që ka të bëjë me kontrollin teknik të automjeteve.

Të nderuar deputetë,

Si instrument të rëndësishëm, ky komision konsideron edhe ndërgjegjësimin e shoqërisë civile dhe komunitetin e biznesit dhe ndërgjegjësim të komunitetit me legjislacionin për konkurrencë dhe përfitimet që vijnë nga konkurrenca. Këto rekomandime i shohim në faqen 27, mandej ajo që është shumë e rëndësishme, që edhe ne si deputetë duhet të mbështesim, është edhe iniciimi për plotësim ndryshimin e Ligjit aktual me të drejtë, sepse duhet të kombinohen modelet e ndryshme, duke ditur se ka modele ku ligji i konkurrencës trajton vetëm problemet e monopoleve që shfaqen në forma të ndryshme. Pra, në vendet e ndryshme, modelet e ndryshme. Por ka modele që përveç monopoleve të mirëfillta, trajton edhe çështje të praktikave të tjera antikonkurruese ose siç quhen ndryshe konkurrenca e pandershme, konkurrenca e padrejtë.

Përgjithësisht ky është një raport i punuar mirë që pasqyron një angazhim serioz të bartësve të këtij institucioni si dhe efektet pozitive të punës së tyre njëvjeçare në zbatimin e Ligjit të konkurrencës. Në fund të nderuar deputetë, e mbështes raportin e Komisionit të Konkurrencës, duke rekomanduar që të krijohen kushte më të favorshme për punë, në mënyrë që të realizojnë detyrat dhe objektivat që synojnë vendosjen e një disipline të plotë në zbatimin e rregullave të konkurrencës në Kosovë për të siguruar një mjedis sa më konkurrues si dhe mbështetjen e procedimin më të shpejtë të draftligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Shala! Fjalën e ka zonja Sanije Alijaj, të bëhet gati zotëri Driton Tali.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në ekonominë e shteteve në tranzicion, siç është Kosova, veprimtaria për mbrojtjen e konkurrencës përballet me shumë sfida specifike. Sektorë të ndryshëm janë në pronësi të shtetit që e vështirësojnë liberalizimin e ekonomisë së tregut.

Raporti mbi veprimtarinë e Komisionit për vitin 2009 dhe objektivat për vitin 2010, tregon vullnetin e institucioneve të Republikës së Kosovës për forcimin e kapaciteteve institucionale, për zbatimin e Ligjit të konkurrencës, lirinë e veprimtarisë ekonomike, duke eliminuar zbatimin në praktikave të pandershme që mundësojnë lulëzimin e monopoleve që rritin çmimet për konsumatorin, uljen e prodhimit, zvogëlimin e mundësive për zgjedhjen e produkteve, zvogëlimin e novacionit, shërbimet ndaj klientit dhe uljen e mirëqenies së konsumatorit.

Komisioni prej 5 anëtarëve është formuar në nëntor të vitit 2008 dhe punën e ka punuar në mars të vitit 2009. Pra, sot shqyrtojmë punën nëntëmujore të Komisionit, i cili deri në tetor të vitit të kaluar ka punuar pa asnjë punonjës, që ka kushtëzuar të merret kryesisht me veprimtarinë ndihmëse e shumë pak me veprimtari studimore. Komisioni veprimtarinë e realizon përmes tri departamenteve: Departamenti i Analizave dhe Hetimit të Tregut; Departamenti i Çështjeve Juridike dhe Departamenti i Administrimit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Veprimtaria e Komisionit të Konkurrencës është e koncentruar në nxjerrjen e akteve nënligjore për përmirësimin e Ligjit të konkurrencës dhe në përputhje me standardet e ekonomisë së tregut e në veçanti në ndryshimin e dispozitave që rregullojnë funksionimin e Komisionit të Konkurrencës dhe procedurat e përgjithshme administrative.

Objektivë tjetër e Komisionit për të përmbushur misionin e tij ashtu siç paraqitet në raport janë studimi, analizimi dhe vlerësimi i kushteve të tregut në drejtim të zbatimit të Ligjit të konkurrencës. Komisioni për realizimin e këtij objekti është nisur nga ankesat dhe kërkesat e paraqitura për kufizime të konkurrencës apo abuzimet në pozicionin dominues. Në këtë drejtim Komisioni, pas marrjes së informacionit se pronarët e disa furrave të bukës kanë lidhur marrëveshje për çmimin e bukës standarde prej 30 centë, Komisioni i Konkurrencës, pas analizimit të marrëveshjes dhe pas mbajtjes së një seance dëgjimore me përfaqësues të këtyre furrave ka konstatuar se kjo marrëveshje është në kundërshtim me Ligjin e konkurrencës dhe e ka anuluar dhe çmimi është kthyer në nivelin e mëparshëm.

Veprim tjetër i Komisionit është hetimi i marrëveshjes midis Kompanisë së sigurimit mbi Pulin kufitar, e nënshkruar dhe jetësuar që nga viti 2003 deri në vitin 2009. Komisioni i mbështetur nga këshilltari i CDF ka siguruar informacionin lidhur me marrëveshjen dhe ka mbajtur edhe me këtë rast një seancë dëgjimore dhe ka konstatuar se kjo marrëveshje është bazuar në Rregulloren e nxjerrë nga Banka Qendrore e Kosovës, Rregullorja – neni 3.3. dhe Komisioni ka konstatuar dhe ka kërkuar nga Banka Qendrore që ky nen të anulohet, sepse është në kundërshtim me Ligjin e konkurrencës dhe me praktikën e ekonomisë së tregut.

Veprimi i Komisionit për hetimin e vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit për kontrollin teknik të automjeteve, Komisioni pas hetimit të disa qendrave të kontrollit teknik të automjeteve vëren se qendrat e kontrollit teknik të automjeteve bazohen në nenin 36 të Udhëzimit administrativ të Ministrisë dhe i drejtohet Ministrisë për shfuqizimin e këtij neni se është në kundërshtim me Ligjin e konkurrencës.

Sa i përket zhvillimit të kulturës, Komisioni ka organizuar disa **work-shope** me përfaqësues të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare ku është prezantuar mënyra e funksionimit të Komisionit, bashkëpunimi i tij me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare, ku edhe për një kohë të shkurtër është anëtarësuar në disa prej tyre.

Kurse sa i përket objektivave për vitin 2010 që paraqiten në pjesën e fundit të raportit, Komisioni është koncentruar në përmirësimin e kuadrit të plotë ligjor dhe fuqizimin e kapaciteteve për zbatimin e tij për zhvillimin e ekonomisë drejt hapjes dhe fuqizimit të tregjeve për një konkurrencë efektive.

Bazuar në këto objektiva për vitin 2010, do të vlerësoja se ky komision që është shumë i rëndësishëm do t'i lejojë vetes një komoditet shumë të mirë për të pasur qasje për parregullsitë që bëhen në kompanitë e mëdha të Kosovës dhe me këtë rast do të vlerësoja se kompanitë e mëdha do t'i hanë kompanitë e vogla, ashtu siç thotë një fjalë e urtë: “ peshku i madh e han peshkun e vogël”.

Në fund, raporti prezanton në mënyrë simbolike të veprimeve, pra janë shqyrtuar për 9 muaj të funksionimit të mirëfilltë vetëm 9 marrëveshje dhe të cilat janë anuluar, kur dihet që zhvillimi ekonomik i vendit tonë e përcjell një numër i madh i parregullsive për shkak të mosnjohjes së Ligjit të konkurrencës dhe praktikave të ekonomisë së tregut.

Raportin e përkrah për aq sa është i zbatuar puna e tij, por kërkoj që këtë vit puna të jetë më efektive pasi ka shumë parregullsi në zhvillimin ekonomik të vendit. Pra, institucionet t'i ofrojnë kushte pune se veprimtaria e këtij komisioni është shumë e rëndësishme për kontrollin e kompanive për respektimin e Ligjit të konkurrencës dhe praktikave të konkurrencës në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Alijaj! Zotëri Driton Tali e ka fjalën!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

A kemi kuorum, zoti kryesues, apo të dal t'i thirri deputetët e opozitës se zakonisht na po ua bëjmë juve këtë kuorumin? S'keni fort deputetë, prej 70-tëve, sa keni mbetur? Jeni nja 30 a jo? Bile edhe Qeveria po na mungon, s'e kemi as ministrin sponsorues i cili do duhej të ishte këtu të paktën.

Sidoqoftë, të nderuar të pranishëm,

Unë po filloj këtë raport me Ligjin për konkurrencën numër 2004, pra ky që është në fuqi dhe atë me nenin 24 1/c. Ja se çka thotë: "Për çdo vit kalendarik Komisioni kosovar i konkurrencës do të përgatisë, publikojë dhe dorëzojë Kuvendit një raport vjetor, duke i analizuar kushtet konkurruese në ekonominë e përgjithshme të Kosovës si dhe në sektorë të veçantë – industri dhe tregje dhe duke i përmbledhur të gjitha masat hetimore dhe të ekzekutimit që Komisioni kosovar i konkurrencës i ka ndërmarrë gjatë vitit kalendarik në fjalë".

Konform kësaj, unë po them, në faqe 4 është edhe një fjalë, po edhe këtë po e lexoj, paragrafi 2 thotë se "objektivi kryesor që ka ky institucion është që të ruajë dhe të nxisë konkurrencën duke mbrojtur lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve të ndryshëm në treg", e tjera, e tjera. Dhe, shtrohet pyetja, të nderuar të pranishëm se ky raport a është shkruar konform këtyre kërkesave, këtyre objektivave dhe qëndrimeve?

Nëse e marrim dhe e shikojmë, se këtu na i lexuan disa herë deputetët – parafolësit raportin dhe do t'i kisha lutur që herëve tjera të mos na e lexojnë këtu, por ta lexojnë në shtëpi, të shohin se nga faqja 15, janë nja 2-3 raste që ky komision ka ndërmarrë dhe kemi të bëjmë me hetimin e furrave, pastaj hetimin e marrëveshjes midis kompanive të sigurimit, pastaj kemi të bëjmë edhe me një rast në Ministrinë e Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit lidhur me kontrollin teknik të automjeteve dhe këtu përfundon.

Ky raport pra merret më shumë me përshkrimin e Ligjit për konkurrencën. Pra, në të gjitha faqet tjera na shpjegon se çka duhet bërë, si duhet bërë, e tjera e tjera.

Prandaj, po them, a duhet të quhet ky raport? Unë, me zor po e quaj raport! Dhe, bazuar nga ky raport, domethënë, nga këto tri raste që i cekim, shtrohet pyetja se a është çdo gjë në rregull me industrinë, me sektorët e tregut, me sektorët e ndryshëm të tregut, okej në Kosovë? Po, nëse i shikojmë, nuk del ashtu.

Për shembull, nëse e marrim dhe e shikojmë industrinë bankare, ashiqare shihet se bankat janë marrë vesh në mes veti, sepse nuk është e mundshme që në Kosovë të jenë këto norma të interesit dhe mos të ndryshojnë fort prej bankës në bankë. Pra, shihet ashiqare se në këtë sektor kemi marrëveshje oligopolistike që është në kundërshtim me nxitjen e konkurrencës së lirë. Pra, është në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Kosovës, neni 10.

Pastaj, shembull, marrim tregun e karburanteve. Kjo pat ndodhur edhe vjet, edhe parvjet, por edhe sivjet. Sa herë që të hipin çmimet e naftës në bursë tregtarët e karburanteve në Kosovë menjëherë i rritin çmimet. Të gjithë, së bashku! Ama, kur i bie çmimi i naftës nëpër bursa, siç është tash rasti në këtë muaj – ka ra 20%, çmimi i karburanteve në Kosovë bie zakonisht pas dy-tre muajve dhe po ashtu të gjithë njësoj, në mënyrë të orkestruar të njëjtën kohë. Dhe tash, thuaj se këtu nuk ka marrëveshje të brendshme apo marrëveshje kolektive në mes të shitësve të karburanteve!

Po them, e thanë edhe të tjerët pse ky raport i zbehtë nuk ka diçka për këto gjëra dhe nuk është ndonjë çështje e madhe, sepse për t'u marrë me këto gjëra duhet pasur ekspertizë dhe mekanizma të sofistikuar që unë e di që ky komision nuk i ka, sepse Qeveria nëpër komisione dhe borde është e interesuar më shumë të çojë njerëz, qofshin partizanë partiakë apo familjarë, se sa njerëz të duhur në vend të duhur.

Ama, që ky komision të mos merret fare me industrinë e mishit, apo me importin e mishit, ku ndërmarrësit dhe punëtorët e ndërmarrjeve kosovare e kundërshtuan aq shumë – bile pati edhe protesta nga ana e tyre dhe për pak sa s'u futën edhe në Kuvend, bile edhe në Qeveri – këtë nuk mund ta kuptoj. Tërë vitin 2009, ndërmarrësit kosovarë - tregtarët e mishit janë ankuar se Qeveria ruan monopol aty dhe ky komision fare asnjë fjalë nuk e shkruan në këtë raport për tregtinë me mishin e bardhë, sidomos, bile as dy fjalë s'i shkruan.

Pastaj, si është e mundur që ky raport të mos merret fare as me tregun e kontrollit të cilësisë së naftës. Unë tentova javën e kaluar ta hap këtë çështje, edhe pse zotëri ministri i Tregtisë dhe Industrisë u iritua paksa, i mbeti hatri, po çka të bëjë, qe! Me të drejtë bile, ai më tha se – unë nuk marr vesh nga kjo punë! Plotësisht kishte të drejtë, sepse, unë nuk kam ndonjë njohuri afariste të këtij lëmi. Jo që vet kurrë nuk jam marrë me kontrollimin e cilësisë së naftës po askush nga familja ime, bile as vëllezërit e mi s'merren me këtë punë, andaj e patë të drejtë që unë me të vërtetë nuk kam njohuri.

Por, ajo që desha ta them në atë seancën e së enjtes së kaluar, pra të 27 majit e nuk munda, për shkak të kohës, ishte se unë e kam një deklaratë të dhënë nga drejtori i Drejtorisë së Akreditimit dhënë Radios “Evropa e Lirë” më 25 mars 2010, madje edhe zotëri ministër Zharku pati marrë pjesë në këtë intervistë dhe ku zotëri Ibush Luzha, pra drejtori i Drejtorisë së Akreditimit që besoj se ai është ekspert, sepse unë nuk dyshoj që ministri e ka çuar për arsye tjera atë njeri ta udhëheq Drejtorinë e Akreditimit, thotë unë po e citoj: “Në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë janë të regjistruara dhe akredituara katër kompani për kontrollin e kualitetit të naftës në Kosovë. Që të katërtat i plotësojnë kriteret e kërkuara për akreditim”, për të vazhduar, “më e para është akredituar KPU “Inspekt”, e dyta “Inkos”, e treta “Derivati” dhe e katërta që është akredituar është “Ballkan-petroll”. Por, unë s'di pse Komisioni kosovar i konkurrencës nuk po e ditka, kur e gjithë Kosova e di, vetëm se “Derivati” e bën kontrollin e cilësisë së naftës në pikën doganore të Hanit të Elezit. Pse është kështu?

Sipas një deklaratë të ministrit, edhe atë po them intervistën e njëjtë të “Evropës së Lirë” të cilën disi e përsëriti edhe të enjten, është se Ligji mbi akreditimin shumë qartë përcakton se akreditimi është vullnetar, kurse dhënia e autorizimit për një fushë të caktuar nuk është obligim ligjor, por është çështje e vlerësimit të plotë të Ministrisë, gjegjësisht ministrit. E kjo është fund i citatit. Mendoj se këtu komenti është i tepërt. Vetëm nëse kolegët e mi përpara më lejojnë ta kryej fjalimin, do të ishte mirë, sepse janë shumë kah më pengojnë.

Për fund, një koleg i imi me cinizëm në seancën e kaluar e tha se pse nuk po e kërkon EULEX-in për ndihmë në këtë çështje, duke aluduar në atë se zakonisht unë e thërras EULEX-in kur shoh se ka dyshime të korrupsionit. Unë zakonisht EULEX-in e thërras atëherë kur institucionet e Kosovës dështojnë në luftimin e korrupsionit. Pra, zakonisht i jap një kohë institucioneve të Kosovës që ato vetë t'i zgjidhin, dhe pastaj, kur ato dështojnë e thërras EULEX-in, dhe atë gjithmonë konform kompetencave që ky Kuvend i nderuar, më 12 shkurt të vitit 2007 ia ka dhënë EULEX-it. Unë atëherë nuk kam qenë deputet, pra tjetërkush e ka thirrur EULEX-in këtu, por nëse është te EULEX-i gjithmonë kërkoj që ata të reagojnë atëherë kur institucionet ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Tali! Tani fjalën e ka zonja Suzan Novobrdaliu, të bëhet gati zotëri Abdyl Ymeri.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zotëri kryesues! Kabineti qeveritar na mungon, kryeministri, zëvendëskryeministrat s'i kemi, 16 ministra, krejt mungojnë. Karriget e zbraza! S'kemi kë ta përshëndesim.

Të nderuar deputetë,

E kam shqyrtuar këtë raportin e Komisionit kosovar të konkurrencës për vitin 2009 dhe në lidhje me këtë raport tani shpreh mendimet e mia.

Një pjesë e madhe e këtij raporti është i ngarkuar me interpretim dhe krahasim të panevojshëm të Ligjit për konkurrencën sikur edhe me propozimet e tyre për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit për konkurrencën në Kosovë, me çka më shumë i ngjason një projektligji se sa një raport të hartuar mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në ligj. Deri te kjo duket se ka ardhur si rezultat i interpretimit të gabuar që hartuesit i kanë bërë dispozitave të Ligjit për konkurrencën në Kosovë. Konkretisht, nenit 24.1 paragrafi d) sepse rekomandimet e tyre për përmirësimin e këtij ligji janë inkorporuar në brendësi të raportit e jo në formë rekomandimi ashtu siç duhej të ishin dhënë.

Ky Kuvend ka vendosur për krijimin e Komisionit kosovar të konkurrencës në fillim të nëntorit 2008, ndërsa në këtë raport thuhet se ky organ ka filluar punën e tij tek në muajin mars të vitit 2009, do të thotë 5 muaj më vonë. Arsyeja është mungesa e ambienteve të punës. Fajin për këtë vonesë, besoj se duhet t'ia adresojmë Qeverisë dhe këtij Kuvendi të cilët po krijojnë agjencione pa u siguruar ambiente pune, pra me një fjalë vetëm po akomodojnë militantët e tyre, ndërsa rezultatet janë këto që janë.

Në raport thuhet se Komisioni për një periudhë kohe deri në fund të vitit 2009 ka punuar pa asnjë punonjës në stafin e punës. Sigurisht që arsyet për këtë nuk janë dhënë, ndërsa një institucion serioz do të duhej t'u kërkonte llogari të zgjedhurve të tij për këtë çështje, sepse si rezultat i kësaj mungojnë edhe rezultatet që do të duhej të ishin paraqitur këtu.

Të nderuar kolegë,

Gjatë një viti të plotë kalendarik një organ i cili në fushëveprimtarinë e vet ka aq shumë çështje të cilat do të duhej t'i kishte rregulluar deri më tani, në vitin 2009 i ka trajtuar vetëm 3 të tilla. Në fillim ky komision ka hartuar një marrëveshje të disa furrtarëve të cilët kanë qenë të pajtimit që çmimi fiks i një buke standarde të jetë 30 centë dhe pas angazhimit të tyre në këtë drejtim kanë arritur që të shfuqizojnë atë marrëveshje, sigurisht në letër, sepse çmimi i bukës edhe për një kohë të gjatë ka vazhduar të jetë 30 centë.

Çështja më të rëndësishme të cilën e ka trajtuar ky komision është marrëveshja midis kompanive të sigurimit mbi themelimit e pullit të sigurimit kufitar. Them se është më e rëndësishmja, sepse mërgimtarët tanë prej vitesh obligohen që gjatë hyrjes së tyre në Kosovë të paguajnë edhe policën kufitare e cila e rëndon buxhetin e tyre duke iu krijuar shpenzime shtesë gjatë vizitave që ata i bëjnë në Kosovë.

I bëj kërkesë institucioneve gjegjëse të Republikës së Kosovës që të punojnë më aktivisht për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e byrove dhe deri sa të realizohet një çështje e tillë të gjejnë një zgjidhje transitorë më të favorshme e cila do t'i rëndonte më pak apo aspak mërgimtarët tanë të cilët vijnë në Kosovë me mjete motorike me tabela të huaja. Besoj se ky

është një obligim i ynë i vogël krahasuar me kontributin e madh që ata kanë dhënë në vazhdimësi për Kosovën në zhvillimin ekonomik të saj.

Për fund, kërkoj nga Komisioni kosovar i konkurrencës angazhimin e tij maksimal në kuadër të fushëveprimtarisë së tij dhe hetimin e shumë çështjeve tjera të cilat po e ngufasin konkurrencën e lirë dhe qytetarin e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Novobrdaliu!

Fjalën e ka zotëri Abdyl Ymeri, pastaj Myrvete Pantina dhe i fundit Berat Luzha.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se roli dhe misioni i Komisionit të konkurrencës është thelbësor për rregullimin dhe ekzistencën e një ekonomie funksionale tregu, e cila do të mundësonte funksionimin korrekt të tregut. Konsumatori që të marrë optimumin e shërbimit dhe të cilësisë së produktit, duhet të sigurohet se tregu i lirë funksionon, se ai promovon më të mirën dhe se është i orientuar drejt konsumatorit.

Ekonomia e tregut të lirë, konkurrenca e lirë dhe fer mbron edhe konsumatorin. Kur dihet se ndërmarrjet të cilat janë në konkurrencë ofrojnë shumëllojshmëri të produkteve, produkte më cilësore, shërbime në nivelin e duhur dhe çmime më të ulëta, gjithashtu tregu i lirë nxit inovacionin, sjell risi dhe përsosjen e produkteve. Procesi i konkurrencës është baza e funksionimit të ekonomisë së tregut.

Raportin e kam lexuar me kujdes kur dihet për rëndësinë e ushtrimit të detyrave që ka ky komision. E arsyetoj këtë raport me një fakt se në faqen 7 ku bëhet fjalë për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të konkurrencës shihet se ka filluar punën nga muaji mars 2009 që është një periudhë jo e gjatë e punës së këtij komisioni.

Në raport në fakt ka shumë përshkrime të detyrave me të cilat merret Komisioni në përgjithësi. Ka shumë gjëra të përshkruara të cilat mund të gjenden në Ligj dhe rregulloren e punës që duhet ta ketë komisioni dhe për këtë i konsideroj si të panevojshme të paraqiten në raport, mirëpo këtë e arsyetoj se është raporti i parë.

Raporti i punës për një vit duhet të jetë më analitik dhe të ketë një strukturë mirë të ndërtuar dhe të paraqitet secili aktivitet dhe punë që kryen Komisioni si dhe në mënyrë detale të paraqiten të gjitha të dhënat e buxhetit të planifikuar dhe të realizuar. Stafi i Komisionit duhet të plotësohet sepse në organogram shihet se është i pa plotësuar.

Megjithatë, unë e përgëzoj Komisionin për punën e tyre, hetimet në ndërhyrjet që janë bërë të prodhuesit të bukës, të kompanive të sigurimit mbi Pool-in kufitar, vendimi i Komisionit për mospranimin e kërkesës së BQK-së për të përjashtuar nga ndalimi marrëveshjen mbi themelimin e Pooli-it të sigurimit kufitar, si dhe vendimin lidhur me udhëzimin e Ministrisë së Transportit për kontrollin teknik të automjeteve.

Tregu i Kosovës është një treg relativisht i vogël dhe përqendrimet e aktiviteteve tregtare në duar të pak lojtarëve ndodhin më lehtë se në tregjet e mëdha. Por, inkurajoj këtë komision që në raportin e ardhshëm të punës për vitin 2010 të ketë edhe më shumë kontroll të veprimtarive të ndërmarrjeve duke mbikëqyrur marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve që kufizojnë konkurrencën dhe duke mbikëqyrë abuzimet e mundshme të ndërmarrjeve që zotërojnë një pozitë dominuese në treg. Një kontroll i tillë i strukturës arrihet me anë të kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve. Në këtë mënyrë pengohet krijimi i një strukture tregu që mund

të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve si dhe krijimin e një pozite dominuese e cila mund të çojë në rritjen e çmimeve në treg. Në këtë rast do të përmendja bankat sepse normat e interesit janë shumë të larta. Është mirë që ky komision në përpikëri të përcjellë zbatueshmërinë e Ligjit i cili do të mundësonte që të kemi një treg të lirë i cili siguron edhe konsumatorin. Ju faleminderit!

Drejtimitin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zotëri kryetar!

Komisioni kosovar i konkurrencës është një komision relativisht i ri i cili ka filluar punën në muajin mars të vitit 2009, prandaj edhe periudha e raportimit është për 9 muaj. Mendoj se ky komision është shumë i rëndësishëm, konkretisht, puna e këtij komisioni paraqet një punë të rëndësishme, mirëpo ende nuk janë krijuar kushtet e nevojshme për funksionimin e plotë të këtij komisioni, prandaj mbetet në të ardhmen të krijohen kushtet në mënyrë që ky komision të jetë funksional dhe të ushtrojë punën e vet si duhet.

Në mandatin e Komisionit kosovar të konkurrencës është kryesisht parandalimi dhe luftimi i disa dukurive, sikurse janë marrëveshjet antikonkurrese ose krijimi i kartelave të cilat merren me caktimin e çmimit dhe ndarjen e tregjeve, është edhe abuzimi me pozitën dominuese ose krijimi i monopolizimit si dhe bashkimet antikonkurrese. Mirëpo, gjatë punës së këtij komisioni, ky komision është ballafaquar edhe me disa probleme që e kanë penguar funksionimin e saj. Konkretisht mungesa e ambientit të punës si ceket edhe në raport është problem i madh dhe mbetet edhe krijimi i kapaciteteve njerëzore që do të jenë të afta për të zbuluar, hetuar dhe eliminuar sjelljen antikonkurrese të pjesëmarrësve në treg. Gjatë periudhës për të cilën raporton Komisioni i konkurrencës, ky komision ka bërë hetimin e disa rasteve të dyshuara për kufizime të konkurrencës dhe i ka përfunduar me sukses. U përmendën këtu edhe nga parafolësit, rasti i hetimit të shoqatave të furrtarëve për marrëveshjen e caktimit të çmimit të bukës, pastaj ai i marrëveshjes midis kompanive të sigurimit, si dhe rasti që kishte të bëjë me vendimin në lidhje me udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit për kontrollin teknik të automjeteve. Mirëpo, rasti tjetër, për të cilin dyshohet ekzistimi i marrëveshjes së përbashkët në mes të bankave për kushtet e operimit në tregun e Kosovës paraqet një shqetësim për të gjithë qytetarët e Kosovës, që i shfrytëzojnë kreditë bankare, posaçërisht pronarët e bizneseve që financojnë veprimtaritë e tyre përmes kredive bankare. Ky komision ka nisur hetimin ndaj bankave private, kundër marrëveshjeve të kontrollit të përbashkët, për shkak të së cilës marrëveshje kamatat e larta të kredive nuk mund të zbriten. Andaj do të ishte shumë e dobishme që Komisioni të dalë me një konstatim dhe në rast se vërteton që një marrëveshje e tillë ekziston të ndërmarrë masa sa më parë, pasi që dihet se kamatat e larta për kredi pengojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Unë përkrah raportin, por kërkoj që këtij komisioni t'i krijohen kushtet për punë, por edhe ky institucion të ushtrojë ndikimin e vetë të plotë në të gjitha sektorët, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe një herë po kërkoj nga shefat e grupeve që t'i thërrasin deputetët e tyre që të votojnë për pikat e caktuara të rendit të ditës, për çka duhet të jenë prezentë 80 deputet. Kjo është një dhe e dyta, kisha kërkuar që vërtet të kurseheni se jemi duke diskutuar për raportin e punës së Komisionit dhe duhet ta bëjmë një praktikë të flasim për

raportin e jo pastaj të dalim krejt jashtë raportit, sepse raporti na ka ardhur për miratim nga dy komisione.

Fjalën po ia jap diskutuesit të fundit, deputetit Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni i konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Kosovës duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese. Ky komision është njëri nga komisionet më të rëndësishme të pavarura, por që është lënë pa trajtimin e duhur institucional.

Komisioni i konkurrencës që nga themelimi ka hasur në probleme të mëdha, sidomos me vendosjen e mjedisit të papërshtatshëm të punës. Për mungesë të mjediseve të punës Këshilli i Komisionit, dy-tre muajt e parë ka funksionuar vetëm nëpër kafene të kryeqytetit. Pastaj është vendosur edhe në disa kthina në objektin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe duke pasur parasysh se as këtu nuk kishte kushte elementare të punës dhe vendosja në objektin e Ministrisë paraqiste konflikt institucional interesi, komisioni pas 7-8 muajve u shpërngul dhe u vendos në mjediset e objektit të Kuvendit të Kosovës ku gjendet edhe sot.

Komisioni i konkurrencës edhe sot nuk ka kushte elementare të punës. Me vetëm 2 zyre, me gjithsej 35 m² punojnë 11 persona prej të cilëve 5 janë komisionarë të zgjedhur nga Kuvendi, prandaj i takon Kuvendit të Kosovës si themelues t'i gjejë lokale të përshtatshme dhe t'i krijojë kushte të punës këtij komisioni të pavarur, ashtu sikur që i kanë komisionet apo agjencitë tjera të pavarura të Kosovës.

Kam vërejtje në emërtimin e këtij komisioni. Emërtimi i drejtë duhet të jetë: Komisioni i konkurrencës i Kosovës e jo Komisioni kosovar i konkurrencës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për hir edhe tuajin, edhe të opinionit Parlamenti nuk e ka asnjë obligim t'i sigurojë asnjë agjencioni apo komisioni hapësirë fizike të punës. Ajo është e drejtë dhe obligim ekskluziv i Qeverisë së Kosovës. Prandaj, mos e ngatërmoni Kuvendin. Kuvendi nuk ka obligim, edhe një herë po them, t'i gjejë hapësirë asnjë agjencioni të pavarur që e zgjedh. Çështja e hapësirës është e Qeverisë.

Në sallë kemi 65 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe e votojmë Raportin e punës së Komisionit të Konkurrencës për vitin 2009. Votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 5 “kundër”, 8 abstenime – Kuvendi miraton Raportin e punës së Komisionit të Konkurrencës për vitin 2009.

Pika e radhës është:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media**

Edhe një ndërhyrje do ta bëj. Edhe një herë po i ftoj shëfat e grupeve parlamentare që t'i ftojnë deputetët të jenë prezent në sallë. Ose, ftoj deputetët që kartelat e deputetëve që nuk janë prezentë t'i heqin nga aparatet, për faktin se ne këtu kemi 81 – 82 deputetë dhe në fakt ata nuk janë prezent. Hiqni kartelat dhe të mos vendosen kartelat pa prezencën e deputetëve në sallë.

Jo, sepse do të ishte mirë ta bëjmë një kulturë, deputeti sa herë të dalë nga salla le ta marrë me veti kartelën, sepse pastaj po kemi prezantim jo real të prezencës së deputetëve në seancë. Të vazhdojmë.

Komisioni parlamentar ad-hoc, në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim ka shqyrtuar listën e kandidatëve të nominuar nga Komisioni i Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim emrat e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc Hajredin Hyseni që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë Raportin me rekomandime.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në mbështetje të Rregullës 46 dhe 52 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës si dhe nenit 4.4 dhe 5.2 c/ të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, komisioni ad-hoc i Parlamentit të Kosovës, në mbledhjet e mbajtura më 7 dhe 12 maj 2010 ka shqyrtuar listën e nominimeve të Komisionit të Pavarur për Media për përzgjedhjen e dy anëtarëve nga shoqëria civile dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës këta dy emra:

1. Daut Demaku, i cili ka marrë numrin më të madh të votave 13, dhe
2. Venera Hajrullahu, 10 vota, për emërimin e tyre në Këshillin e

Pavarur për Media.

Pra, kështu Kuvendi i Kosovës plotëson obligimet ligjore që i ka ndaj Komisionit të Pavarur për Media, duke i përzgjedhur, emëruar këta dy anëtarë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në vazhdim kërkohet të marrin fjalën në emër të grupeve. Mendoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e kreu këtë. Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryetar!

Vetë fakti që kryetari i Komisionit dhe Komisioni i ka votuar këta, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë rekomandim, gjegjësisht këto dy propozime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i AAK-ës e mbështet propozimin e Komisionit dhe fton deputetët që ta miratojnë propozimin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Në emër të AKR-ës fjalën e ka kërkuar deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar! Sigurisht se edhe Grupi Parlamentar i AKR-ës mbështet këta dy emra që kanë ardhur për Komisionin e Pavarur për Media, por do të kisha thënë me këtë rast vetëm edhe një gjë. Përkujtoj se anëtari i shtatë i Komisionit të Pavarur për Media mungon tash dy vjet e sa dhe ndoshta iniciativa e grupeve parlamentare për ta sjellë nga një emër te Komisioni do të ishte gjë e qëlluar për t'u kompletuar Këshilli. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë unë po kërkoj nga kryetarët e grupeve parlamentare që në seancën e radhës ta sjellin propozimin për kandidatin e theksuar.
Në emër të LDD-së fjalën e ka kërkuar deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zotëri kryetar!
Grupi parlamentar i LDD-së mbështet propozimi ne Komisionit ad-hoc për emërimin e të dy anëtarëve për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe do të votojmë për. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+ deputeti Zylfi Merxha e ka kërkuar fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit i nderuar kryetar i Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi! Ju përsëritesha juve dhe stafin tuaj, se tjetër s'kam, s'po shoh askënd, stafin po. Ne Grupi 7+ e përkrahim këtë propozim për të dy kandidatët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS? Nuk ka! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Deputeti Numan Baliq e ka fjalën.

NUMAN BALIQ: Faleminderit zotëri kryetar i Kuvendit!
Mi čemo takođe kao Parlamentarna grupa za integraciju podržati ova dva prijedloga i istaći značaj s obzirom da sam učestvovao tamo i kao član ove komisije o izboru ova dva člana Nezavisne komisije za medije i smatramo da je veoma važno da se obavi dopuna sa ova dva člana Nezavisne komisije za medije i da naravno to bude novi podsticaj za Nezavisnu komisiju za medije da obavlja profesionalno svoj posao s obzirom da su nam medije svima nama veoma važne na Kosovu. Hvala vam lepo!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se Kuvendi emëroi Daut Demakun dhe Venera Hajrullahun, anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media me mandat dyvjeçar. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës:

- Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

(Reagim nga deputetët)

Këtë e keni kryer! Mirë. Kjo ishte vetëm për njoftim.

Tani e kemi pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës dhe pikën e katërt që na duhen për të dy pikat mbi 80 deputetë për të votuar. Në sallë kemi 76 deputetë, apo 77.

(Reagim)

Atëherë, po e lëmë për orën 14:00 dhe po ju njoftoj se prej orës 14:00 do të votohet për këto dy pika. Njëkohësisht do të konstatohet edhe prezenca e deputetëve në seancë.

(Seanca vazhdoi punën në orën 14:00)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën! Do të thotë, tash i kemi dy pika të rendit të ditës që janë debatuar e do ta kemi vetëm votimin. E kemi pikën e katërt:

4. Harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Kuvendit

Kjo është diskutuar dhe mendoj se dihet për çka është. Dhe, tash lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

A ka që votojnë pa kartela? 1, 2, 3, 4 – janë “për”. Faleminderit! Pra, më 34 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim miratohet harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Kuvendit.

Tani vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës:

16. Ratifikimi i marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër.

Edhe për këtë keni debatuar dhe sot e kemi vetëm procedurën e votimit. Edhe për këtë na duhen 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit, pra, po shkojmë me procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Gani Koci e ka fjalën.

(Reagim)

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar! Unë dola vetëm t’ju them se ndoshta në seancën e kaluar u shtrua çështja që s’e kanë pasur materialin në duar e tash e kanë atë lidhur me Marrëveshjen ndërkombëtare që ka të bëjë me donacione dhe me kredi e që iu kanë akorduar Republikës së Kosovës.

Unë pra dola vetëm të them një fjalë, me mos votimin për këtë marrëveshje opozita ose të gjithë ata që nuk e kanë votuar e kanë humbur të drejtën që nesër të thonë pse Kosova nuk po i thith donacionet që i janë premtuar Republikës së Kosovës në ato konferencat e famshme ndërkombëtare. Prandaj, le ta dinë qytetarët e Kosovës se kush nuk po do t’i thithë donacionet që janë për zhvillimin ekonomik dhe social të Republikës së Kosovës. Këtë desha ta them, sepse rezultati i votave doli që nuk është miratuar dhe nuk është ratifikuar. Kuvendi nuk e ka të drejtën e ndryshimit të marrëveshjeve të tilla. E ka vetëm të drejtën e ratifikimit të tyre, prandaj po them edhe një herë, ata që s’e kanë votuar le të arsyetohen para qytetarëve të Kosovës pse Kosova nuk mund t’i thithë donacionet e akorduara.

KRYETARI: Faleminderit!

(Reagime)

Pa kartela, a ka “për”? Nuk ka! Atëherë unë e jap rezultatin e votimit. Me 68 vota “për”, 15 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi ose nuk e ratifikoi Marrëveshjen e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me shoqatat ndërkombëtare për zhvillim për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e

pasurisë së patundshme dhe kadastër. Jo, s'është miratuar! Jo, debatin e keni bërë më herët. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës